

**RESPEKTIMI I TË DREJTAVE THEMELORE NË
BASHKIMIN EUROPIAN PAS HYRJES NË FUQI TË
TRAKTATIT TË LISBONËS.
ÇËSHTJA E ADERIMIT TË BE-SË NË KEDNJ.**

Doktoranti:

VALBONA SANXHAKTARI

Dorëzuar:

Universitetit Europian të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës, në Fakultetin
Juridik, në Departamentin e të Drejtës Publike, në drejtimin e Drejtë
Ndërkombëtare dhe Europiane, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”.

Udhëheqës shkencor:

Prof.Asoc. Dr. ERJONA BANA (CANAJ)

Numri i fjalëve: 59 996

Tiranë, Maj 2015

©Copyright E drejta e autorit: Valbona Sanxhaktari 2015.

Përmbajtja e këtij punimi është totalisht autentike. Të gjithë të drejtat janë të rezervuara.

ABSTRAKTI

Njohja dhe mbrojtja e të drejtave themelore të njeriut është kthyer, së fundmi, në një tematikë kyçe në Bashkimin Evropian. Kjo problematikë ka sjellë domosdoshmërinë e ndryshimit të qëndrimit të GJED-së si dhe amendime të Traktateve të BE-së. Qëllimi i këtij punimi është të përçojë një përshkrim të hollësishëm se si realizohet mbrojtja e të drejtave të njeriut para dhe pas aderimit të BE-së në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Punimi do të trajtojë marrëdhëniet ndërmjet GJED-së dhe GJEDNJ-së nën këndvështrimin e draftmarrëveshjes së aderimit të BE-së në KEDNJ dhe raportit ndërmjet dy instrumenteve kyesore për të drejtat e njeriut në Evropë, pra Kartës dhe Konventës. Punimi fillimisht fokusohet në njohjen dhe evoluimin e mbrojtjes të të drejtave themelore të njeriut në Bashkimin Evropian, qëndrimin që ka mbajtur Gjykata e Drejtësisë në lidhje me to dhe qasjen, në vazhdimësi, të jurisprudencës së saj. Kjo analizë kalon nga heshtja fillestare e Traktateve të BE-së deri në krijimin e një katalogu të veçantë për të drejtat themelore për Bashkimin (Karta) si dhe aderimin e Bashkimit në KEDNJ.

Më tej në punim trajtohet situata aktuale e të drejtave të njeriut në BE, zhvillimet politike dhe institucionale në çështje si përfshirja e të drejtave të njeriut në kornizën e traktatit të Lisbonës, roli i agjencisë të të drejtave themelore në BE dhe politikat evropiane, me fokus të drejtat e njeriut. Në punimin tim doktoral theksi vihet mbi rëndësinë e aderimit të BE-së në KEDNJ, i cili do të përbënte një zhvillim të rëndësishëm në mbrojtjen, në mënyrë koherente, të të drejtave themelore në Evropë. Diskutimi për aderimin e BE-së në KEDNJ ka filluar në fund të viteve '70 dhe ende ai nuk ka përfunduar, pasi shtetet kanë qenë skeptike për pasojat e tij. Në këtë pjesë do t'i jepet përgjigje pyetjeve se cilat janë efektet ligjore më thelbësore të draftmarrëveshjes së aderimit, të cilat kanë qenë objekt diskutimi nga palët, a ka ezauruar draftmarrëveshja çështjet e mundshme problematike që mund të dalin pas aderimit të BE-së në KEDNJ.

Në përfundim të punimit trajtohet edhe e drejta për jetë private/familjare si rast studimor. Analiza fokusohet në kuptimin e përgjithshëm të së drejtës për respektimin e jetës private/familjare, bazën ligjore që përdor, respektivisht, GJED-ja dhe GJEDNJ-ja në rastin e shkeljes të së drejtës për jetë private/familjare si dhe mënyrën e veprimit të gjykatës përballë një rasti konkret.

Fjalët kyçe: të drejta themelore, BE, politikat evropiane për të drejtat e njeriut. Karta, KEDNJ, marrëveshjet e aderimit të BE-së në KEDNJ, pasojat juridike.

ABSTRAKT

Fundamental human right recognition and protection is nowadays one of the key topics in the European Union countries. This problem has led to the necessity of changing the attitude of the ECJ as well as the amendments of the EU Treaties. The purpose of this study is to describe in detail how human rights protection is achieved before and after EU adherence to the European Convention on Human Rights. The thesis will also describe the relationship between the ECJ and ECHR draft agreement from the perspective of the adherence of the EU to the ECHR and the relationship between the two crucial instruments of human rights in Europe, which are the Charter and the Convention. The thesis initially focuses on the evolution of knowledge and protection of fundamental human rights in the European Union, the position that the Court of Justice held regarding to these issues and its jurisprudence. This analysis starts from the EU Treaties explanation and continue with the creation of a special catalog of the fundamental rights of the Union (the Charter) and the Union adherence to the ECHR. Furthermore, in the study is addressed the current situation of human rights in the EU, political and institutional developments, issues such as the involvement of human rights in the framework of the Lisbon Treaty, the role of the agency for fundamental rights in the EU and European policies, with focus on the human rights.

My doctoral thesis emphasis the importance of EU adherence to the ECHR, which would represent an important development in the protection, in a coherent way, of the fundamental rights in Europe. Discussion of EU adherence to the ECHR has started in the late `70s ant it has not been concluded yet, because the countries have been skeptical about its consequences. In this section will be given answers to questions such as: which are the most essential legal effects of draft agreement adherence which have been the subject of discussion by the parties. In addition here will be given answers for: has the draft agreement foreseen the different possible problematic issues that may arise after adherence of EU to ECHR. In the last paragraphs of this doctoral thesis is treated in the form of a case study the issue of the human right, private life/family right. The analysis focuses on human right respect, the right for private life/family, the legal basis used, the ECtHR and the ECHR in the case of violation of the right to private life/family as well as the attitude of the court in front of a specific case.

Keywords: fundamental rights, EU, European policy on human rights. Charter, the ECHR, the adherence treaties of the EU to the ECHR, the legal (juridical) consequences.

DEDIKIM

Ky punim i dedikohet familjes sime

dhe, në mënyrë të veçantë,

prindërve!

FALËNDERIM

Me rastin e përfundimit të punimit doktoral, kam kënaqësinë të falënderoj të gjithë ata që më kanë mbështetur, më kanë ndihmuar me të dhëna dhe më kanë udhëzuar për realizimin e punimit, pasi nëpërmjet tij kam mundur të njoh standardet më të mira evropiane dhe ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut dhe, në mënyrë të veçantë, rendin juridik evropian dhe atë të Këshillit të Evropës lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut.

Falënderoj, gjithashtu, profesorët e Universitetit Evropian të Tiranës. Sugjerimet e tyre i kam pasur si orientime referimi për punimin e temës dhe baza mbi të cilën është ndërtuar ky punim dhe është realizuar kjo analizë. Dëshiroj të falënderoj Prof. Dr. Ksenofon Krisafin, Prof. Dr. Romeo Gurakuqin dhe Prof. Dr. Xhezair Zaganjorin për kohën që më kanë kushtuar dhe për ndihmën e dhënë përmes këshillave të tyre. Pa vërejtjet dhe sugjerimet e tyre, teza nuk do të ishte e nivelit të duhur.

Gjithashtu, dua të falënderoj, veçanërisht, udhëheqësin tim shkencor, Prof.Asoc. Dr. Erjona Bana (Canaj), për ndihmën e madhe që më ka dhënë përmes sugjerimeve dhe vërejtjeve, për vëmendjen që më ka kushtuar dhe për korrektësinë që ka treguar gjatë studimeve të Doktoratës, e veçanërisht gjatë punimit të kësaj teze, duke qenë një mbështetje e madhe për mua. Ajo ka qenë prezente në të gjitha fazat e punimit dhe në ditët doktorale të zhvilluara. Si udhëheqës shkencor, Prof.Asoc. Dr. Erjona Bana, më ka ndihmuar vazhdimisht për të kaluar vështirësitë që kam hasur, duke më inkurajuar që të mos tërhiqem para vështirësive të aspektit teorik apo praktik. Pas takimeve të shpeshta me të, jam ndier gjithmonë e frymëzuar, duke u kthyer për të punuar me dëshirë punimin tim.

Dhe së fundi por jo nga rëndësia, një falënderim tepër të ngrohtë shpreh për Familjen time, për kurajën dhe mbështetjen që më kanë ofruar në rrugën e gjatë të arsimimit tim. Kjo tezë ishte një sfidë dhe nuk mund të ndodhte pa sakrifica. Nuk do të mund ta përfundoja këtë punë pa mbështetjen e Familjes sime. Do t'u jem gjithmonë mirënjohës Prindërve të mi, për kultivimin e dëshirës për të arritur qëllimet e mia dhe të angazhohem për të përfunduar atë që kam filluar. Falenderim i veçantë për motrën time për përkrahjen në çdo drejtim. Dua ta falënderoj edhe vajzën time Martinën. Faleminderit Marti, që me prezencën tënde dhe humorin e mirë, më dhe një frymëzim më shumë për të mbaruar këtë punim.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

RESPEKTIMI I TË DREJTAVE THEMELORE NË BE PAS HYRJES NË FUQI TË TRAKTATIT TË LISBONËS. ÇËSHTJA E ADERIMIT TË BE-së NË KEDNJ

PJESA E PARË

KAPITULLI I

1. Hyrje.....fq. 1
2. Pyetje dhe hipoteza.....fq. 4
3. Metodologjia e kërkimit.....fq. 6
4. Rëndësia e punimit.....fq. 7
5. Qëllimi i punimit.....fq. 8

KAPITULLI II

Krijimi dhe evoluimi i të drejtave të njeriut në BE.

1. Evoluimi i mbrojtjes të të drejtave të njeriut në Bashkimin Evropian.....fq. 9
2. Roli i rëndësishëm i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore në BE.....fq. 15
3. Parimet e përgjithshme të së drejtës së BE-së dhe zhvillimi i tyre në kohë.....fq. 19
4. Traditat e përbashkëta kushtetuese të shteteve anëtare.....fq. 27
5. KEDNJ-ja si burim i rëndësishëm së veçantë për të drejtën e BE-së.....fq. 33
6. Instrumente të tjera juridike ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që veprojnë në BE.....fq. 36
7. Karta e të Drejtave Themelore në Bashkimin Evropian.....fq. 40
- 7.1. Përmbajtja e Kartës.....fq. 42

- 7.2. Standardi i ri i mbrojtjes që krijon Karta në Bashkimin Evropian dhe referencat e Gjykatës.....fq. 46
- 7.3. Interpretimi i Kartës. Analizë e neneve 51- 54, të saj.....fq. 50
- 7.4. Statusi aktual i Kartës.....fq. 56

KAPITULLI III

Veprimtaria e BE-së lidhur me të drejtat e njeriut. Kundërshtimi i akteve ligjore dhe akteve administrative.

- 1. Veprimtaria e BE-së dhe roli i institucioneve lidhur me të drejtat e njeriut..fq. 62
- 2. Kundërshtimi i legjislacionit të BE-së..... fq. 65
 - 2.1. Kundërshtimi i akteve administrative të BE-së.....fq. 72
 - 2.2. Çështjet që kanë të bëjnë me personelin.....fq. 73
 - 2.3. Procedurat e konkurrencës.....fq. 73

KAPITULLI IV

Kundërshtimi ndaj veprimeve të shtetit anëtar lidhur me të drejtat themelore.

- 1. Kundërshtimi ndaj veprimeve të shtetit anëtar lidhur me të drejtat Themelore.fq. 77
- 2. Orientimi i GJED-së lidhur me zbatimin e dispozitave të legjislacionit të BE-së bazuar në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.....fq. 79
- 3. Shtetet anëtare si “faktorë” të BE-së.....fq. 80
- 4. Shmangia e masave të së drejtës komunitare nga shtetet anëtare.....fq. 81
- 5. Shtetet anëtare dhe situatat jashtë sferës të së drejtës së Bashkimit Evropian fq.88

PJESA E DYTË

KAPITULLI V

Situata aktuale e të drejtave të njeriut në BE. Zhvillimet politike dhe institucionale.

1. Zhvillimet e fundit politike dhe institucionale të të drejtave të njeriut.....fq. 89
2. Roli i agjencisë të të drejtave themelore në BE.....fq. 92
3. Politika evropiane me fokus të drejtat e njeriut.....fq. 93

PJESA E TRETË

KAPITULLI VI

Aderimi i mundshëm i Bashkimit Evropian në KEDNJ.

1. Rreth aderimit të mundshëm të BE-së në KEDNJ.....fq. 99
2. Pasojat e aderimit në lidhje me të drejtat themelore.....fq.101
3. Rishikimi i akteve të GJED-së nga GJEDNJ-ja dhe influenca reciproke ndërmjet dy gjykatave, përpara aderimit.....fq.102
4. Draftmarrëveshja e aderimit të BE-së në KEDNJ.....fq.107
 - 4.1. Çështje të përgjithshme.....fq.107
 - 4.2. Çështje institucionale.....fq.108
 - 4.3. Çështje juridiksionale.....fq.109
5. Problemet e mundshme pas aderimit.....fq.119

KAPITULLI VII

Rast studimor.

Mbrojtja e të drejtës për jetë familjare sipas GJEDNJ-së dhe sipas GJED-së.

1. Kuptimi i së drejtës për jetë familjare sipas GJEDN-së.....fq.133

2.	Standardet e vendosura nga GJEDNJ-ja mbi shtrirjen e “jetës familjare”..	fq.134
2.1.	Familja e bazuar në marrëdhënie martesore.....	fq.141
2.2.	Bashkëjetesa.....	fq.144
2.3.	Jeta familjare dhe mungesa e lidhjeve të gjakut.....	fq.148
2.4.	Mbrojtje e posaçme e fëmijëve dhe Konventa e Hagës mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve.....	fq.150
2.5.	Kur mbaron jeta familjare?.....	fq.163
3.	E drejta për jetë familjare sipas GJED-së.....	fq.163

KAPITULLI VIII

KONKLUSIONE	fq.169
--------------------------	--------

BIBLIOGRAFIA	fq.189
---------------------------	--------

LISTA E SHKURTIMEVE

Në këtë punim janë përdorur shkurtime të mëposhtme:

❖	AUE	Akti Unik Evropian
❖	BE	Bashkimi Evropian
❖	FZKE	Fletorja Zyrtare e Komuniteteve Evropiane
❖	GJED	Gjykata Evropiane e Drejtësisë
❖	GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
❖	KARTA	Karta për të Drejtat Themelore të Njeriut
❖	KEE	Komuniteti Ekonomik Evropian
❖	KEDNJ	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
❖	PE	Parlamenti Evropian
❖	PVGJE	Përmbledhje e vendimeve të Gjykatës Evropiane
❖	KE	Këshilli i Evropës
❖	SIS	Sistemi Informativ Shengen
❖	TBE	Traktati i Bashkimit Evropian
❖	TFBE	Traktati për funksionimin e Bashkimit Evropian
❖	TKEE	Traktati i Komunitetit Ekonomik Evropian
❖	Tr.A	Traktati i Amsterdami
❖	Tr.L	Traktati i Lisbonës

Kapitulli I: Hyrje

Të drejtat e njeriut janë të drejta dhe liri themelore pa të cilat njerëzit nuk mund të jetojnë si qenie njerëzore me dinjitet. Ato përbëjnë bazën e lirisë, drejtësisë e paqes dhe respektimi i tyre mundëson progresin e plotë të individit dhe shoqërisë¹. Të gjithë personat janë të pajisur me të drejta të tilla thjesht për arsyen se janë qenie njerëzore (Feldman, 2002: 51).

Të drejtat e njeriut janë konsideruar si:

- a) themeli i respektimit për dinjitetin dhe mirëqenien e çdo inividi;
- b) universale, pasi ato janë njëlloj të aplikueshme pa diskriminim ndaj të gjithë individëve;
- c) të pashkelshme, pasi askujt nuk mund t'i cenohen të drejtat dhe liritë tej limiteve të venosura;
- d) të pandashme, të ndërlidhura e të pavarura, në kuptimin që të gjithë personat kanë të njëjtën rëndësi dhe të drejtat janë njësoj esenciale për respektimin e dinjitetin e çdo personi.

Ligji ndërkombëtar detyron shtetet të sigurojnë zbatimin e të drejtave të njeriut duke shqyrtuar veprimet e shteteve kur dhunojnë këto të drejta². Pas Luftës së Dytë Botërore, u krijua organizata e OKB-së, e cila në mënyrë të vazhdueshme ka nxjerrë traktate, konventa e pakte për mbrojtjen e të drejtave themelore. Organizata të ndryshme ndërkombëtare janë themeluar për këtë qëllim edhe në Evropë. Me rëndësi të veçantë në fushën e mbrojtjes të së drejtave të njeriut është Këshilli i Evropës, që me instrumentet e tij ligjore dhe institucionale është një organizatë shembull në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ) dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) janë dy instrumentet kryesor,

¹ Në hyrjen e Kartës së OKB- së; Preambula e DUDNJ; Preambula e Paktit Ndërkombtar i të Drejtave Civile dhe Politike; Paktit Ndërkombtar i të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.

² Komentarit mbi Përgjegjësinë e Shteteve për Aktet e Paligjshme, 2001, vol. II, pjesa e dytë, neni 40.

me anë të të cilëve realizohet mbrojtje efektive e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Shtetet anëtare të BE-së janë frymëzuar nga instrumentet ndërkombëtare universale në këtë fushë, duke synuar ta realizojnë këtë mbrojtje edhe brenda BE-së. Në këtë kuadër është për t'u theksuar fakti që të gjitha shtetet anëtare të BE-së janë njëkohësisht edhe shtete anëtare në Këshillin e Evropës dhe OKB.

Fillimisht e drejta e Komunitetit Evropian përbëhej nga tërësia e normave për krijimin dhe funksionimin e tri komuniteteve. Traktati për themelimin e Komunitetit të Qymyrit e Çelikut u nënshkrua nga vetëm gjashtë shtete, me afat funksionimi për dhjetë vjet (me të drejtë përsëritje). Në vitin 1957 u firmosën në Romë traktatet themeluese të Komunitetit Ekonomik Evropian dhe Euroatomit. E drejta e Bashkimit Evropian (jo Komunitetit Evropian) rrjedh nga krijimi i BE-së me Traktatin e Bashkimit Evropian, i cili hyri në fuqi në vitin 1993. Etapat më të rëndësishme të ecurisë së BE-së janë përcaktuar nga një sër traktatesh, konkretisht Traktati i Amsterdimit në 1965 (*Traktati mbi bashkimin e ekzekutivëve*), Traktati i Luksenburgut në 1970, Akti Unik Evropian në 1986, Traktati mbi Bashkimin Evropian, Traktati i Amsterdimit në 1997, Traktati i Nisës në 2003 dhe Traktati i Lisbonës në 2007.

Bashkimi Evropian, duke qënë pjesë e një integrimi të vazhdueshëm, institucionet e BE-së dhe qeveritë e vendeve anëtare, duke filluar nga pranvera e vitit 2000, nisën debatin e madh për të ardhmen evropiane. Ky debat i organizuar është zhvilluar në tri etapa: e para, nga marsi deri në dhjetor 2000, në funksion të Konferencës Ndërqeveritare dhe Këshillit Evropian të Nisës; e dyta për të përcaktuar funksionet dhe detyrat e Konventës që të miratohej në Këshillin Evropian në Laken, në dhjetor 2001; dhe e treta pas marsit 2002, që është përqendruar më tepër në thelbin e përmbajtjes së dokumentit, që Konventa do t'i paraqesë Konferencës Ndërqeveritare në bashkëpunim me Këshillin Evropian, para qershorit 2004 (Milo, 2002). Në kuadrin e Bashkimit Evropian një instrument i rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave themelore është edhe Karta mbi të

Drejtat Themelore, e vitit 2000. Ajo u formësua në etapën e parë të këtij debati dhe hyri në fuqi pasi është ratifikuar nga të gjitha Shtetet Anëtare, në vitin 2009.

Ndyshimet në traktatet themeluese janë paraprirë nga qasja e GJED-së në mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut. Ajo ka luajtur një rol mjaft aktiv në përcaktimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës së KE-së dhe BE-së, për të mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore të individit. Megjithatë, është për tu evidentuar fakti që ndërmjet qëndrimit të GJEDNJ-së dhe GJED-së ka pasur mungesë koherence përsa i përket mbrojtjes të së drejtave themelore. Madje dhe jo në pak raste ato kanë qënë në kontraditë me njera tjetrën.

Kjo situatë ka sjellë që në disa raste shtetet anëtare të BE-së të mbajnë përgjegjësi për veprimet që ato kanë kryer në kuadër të detyrimeve brenda Bashkimit Evropian, ndërsa në disa raste të tjera ku përgjegjësi ka pasur vetëm BE-ja (*rasti Connolly*) aplikimi është deklaruar i papranueshëm. Aderimi i BE-së në KEDNJ mendohet të mbyllë boshllëkun që ekziston në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, kur përgjegjës për shkeljen është vetë Bashkimi dhe do të sigurojë që qëndrimi i të dyja gjykatave të jetë në koherencë. Në rastet kur GJED-ja do të devijonte nga qëndrimi i mbajtur nga GJEDNJ-ja, atëherë kërkuesi ka mundësinë t'i drejtohet kësaj të fundit për realizimin e të drejtës së tij.

Pyetje dhe hipoteza

Zhvillimet e ndryshme institucionale dhe politike në fushën e të drejtave të njeriut nuk e kanë mbyllur debatin nëse BE-ja është një organizatë e rëndësishme për të drejtat e njeriut. Kritika ka pasur rreth faktit nëse vëmendja e BE-së për mbrojtjen e të drejtave të njeriut është më shumë retorikë, ose instrumentalizëm vetëshërbyes. Në fushat e migrimit, azilit dhe drejtësisë penale në veçanti, BE-ja është kritikuar për neglizhimin dhe dëmtimin e çështjeve për të drejtat e njeriut.

Hipoteza:

Bashkimi Evropian në këtë fazë ka nevojë të rimendojë përsëri politikat e tij lidhur me të drejtat e njeriut, nëse nuk dëshiron të humbasë influencën në një mjedis politik ndërkombëtar në ndryshim. Duhet të mos humbasë kohë, por të aderojë sa më shpejt në KEDNJ dhe të krijojë një standard të ri në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore. Edhe pse mund të mbarten shumë problematika zgjidhja e tyre duhet parë me pozitivizëm dhe jo raporte epërsie dhe hierarkie.

Pyetjet që do të shtrohen në këtë studim dhe të cilave do t'u jepet një shpjegim në faqet e mëposhtme, janë:

- i.* A janë shtuar kompetencat e Bashkimit në fushën e të drejtave të njeriut dhe nëse Karta krijon një kompetencë të re për Bashkimin në këtë fushë?
- ii.* A është krijuar vërtet një standard i ri i mbrojtjes nga Karta në Bashkimin Evropian apo këto kanë ngelur vetëm të shkruara dhe jo të aplikuara?
- iii.* Aderimi i BE-së në KEDNJ a do të mbyllë boshllëkun që ekziston në mbrojtjen e të drejtave të njeriut kur përgjegjës për shkeljen është vetë Bashkimi?
- iv.* Aktualisht kemi ekzistencën e dy instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, më konkretisht, Kartën e Lirive Themelore dhe Konventën

Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Çfarë raporti kanë këto me njëra-tjetrën dhe cili do të jetë raporti i tyre pas aderimit të BE-së në KEDNJ?

- v. Cili do të jetë raporti ndërmjet dy gjykatave?
- vi. Cilat janë pasojat që do të sjellë aderimi, i cili ka qenë në axhendën e shteteve për më shumë se 30 vjet dhe akoma nuk ka përfunduar? A janë zgjidhur çështjet nga draftmarrëveshja e aderimit dhe kush mund të jenë disa nga problemet e mundshme pas aderimit?
- vii. Cilat janë arsyet reale pse jemi akoma në pritje të aderimit të BE-së në KEDNJ?

Metodologjia e kërkimit

Puna studimore për këtë temë ka kaluar në tri faza të ndryshme, të cilat shkurtimisht po i përshkruaj më poshtë.

Faza e parë: Në këtë fazë jam fokusuar në gjetjen dhe seleksionimin e literaturës juridike kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e të drejtave themelore në Bashkimin Evropian. Në këtë fazë përfshihen dhe kërkimi e seleksionimi i vendimeve gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në portalet përkatëse online. Përkatësisht në faqen e web-it:

<http://hudoc.echr.coe.int> dhe <http://curia.europa.eu>.

Faza e dytë: Gjatë kësaj faze kam analizuar materialet e përzgjedhura. Shqyrtimi i këtyre materialeve ka pasur si qëllim të trajtojë teorikisht mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut brenda kuadrit ligjor të Bashkimit Evropian. Po ashtu, mbrojtja e të drejtave themelore dhe e së drejtës për jetë private është kombinuar edhe me anën praktike, ku janë referuar vendimet përkatëse të GJED-së dhe GJEDNJ-së.

Faza e tretë: është konsideruar dhe si faza përfundimtare, ku pasi janë hedhur të gjitha mendimet dhe konkluzionet e arritura është rishikuar materiali në përputhje edhe me zhvillimet e fundit, megjithëse ato nuk kanë qenë shumë të medha apo progresuese, pasi procesi lidhur me aderimin e mundshëm ka ecur avash. Materiali i punuar është konsultuar me studiues të fushës, gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese dhe me kolegë, lidhur edhe me qëndrimin e tyre ndaj zhvillimeve të fundit të këtyre dy institucioneve në kuadër të një aderimi të mundshëm si dhe pasojave.

Rëndësia e punimit

Ky punim mendohet se ka një rëndësi të veçantë për tematikën që trajton. Kuptohet që të drejtat dhe liritë themelore në Bashkimin Evropian janë të trajtuara nga shumë studiues dhe pikërisht për këtë arsye sfida ka qenë tejet e madhe, por nga ana tjetër statusi i të drejtave të njeriut në sistemin ligjor të BE-së ka ndryshuar thellësisht. Në fillimet e hulumtimeve të mia shpresohej dhe besohej një anëtarësim i shpejtë i Bashkimit Evropian në KEDNJ. Për këtë arsye origjinaliteti dhe rëndësia e këtij punimi kanë një vlerë të veçantë. Aktualisht, situata në Bashkimin Evropian edhe pse ka ndryshuar shumë, paraqitet e tillë që nuk mund të thuhet për një progres të plotë dhe të kënaqshëm lidhur me të drejtat e njeriut. Bashkimi Evropian duke qenë pjesë e një integrimi të vazhdueshëm, institucionet e BE-së dhe qeveritë e vendeve anëtare, duke filluar nga pranvera e vitit 2000, nisën debatin e madh për të ardhmen evropiane. Ky debat i organizuar është zhvilluar në tri etapa: e para, nga marsi deri në dhjetor 2000, në funksion të Konferencës Ndërqeveritare dhe Këshillit Evropian të Nisës; e dyta për të përcaktuar funksionet dhe detyrat e Konventës që të miratohej në Këshillin Evropian në Laken, në dhjetor 2001; dhe e treta pas marsit 2002, që është përqendruar më tepër në thelbin e përmbajtjes së dokumentit, që Konventa do t'i paraqesë Konferencës Ndërqeveritare në bashkëpunim me Këshillin Evropian, para qershorit 2004 (Milo, 2002: 310).

Në kuadrin e Bashkimit Evropian një instrument i rëndësishëm për mbrojtjen e së drejtave themelore është edhe Karta mbi të Drejtat Themelore, e vitit 2000. Ajo u formësua në etapën e parë të këtij debati dhe hyri në fuqi pasi është ratifikuar nga të gjitha Shtetet Anëtare, në vitin 2009. Kjo situatë ka sjellë që në disa raste, shtetet anëtare të BE-së të mbajnë përgjegjësi për veprimet që ato kanë kryer në kuadër të detyrimeve brenda Bashkimit Evropian, ndërsa në disa raste të tjera ku përgjegjësi ka pasur vetëm BE-ja, aplikimi është deklaruar i papranueshëm.

Aderimi i BE-së në KEDNJ do të mbyllë boshllëkun që ekziston në mbrojtjen e të drejtave të njeriut kur përgjegjës për shkeljen është vetë Bashkimi. Për më tepër, aderimi do të sigurojë që qëndrimi i të dyja gjykatave të jetë në koherencë.

Qëllimi i punimit

Nëpërmjet kësaj teme synohet të trajtohet roli dhe rëndësia që kanë marrë në ditët e sotme mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të njeriut në Bashkimin Evropian. Qëllimi kryesor i punimit është hulumtimi shkencor dhe krahasues për të evidentuar dhe analizuar elementet thelbësore të kësaj fushe si dhe problematikat kryesore që hasen në nivel evropian lidhur me garantimin e të drejtave dhe lirive themelore. Qëllimi i këtij punimi është të përçojë një përshkrim të hollësishëm se si realizohet mbrojtja e të drejtave të njeriut para dhe pas aderimit të BE-së në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe në mënyrë të veçantë rolin dhe raportin që ekziston ndërmjet KEDNJ-së dhe Kartës të të Drejtave Themelore në BE e cila së fundi po gjen shprehi dhe aplikim nga ana e të gjitha strukturave dhe hallkave evropiane. Dihet tashmë se të drejtat themelore të njeriut janë shndërruar në një prej çështjeve më kryesore në të drejtën komunitare. Fillimisht traktatet themeluese, as nuk përmbanin ndonjë referencë tek të drejtat e njeriut, nuk detyronin institucionet e Komunitetit t'i respektonin ato gjatë veprimtarisë së tyre. Ndërsa sot problematikat që shtrohen janë të një natyre tjetër, akoma më të rëndësishme dhe interesante.

Në fakt i një rëndësie të veçantë në këtë punim janë sjellja e shumë vendimeve gjyqësore të GJED-së, të cilat kanë zënë vend në historinë e BE-së dhe të cilat në vetvete kanë shkruar rrjedhën e mbrojtjes të të drejtave dhe lirive themelore në Bashkimin Evropian.

Qëllimi i këtij studimi është gjithashtu të evidentoj detyrimet e shteteve anëtare të BE-së në kuadër të dy organizatave ndërkombëtare si Bashkimin Evropian dhe Këshillit të

Evropës, në të cilat ato janë njëkohësisht palë. Detyrimet që kanë shtetet anëtare brenda BE-së dhe mënyra se si ato duhet të veprojnë për të respektuar detyrimet e ndërmarra përsa i përket Konventës (KEDNJ-së). Do të trajtohet raporti që kanë pasur traktatet themeluese me të drejtat e njeriut dhe a ishte e mundur që këto të drejta të realizoheshin efektivisht. *Aktualisht, kemi ekzistencën e dy instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, më konkretisht Kartën e Lirive Themelore dhe Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.*

Kapitulli II: Krijimi dhe evoluimi i të drejtave të njeriut në BE.

1. Evoluimi i mbrojtjes të të drejtave të njeriut në Bashkimin Evropian.

Të drejtat themelore të njeriut janë shndërruar në një prej çështjeve më kryesore në të drejtën komunitare. Fillimisht, Traktatet Themeluese as nuk përmbanin ndonjë referencë tek të drejtat e njeriut, as nuk detyronin institucionet e Komunitetit t'i respektonin ato gjatë veprimtarisë së tyre. Traktatet Themeluese të Komunitetit Evropian të vitit 1957 teknikisht nuk përmbanin asnjë dispozitë në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut³. Në Traktatet Themeluese të Bashkimit Evropian u parashikuan për herë të parë disa të drejta themelore, ndër të cilat mund të përmendim:

- a) liria e qarkullimit të mallrave, personave, shërbimeve dhe kapitaleve;
- b) u ndalua diskriminimi në bazë të kombësisë dhe gjinisë.

Veç të tjerash, këto liri themelore kanë ndihmuar në realizimin e tregut të përbashkët, në qëllimin e shteteve që kishin miratuar Traktatin: në fakt, ky i fundit duhet të ishte rregullimi juridik i një bashkimi ekonomik, në mënyrë që individi të mos mbrohej si person human, por vetëm si protagonist i botës ekonomike në të cilën bashkëveprojnë shtetet, si individ - punëtor, individ - operator ekonomik etj. Ky shpjegim është mbështetur edhe nga fakti që Komuniteti i parë që do të krijohet, KEQÇ-ja, kishte

³ Propozimi për të vazhduar një formulë të tillë, në fakt, edhe në Traktatin e Romës hasi në shumë kundërshtime.

detyra përkatësisht teknike që nuk linin të parashikohej asnjë interferencë me të drejtat themelore, një problematikë që atëherë po zhvillohej në gjirin e Këshillit të Europës. Përkrah çështjeve me natyrë ekonomike, mbrojtja e të drejtave themelore në Traktatet Komunitare gjen një shpjegim edhe në rregullat që ndiqte politika e përgjithshme.

Në kohën e themelimit të KEE-së, shtetet, përveç Francës ishin duke miratuar Konventën Evropiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNj). Kështu, do të ishte e vështirë të arrihej miratimi i Traktatit nëse do të vendoseshin normat lidhur me të drejtat dhe liritë themelore. Veç të tjerash, te disa shtete ekzistonte një ndrojtje për miratimin e Traktatit sepse me përfshirjen e një dokumenti të të drejtave themelore, veprimtaria e organeve të Komunitetit nuk do të kishte më kufizime dhe, në këtë mënyrë, ato do të mbronin jo vetëm interesat ekonomikë por edhe ato politikë. Mungesa e përfshirjes së këtij dokumenti në traktat u balancua në një farë mënyre nga garancia që dhanë shtetet që firmosën për mbrojtjen e këtyre të drejtave me anën e sistemeve kombëtare të tyre.

Mundësia që aktiviteti legjislativ i organeve komunitare mund të shkelë të drejtat themelore lind nga fakti që shtetet anëtare të Komunitetit Evropian, duke miratuar traktatet themeluese të tyre, kanë transferuar disa kompetenca të tyre tek organet komunitare; këto të fundit, në disa fusha, mund të nxjerrin akte që ndikojnë drejtpërdrejt mbi sistemin e shteteve anëtare (si në rastin e normave *self executing*). Kështu, duke munguar, në sistemin komunitar një normë precize, që imponon respektin e të drejtave themelore, dhe duke munguar, veç të tjerash, një listë e të drejtave themelore, qytetarët e shteteve anëtare nuk janë të mbrojtur përballë akteve që mund të shkelin interesat e tyre. Për këtë arsye u mendua që, fillimisht, të drejtat themelore të mbroheshin ende nga shtetet anëtare, derisa të arrihej në një marrëveshje të dytë.

Statusi i të drejtave të njeriut në sistemin ligjor të BE-së ka ndryshuar në mënyrë rrënjësore. Ndërkohë, që sot mendohet se Traktati i Komuniteteve Evropiane duhej ta

kishte bërë Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) pjesë të së drejtës së komuniteteve të reja. Ky Traktat nuk u zbatua asnjëherë, për shkak të refuzimit nga ana e Francës të Traktatit të Mbrojtjes së Komunitetit në vitin 1954. Si pasojë, KEE-ja dhe Traktatet e Euroatomit në 1957-ën u hartuan në mënyrë të kujdesshme dhe lanë pas dore referencat lidhur me të drejtat e njeriut. Gjithsesi, të drejtat e njeriut janë pozicionuar në vendin qendror në sistemin ligjor të BE-së, duke u radhitur ndër dispozitat kryesore të normave të BE-së.⁴

Pavarësisht parimeve të pohuara nga Gjykata e Drejtësisë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, vazhdonte ende të mos kishte gjurmë për mbrojtjen e këtyre të drejtave në traktatet themeluese. Në Aktin Unik Evropian të vitit 1986 çështja ishte përballuar vetëm në hyrje, ku deklarohet vullneti i shteteve që të *“avanconin bashkë demokracinë, bazuar mbi të drejtat themelore të njohura nga Kushtetutat e shteteve anëtare, nga KEDNJ-ja dhe nga Karta Sociale Evropiane”*.

Vetëm me Traktatin e Maastricht-it u aprovua neni “f” (neni aktual 6) që, në paragrafin 2, konfirmon se *“Bashkimi Evropian respekton të drejtat themelore të cilat janë garantuar nga Traktati i Romës në vitin 1950 mbi të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe të traditave kushtetuese të përbashkëta të shteteve anëtare, si parime të përgjithshme të së drejtës komunitare”*. Por, norma shtesë në Traktatin e Maastricht-it nuk ishte e mjaftueshme. Kjo fushë u rishikua edhe në Traktatin e Amsterdimit. Rëndësia e të drejtave themelore në ndërtesën evropiane është forcuar dhe respektimi i tyre garantohet në disa drejtime. Neni i ri “f” i Traktatit të BE-së përmban në paragrafin e parë referimin të *“parimet e lirisë, të demokracisë, të respektit të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, si dhe të shtetit të së drejtës, parime të përbashkëta për shtetet anëtare”*, mbi të cilat është themeluar Bashkimi Evropian. Nga ana tjetër, neni “O”

⁴Çështjet C-402 dhe 415/05 *P Kadi & Al Barakaat International Foundation v Council and Commission*, 2008, I-6351.

sanksionon respektimin e parimit të sipërpërmendur si kusht për të aderuar në Bashkimin Evropian.

Një përforsim i të drejtave themelore haset edhe me ndryshimet që i sjell së fundi Traktati i Lisbonës nenit 6 TBE. Sipas këtij neni:

“1. Bashkimi njeh të drejtat, liritë dhe parimet e sanksionuara në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, të 7 dhjetorit të vitit 2000, të miratuar më 12 dhjetor të vitit 2007, në Strasburg, e cila ka të njëjtën vlerë juridike si dhe traktatet. Dispozitat e Kartës nuk i zgjerojnë në asnjë mënyrë kompetencat e Bashkimit Evropian, të përcaktuara në traktate. Të drejtat, liritë dhe parimet e Kartës interpretohen konform dispozitave të përgjithshme të titullit VII të Kartës, të cilat rregullojnë interpretimin dhe aplikimin e saj, si dhe duke pasur parasysh shpjegimet, të cilave i referohet Karta, që tregojnë burimet e këtyre dispozitave.

2. Bashkimi Evropian anëtarësohet në Konventën Evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Ky anëtarësim nuk ndryshon kompetencat e Bashkimit Evropian të përcaktuara në Traktate.

3. Të drejtat themelore të sanksionuara nga Konventa Evropiane për liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe ato që rezultojnë nga praktikat kushtetuese të përbashkëta të shteteve anëtare janë pjesë e së drejtës së Bashkimit Evropian si parime të përgjithshme.”.

Traktati i Lisbonës, siç e kemi theksuar edhe më parë, e bën Kartën të detyrueshme nëpërmjet modifikimit të nenit 6 dhe nuk e ka bërë pjesë të Traktatit. Korniza kushtetuese e BE-së sot mbart një koleksion mbresëlënës dispozitash për të drejtat e njeriut. Traktatet deklarojnë se BE-ja është themeluar në bazë të të drejtave të njeriut dhe se ato i japin një efekt detyrues Kartës të të Drejtave Themelore të Njeriut dhe parashikojnë aderimin e BE-së në KEDNJ. Traktatet kërkojnë që të gjithë kandidatët, si shtete anëtare që mbështetin këto vlera, të përfshijnë një mekanizëm sanksionues për

shtetet anëtare ekzistuese, të cilat shkelin vazhdimisht dhe seriozisht këto të drejta. Ka një bazë të qartë ligjore në nenin 19 TFBE për një regjim të fortë të BE-së kundërdiskriminues. Pjesa kryesore e kornizës të të drejtave të njeriut është tashmë neni 6 TBE. Këto zhvillime siç janë të rëndësishme janë dhe relativisht aktuale. Për disa vite, pas themelimit, KEE-ja u përqendrua në krijimin e një tregu të përbashkët, megjithëse përpjekjet për të zgjeruar projektin e integritit nuk ishin asnjëherë jashtë axhende (Dausies, 1985: 398, 399; Pescatore, 1981: 295). Por, mbështetja për këtë dhe për ripërfshirjen e qëllimeve më ambicioze dhe vlerave themelore në kornizën ligjore dhe kushtetuese ishte fillimisht e ngadaltë për të zbritur në terren. Deri në vitin 1970 të drejtat e njeriut lidhen me pranimin institucional formal nga Komuniteti Evropian, duke përfshirë GJED-në dhe shtetet anëtare. Zhvillimet më të rëndësishme erdhën në vitet 1990-të me zbatimin e Traktateve të Maastrichtit dhe Amsterdimit dhe me hartimin e Kartës të të Drejtave. Ende, ligjshmëria e rrënjëve të KEE-së në projektet e tregut të përbashkët mbetet e rëndësishme pasi, përveç se ndryshon në mënyrë konstante dhe shpërndahet për nga natyra, fokusi i BE-së mbetet ekonomik dhe debati mbi qëllimin e përshtatshëm të rolit të të drejtave të njeriut mbetet i kundërshtuar edhe pas ndryshimeve të rëndësishme të prezantuara nga Traktati i Lisbonës.

Pra, të paktën tri burime formale për të drejtat e njeriut në BE janë sot të listuara në nenin 6 TBE. E para është *Karta e BE-së për të Drejtat Themelore të Njeriut*, që u shpall në vitin 2000 dhe u ngrit në të njëjtin status ligjor detyrues si Traktatet nga Traktati i Lisbonës në 2009-ën. E dyta është *KEDNJ-ja*, e cila është trajtuar nga GJED-ja si një “burim i veçantë frymëzimi” për parimet e të drejtave të njeriut dhe që do të bëhen formalisht të detyrueshme në BE kur ajo aderon në KEDNJ, duke qenë se neni 6 (2) e përcakton këtë. E treta, ka të bëjë me “*parimet e përgjithshme të së drejtës së BE-së*”, një strukturë parimesh ligjore, duke përfshirë të drejtat e njeriut, artikuluar dhe zhvilluar nga GJED-ja përgjatë viteve, hartuar nga traditat kushtetuese kombëtare,

KEDNJ-ja dhe nga traktate të tjera ndërkombëtare të nënshkruara nga shtetet anëtare. Këto tri burime mbivendosen, pasi shumë dispozita të Kartës së BE-së bazohen në KEDNJ, duke krijuar një sasi të caktuar konfuzioni ligjor. Burime të tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut janë përfshirë rrallë. GJED-ja, së fundi, ka bërë të qartë se e sheh Kartën si “bazën kryesore” në të cilën gjykatat e BE-së garantojnë që të drejtat e njeriut vëzhgohen⁵. Sidoqoftë, Mbretëria e Bashkuar, Polonia dhe Republika Çeke negociuan një protokoll në Traktatin e Lisbonës që synon të kufizojë impaktin e Kartës në këto shtete. Standardet e të drejtave të BE-së janë të detyrueshme për BE-në dhe për institucionet e strukturat në të gjitha aktivitetet dhe në shtetet anëtare kur ato veprojnë brenda qëllimit të së drejtës së BE-së. Pyetjet vazhdojnë të ngrihen rreth fushës së zbatimit të shteteve anëtare “brenda qëllimit të së drejtës së BE-së” për këto qëllime. BE-ja ka integruar gradualisht problemet e të drejtave të njeriut në një tërësi politikash. Politika e brendshme, e orientuar e këtij tipi, është struktura e ligjit kundër diskriminimit, që është shpërndarë në mënyrë domethënëse kohët e fundit, si dhe fusha e zhvillimit të mbrojtjes të të dhënave personale dhe privatësisë. Në marrëdhëniet e jashtme të BE-së, të drejtat e njeriut janë paraqitur më dukshëm⁶. Bashkimi Evropian promovon në mënyrë aktive politikat e “të drejtave të njeriut dhe demokratizimin” në vende të ndryshme të botës dhe përdor dispozitat për të drejtat e njeriut në tregtinë ndërkombëtare dhe në politikat e zhvillimit. Ajo ka vendosur një “politikë kushtëzuese”, bazuar në të drejtat e njeriut, mbi shtetet anëtare candidate dhe pretendon të integrojë të drejtat e njeriut nëpërmjet politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë. Në 2009-ën, BE-ja, për të parën herë, përfundoi një traktat të madh ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Paaftësi, që ka implikime politike të jashtme dhe të brendshme. Përveç zbatimit të Kartës të të Drejtave, ka pasur disa iniciativa institucionale të rëndësishme në fushën e të drejtave të

⁵ Dokumenti i GJED-së mbi aspekte të ndryshme të aderimit të BE-së në KEDNJ, Luksemburg, 5 maj 2010.

⁶ Marrë nga: <http://eas.europa.eu/human rights/index en.htm>.

njeriut, duke përfshirë krijimin në vitin 1999 të një mekanizmi sanksionues për shkelje serioze dhe të vazhdueshme të të drejtave të njeriut në nenin 7 TBE dhe krijimi i një Agjencie të të Drejtave Themelore në BE, në vitin 2007. Zhvillimet e ndryshme institucionale dhe politike në fushën e të drejtave të njeriut nuk e kanë mbyllur debatin nëse BE-ja është një organizatë e rëndësishme për të drejtat e njeriut (Alston dhe Heenan, 1999). Kritika ka pasur rreth faktit nëse vëmendja e BE-së për mbrojtjen e të drejtave të njeriut është më shumë retorikë ose instrumentalizëm vetëshërbyes (Williams 2004). Në fushat e migrimit, azilit dhe drejtësisë penale, në veçanti, BE-ja është kritikuar për neglizhimin dhe dëmtimin e çështjeve për të drejtat e njeriut (Teitgen-Colly 2006). Është sugjeruar se BE-ja ka nevojë të rimendojë politikat e saj për të drejtat e njeriut, nëse nuk dëshiron të humbasë influencën në një mjedis politik ndërkombëtar në ndryshim⁷.

2. Roli i rëndësishëm i GJED-së në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore në BE.

Është e vërtetë se Bashkimi ka në themel vlerat e respektimit të dinjitetit të njeriut, lirisë, demokracisë, barazisë, shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut⁸. Megjithatë, siç u theksua edhe në paragrafin pararendës, traktatet kanë pasur mungesa në njohjen e të drejtave themelore të njeriut. Një rol shumë të rëndësishëm në njohjen dhe zhvillimin e këtyre të drejtave ka luajtur Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GJED). Prurjet e jurisprudencës u konfirmuan më pas edhe nga traktatet. Gjykatës së Drejtësisë i është dashur të mbushë këtë mangësi të traktateve. Ajo ka elaboruar në mënyrë të vazhdueshme mbrojtjen e të drejtave të njeriut, derisa ato gradualisht u njohën në mënyrë të shprehur edhe nga traktatet.

Konflikti për mbrojtjen e të drejtave të njeriut ka lindur fillimisht si rezultat i veprimit të Komunitetit, nëpërmjet doktrinës së efektit të drejtpërdrejtë dhe përparësisë të së drejtës

⁷ Marr nga raportet e KE mbi Marrëdhëniet e Jashtme: www.europa.eu/content/programmes/C36/

⁸ Neni 2 TBE-së

së Komunitetit. Veprime, të cilat shpeshherë patën ndikim real ligjor mbi interesat ekonomikë dhe tregtarë të aktorëve privatë. Në këto kushte, aktorët ekonomikë filluan të kërkonin mbrojtje ligjore për të drejtat themelore të pronës dhe të tregtisë, të cilave u ishte dhënë mbrojtje e veçantë nga kushtetutat e shteteve anëtare. Refuzimi i GJED-së për të të gjykuar çështje që kishin të bënin me mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut u kundërshtua nga shtetet anëtare duke kontestuar epërsinë e së drejtës së Bashkimit mbi legjislacionin kombëtar të këtyre shteteve. Në këto kushte GJED-ja, ndryshoi qendrim duke i njohur të drejtat themelore si parime të përgjithshme të së drejtës së Bashkimit. Jurisprudenca e Gjykatës, evoluoi edhe më tej duke pranuar se në interpretimin e të drejtave dhe lirive themelore Gjykata frymëzohet nga “traditat e përbashkëta kushtetuese” dhe nga traktatet ndërkombëtare. Këto arritje në jurisprudencë u mbështetën edhe nga ndryshimet në traktatet themeluese.

Fillimisht, Gjykata Evropiane e Drejtësisë refuzoi të gjitha paditë që kishin të bënin me të drejtat themelore, me arsyetimin se çështjet e së drejtës kushtetuese kombëtare nuk ishin në kompetencë të saj. Më pas, Gjykatës iu desh ta rishqyrtonte qëndrimin e vet. GJED-ja vetë kishte sanksionuar parimin e përparësisë të së drejtës së Bashkimit mbi legjislacionin e brendshëm të shteteve anëtare si dhe parimin e efektit të drejtpërdrejtë. Këto parime mund të respektohen vetëm nëse mbrojtja e të drejtave themelore, që garanton e drejta e Bashkimit është e barabartë me mbrojtjen që garantojnë kushtetutat kombëtare. Në një fazë të parë, ajo e viteve `50 dhe `60, Gjykata e kishte vetëkufizuar kompetencën në interpretimin e së drejtës komunitare. Fillimet mjaft të vështira të kësaj rruge lidhen me dy vendime të Gjykatës: vendimi i 4 shkurtit të vitit 1959 *Stork dhe Co. c. Autoriteti i Lartë i KEQÇ-së* dhe vendimi i 15 korrikut të vitit 1960, 36/59, për rastin e zyrave të shitjes së qymyrit të Ruhrit.

Në vendimin e *Stork dhe Co.c. Autoriteti i Lartë i KEQÇ-së*⁹, Gjykata e Drejtësisë refuzoi të kontrollonte përputhjen e së drejtës komunitare me të drejtat themelore të njeriut, të cilat ishin sanksionuar në kushtetutat kombëtare. GJED-ja e justifikoi vendimin e vet me motivin se detyra e saj ishte të kontrollonte aplikimin e së drejtës komunitare dhe jo atë të shteteve anëtare. Gjykata pohonte parimin që normat kushtetuese të shteteve anëtare nuk kanë efekt në sistemin komunitar. Vetëm ato norma që janë të sanksionuara në traktate mund të mbrohen nga e drejta evropiane.

Në vazhdim të sjelljes së ngurtë të Gjykatës së Drejtësisë për sa i përket mbrojtjes të të drejtave të njeriut, gjykatat kushtetuese italiane dhe gjermane vendosën të ushtronin një kontroll të ligjshmërisë kushtetuese edhe mbi aktet komunitare. Ka një rëndësi të veçantë vendimi *Frontini* i 27 dhjetorit të vitit 1973, me të cilën Gjykata Kushtetuese e Italisë deklaronte se transferimi i kompetencave organeve të komunitetit dhe kufizimi i sovranitetit italian “mund t’u japin organeve të KEE-së të drejtën të shkelin parimet themelore të sistemeve kushtetuese”.

Në të njëjtën rrugë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese Italiane vendosi dhe Gjykata Gjermane në çështjen *Solange I* të 29 majit të vitit 1974, pohonte se nëse do të hasnin në një kundërshtim ndërmjet normave të së drejtës komunitare të prejardhur dhe atyre kushtetuese që prekin drejtpërdrejt të drejtat e njeriut do të aplikohen këto të fundit. Ky arsyetim i Gjykatës së Drejtësisë hasi në kundërshtinë e gjykatave kushtetuese të shteteve anëtare. Në vendimin *Solange I*¹⁰, Gjykata Kushtetuese Gjermane pranonte se mbrojtja e mjaftueshme e të drejtave themelore në kuadrin e komuniteteve varej nga parimi i përparësisë të së drejtës komunitare ndaj së drejtës kombëtare. Sipas saj, përderisa BE-ja nuk ishte në gjendje të garantonte të drejtat themelore të njeriut, atëherë kanë të drejtë t’i garantojnë ato gjykatat kushtetuese të shteteve anëtare. Pra, në këtë vendim Gjykata Kushtetuese Gjermane nuk pranonte efektin e përparësisë të së drejtës

⁹ Çështja 1/58 *Stork & Cie* kundër Autoritetit të Lartë të Komunitetit të Qymyrit dhe Çelikut, [1959] GJED 17.

¹⁰ Vendim i Gjykatës Kushtetuese Gjermane *Solange I*, datë 29.03.1974.

së Bashkimit lidhur me të drejtat e njeriut. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Gjyakta Kushtetuese Italiane¹¹.

Vendimet e gjykatave kushtetuese të Italisë dhe të Gjermanisë e çuan Gjykatën e Drejtësisë në një ndryshim të pozicionit të saj fillestar. Qysh në vendimin 29/69, *Stauder c. Qyteti i Ulm*, Gjykata pohonte se të drejtat e njeriut “bëjnë pjesë në parimet e përgjithshme të së drejtës komunitare për të cilat Gjykata siguron vëzhgimin”. Është njohja e parë zyrtare e të drejtave themelore, e konfirmuar më vonë në raste të ndryshme, në të cilat Gjykata pohoi se mbrojtja e të drejtave themelore për të cilën ajo siguron vëzhgimin dhe është në dijeni të traditave kushtetuese që mbrojnë këto të drejta, deri në mbërritjen e vendimit nr.36/75, *Rutili c. Ministria e Brendshme franceze*, ku ajo mbështetet në normat me karakter ndërkombëtar dhe, në veçanti, tek ato të të drejtave të garantuara nga KEDNJ-ja. Praktika e Gjykatës, që refuzonte të merrte në konsideratë të drejtat themelore që mbronin shtetet anëtare, paraqeste disa probleme. Legjislacioni i komuniteteve nuk arrinte të garantonte siç duhej respektimin e të drejtave të njeriut. Ndërkohë që mbrojtja e këtyre të drejtave ishte sanksionuar në shumicën e kushtetutave të shteteve anëtare dhe këto të drejta mbroheshin edhe nga Konventa, ku shtetet anëtare ishin palë. Çështja që shtrohej për zgjidhje ishte nëse kompetencat që tashmë ushtroheshin nga komuniteti, duhet t'i shpëtonin ose jo detyrimit për respektimin e të drejtave themelore. Përse individët, që më parë kishin të drejtën e rekursit individual në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, do ta humbisnin atë për kompetencat e transferuara te Komunitetit. Problemi bëhej akoma edhe më i mprehtë kur vetë Gjykata e Drejtësisë kishte pranuar se e drejta e Bashkimit qëndron edhe mbi vetë kushtetutat¹² e shteteve anëtare.

¹¹ Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane *Frontini et Pozzani*, datë 27.12.1972; dhe Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Italiane *Granital*, datë 8.06.1984.

¹²Çështja 6/64 *Flaminio Costa kundër Enel* (1964) GJED.

3. Parimet e përgjithshme të së drejtës së BE-së.

Parimet e përgjithshme të së drejtës evropiane ndahen në dy kategori: ligjore dhe jurisprudence. Shembuj të saktë të llojit të parë i shikojmë tek disa nene të Kartës të të Drejtave të Bashkimit Evropian si, për shembull, neni 41, ku flitet për të drejtën e miradministrimit, neni 42 për të drejtën e rishikimit të akteve etj. Për t'u theksuar është fakti që parimet e kategorisë së parë bazohen tek e drejta për të zhvilluar aktivitetin administrativ dhe këto parime vijnë nga traktatet dhe e drejta e prejardhur (Canaj dhe Bana, 2015: 156)

Por, pjesa më e madhe e parimeve vjen nga kategoria e dytë, nga jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë. Kjo e fundit, dhe pse është e krijuar për të prodhuar të drejtën e siguron atë me anën e “respektimit të së drejtës, me anën e interpretimit dhe aplikimit të traktateve” dhe janë pikërisht këto që ndihmojnë në formimin e së Drejtës Evropiane (*acquis communautaire*): e ashtuquajtura e Drejtë Evropiane e pashkruar. E rëndësishme për t'u theksuar është që parimet e përgjithshme mund të kenë dy lloje funksionesh:

- *integruese*, duke ndërhyrë për të plotësuar vakuumet që mund të ketë një disiplinë e caktuar;
- *interpretuese*, në kuptimin që ato mund të përdoren për të përcaktuar hapësirën ku një normë e Bashkimit Evropian duhet të veprojë.

Gjykata e Drejtësisë është i vetmi organ i cili mund të bëjë interpretimin e normave komunitare duke u bazuar në kriteret e përgjithshme, e në këtë mënyrë, ajo ndihmon në përmbushjen e lakunave që ka e Drejta Evropiane. Bazën kryesore të parimeve të përgjithshme të së Drejtës Evropiane e përbëjnë të drejtat themelore të njeriut. Në kohën kur Traktatet e Bashkimit Evropian kishin vakume për sa i përket mbrojtjes të të drejtave të njeriut, ishte Gjykata e Drejtësisë që me vendimet e saj (prej vitit 1969) mbushte këto lakuna. Gjykata Evropiane e Drejtësisë, në një seri rastesh të hershme,

fillimisht i rezistoi përpjekjes së palëve ndërgjyqëse për të kërkuar të drejtat dhe parimet e njohura nga e drejta kombëtare (siç janë legjitimitimi i pritshëm, proporcionaliteti dhe drejtësia e natyrshme) dhe nuk ishte e gatshme t'i trajtonte ato si pjesë të rendit ligjor të Komunitetit, edhe kur ato ishin parime themelore të përbashkëta për sistemet ligjore të shumicës të të gjitha shteteve anëtare.¹³ Megjithatë, më pas, qëndrimi i Gjykatës ndryshoi. Në fakt, viti 1969¹⁴ përbën një pikë kthese në qëndrimin e Gjykatës së Drejtësisë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Pas këtij momenti, Gjykata e ka zhvilluar e plotësuar vazhdimisht mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Komunitet, duke zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës. Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka mbajtur qëndrimin se e drejta e Komunitetit është sigurisht e lidhur me parime të përgjithshme të pashkruara, që e kanë origjinën nga burime të ndryshme. Parimet e përgjithshme të së drejtës formësohen nga traktatet ndërkombëtare si dhe traditat kushtetuese që janë të përbashkëta për shtetet anëtare. Traktatet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, për të cilat shtetet anëtare kanë bashkëpunuar, ose ato, të cilat shtetet kanë nënshkruar, shërbejnë si udhëzues që duhet të ndiqen brenda strukturës të së drejtës të Komunitetit. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut është qartësisht shembulli i parë i këtij qëndrimi dhe është referuar në raste të ndryshme nga Gjykata.

Që nga vendimi *Handelsgesellschaft*, GJED-ja ka theksuar vazhdimisht autonominë e “parimeve të përgjithshme” të së drejtës, ndërsa thekson njëherazi që burimi i këtyre parimeve nuk është tërësisht i pavarur nga kulturat dhe traditat ligjore të shteteve anëtare.

Një nga çështjet më me rëndësi për njohjen e të drejtave të njeriut është çështja *Stauder*¹⁵. Faktet në këtë rast janë si vijojnë. Aplikanti pretendonte se ishte dhunuar nga implemetimi vendas i një dispozite të KE-së lidhur me një skemë të subvencionimit

¹³ Çështja 1/58 *Stork v. High Authority* 1959, 17; çështja 36,37,38, dhe 40/59 *Geitling v. High Authority* [1960] 423; çështja 40/64 *Sgarlata and the others v. Commission* 1965, 215.

¹⁴ Çështja 29/69 *Stauder kundër Qytetit të Ulm-it*, 1969, 419.

¹⁵ Çështja 29/69 *Stauder*, 1969, 419.

të gjalpit. Përfituesi i një pensioni si veteran i luftës, e konsideronte cenim të dinjitetit personal dhe shkelje të parimit të barazisë faktin që duhej të deklaronte emrin për të blerë gjalpë me çmim të ulët gjatë periudhës së Krishtlindjeve. Në këtë vendim, Gjykata në interpretimin e dispozitës së Komunitetit arriti në përfundimin se: “deklarimi i emrit nuk ishte i nevojshëm”. Në konkluzionet e saj ajo pranoi se respektimi i të drejtave themelore bën pjesë në parimet e përgjithshme themelore të rendit juridik të Komunitetit, rend të cilin Gjykata e Drejtësisë e ka për detyrë ta garantojë. Gjykata, për herë të parë, ka njohur ekzistencën e një kuadri juridik të BE-së edhe për të drejtat themelore. Në çështjen *Stauder*, Gjykata iu përgjigj pozitivisht një argumenti të bazuar mbi të drejtën themelore të dinjitetit njerëzor, për të cilën aplikanti pretendoi se i ishte dhunuar nga implementimi vendas i një dispozite të KE-së lidhur me një skemë të subvencionimit të gjalpit për mirëqenien e përdoruesve. Duke interpretuar masën e KE-së në një mënyrë konsekuente me mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, GJED-ja deklaroi se “dispozita në shqyrtim nuk përmban asgjë të mundshme për paragjykimin e të drejtave themelore të përfshira në parimet e përgjithshme të së drejtës së Komunitetit dhe të mbrojtur nga Gjykata”. Vendimi *Stauder* përfaqësonte kështu një ndryshim të dallueshëm të qasjes, duke futur idenë e parimeve të përgjithshme të së drejtës së KE-së që përfshin mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut (Shachor-Landau, 1989).

Qasja e re u konfirmua dhe u përpunua mbi çështjen e famshme *Internationale Handesgesellschaft*, në të cilën Gjykatës Kushtetuese Gjermane iu kërkua të mos pranonte një masë lidhur me konfiskimin e një kapari për një licencë eksporti, e cila me sa duket konfliktonte me të drejtat dhe parimet kushtetuese gjermane, siç janë ato të lirisë ekonomike dhe proporcionalitetit. Sipas GJED-së rekursi në normat ose konceptet ligjore të së drejtës kombëtare me qëllim për të gjykuar vlefshmërinë e masave të miratuara nga institucionet e Komunitetit do të kishte efekt të kundërt mbi unfirormitetin dhe efikasitetin e së drejtës komunitare. Vlefshmëria e këtyre lloj masave

mund të gjykohet vetëm në dritën e së drejtës komunitare. Në fakt, e drejta që rrjedh nga Traktati, për vetë natyrën e saj, nuk mund të anashkalohet nga normat e së drejtës kombëtare. Prandaj, vlefshmëria e një mase të BE-se ose efekti i saj brenda një shteti anëtar nuk mund të ndikohet nga pretendimet se ajo është në kundërshtim me të drejtat themelore të formuluar nga Kushtetuta e atij shteti ose me parimet e një strukture kushtetuese kombëtare. Gjithsesi, një kontroll duhej bërë nëse është shpërfillur ose jo ndonjë garanci analoge e pandarë nga e drejta komunitare. Në fakt, respekti për të drejtat themelore përbën një pjesë integruese të parimeve të përgjithshme të së drejtës së Komunitetit, të mbrojtura nga Gjykata e Drejtësisë. Mbrojtja e këtyre të drejtave, ndërsa frymëzohet nga traditat kushtetuese të përbashkëta të shteteve anëtare, duhet siguruar brenda strukturës dhe objektivave të Komunitetit. Prandaj, duhet të përcaktohet, në dritën e dyshimeve të shprehura nëse sistemi i kaparit ka shkelur të drejtat e një natyre themelore, respekti për të cilat duhej të sigurohet në sistemin ligjor të Komunitetit. GJED-ja konkludoi se nuk kishte asnjë shkelje të pretenduar të të drejtave, pasi kufizimi i lirisë për të tregtuar, etj., nuk ishte në shpërpjesëtim me interesin e përgjithshëm të parashikuar nga sistemi i kaparit. Megjithatë, kur çështja iu rikthye gjykatës gjermane, gjykata kombëtare konkludoi se parimi i proporcionalitetit i mbrojtur nga e drejta kushtetuese gjermane që cenuar vërtet nga sistemi i kaparit. Rasti në fjalë përbën një ilustrim interesant të vështirësisë së përballur nga GJED-ja në kërkim të përvetësimit të “parimeve të përbashkëta kushtetuese” të shteteve anëtare, si pjesë e rendit ligjor të Komunitetit. Në qoftë se interpretimi i GJED-së për kërkesat e këtyre parimeve ndryshon ndjeshëm nga interpretimi i shteteve anëtare, të cilat gjithashtu kërkojnë të sigurojnë mbrojtjen e tyre, atëherë legjitimiteti i gjykimeve të GJED-së ka gjasa të vihet në dyshim.

Megjithëse kishte përparime të dukshme në qëndrimin e Gjykatës, përsëri mbrojtja që u ofrohej të drejtave të njeriut ishte e pamjaftueshme. Për këtë arsye, në vitin 1974

Gjykata shkoi edhe më tej, duke iu referuar edhe instrumenteve ndërkombëtare në të cilat shtetet anëtare kanë aderuar, në veçanti, Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Në Çështjen 4/73 *Nold k. Komisionit* të vitit 1974 lidhur me ndikimin drastik të normës komunitare për tregun e qymyrit mbi të drejtën e jetesës së aplikantit, Gjykata tregoi se kishte dy burime kryesore “frymëzimi” për parimet e përgjithshme të së drejtës së KE-së: i pari ka të bëjë me traditat e përbashkëta kushtetuese kombëtare dhe i dyti me marrëveshjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Sipas GJED-së, në rastin *Nold*, tashmë të drejtat themelore formojnë një pjesë integruese të parimeve të përgjithshme të së drejtës, respektimin e të cilave e siguron ajo. Në mbrojtje të këtyre të drejtave Gjykata është e detyruar të marrë frymëzim nga traditat kushtetuese të përbashkëta për shtetet anëtare dhe prandaj nuk mund të përkrahë masat që janë të papajtueshme me të drejtat themelore të njohura dhe të mbrojtura nga kushtetutat e këtyre shteteve. Po ashtu, traktatet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, për të cilat shtetet anëtare kanë bashkëpunuar ose që ata i kanë nënshkruar, mund të përbëjnë udhëzime të cilat duhet të ndiqen brenda strukturës legjislative komunitare.

Në çështjen *Nold* (Çështja 4/73 *Nold*, 1974, GJED 491) GJED-ja u shpreh se: “.... traktatet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ku shtetet anëtare janë palë, mund të përdoren si udhëzuese të cilat duhet të zbatohen brenda strukturës të së drejtës së Komunitetit.” Në këtë çështje Gjykata tregoi se kishte dy burime kryesore “frymëzimi” për parimet e përgjithshme të së drejtës së KE-së: i pari traditat e përbashkëta kushtetuese kombëtare dhe i dyti marrëveshjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Gjykata fillimisht vendosi masat mbrojtëse për çdo të drejtë themelore, nisur nga dispozitat e traktateve. Ajo përcaktoi shumë “ndalime diskriminimi” që buronin nga aspekte të ndryshme të parimit të përgjithshëm të barazisë (Borchardt Borchardt, 2011:

25). Për shembull, ndalimi i trajtimit diskriminues mbi bazën e kombësisë (sot neni 18 TFBE), ndalimi i trajtimit diskriminues mbi bazën e gjinisë, racës, përkatësisë fetare, etnike etj. (sot neni 10 TFBE), trajtimi i barabartë në lidhje me katër liritë themelore etj. Gjykata e Drejtësisë është shprehur se: “Parimi i mosdiskriminimit mbi bazën e moshës është i përbashkët në traditat kushtetuese të shteteve anëtare. Ky parim është drejtpërdrejtë i zbatueshëm si rezultat i efektit të drejtpërdrejtë të dispozitave të Traktatit”. Ky qëndrim është mbajtur në çështjen *Mangold*¹⁶ (paragrafi 47) si dhe nga Avokati i Përgjithshëm Mazak në çështjen *Palacios de la Villa*¹⁷, (paragrafi 87-98 dhe 132-138).

Një parim tjetër, i trajtuar shpesh në procedime gjyqësore, është parimi i trajtimit të barabartë. Kjo do të thotë që rastet e ngjashme duhet të trajtohen në mënyrë të ngjashme, përveç kur ka arsye objektive për të bërë dallim në gjykim. Gjykata e Drejtësisë është shprehur që ky parim nuk ndalon zbatimin e masave më të rrepta për shtetasit apo mallrat e prodhuara në vend nga ato që zbatohen për shtetasit ose produktet nga shtetet e tjera anëtare (Borchardt Borchardt, 2011: 26). Ky “diskriminim në sens të kundërt” është rezultati i pashmangshëm i sferës së kufizuar të kompetencave të Bashkimit dhe nuk mund të zgjidhet nga e drejta komunitare. Pra, respektimi i parimit të barazisë në katër liritë themelore gjen zbatim vetëm për tregtinë ndërkufitare.

Gjykata e Drejtësisë ka trajtuar edhe parimin e shtetit të së drejtës. Në këtë aspekt, rëndësi të veçantë merr parimi i proporcionalitetit. Sipas këtij parimi, mjetet e përdorura nga shteti për të arritur qëllimin duhet të jenë proporcionale, pra të nevojshme për arritjen e qëllimit dhe në masën e domosdoshme për përmbushjen e qëllimit. Parime të tjera thelbësore që lidhen me të drejtën e Bashkimit janë edhe parimet e procesit të rregullt ligjor, mosprapaveprueshmëria e ligjit, transparenca në kryerjen e funksioneve nga institucionet e Bashkimit etj.

¹⁶ Çështja C- 144/04 Mangold, 2005 GJED I-09981.

¹⁷ Çështja C-411/05 Palacios de la Villa, 2007 GJED I-08531.

Në çështjen *Wachauf*¹⁸ Gjykata vendosi se, në mbarim të qiramarrjes, shteti anëtar duhej të jepte kompensim për fermerin qiramarrës që e kishte ndërprerë prodhimin e qumështit, si rezultat i implementimit të rregullores së KE-së nga shteti anëtar. Gjykata arriti në këtë konkluzion, megjithëse rregullorja e implementuar nuk e parashikonte në mënyrë të veçantë një kompensim të tillë. Ky arsyetim ishte i justifikuar sipas Gjykatës pasi, kur zbatohet e drejta e Komunitetit nga shtetet anëtare, këto të fundit janë të detyruara të respektojnë po ato parime të përgjithshme dhe të drejta themelore që e detyrojnë edhe Komunitetin në veprimet e tij. Në çështjen *Kadi*¹⁹ Gjykata i cilësoi si “parime kushtetuese” të drejtat themelore duke i vendosur në të njëjtin nivel, e madje edhe në nivel më të lartë se dispozitat e tjera të Traktatit.

Gjykata e Drejtësisë ka theksuar se mbrojtja e të drejtave të njeriut nuk është absolute. Këto të drejta mund të kufizohen nëse është e nevojshme për të arritur objektivat e Komunitetit. Kufizimi ose cenimi i tyre duhet të jetë brenda limiteve të lejueshme, të cilat nuk mund të prekin thelbin e të drejtave themelore²⁰. Pra, sipas Gjykatës kufizimi është i justifikuar nga objektivat e përgjithshëm të KE-së dhe se vetëm një ndërhyrje arbitrare do ta bënte të pavlefshëm legjislacionin e KE-së.

Nga ana tjetër, ekzistojnë diferenca ndërmjet gjuhës së përdorur nga traktatet dhe jurisprudencës së GJED-së, për shembull kujt i adresohet për mbrojtjen e normave. Sipas praktikës gjyqësore të GJED-së është Gjykata ajo që siguron mbrojtjen e parimeve të përgjithshme; në periudhën ndërmjet Traktatit të Mastritit dhe Traktatit të Lisbonës është Bashkimi ai që i respekton ato; ndërsa në Traktatin e Lisbonës nuk është specifikuar se kujt i adresohet mbrojtja e parimeve të përgjithshme.

GJED-ja nuk është treguar e qartë në interpretimin e saj se përse disa të drejta janë pjesë e parimeve të përgjithshme të së drejtës së Bashkimit sipas nenit 6/3 të TBE. Shembuj të qartë për këtë situatë vijnë nga rastet konkrete që janë ngritur përpara GJED-së, ku

¹⁸ Çështja 5/88 *Wachauf* kundër Gjermanisë, 1989 GJED 2609.

¹⁹ Çështja C-402/05 *Kadi* kundër Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Komisionit, 2008 GJED I-06351.

²⁰ Çështja 265/87 *Schröder*, 1989 GJED 2237.

janë njohur si parime të përgjithshme të së drejtës së Bashkimit, të drejta që nuk i përkasin as konventave ndërkombëtare, as traditave të përbashkëta të shteteve anëtare. Në këto raste Gjykata është bazuar në parime të tjera të cilat kanë të njëjtin efekt që mund të kishin të drejtat themelore. Një rast i tillë është çështja, *Dow Benelux*²¹, *Dow Cheramica Iberica*²² në të cilat e drejta për të mbrojtur hapësirat e biznesit nuk parashikohet as në nga KEDNJ-ja, as nga traditat kushtetuese kombëtare të shteteve anëtare. Në këto raste Gjykata u bazua në parimet e përgjithshme që interferonin me të drejtën për jetë private si të personave, fizikë ashtu edhe të personave juridikë, të cilat duhet të parashikoheshin me ligj dhe të ishin proporcionale.

Në grupin e parimeve të përgjithshme, të cilat kanë si qëllim mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe që janë jashtë kategorisë së nenit 6/3 të TBE, përmendim p.sh parimin e gjykimit të drejtë, të drejtën për t'u dëgjuar, të drejtën për t'u mbrojtur. Këto janë konsideruar si parime të përgjithshme të së drejtës së Bashkimit, edhe pa iu referuar nenit 6 të KEDNJ-së. Ndër parimet e tjera, që janë zhvilluar jashtë kontekstit specifik të të drejtave themelore klasike, është edhe parimi i transparencës në çështjet administrative, i cili është i lidhur edhe me parimin e aksesit në dokumentet publike.

Neni 6/3 ka rëndësi të veçantë në nxitjen e koherencës së rendit kushtetues të Bashkimit dhe të shteteve anëtare. Ky nen përfaqëson një mundësi për të drejtën e Bashkimit për t'u përditësuar me zhvillimet e përbashkëta kushtetuese të shteteve anëtare në lidhje me të drejtat e njeriut. Të drejtat themelore të njeriut nuk janë statike dhe pikëpamja mbi to zhvillohet me kohën. Një shembull i këtij zhvillimi është edhe e drejta për një proces të rregullt ligjor si dhe e drejta për zgjidhje efektive. Në disa shtete anëtare të KEDNJ-së, nenet 6 dhe 13 i konventës nuk mund t'i japin kërkuarit të drejtën e aksesit direkt në gjykatë në mënyrë të pavarur, por vetëm në rastin e shkeljes së dispozitave kombëtare të ligjit procedural. Megjithatë, në disa shtete kjo e drejtë është zhvilluar duke fituar një

²¹ Çështja 85/87 Don Benelux, 1989 GJED 3150.

²² Çështja 99/87 Don Cheramica Iberica, 1989 GJED 3181.

status të pavarur. Ky interpretim u pasqyrua edhe në vendimet e Gjykatës së Drejtësisë, p.sh në çështjen *Kadi I*²³ i konsideroi këto të drejta si pjesë e së drejtës ndërkombëtare *jus cogens*. Shembuj të tjerë për evoluimin e interpretimit të të drejtave kanë të bëjnë me të drejtat e transseksualëve, ku, sipas disa legjislacioneve, atyre u lejohet e drejta për t'u martuar; kuptimi i së drejtës për jetë private sidomos duke marrë parasysh zhvillimin e teknologjisë në fushën e mjeksisë, bioteknologjisë etj. Është e vërtetë që këtë funksion e realizon pjesërisht neni 52 paragrafi 2 dhe 3 i Kartës. Megjithatë, kjo vlen vetëm për të drejtat e parashikuara në Kartë, pra nuk mbulon të gjithë spektrin e të drejtave dhe parimeve sipas nenit 6/2 të TKE-SE.

Koncepti ligjor i “parimeve të përgjithshme” ka mangësitë e tij, të cilat mund të ndikojnë negativisht në të drejtat themelore. Kjo ka të bëjë kyesisht me anën formale të normave. Parimet e përgjithshme nuk kanë qartësinë që paraqesin rregullat e shkruara. Ato në përgjithësi janë të përgjithshme dhe qendrojnë në nivelin e parimeve.

4. Traditat e përbashkëta kushtetuese të shteteve anëtare.

Traditat kushtetuese kombëtare janë relativisht të qarta dhe të pakundërshtueshme si dhe të konsoliduara ndër vite në Bashkimin Evropian. Në fakt, përdorimi që u bën GJED-ja të drejtave konkrete të veçanta nga këto burime të përgjithshme dhe aplikimi i tyre në rrethana specifike të çështjeve të veçanta, është ende i kontestuar. Praktika gjyqësore e Gjykatës është mbështetur shumë pak në dispozitat kushtetuese për të drejtat e njeriut, pavarësisht rëndësisë simbolike që u është dhënë si nga Gjykata, edhe nga traktatet e BE-së “traditave të përbashkëta kushtetuese” të shteteve. Ndonëse ka pasur raste që Avokati i Përgjithshëm ka përcjellë një analizë të shkurtër të dispozitave kushtetuese kombëtare, Gjykata shumë më rrallë ka cituar ndonjë dispozitë të veçantë kushtetuese.²⁴ Në fakt është e vështirë për GJED-në të mbrojë një qasje “të përbashkët”, ku një e drejtë

²³ Çështja C-402/05 Kadi kundër Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Komisionit, [2008] GJED I-06351 dhe Çështja C-415/05 Kadi kundër Këshillit dhe Komisionit, GJED 2008.

²⁴Çështja 17/74 *Transocean Marine Paint v. Commission* 1974, 1063, paragrafi 17.

e caktuar nuk shfaqet në çdo kushtetutë kombëtare, ndërsa një instrument si KEDNJ-ja supozohet se pasqyron me saktësi angazhimet që ndajnë bashkërisht të gjitha shtetet anëtare. Për më tepër, frika e rrezikimit të epërsisë doktrinale të së drejtës së BE-së nëpërmjet shfaqjes së nënshtrimit ndaj një dispozite të caktuar kushtetuese kombëtare ka frymëzuar praktikën gjyqësore të GJED-së qysh nga vendimi *Costa k. Enel* (Çështja 6/64, 1964, 585). Kjo është e dukshme në çështjen *Hauer*, ku një normë e KE-së, sipas së cilës u kufizua e drejta e aplikantes për të mbjellë hardhi në tokën e saj, nxiti Gjykatën referuese Administrative të Gjermanisë Federale të deklarojë se një normë e KE-së, e cila ishte e papajtueshme me të drejtat themelore kushtetuese gjermane, nuk do të aplikohet. Ne shohim këtu që GJED-ja duket se kërkon ta bazojë vendimin e saj në “traditat kushtetuese të përbashkëta” të shteteve dhe në angazhimet kolektive të KEDNJ-së.

Çështja 44/79 *Hauer k. Land Rheinland-Pfalz*²⁵ tregon më së qarti se problemi i shkeljes së mundshme të të drejtave themelore nga një masë e institucioneve të Komunitetit mund të gjykohet vetëm në dritën e së drejtës së vetë Komunitetit. Futja e kriterëve të veçanta të vlerësimit, që rrjedhin nga legjislacioni ose e drejta kushtetuese e një shteti anëtar, duke dëmtuar unitetin dhe efikasitetin real të së drejtës së Komunitetit, do të çonte në mënyrë të paevitueshme në shkatërrimin e unitetit të tregut të përbashkët dhe do të rrezikonte kohezionin e Komunitetit.

Në gjykimin e cituar dhe në një gjykim të mëvonshëm të 14 majit 1974, *Nold*, Gjykata theksoi gjithashtu se të drejtat themelore përbëjnë një pjesë integruese të parimeve të përgjithshme të së drejtës, respektimin e të cilave ajo siguron. Sikurse theksoi se, në mbrojtje të këtyre të drejtave, Gjykata është e detyruar të marrë frymëzim nga traditat kushtetuese të përbashkëta të shteteve anëtare në mënyrë që masat, të cilat janë të papajtueshme me të drejtat themelore të njohura nga Kushtetutat e këtyre shteteve, të

²⁵Çështja 44/79 *Hauer k. Land Rheinland-Pfalz* 1979, 3727.

jenë të papranueshme për Komunitetin dhe se, po ashtu, traktatet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut ku shtetet anëtare kanë bashkëpunuar ose në të cilat janë nënshkruar, mund të përbëjnë direktiva që duhet të zbatohen brenda strukturës të së drejtës komunitare. Ky koncept ishte pranuar më vonë nga deklarata e përbashkët e Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit, më 5 prill 1977, e cila, pas anulimit të praktikës gjyqësore të Gjykatës, i referohet nga ana tjetër Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. E drejta e pronës është garantuar në rendin ligjor të Komunitetit në përputhje me idetë e përbashkëta të kushtetutave të shteteve anëtare, të cilat janë reflektuar gjithashtu në protokollin e parë të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Është e nevojshme të vlerësojmë gjithashtu treguesit e parashikuar nga normat kushtetuese dhe praktikat e nëntë shteteve anëtare. Një nga argumentet e para që paraqitet në këtë drejtim është se këto norma dhe praktika lejojnë legjislaturën të kontrollojë përdorimin e pronës private në përputhje me interesin e përgjithshëm. Kështu, disa kushtetuta u referohen detyrimeve që rrjedhin nga zotërimi i pronës, German Grundgesetz, neni 14 (2), fjalia e parë, funksioni social i saj Kushtetuta Italiane, neni 42 (2), nënshtrimi i përdorimit të saj ndaj kërkesave të dobisë së përbashkët, German Grundgesetz, neni 14 (2), fjalia e dytë, si dhe Kushtetuta Irlandeze, neni 43 (2.2), ose drejtësisë sociale, neni 43 (2.1).

Në çështjen *Martinez et al.*, aplikantët përdorën pa sukses traditat parlamentare të përbashkëta të shteteve anëtare, po aq sa mbi lirinë për shoqatat,²⁶ me qëllim goditjen e refuzimit që nuk i lejonte ata, si një grup i papozicionuar, të regjistroheshin si një parti politike për të fituar privilegje të caktuara, por Gjykata e Shkallës së Parë nuk e mohoi në parim mundësinë që “traditat e përbashkëta parlamentare” mund të përbënin një burim frymëzimi për parimet e përgjithshme të së drejtës komunitare.²⁷

²⁶Çështja C-415/93 *Union Royal Belge des Societes de Football Association v. Bosman* [1995] I-4921; çështjen C-325/92 *Montecatini v. Commission*, 1999 I-4539.

²⁷ Çështjet T-222,327, dhe 329/99 *Martinez, Gaulle, Front national and Boninov*.

Gjetja e mbështetjeve të përbashkëta, në krijimin e burimeve të frymëzimit për të drejtat themelore të BE-së, natyrisht që është vetëm hapi i parë. Në qoftë se GJED-ja do të zgjidhte një qasje “të emëruesit më të ulët të përbashkët”, kishte rrezik që Gjykata t’i jepte miratim BE-së vetëm për ato të drejta që ishin të përbashkëta për të gjitha (ose shumicën) shtetet dhe mund të mos merrte parasysh mbrojtjen e dhënë nga një shtet i vetëm për një të drejtë të konsideruar themelore brenda atij rendi ligjor. Nga ana tjetër, një qasje e “standardit maksimal” do të çonte në situatën e kundërt, ku njohja e një të drejte specifike nga një shtet i veçantë anëtar, edhe pse e pandarë me ndonjë tjetër, do t’u imponohej dhe shteteve të tjera nga GJED-ja me anën e parimeve të përgjithshme të së drejtës së BE-së (Besselink, 1998; Weiler, 1999).

Në rastin *Mannesmannrohen-Werke*, lidhur me të drejtën për të ndenjur në heshtje në kontekstin e procedurave të konkurrencës, GJSHP-ja nuk e pranonte qasjen e “standardit maksimal”. Në fushën e ligjit të konkurrencës, ligjet e shteteve anëtare nuk njohin në përgjithësi ndonjë të drejtë për të mos inkriminuar veten. Prandaj dhe nuk ka rëndësi për rezultatin e rastit konkret nëse është ose jo një parim i së drejtës gjermane, sikurse pretendon aplikanti.²⁸

Në çështjen *AM & S*, jo të gjithë shtetet anëtare ishin të kënaqura me përfundimin e Gjykatës për një parim konfidencialiteti, avokat - klient, të nxjerrë nga një analizë krahasuese e legjislacionit të shteteve anëtare dhe qeveria franceze në veçanti argumentoi se rasti në fjalë paraqiste “një përpjekje për të futur fshehurazi në komunitet atë çka nuk ishte thjesht një normë kombëtare e së drejtës angleze”.²⁹ Megjithatë, Avokati i Përgjithshëm mbrojti pikëpamjen se një parim i përgjithshëm mund të nxirrej nga shtete të ndryshme, edhe nëse “origjina konceptuale” e parimit dhe “shtrirja e aplikimit të tij në detaje” ndryshonin midis shteteve anëtare.

²⁸ Çështja T-112/98 *Mannesmannrohren-Werke*, nr.17, paragrafi 84.

²⁹ Çështjen 155/79 *AM&S*, nr.19, 1575, 1631, çështjen 17/74 *Transocean Marine Paint*, nr.35.

Një teknikë disi e ngjashme ishte përdorur nga GJED-ja në rastin *Omega Spielhallem*, ku ajo zgjodhi të shkëputej nga *koncepti i fortë dhe i veçantë* i dinjitetit njerëzor brenda së drejtës gjermane për një *koncept më të përgjithshëm* të dinjitetit njerëzor, i cili mund të thuhet se përqafohej nga të gjitha shtetet e tjera anëtare. Megjithatë, *Omega Spielhallen* ishte një rast më i lehtë për t'u vendosur, pasi ai nuk lidhej me kundërshtimin e një shteti anëtar për vlefshmërinë e një mase të KE-së, por më tepër me një shtet që ishte duke kërkuar një heqje individuale të rregullave komunitare për lëvizjen e lirë.³⁰ Në këtë rast, Gjermania ishte duke kërkuar pranimin e standardeve të saj të mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, jo për ta imponuar atë ndaj shteteve të tjera anëtare, por që të çlirohej për vete nga parimet e lëvizjes së lirë.

Në përgjithësi, mund të thuhet se Gjykata është e përgatitur të njohë një të drejtë të veçantë si pjesë të parimeve të përgjithshme të së drejtës së BE-së kur disa shtete anëtare, edhe pse jo të gjitha ato, e njohin shprehimisht atë të drejtë³¹ dhe GJED-ja është treguar gjithashtu më e kujdesshme se GJSHP-ja për të mos e refuzuar kërkesën e një shteti për njohjen e një të drejte të veçantë, me arsyen se ajo është njohur vetëm nga ai shtet.

Përfundimisht, edhe kur mund të thuhet se ka një konsensus të përgjithshëm mes shteteve që ekziston një e drejtë e veçantë, duket se është e pashmangshme që nuk do të ketë një konsensus për mënyrën se si ajo e drejtë duhet të interpretohet dhe “të përkthehet” në një parim të përgjithshëm të së drejtës së BE-së. Për shembull, në qoftë se të gjitha shtetet anëtare bien dakord se duhet të kishte mbrojtje për lirinë e shprehjes, ka mundësi që ata të kenë këndvështrime të ndryshme për mënyrën se si, në një kontekst të veçantë, duhet mbrojtur ajo. Sistemet ligjore kombëtare ndryshojnë shumë,

³⁰Çështja C-36/02 *Omega Spielhallen und Automatenaufstellungs – GmbH v. Oberburgermeisterin der Bundesstadt Bonn* 2004 I-9609, paragrafi 34-38. Shih gjithashtu çështjen C-112/00 *Schmidberger k. Austria* 2003 I-5659.

³¹Çështja C-49/88 *Al-Jubail*, nr.30, paragrafi 16.

për shembull, në shkallën me të cilën ato rregullojnë natyrën dhe përmbajtjen e transmetimit radio-televiziv (Craufurd-Smith, 1997).³²

Të marrim një shembull tjetër, ndërkohë që të gjitha shtetet anëtare njohin të drejtën e jetës, një grusht prej njëzet e nëntë shtetesh, përfshirë Irlandën dhe Maltën, vazhdojnë të mbajnë në fuqi ligje kombëtare jashtëzakonisht kufizuese për abortin, ligje që në rastin e Irlandës reflektojnë pjesërisht statusin kushtetues të fetusit për të drejtën e jetës. Një shembull tjetër mund të shihet në mbrojtjen e fortë që u jepet nga *Grundgesetz* i Gjermanisë të drejtave ekonomike dhe lirisë për të ushtruar një tregti ose profesion, ndërkohë që kushtetutat e shteteve të tjera pasqyrojnë përparësi të ndryshme sociale. Në rastin *Grant* dhe *D k. Këshillit*, GJED-ja u mbështet pjesërisht në konceptet e ndryshme ligjore kombëtare të martesës për të mohuar se kishte pasur ndonjë shkelje të të drejtave të aplikantit sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës komunitare.³³

Me fjalë të tjera, megjithëse ideja e “traditave të përbashkëta kushtetuese” si një themel për parimet e përgjithshme të së drejtës së BE-së është një themel tërheqës, në parim, prapë është e vështirë të shmanget fakti se dallimet midis koncepteve kombëtare specifike të të drejtave të veçanta të njeriut janë shpesh të mëdha. Kështu që, edhe pse GJED-ja pranon argumentet e një pale të veçantë që një e drejtë e dhënë duhet të njihet si pjesë e së drejtës së komunitetit, mënyra me të cilën Gjykata vendos shtrirjen ligjore të asaj të drejte dhe kufizimet e mundshme të saj në kontekstin e rastit në shqyrtim mund të dallojë nga mënyra që ajo do të zbatohet në një kontekst kombëtar dhe mund ta zhgënjejë aplikantin, siç u pa në rastet *Hauer*³⁴ dhe *Handelsgesellschaft*.³⁵

Disa studiues, eksperte të kësaj fushe, kanë argumentuar se Gjykata duhet medoemos që të përpunojë një “standard maksimal universal”, të bazuar mbi nivelin më të lartë të

³²Çështja C-245/01 *RTL Television GmbH v. Niedersächsische Landesmedienanstalt für privaten Rundfunk* 2003 I-12489.

³³ Çështja C-249/96 *Grant*, nr.24; çështjet C-122 dhe 125/99 *PD v. Council* 2001 I-4319.

³⁴ Çështja 44/79 *Hauer v. Land Rheinland-Pfalz* 1979 3727.

³⁵Çështja 11/70 *Internationale Handelsgesellschaft v. Einfuhr-und Vorratstelle für Getreide und Futtermittel* 1970, 1125.

mbrojtjes së dhënë nga një shtet i vetëm anëtar. Nga ana tjetër, disa studiues të tjerë jo vetëm kanë theksuar, por edhe kanë paralajmëruar për riskun e qasjes së “emëruesit më të vogël të përbashkët”.

Vetë Gjykata nuk refuzon njohjen e një parimi që është i rëndësishëm në një numër shtetesh anëtare; ajo nuk ka pranuar kurrë shprehimisht as qasjen maksimaliste, as atë minimaliste, por ka vazhduar, në një bazë pragmatike, rast-pas-rasti, të identifikojë dhe të interpretojë të drejtat që janë mbrojtur me ligj.

Ndonëse Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk është pjesë formale e legjislacionit komunitar, ajo është burimi më i zakonshëm i referimit për të drejtat themelore të BE-së. GJSHP-ja dhe GJED-ja rregullisht përdorin dispozitat e KEDNJ-së dhe në vitet e fundit i janë referuar shumë shpesh praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Marrëdhëniet midis dy sistemeve, të cilat janë qartësuar nga Karta e të Drejtave Themelore të BE-së dhe nga Traktati për themelimin e një Kushtetute për Europën, mbeten ligjërish të mjegullta. Ndërkohë që kërkesat për të drejtat themelore janë bërë gjithnjë e më të shpeshta para GJSHP-së dhe GJED-së, ato kanë qenë më të suksesshme në konflikte që përfshijnë aktet administrative individuale, sikurse janë çështjet e stafit ose dhe procedurat e konkurrimit, sesa në goditjen e politikës legjislative.

5. KEDNJ-ja si burim i rëndësishëm së veçantë për të drejtën e BE-së.

Gjykata e Drejtësisë gjithmonë e ka trajtuar Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut si një burim të veçantë frymëzimi për parimet e përgjithshme të së drejtës së BE-së. Ajo ka vendosur, për shembull, që legjislacioni i KE-së, që pakëson kompetencat e autoriteteve të shteteve anëtare për të kufizuar lirinë e lëvizjes,³⁶ ose legjislacioni lidhur me të drejtën për të prezantuar rekurse në procese gjyqësore, ose të drejtat kundër

³⁶Çështja 36/75 *Rutili v. Minister of the Interior* 1975 GJED PVGJE 1219.

diskriminimit gjinor, ose për mbrojtjen e të dhënave dhe të privatësisë, ishin shfaqje specifike e së drejtës së KE-së për parimet e përgjithshme të përfshira në KEDNJ.³⁷

Megjithëse GJED-ja kurrë nuk është shprehur se KEDNJ-ja është formalisht e detyrueshme për KE-në dhe BE-në dhe as që dispozitat e saj janë formalisht të përfshira në të drejtën e BE-së, (neni 6 i TBE-së i referohet shprehimisht KEDNJ-së), në terma më praktike, GJED-ja, madje edhe GJSHP-ja, pavarësisht këmbënguljes së saj më të fortë për “pamje të jashtme” formale të KEDNJ-së³⁸ vazhdimisht i referohet “domethënies së veçantë” të Konventës si një burim kryesor frymëzimi për parimet e përgjithshme të së drejtës së KE-së.³⁹

Në këtë mënyrë Gjykata mund të vazhdojë të kërkojë autonominë dhe epërsinë e së drejtës së Komunitetit dhe, ndërsa shmang detyrën e përfshirjes juridikisht të Konventës dhe të marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare në të drejtën e komunitetit pa miratimin e shteteve anëtare, ajo mundet, në të njëjtën kohë, të synojë për një konsensus të fortë mes shteteve, të cilat janë të gjitha nënshkruese të KEDNJ-së, në lidhje me themelet e parimeve të përgjithshme të së drejtës së Komunitetit. Përfundimisht, nëpërmjet shtjellimit të KEDNJ-së si burim frymëzimi, më tepër se një kartë formalisht detyruese dhe e inkorporuar, GJED-ja ka ruajtur lirinë për të “shkuar përtej” Konventës në njohjen e të drejtave si pjesë e së drejtës së KE-së, siç janë e drejta për konfidencialitetin avokat-klient, që rrjedh nga parimet e “përbashkëta” të së drejtës së shteteve anëtare në çështjen *AM & S* (Çështja 155/79 1982 1575), të cilat nuk ishin të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ-ja⁴⁰.

Pyetja e shtruar është nëse marrëveshjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në të cilat të gjitha shtetet anëtare janë palë, duhet të shiheshin thjesht si përfaqësuese të një emëruesi të përbashkët më të ulët (dysHEME), përtej të cilit GJED-ja është e lirë të

³⁷Çështja 222/84 [1986] PVGJE 1651, paragrafi 18; çështja C-424/99 2001, I-9285, paragrafi 45.

³⁸Çështja T-347/94 [1998] GJED PVGJE II 1751, paragrafi 311; çështja T-112/98 2001 II-729, paragrafi 59.

³⁹Çështja C-260/89 1991 I-2925, GJED paragrafi 41.

⁴⁰Av.Përgj. Warner, në opinionin e tij AM&S.

zhvillojë standarde më të larta të mbrojtjes, ose ato duheshin parë më tepër si përfaqësuese të standardit të vetëm të përbashkët mes të gjitha shteteve anëtare dhe, për pasojë, si standardi më i lartë (tavan) nga ku mund të nxirren parimet e përgjithshme të BE-së?

Në çdo rast, konsensusi në lidhje me KEDNJ-në duket se është që ajo përfaqëson një dysHEME më shumë sesa një tavan dhe që, ndërsa niveli i mbrojtjes për të drejtat nuk duhet të bjerë nën nivelin e parashikuar nga Konventa,⁴¹ e drejta e BE-së mund të sigurojë një mbrojtje më të madhe. Kjo është pikëpamja që mbizotëroi në hartimin e Kartës së BE-së për të drejtat themelore⁴².

Përveç KEDNJ-së, Gjykata herë pas here harton, megjithëse jo aq shpesh, instrumente të tjera rajonale dhe ndërkombëtare (Ahmed and Butler, 2006). Në çështjen *Defrenne k. Sabena III*,⁴³ Gjykata, duke menduar që eliminimi i diskriminimit gjinor ishte një e drejtë themelore e Komunitetit, mbështeti konkluzionin e saj nëpërmjet vërejtjes se “të njëjtat koncepte janë njohur nga Karta Sociale Evropiane e 18 nëntorit 1961 dhe nga Konventa nr.111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, e 25 qershorit 1958, për diskriminimin në lidhje me punësimin dhe profesionin”.⁴⁴ Në një sërë çështjesh, Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP) është identifikuar si një burim frymëzimi për parimet e përgjithshme të së drejtës së KE-së, megjithëse GJED-ja në rastin *Grant* ishte kundër shqyrtimit të një opinionit dhënë nga Komiteti i të Drejtave të Njeriut pranë KNDCP-së.⁴⁵

Në një mënyrë disi të diskutueshme në rastet *Kadi* dhe *Jusuf*, Gjykata e Shkallës së Parë vendosi se ajo nuk mund të rishikonte zbatimin nga ana e KE-së të Rezolutës së Këshillit të Sigurisë së OKB-së, që ngrinte asetet e individëve të dyshuar për përfshirjen në akte terroriste, për pajtueshmëri me parimet e përgjithshme të së drejtës komunitare.

⁴¹Çështja C-49/88 [1991] PVGJE I-3187, 3230-3231, Shih AV.Përgj.

⁴²Neni 52 (3) i Kartës.

⁴³Çështja 149/77 [1978] PVGJE 1365.

⁴⁴Çështja 6/75 [1975] PVGJE 823, 836.

⁴⁵Çështja C-249/96 [1998] PVGJEI-621, paragrafi 44-47.

Dhe nuk mund ta bënte atë rishikim sepse, ndonëse KE nuk është e detyruar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Karta e OKB-së, është e detyruar indirekt nga dispozitat e traktatit të KE-së për zbatimin e Kartës së OKB-së po aq sa edhe shtetet anëtare.⁴⁶ Megjithatë, GJSHP-ja vendosi se ajo mund ta rishikonte indirekt rezolutën e OKB-së për pajtueshmëri me parimet *ius cogens* të së drejtës ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.⁴⁷

Për më tepër, në një padi ndaj direktivës për bashkim familjar të BE-së, ngritur nga Parlamenti Evropian, GJED-ja, ndërsa përkrahte direktivën u bazua jo vetëm në GJED dhe KNDCP, por edhe në Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe iu referua, veç këtyre, edhe tri instrumenteve për të drejtat e njeriut në Këshillin Evropian, të cilat citoreshin nga vetë ajo direktivë.⁴⁸ Ky ishte gjithashtu rasti i parë në të cilin GJED-ja, në krahasim me GJSHP-në e cila e kishte cituar rregullisht Kartën, u mbështet shprehimisht në dispozitat e Kartës së BE-së për të drejtat themelore, e cila ishte shpallur politikisht në vitin 2000 dhe ishte përfshirë në Traktatin Kushtetues në vitin 2004, por statusi ligjor i saj mbeti i dykuptimtë pas mosratifikimit pasues të TK-së.

6. Instrumente të tjera juridike ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që veprojnë në BE.

Çështja më problematike në ndryshimet që kanë pësuar traktatet është mungesa e përmendjes së konventave të tjera të të drejtave të njeriut përveç KEDNJ-së. Neni 6 në paragrafin 3 të traktatit të Lisbonës pohon se mbron “të drejtat themelore siç garantohen KEDNJ-ja dhe traditat e përbashkëta kushtetuese të shteteve anëtare”⁴⁹. Megjithatë, kjo nuk e ka ndaluar GJED-në të bazohet në konventat e tjera të të drejtave të njeriut.

⁴⁶Çështja T-315/01 [2005] PVGJE II-3649, paragrafi 192-208, 221-225; çështja T-306/01 *Yusuf and Al Barakaat International Foundation v. Council and Commission* [2005].

⁴⁷ Çështja T-315/01 *Kadi*, nr 25 më lart, paragrafi 226-232; çështja T-306/01 *Yusuf*, nr.25 më lart, paragrafët 277-283.

⁴⁸Çështja C-540/03 *European Parliament v. Council* [2006] PVGJE I-5769, paragrafët 37-39, 57, 107 në veçanti.

⁴⁹ Nenin F/6 i BE-së.

Kërkuesit mund t'i mbështetin pretendimet e tyre edhe në traktatet e tjera ndërkombëtare përveç KEDNJ-së, në të cilat shtetet anëtare janë palë, për mbrojtjen e të drejtave të tyre themelore. Gjykata Evropiane e Drejtësisë në disa çështje radhazi ka përcaktuar Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, si pjesë e burimeve për mbrojtjen e të drejtave themelore⁵⁰.

Në çështjet Viking dhe Laval, Gjykata e Drejtësisë konsideroi si pjesë të parimeve të përgjithshme Kartën Evropiane Sociale (e vitit 1961) dhe në Konventën ILO Nr.87 Mbi Lirinë e Grumbullimit dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Organizimit. Në të dyja këto raste GJED-ja ka mbajtur të njëjtin qëndrim në lidhje me të drejtën e grevës.

Rrethanat e çështjes Federata Ndërkombëtare e Transportit të Punëtorëve dhe Bashkimi i Marinarëve Finlandez kundër Viking Line ABP dhe OU Viking Line Esti⁵¹ janë si vijon. Një ndërmarrje finlandeze e transportit detar kishte vendosur të vendosej në Estoni dhe, si rezultat i kësaj, të regjistronte një anije në Estoni. Ndërmarrja finlandeze do ta ndërmernte këtë hap, pasi donte të përfitonte nga krahu i punës, i cili ishte më i lirë në Estoni. Ky veprim u kundërshtua nga Bashkimi Tregtar Finandez, që ishte i lidhur me Federatën e Bashkimeve Tregtare me qëndër në Mbretërinë e Bashkuar. Po ashtu, punëtorët e Federatës e mbështetën këtë kundërshtim të Bashkimit Tregëtar Finlandez dhe kërcënuan se do të organizonin greva dhe bojkote, nëse ndërmarrja finlandeze nuk do të zbatonte kushtet e marrëveshjes kolektive të zbatuara në Finlandë për ekuipazhin që do të punonte në anijen e regjistruar në Estoni. Në çështjen *Laval un Partneri Ltd* kundër *Svenska Byggnadsarbetareförbundet*⁵², situata është e ngashme me rastin e parë. Një shoqëri tregtare ndërtimi letoneze kishte vendosur të zhvendoste punëtorët e saj në shoqëritë e saj vartëse në Suedi. Për të njëjtën punë punëtorët në Suedi pagueshin më

⁵⁰Çështja 374/87 [1989] GJED 3283, paragraph 31; Çështjet e Bashkuara C-297/88 dhe C-197/89 [1990] GJED I-3763, paragraph 68.

⁵¹Çështja C-438/05, [2007] GJED I-10779, çështja Federata Ndërkombëtare e Transportit të Punëtorëve dhe Bashkimi i Marinarëve Finlandez kundër Viking Line ABP dhe OU Viking Line Esti.

⁵²Çështja C-341/05, [2007] GJED I- 11767, çështja Laval un Partneri Ltd kundër Svenska Byggnadsarbetareförbundet.

shumë se ata në Letoni. Shoqëria pretendonte të zbatonte kontratat e punës të lidhura në Letoni edhe për punëtorët që do të transferoheshin në Suedi. Ky veprim i shoqërisë u kundërshtua nga Bashkimi Tregtar Suedez, i cili kërkonte nga shoqëria të zbatonte kontratat e punës kolektive të lidhura në Suedi për punëtorët që do të transferoheshin në këtë vend. Sipas saj ishte e papranueshme që për të njëjtën punë dhe brenda të njëjtës kompani, punëtorët të paguheshin me paga të ndryshme.

Në të dyja këto raste bashkëbisedimet me bashkimet tregtare dështuan dhe, si rezultat, ata ushtruan të drejtën e grevës për të detyruar shoqëritë të firmosnin kontratat kolektive respektive. Gjykatat kombëtare i kërkuan vendim paragjykimor GJED-së. A përbënin veprimet kolektive (në veçanti greva) kufizime në kundërshtim me nenet 43 dhe 49 të Komunitetit Evropian (aktualisht nenet 49 dhe 56 të TFBE)? Nëse po, a ishin të justifikuar këto kufizime sipas legjislacionit të Komunitetit Evropian?

GJED-ja rrëzoi argumentet në lidhje me mosaplikimin e neneve 43 dhe 49 të KE-së, për çështjen në shqyrtim. Së pari, ajo konstatoi se neni 137/5 i KE-së (neni 153/5 i TFBE) përjashtonte në mënyrë të shprehur nga fusha e zbatimit e të drejtës të Komunitetit, të drejtën e grevës. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se veprimet kolektive bien jashtë fushës të së drejtës komunitare në lidhje me lëvizjen e lirë. Së dyti, GJED-ja theksoi se e drejta për të ndërmarrë veprime kolektive, e njohur nga konventat ndërkombëtare, është njohur gjithashtu nga e drejta e Komunitetit si pjesë e parimeve të përgjithshme të legjislacionit komunitar. Gjykata iu referua Kartës Evropiane Sociale (viti 1961) dhe Konventës ILO nr.87 mbi Lirinë e Grumbullimit dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Organizimit, respektivisht në paragrafët 43 dhe 90 të vendimit, për secilën çështje. Kjo e drejtë nuk është absolute dhe si e tillë ajo mund të jetë objekt i kufizimeve. Kufizimet duhet të jenë në përputhje me të drejtat e tjera themelore dhe parimet e sanksionuara në TKE, sidomos me parimin e proporcionalitetit.

Gjykata mbajti qëndrimin se marrëveshjet kolektive në fjalë përbënin një pengesë për të ushtruar lirinë e ofrimit të shërbimeve nga shoqëritë tregtare, duke marrë parasysh faktin se këto marrëveshje vështirësonin ushtrimin e lirive sipas TKE. Sipas GJED-së, mund të vendoseshin kufizime të lirive nëse ato justifikoheshin nga një interes thelbësor publik. Mbrojtja e të drejtave të punëtorëve në shtetin anëtar pritës përbënte interes publik. Masat e marra duhet gjithashtu të plotësonin kushtet që t'i shërbenin qëllimit për të cilin ishin marrë dhe të mos shkonin përtej asaj që ishte e nevojshme për arritjen e qëllimit. Si rezultat, bashkimet tregtare mund të ndërmarrin veprime kolektive nëse ato janë të justifikuara sipas interesit publik, sigurisë publike ose shëndetit si dhe respektojnë parimin e proporcionalitetit.

Në çështjen *Bressol*⁵³, Gjykata interpretoi nenin 13/2 mbi aksesin në edukim sipas Paktit për të Drejtat Ekonomike, Sociale, dhe Kulturore. Ndërsa në çështjen *C 540/03*⁵⁴, GJED iu referua Konventës mbi të Drejtat e Fëmijëve të Kombeve të Bashkuara, si pjesë e parimeve të përgjithshme të së drejtës së Bashkimit.

Më e diskutueshme ka qenë praktika e BE-së në vitet e fundit lidhur me instrumentet e tjera të Këshillit të Evropës për të drejtat e njeriut, siç është Konventa për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore, ku BE-ja ka insistuar në përfshirjen e një “klauzole ndarëse”, e cila efektivisht parashikon që BE-ja dhe shtetet anëtare, në marrëdhëniet mes tyre, do të zbatojnë normat e së drejtës komunitare mbi trafikimin qenieve njerëzore, më tepër sesa dispozitat e Konventës së re⁵⁵.

Kjo praktikë është kritikuar për dobësim të zbatimit të konventave të të drejtave të njeriut të këtij lloji për BE-në dhe shtetet e saj anëtare dhe për lejimin e mundshëm të zbatimit të standardeve më të ulëta të të drejtave të njeriut, në nivel më të ulët se dysHEMEJA e vendosur nga vetë instrumenti i Këshillit të Evropës (Holovaty, 2005).

⁵³Çështja C-73/08 *Bressol*, [2010] GJED I- 02735.

⁵⁴Çështja C 540/03 Parlamenti kundër Këshillit [2006] GJED I 5769, paragraph 37.

⁵⁵Nenin 40 (3) i Konventës së Këshillit të Europës.

Rrjeti i ekspertëve të pavarur të BE-së mbi të drejtat e njeriut, themeluar në vitin 2002, ka argumentuar gjithmonë që standardet e mbrojtjes të të drejtave themelore brenda të drejtës së BE-së (në veçanti siç shprehen në Kartën e BE-së) duhet “të indeksohen” sipas standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, në mënyrë që të shmangin kërkesën ndaj shteteve anëtare për të zgjedhur mes besnikërisë së tyre për të drejtën e BE-së dhe angazhimeve të tyre të tjera ndërkombëtare⁵⁶.

7. Karta e të Drejtave Themelore në Bashkimin Evropian.

Ideja për hartimin e Kartës për të Drejtat Themelore u formësua gjatë Presidencës Gjermane në Bashkimin Evropian, në fillim të vitit 1999. Këshilli Evropian i vitit 1999 ishte ai që ndërmori iniciativën për hartimin e një Karte të të Drejtave Themelore për BE-në. Ky zhvillim erdhi pas shumë vitesh diskutime nëse BE-ja duhej të miratonte KEDNJ-në ose duhej të kishte Kartën e vet të të Drejtave. Procesi i Konventës së re, me të cilin ishte adoptuar Karta dhe që u bë një model për Konventën pasuese mbi të ardhmen e Evropës prodhoi një projektkartë në më pak se një vit, duke ndjekur një procedurë relativisht më të hapur dhe me një pjesëmarrje më të madhe sesa pothuajse çdo iniciativë paraardhëse e KE-së ose BE-së (De.Burca, 2001). Në qershor të vitit 1999 Këshilli Evropian i Këln-it miratoi fillimin e procesit për hartimin e një deklaratë për të drejtat themelore, e cila më vonë mund të përfshihej në traktate. Kjo deklaratë do të hartohej me pjesëmarrjen e Parlamentit Evropian, të parlamenteve kombëtare dhe të përfaqësuesve të qeverive të Shteteve Anëtare. Përkatësisht, në të morën pjesë 15 përfaqësues nga qeveritë e shteteve anëtare, 16 anëtarë nga Parlamenti Evropian si dhe 30 anëtarë nga parlamentet kombëtare. Punimet filluan në dhjetor të vitit 1999. Ato përfunduan në kohë për Këshillin Evropian të Nisës, në dhjetor të vitit 2000. Karta u nënshkrua në dhjetor të vitit 2000, nga Parlamenti Evropian, Këshilli dhe Komisioni, me rastin e Këshillit Evropian të Nisës. Karta u shpall solemnisht nga Komisioni,

⁵⁶ Marrë nga http://EC.europa.eu/justice_home/cfr_cdf/index_en.htm.

Parlamenti dhe Këshilli dhe u aprovua politikisht nga shtetet anëtare në Nisë, në samitin e Këshillit Evropian në dhjetor 2000.

Karta u hartua “sikur” të kishte efekt të plotë ligjor, (Betten, 2001) por çështja e statusit të saj ligjor përfundimtar ishte lënë të vendosej nga procesi politik që vinte pas deklaratave të Këshillit Evropian në Nisë dhe Leaken (De Witte, 2001). Kjo, nga ana e saj, çoi në vitin 2004 në hartimin e Traktatit Kushtetues nga Konventa mbi të ardhmen e Europës, që përfshiu edhe Kartën e të Drejtave Themelore, me një sërë amendamentesh, si pjesa II e tekstit kushtetues prej tri pjesësh. Me fjalë të tjera, po të qe ratifikuar Traktati Kushtetues siç u parashikua në vitin 2005, Karta e të Drejtave Themelore do të ishte bërë pjesa themelore detyruese e një Kushtetute Evropiane. Për herë të parë, në Konventën për të Ardhmen e Evropës, u propozua përfshirja e plotë e Kartës në pjesën e dytë të Kushtetutës. Inkorporimi i saj në Traktatin Kushtetues u kushtëzua nga disa ndryshime që duhet të bëheshin në dispozitat përfundimtare të saj. Këto ndryshime do të shërbenin për të kujtuar se Karta zbatohet vetëm në fushat e kompetencës së Bashkimit. Si rrjedhojë e rezultatit negativ të referendumit holandez dhe francez, në lidhje me vetë Kushtetutën, Karta nuk pati rezultatet e pritura. Teksti i rishikuar i Kartës u nënshkrua edhe një herë nga Parlamenti, Këshilli dhe Komisioni më 12 dhjetor 2007. Traktati i Lisbonës nuk e përfshin Kartën në Traktat, por i jep asaj vlerë ekuivalente me atë të traktateve. Traktati i Lisbonës e bën Kartën të detyrueshme nëpërmjet modifikimit të nenit 6, por nuk e ka bërë pjesë të traktatit. Mendohet se kjo ka ardhur për shkak të kundërshtimeve të atyre shteteve që kishin firikë të kontrolloheshin me përpikëri nga ana e Gjykatës së Drejtësisë për këto fusha të veçanta (Canaj, 2010).

Ajo ka natyrën e një marrëveshjeje ndërinstitucionale, e cila të paktën në planin politik ishte e detyrueshme për institucionet. Konkretisht, Komisioni vendosi se çdo akt legjislativ i propozuar nga ai, do të ishte subjekt i kontrollit paraprak të përpuethshmërisë së tij me Kartën. Që nga krijimi i Agjencisë për të Drejtat Themelore,

Komisioni i ka referuar fillimisht propozimet legislative te kjo agjenci për të kontrolluar përputhshmërinë e tyre me Kartën. Parlamenti Evropian ka dërguar përpara Gjykatës së Drejtësisë aktet legislative të BE-së për të kontrolluar përputhjen e tyre me të drejtat e njeriut, duke përfshirë edhe ato të drejta të parashikuara nga Karta. Ajo u përdor si dokument referues nga gjyqtarët e Gjykatës së Drejtësisë⁵⁷ dhe në disa raste edhe nga gjyqtarët e Gjykatës së Strasburgut, p.sh në çështjen *Bosphorus*.⁵⁸ Karta synonte t'i bënte më të qarta të drejtat ekzistuese për qytetarët evropianë, si dhe për t'i përshtatur ato më mirë me zhvillimin e shoqërisë. Hartuesit e Kartës vendosën t'i jepnin asaj një formë juridike, në mënyrë që në rast nevojë ajo të mund të përfshihej pa ndryshime në traktate.

7.1. Përmbajtja e Kartës.

Karta ka prirje të themelojë bazat e një Bashkimi Evropian, i cili synon të garantojë dhe të respektojë më së miri edhe të drejtat e shtetasve evropianë, të cilat nuk janë ekskluzivisht me karakter ekonomik. Karta ka si qëllim forcimin e mbrojtjes të të drejtave themelore duke marrë parasysh ndryshimet në shoqëri, përparimin shoqëror si dhe zhvillimet shkencore e teknologjike, duke i bërë këto të drejta më të dukshme. Karta konfirmon se të drejtat e njeriut janë të pandashme, të ndërlidhura me njëra - tjetrën dhe të pavarura. Ajo përmban të drejta politike, civile, sociale dhe ekonomike. Këto të drejta paraqiten në 50 nene, të cilat janë të ndara në 6 tituj. Për herë të parë në një dokument të këtij tipi gjejmë të bashkuara të drejtat civile dhe politike me të drejtat ekonomike dhe sociale. Ekuilibri i arritur midis këtyre dy kategorive përcakton ato që sot quhen vlera të përbashkëta të të gjitha shteteve anëtare. Ky ekuilibër ka qënë i vështirë për t'u arritur sepse në fushën e të drejtave sociale shfaqen ndryshime midis modeleve sociale që ka përqaftuar secili shtet anëtar (Jacquè, 2010). Karta qëndron në themel të të gjithave

⁵⁷Çëshja C-540/03 Parlamenti Evropian kundër Këshillit [2006] GJED I-5769. Më pas Karta është referuar edhe në çështje të tjera si, C-303/05 Advocaaten voor de Wareld VZW kundër Leden van de Ministerraad [2007] ECR I-3635.

⁵⁸Vendim i GjEDNj-së Bosphorus kundër Irlandës, datë 30 Qershor 2005.

institucioneve dhe bëhet drejtpërdrejt e zbatueshme me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës. Qytetarët e BE-së mund t'i drejtohen Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut vetëm kur plotësojnë kërkesat e nenit 263/4 të TBE (ish neni 130 parag.4, i TBE-së), sipas të cilit ata duhet të jenë të prekur specifikisht nga një masë e institucioneve të BE-së, agjenci ose organ (Zajmi, 2009). Preambula e Kartës deklaron se BE-ja njeh të drejtat, liritë dhe parimet e ekspozuara aty. Bashkimi i ka rrënjët tek vlerat e pandashme dhe universale të dinjitetit njerëzor, lirisë, barazisë dhe solidaritetit. Ai kontribuon për ruajtjen dhe zhvillimin e këtyre vlerave të përbashkëta duke respektuar njëkohësisht larminë e kulturave dhe traditave të popujve të Evropës, identitetet kombëtare të shteteve anëtare si dhe organizimin e autoriteteve të tyre publike në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor. Që në preambul sqarohet se Karta nuk krijon të drejta të reja. Ajo synon të bëjë një përmbledhje të të drejtave ekzistuese duke bërë një përmbledhje krijuese të të drejtave të përfshira në marrëveshjet e ndryshme evropiane e ndërkombëtare dhe në kushtetutat kombëtare, të cilat GJED-ja kishte vite tashmë që i përdorte. Madje, në mënyrë eksplicite në të përmendet se ajo ripohon të drejtat që rrjedhin prej traditave kushtetuese dhe detyrimeve ndërkombëtare që janë të përbashkëta për shtetet anëtare prej Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Kartës Sociale të miratuar nga Bashkimi dhe nga Këshilli i Evropës si dhe nga jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së BE-së dhe GJEDNJ-së. Një temë që ka ngjallur mjaft debate ka qenë edhe fakti nëse Karta krijon të drejta të reja. Mbretëria së Bashkuar përkrah shqetësimin se Karta krijon të drejta të reja dhe sipas pikëpamjes së saj, një nga këto është e drejta për bisedime kolektive dhe veprim kolektiv (neni 28 i Kartës për të Drejtat Themelore). Ky nen sanksionon se: “Në përputhje me të drejtën e Bashkimit dhe me ligjet e praktikat kombëtare, punonjësit dhe punëdhënësit apo organizatat e tyre përkatëse kanë të drejtën e bisedimeve kolektive dhe të drejtën për të nënshkruar marrëveshje kolektive sipas niveleve të përshtatshme

dhe, në rastet e konflikteve të interesit, të ndërmarrin veprime kolektive për mbrojtjen e interesave të tyre, përfshirë grevën”. Në kohën e hartimit të këtij neni në Mbretërinë e Bashkuar nuk ekzistonte në mënyrë specifike e drejta për të bërë grevë. Rrjedhimisht u ngrit çështja nëse neni 28 i Kartës krijonte një të drejtë të re në legjislacionin e Mbretërisë së Bashkuar.

Sipas shpjegimeve⁵⁹, për të drejtat e parashkuara nga Karta, neni 28 është bazuar në nenin 6 të Kartës Sociale Evropiane, pikat 12-14 në Kartën e Komunitetit mbi të Drejtat Themelore Sociale të Punëtorëve, si dhe në nenin 11 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Neni 11 i Konventës është interpretuar nga GJEDNJ-ja⁶⁰ se përfshin edhe të drejtën për veprime kolektive. Megjithatë, neni 11 përmban një të drejtë relative dhe si i tillë mund të jetë objekt i kufizimeve nga e drejta e shteteve anëtare.

Gjithsesi, është për t`u përmendur se e drejta për grevë është njohur nga e drejta e BE-së dhe jurisprudenca e GJED-së, si p.sh. në çështjen *Federata Ndërkombëtare e Transportit të Punëtorëve dhe Bashkimi i Marinarëve Finlandez kundër Viking Line ABP dhe OU Viking Line Esti*⁶¹ ose në çështjen *Laval un Partneri Ltd kundër Svenska Byggnadsarbetareförbundet*.⁶² Në këto dy çështje gjykata jo vetëm që ka njohur të drejtën e grevës, por edhe ka shtjelluar mënyrën e interpretimit të kësaj të drejte sipas legjislacionit të BE-së. Përmbajtja e Kartës sipas titujve është si vijon:

Titulli I: Dinjiteti, afirmon mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, të drejtën për të jetuar, të drejtën e integritetit të njeriut, ndalimin e torturës dhe trajtimit apo dënimit çnjerëzor ose degradues, si dhe ndalimin e skllavërisë dhe punës së detyruar.

Titulli II: Liritë, garantojnë disa të drejta, si: të drejtën për liri dhe siguri, të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, të drejtën për mbrojtjen e të dhënave

⁵⁹ Marrë nga: Official Journal of the European Union, 2007, No C 303.

⁶⁰Vendim i GJEDNJ-së S.Cmidt dhe Dahlstrom kundër Suedisë, datë shkurt 1976.

⁶¹Çështja C-438/05 Federata Ndërkombëtare e Transportit të Punëtorëve dhe Bashkimi i Marinarëve Finlandez kundër Viking Line ABP dhe OU Viking Line Esti, [2007] GJED I-10779.

⁶²Çështja C-341/05 Laval un Partneri Ltd kundër Svenska Byggnadsarbetareförbundet, [2007] PVGJE I-11767.

personale, të drejtën për t'u martuar dhe për të krijuar familje, lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, lirinë e shprehjes dhe të informimit, të drejtën e tubimit dhe bashkimit, lirinë për artin dhe shkencën, të drejtën për arsimim, të drejtën për të zgjedhur profesionin dhe të drejtën për punën, lirinë e sipërmarrjes, të drejtën e pronës, të drejtën për të kërkuar strehim, si dhe mbrojtja në rast largimi, dëbimi apo ekstradimi.

Titulli III: Barazia, garanton barazinë përpara ligjit, mosdiskriminimin, respektimin e larmisë kulturore fetare dhe gjuhësore, të drejtat e fëmijëve, të drejtat e të moshuarve, si dhe integrimin e personave me aftësi të kufizuara.

Titulli IV: Solidariteti, siguron për punëtorët të drejtën për t'u informuar dhe për t'u këshilluar brenda ndërmarrjes, të drejtën për bisedime kolektive dhe veprim kolektiv, të drejtën për të përdorur shërbimet e punësimit, të drejtën e mbrojtjes në rast pushimi të pajustificuar nga puna, ndalimin e punës së fëmijëve dhe mbrojtjen e të rinjve në vendin e punës, të drejtën e sigurimeve shoqërore dhe ndihmën sociale, të drejtën e kujdesit shëndetësor, të drejtën e shërbimit me interes të përgjithshëm ekonomik, të drejtën e mbrojtjes mjedisore, si dhe të drejtën e mbrojtjes së konsumatorit.

Titulli V: Të drejtat e shtetasve, garanton të drejtën e votës në Parlamentin Evropian dhe në zgjedhjet vendore, të drejtën e miradministrimit, të drejtën për t'u njohur me dokumentet, të drejtën për t'iu drejtuar Avokatit Evropian të Popullit, të drejtën për peticion, lirinë e lëvizjes dhe të vendbanimit, si dhe të drejtën për mbrojtjen diplomatike dhe konsullore.

Titulli VI: Drejtësia, siguron të drejtën për zgjidhje ligjore të efektshme dhe gjykim të drejtë, prezumimin e pafajësisë, të drejtën e mbrojtjes, të drejtën për të mos u gjykuar apo ndëshkuar dy herë në proces penal për të njëjtën veprë, si dhe parimin e legjitimitetit dhe proporcionalitetit për veprat penale dhe dënimet.

Karta përmban disa dispozita novatore, për shembull, ndalimin e klonimit riprodhues njerëzor, sikundër dhe ka bërë heqje të dukshme, për shembull, mbrojtjen e të drejtave

të minorenëve (përmbajtja e Kartës). Katalogu i saj është zgjeruar me të drejta të tilla si: liria e artit dhe shkencës, e drejta e zgjedhjes së profesionit dhe për të punuar, liria e drejtimit të një biznesi, e drejta e integritetit të personit, ndalimi i trafikimit të qenieve njërëzore si një formë skllavërie, të drejtat e të moshuarve, të personave me të meta, e drejta për të arritur marrëveshje kolektive të punës, e drejta për mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e konsumatorit, e drejta për miradministrim, e drejta e informimit mbi dokumentet zyrtare, e drejta e peticionit, si dhe e drejta për mbrojtjen diplomatike e konsullore. Siç shikohet Karta përmban një listë shumë të gjerë të drejtash ekonomike, sociale dhe kulturore përveç atyre civile e politike që janë të përbashkëta me KEDNJ-në. Në rastin e Kartës këto të drejta janë më gjithëpërfshirëse (Daci, 2011).

7.2. Standardi i ri i mbrojtjes që krijon Karta në Bashkimin Evropian dhe referencat e Gjykatës.

Kapitulli i fundit i Kartës përmban klauzolat e përgjithshme që lidhen me fushën e zbatimit të Kartës, subjektet të cilave ajo i adresohet, marrëdhëniet e saj me instrumentet e tjera ligjore dhe “standardin” e mbrojtjes. Neni 51 i Kartës dhe neni 6/1 i Traktatit të Bashkimit Evropian përcakton fushën e zbatimit të Kartës. Karta sanksionon në mënyrë të shprehur se ajo nuk e zgjeron fushën e zbatimit të së drejtës së Bashkimit përtej kompetencave të Bashkimit. Ajo nuk përcakton asnjë kompetencë a detyrë të re për Bashkimin dhe as nuk modifikon kompetencat dhe detyrat e përcaktuara në traktate. Karta u drejtohet institucioneve, organeve, zyrave dhe agjencive të Bashkimit si dhe shteteve anëtare, “vetëm” kur ato zbatojnë legjislacionin e Bashkimit. Shtetet anëtare dhe institucionet e Bashkimit respektojnë të drejtat, mbikëqyrin parimet dhe promovojnë zbatimin e tyre në përputhje me kompetencat përkatëse. Ato respektojnë kufizimet e kompetencave të Bashkimit ashtu siç ia kanë deleguar traktatet.

Pra, Karta nuk zbatohet në rastin e së drejtës kombëtare të shteteve anëtare kur kjo e drejtë nuk vjen si rezultat i zbatimit të legjislacionit të Bashkimit. Kur një shtet anëtar

vepron në një fushë që mbulohet nga kompetenca ekskluzive e Bashkimit ose nga një kompetencë joekskluzive, por që ushtrohet nga Bashkimi, veprimet e tij duhet të kryhen në respektim të Kartës. Fakti që Karta e detyron Bashkimin të respektojë p.sh. lirinë e shprehjes nuk do të thotë se e lejon atë të miratojë një direktivë për harmonizimin e legjislacioneve kombëtare në këtë fushë. Bashkimi nuk ka kompetencë të përgjithshme për të nxjerrë akte në fushën e të drejtave të njeriut.

Megjithatë, edhe pse Karta dhe Traktati i Bashkimit Evropian shprehet qartë për fushën e zbatimit të Kartës, disa shtete si Britania e Madhe dhe Polonia, druajtën se interpretimi i Kartës nga GJED mund të shtrihej në fusha të tjera të së drejtës kombëtare të shteteve (Kaczorowska, 2011: 244). Për këtë arsye këto shtete nënshkruan protokollin 30, të cilit iu bashkua më vonë edhe Çekia.

Ka autorë që mendojnë se neni 51 paraqet dy mundësi të ndryshme të të vepruarit të Bashkimit Evropian. Paragrafi i dytë i nenit 51 e paraqet Kartën thjesht si një formë të kodifikuar ose të plotësuar të asaj çka ekzistonte në jurisprudencën e GJED-së. Pra, sipas këtij paragrafi ajo është një set i gjerë standardesh ndaj të cilëve veprimet e BE-së dhe të shteteve anëtare do të gjykohen brenda shtrirjes ekzistuese të politikave dhe kompetencave të BE-së dhe jo si një burim ose bazë për veprime pozitive. Ndërsa paragrafi i parë i nenit 51, i cili vendos detyrimin për të nxitur të drejtat, sugjeron diçka më proaktive.

Si përfundim, duke mbajtur parasysh përmbajtjen e të dy paragrafëve, konstatojmë se, shtetet anëtare për të respektuar, mbikëqyrur dhe nxitur të drejtat e Kartës, duhet të “respektojnë” kufijtë e kompetencave që i jepen Bashkimit nga traktatet themeluese. Po ashtu, Karta nuk “zgjeron sferën e zbatimit” të së drejtës së BE-së.

Në Bashkimin Evropian është ngritur pyetja nëse të drejtat themelore kanë opo jo efekt ndërmjet palëve private dhe nëse mund të kërkojë njëra palë private respektimin e të drejtave themelore nga palët e treta private. Kjo çështje është njohur ndryshe edhe si

“efekti horizontal” i të drejtave të njeriut. Efekti horizontal ndahet në dy kategori, në direkt dhe indirekt (Besselink, 2012). Në efektin horizontal direkt, palët që kërkojnë njohjen e të drejtave themelore ndërmjet njëra-tjetrës, janë palë private. Efekti horizontal indirekt ka të bëjë përsëri me marrëdhënjet ndërmjet palëve private, por këto marrëdhënie rregullohen nga një akt i autoritetit publik. Në disa raste edhe vendimet e gjykatës janë të përfshira në këtë kategori.

Përgjithësisht në shtetet anëtare nuk pranohet zbatimi i efektit horizontal të drejtpërdrejtë për të drejtat e njeriut sipas kushtetutave kombëtare të tyre. Detyrimin primar për të respektuar të drejtat themelore e kanë autoritetet publike. Megjithatë, ka kushtetuta të shteteve anëtare që e pranojnë në mënyrë të shprehur aplikimin e efektit horizontal direkt për disa të drejta. P.sh. në Qipro pranohet efekti horizontal direkt për të drejtën e jetës private, korrespondencës dhe komunikimit⁶³.

Nga interpretimi literal i nenit 51/1 përjashtohet efekti i drejtpërdrejtë i klauzolës horizontale, duke qënë se palët private nuk bëjnë pjesë në subjektet të cilave u drejtohet Karta. Mirëpo qëndrimi i GJED-së tregon të kundërtën. Në praktikën e saj të konsoliduar⁶⁴, Gjykata i ka dhënë efekt horizontal të drejtpërdrejtë lirisë së lëvizjes së punëtorëve, lirisë së ofrimit të shërbimeve dhe lirisë së vendosjes. Po ashtu të drejtave të qytetarisë së BE-së u është njohur efekt i drejtpërdrejtë. Të drejta, të cilat janë mishëruar tashmë edhe në Kartë⁶⁵.

GJED-ja e ka bërë të qartë se të drejtat kolektive, ashtu siç janë parashikuar nga neni 28 i Kartës, kanë efekt horizontal të drejtpërdrejtë. Këtë qëndrim ajo e ka mbajtur në

⁶³Neni 15 i Kushtetutës së Qipros.

⁶⁴Çështja 36/74 *Walrave and Koch* [1974] PVGJE 1405, paragraph 17; Case 13/76 *Donà* [1976] PVGJE 1333, paragraph 17; *Bosman*, paragraph 82; Joined Cases C 51/96 and C 191/97 *Delière* [2000] PVGJE I 2549, paragraph 47; Case C 281/98 *Angonese* [2000] ECR I 4139, paragraph 31; Case C 309/99 *Wouters and Others* [2002] PVGJE I 1577, paragraph 120.

⁶⁵ Neni 15/2 dhe neni 45, i Kartës.

çështjet Viking⁶⁶ dhe Laval⁶⁷. Si konkluzion, mund të themi se për të tilla të drejta zbatohet efekti horizontal i drejtpërdrejtë.

Neni 51/1 i Kartës ka efekt horizontal indirekt, në rastet kur çështjet kanë të bëjnë me veprimet e shteti anëtar, i cili vepron brenda fushës të së drejtës së Bashkimit. Dispozita zbatohet edhe në rastet kur shteti anëtar dështon të veprojë. Një rast i tillë është kur shteti nuk vepron apo kur vepron por nuk merr të gjitha masat e nevojshme p.sh. për të bërë të zbatueshme një direktivë përsa u përket kushteve të të punës. Kërkuesit mund të kërkojnë shkelje të të drejtave të parashikuara nga direktiva sipas legjislacionit të Bashkimit Evropian. Gjykata ka mbajtur këtë qasje në çështjen *Mangold*⁶⁸ dhe *Kücükdeveci*⁶⁹.

Po ashtu, ka pasur debate në lidhje me dallimin ligjor ndërmjet parimeve, të drejtave dhe lirive sipas Kartës. Amendamenti më i debatuar i Kartës ka qenë paragrafi 5 i nenit 52, i cili bën dallimin e dispozitave të Kartës që përmbajnë “parime”. Sipas këtij paragrafi, këto dispozita do të kishin “kompetencë gjyqësore” vetëm kur:

- a) ato ishin implementuar me akte legjislativë ose ekzekutive të BE-së ose të shteteve anëtare, dhe
- b) vetëm në lidhje me interpretimin ose vendimet mbi ligjshmërinë e këtyre akteve.

Kjo dispozitë duket se ka synimin të përfshijë në Kartë dallimin tradicional mes të drejtave civile dhe politike, që konsiderohen të drejta negative, dhe të drejtave ekonomike e sociale, që konsiderohen të drejta pozitive. Karta mbështetet në dallimin midis të drejtave dhe parimeve. Të drejtat mund të përdoren drejtpërsëdrejti nga individët, kurse të dytat mund të përdoren vetëm nëpërmjet masave që i vënë ato në zbatim. Pra, është e mundur të kundërshtohet në Gjykatë vlefshmëria e një akti të Bashkimit që do të binte në kundërshtim me një parim. Për shembull një legjislacion që

⁶⁶Çështja C-438/05 Viking, [2007] ECR I-10779.

⁶⁷Çështja C-341/05 Laval un Partneri Ltd kundër Svenska Byggnadsarbetareförbundet, [2007] PVGJE I-.

⁶⁸Çështja C-144/04 Mangod, [2005] PVGJE I-0998.

⁶⁹Çështja C- 555/07 Küçükdeveci, [2010] PVGJE I-00365.

do të sillte pasoja të dëmshme për mjedisin do të anulohet për shkelje të së drejtës për mbrojtje mjedisore. I takon gjyqtarit t'i identifikojë parimet, sepse Karta nuk bën ndonjë dallim të qartë midis të drejtave dhe parimeve, kur dihet për më tepër që jo të gjitha të drejtat sociale përbëjnë parime. Për shembull, garantimi i vendit të punës në rast leje linjdjeje krijon një të drejtë që mund të kërkohet të mbrohet drejtpërdrejt në gjykatë.

Për aq kohë sa kjo Kartë përmban të drejta të cilat u korrespondojnë të drejtave të garantuara nga Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, kuptimi dhe shtrirja e këtyre të drejtave do të jetë e njëjtë me ato të vendosura nga Konventa e përmendur. Neni 52/3 sanksionon se: “kuptimi dhe fusha e veprimit e këtyre të drejtave do të jetë e njëjtë me ato që parashikohen në KEDNJ”. Sipas këtij përkufizimi kuptimi dhe fusha e veprimit të këtyre të drejtave të parashikuara nga Karta do të jetë në varësi të interpretimit të KEDNJ-së nga GJEDNJ-ja.

Neni 52/3 synon të nxitë harmoninë midis dispozitave të Konventës Evropiane dhe atyre të Kartës, ndonëse nuk e pengon BE-në të zhvillojë një mbrojtje më të gjerë nga sa është parashikuar në Konventë. GJEDNJ-ja është shprehur se: “Konventa është një instrument i gjallë, i cili duhet të interpretohet nën dritën e kushteve aktuale dhe në përputhje me zhvillimet e së drejtës ndërkombëtare, me qëllim që të reflektojë standardet më të larta të kërkuara në fushën e mbrojtjes të të drejtave të njeriut”⁷⁰. Ky qëndrim i GJEDNJ-së është konsoliduar tashmë.

Të drejtat e parashikuara në Kartë mund të zhvillohen si rezultat i zhvillimit të traditave kushtetuese të shteteve anëtare, të cilat mund të kenë një interpretim më të përparuar me kalimin e kohës. Gjithashtu, në këtë kuadër edhe GJEDNJ-ja do të ketë një rol të rëndësishëm në interpretimin dinamik të Kartës. Shumica e traditave të përbashkëta kushtetuese të shteteve anëtare përkon me të drejtat e parashikuara në KEDNJ-në, ashtu siç janë interpretuar nga GJEDNJ-ja.

⁷⁰Vendimi i Gjednj Demir dhe Baykara kundër Turqisë, datë 12.11.2008.

7.3. Interpretimi i Kartës. Analize e neneve 51- 54 te saj.

Neni 51(1) tregon se Karta u drejtohet institucioneve dhe organeve të BE-së dhe të shteteve anëtare, vetëm kur ata janë “duke zbatuar” të drejtën e Unionit. Një përmendje e përciptë e parimit të varësisë është bërë në këtë kontekst, megjithëse kuptimi i tij është i vështirë për t’u shquar. Neni 51 vijon të përcaktojë që BE-ja dhe shtetet anëtare “respektojnë të drejtat, mbikëqyrin parimet dhe nxitin zbatimin e tyre në përputhje me kompetencat e tyre përkatëse”. Ky detyrim “për të nxitur” të drejtat në Kartë përplasat me frazën negative të fjalisë që vijon në nenin 51(2) dhe e cila pohon se Karta nuk krijon asnjë kompetencë ose detyrë të re për KE-në ose BE-në⁷¹.

Me fjalë të tjera, dy mundësi të ndryshme janë prezantuar nga pjesë të ndryshme të nenit 51. Paragrafi (2) e paraqet Kartën thjesht si një formë të kodifikuar ose të plotësuar të asaj çka ekzistonte në jurisprudencën e GJED-së: domethënë një set i gjerë standardesh ndaj të cilëve veprimet e BE-së dhe shteteve anëtare do të gjykohen brenda shtrirjes ekzistuese të politikave dhe kompetencave të BE-së dhe jo si një burim ose bazë për veprime pozitive, ndërsa detyrimi për të nxitur të drejtat sugjeron diçka më proaktive⁷². Në nenet 52 deri në nenin 54 të saj parashikohet mënyra se si do të interpretohen të drejtat e njohura nga Karta. Çështja e mbivendosjes mes dispozitave ekzistuese të së drejtës komunitare dhe dispozitave të reja të Kartës zgjidhet duke siguruar se të drejtat e njohura nga Karta, të cilat janë “të bazuara mbi “Traktatet e KE-së ose BE-së do të ushtrohen në kushtet dhe brenda kufijve të caktuar nga këto traktate”. Kjo mënyrë formulimi në Kartë shmang çdo ndryshim të mundshëm në interpretimin e dispozitave me formulim të ngjashëm të Kartës dhe traktateve të BE. Karta nuk mund të interpretohet se kufizon të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, ashtu siç njihen në

⁷¹ Neni 51 paragrafi 2 konfirmon se Karta mund të mos ketë efektin e zgjerimit të kompetencave dhe të detyrave të cilat Traktati i jep Komunitetit dhe Unionit. Përmendja e shprehur është bërë këtu si pasojë logjike e parimit të shtesës dhe të faktit se Unioni ka vetëm pushtetet që i janë dhënë. Të drejtat themelore siç garantohen në Union nuk kanë ndonjë efekt tjetër veç në kontekstin e pushteteve të vendosura nga Traktati.

⁷² Shih fjalimin e Komisionerit Vitorino në Parlamentin Evropian në 17 prill 2002, “The Future of fundamental Rights in the EU

fushat përkatëse të zbatimit nga e drejta e Bashkimit dhe e drejta ndërkombëtare si dhe nga marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Bashkimi dhe shtetet anëtare janë palë (Neni 53 i Kartës). Në interpretimin e Kartës, ashtu si parashikohet në të, merren plotësisht parasysh ligjet dhe praktikat kombëtare. Karta nuk mund të interpretohet se nënkupton të drejtën për t'u angazhuar në veprimtari apo për të kryer ndonjë veprim që synon shkatërrimin e ndonjë prej të drejtave dhe lirive të njohura nga kjo Kartë apo kufizimin e tyre në një masë më të madhe nga ç'parashikohet në të.

Neni 52 (1), i cili mbështetet si në jurisprudencën e KEDNJ-së edhe në atë të GJED-së, përmban një klauzolë të përgjithshme “cenimi” që tregon natyrën e kufizimeve mbi të drejtat e Kartës, të cilat do të jenë të pranueshme (Triantafyllou, 2002). Çdo kufizim në ushtrimin e të drejtave dhe lirive të përfshira në Kartë duhet të “jetë i parashikuar me ligj” dhe duhet të respektojë *thelbin* e këtyre të drejtave dhe lirive. Kufizimet duhet të plotësojnë kërkesat për proporcionalitet dhe duhet të jenë “të nevojshme dhe të plotësojnë vërtet objektivat e interesit të përgjithshëm, të njohur nga Unioni, ose nevojën për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e të tjerëve”⁷³.

Neni 52 (2) më pas shtron çështjen e mbivendosjes mes dispozitave ekzistuese të së drejtës komunitare dhe dispozitave të reja të Kartës, duke siguruar se të drejtat e njohura nga Karta, të cilat janë “të bazuara mbi” Traktatet e KE-së ose BE-së “do të ushtrohen në kushtet dhe brenda kufijve të caktuar nga këto traktate”. Kjo duket se synonte të shmangte çdo ndryshim të mundshëm në interpretimin e dispozitave me formulim të ngjashëm të Kartës dhe traktateve të KE/BE-së, megjithëse shprehja “të bazuara në” është ndoshta disi e paqartë. Memorandumi shpjegues referon më saktë një të drejtë që “rezulton nga” Traktatet dhe përcakton se Karta nuk ndryshon sistemin e të drejtave të dhëna nga traktatet.

⁷³ Ky formulim ishte kritikuar nga disa që e shihnin atë si leje për objektivat ekonomike të BE-së për t'u futur si bazë për kufizimin e shtrirjes së të drejtave themelore, diçka e cila nuk do të ishte e mundur nën shumicën e dispozitave të KEDNJ

Marrëdhëniet e ndërlikuara mes KEDNJ-së, instrumenteve të tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, dispozitave kushtetuese kombëtare dhe Kartës së re janë përshkruar në nenet 52(3) dhe 53. Duket se gjatë procesit të hartimit u zhvillua një debat i gjatë dhe i nxehtë mbi marrëdhëniet e duhura të Kartës me Konventën, si dhe mbi çështjen nëse një e drejtë e përfshirë në Kartë duhej interpretuar domosdoshmërisht në të njëjtën mënyrë si një e drejtë e ngjashme ose identike e përfshirë në KEDNJ, ose dhe mbi marrëdhëniet e duhura midis Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Neni 52(3) lidhet veçanërisht me KEDNJ-në dhe është e dukshme që synon të nxitë harmoninë mes dispozitave të Konventës Evropiane dhe atyre të Kartës, ndonëse nuk e pengon BE-në të zhvillojë një mbrojtje më të gjerë nga sa është parashikuar në Konventë. “Për aq kohë sa kjo Kartë përmban të drejta të cilat u korrespondojnë të drejtave të garantuara nga Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, kuptimi dhe shtrirja e këtyre të drejtave do të jetë e njëjtë me ato të vendosura nga Konventa e përmendur. Kjo dispozitë nuk e pengon të drejtën e Unionit të sigurojë një mbrojtje më të gjerë.” Kjo dispozitë nuk merret në mënyrë të veçantë me çështjen e marrëdhënieve mes dy gjykatave evropiane, GJEDNJ-së dhe GJED-së, megjithëse duket që ka synuar të përkrahë respektimin e GJEDNJ-së nga ana e GJED-së.

Neni 52/5 i Kartës cakton një ndryshim ndërmjet “të drejtave” dhe “parimeve”. Termi “të drejta” u referohet të drejtave civile dhe politike të cilat janë quajtur ndryshe të drejtat e “brezit të parë”, ndërsa termi “parim” nënkupton të drejtat ekonomike, kulturore dhe sociale të cilat janë konsideruar si të drejta të “brezit të dytë”. Ndryshimi në emërtim sjell edhe ndryshim në pasojat juridike, pasi sugjerohet se parimet nuk mund të goditen drejtpërdrejt me padi pozitive nga institucionet e BE-së dhe autoritetet e shteteve anëtare. Ndërsa të drejtat, nga ana tjetër, mund të jenë shkak i ngritjes së padisë.

Gjithsesi, një nen i Kartës mund të përmbajë të dyja elementet edhe të së drejtës, edhe të parimit. Për shembull neni 23 barazinë ndërmjet burrit dhe gruas, neni 34 sigurimet shoqërore dhe ndihmën sociale, neni 33 jetën familjare dhe profesionale, e cila përmban një ndalim për pushimin nga puna kur ka si shkak jetën familjare etj (Besselink, 2012). Në rastin e nenit 31 të Kartës mbi kushtet e punës të ndershme dhe të drejta, është e domosdoshme të merren masat legislative të nevojshme nga shtetet anëtare për ta bërë të zbatueshëm këtë nen. Megjithatë, në çështjen *Dominguez*⁷⁴ Gjykata e konsideroi të drejtën për të përfituar leje vjetore si një “parim”, i cili “është i detyrueshëm për t’u zbatuar”. Shtetet anëtare “nuk janë të autorizuara ta bëjnë këtë të drejtë objekt të çfarëdo parakushti”. Ndërsa Avokati i Përgjithshëm e ka konsideruar nenin 31/2 si “të drejtë”. Të drejtat dhe liritë që parashikohen në Kartë nuk janë absolute, por ato mund të kufizohen kur plotësohen disa kushte. Këto kushte janë: a) vendosja e kufizimit vetëm me ligj (rezervë ligjore absolute), b) kufizimi të mos cenojë thelbin e këtyre të drejtave e lirive, c) kufizimet të jenë proporcionale dhe të nevojshme, d) kufizimet të vendosen për shkak të interesit të përgjithshëm të njohura nga Bashkimi ose për të mbrojtur liritë dhe të drejtat e të tjerëve. Çdo kufizim që nuk plotëson të gjitha kushtet e sipërpërmendura është i papranueshëm. Përsa i përket vlerësimit të të drejtave ose peshës që ato kanë, Gjykata ka vlerësuar se nuk ka diferencë ndërmjet tyre, pra çdo e drejtë mund të përdoret për të kufizuar një të drejtë tjetër themelore. Për shembull, në çështjet *Schmidberger*⁷⁵, *Omega*, *Laval*, e drejta për t’u grumbulluar dhe liria e shprehjes kanë shërbyer si kufizim i lirisë së lëvizjes së mallrave dhe shërbimeve. Ndërsa në çështjen *Viking*, e drejta për të ndërmarrë veprime kolektive ka kufizuar lirinë e vendosjes sipas TKE-së.

Memorandumi shpjegues deklaroi se legjislativi i BE-së duhet të pajtohet me standardet e vëna në KEDNJ “pa cenuar në këtë mënyrë autonominë e Komunitetit dhe atë të

⁷⁴Çështja C-282/10 *Dominguez*, [2012].

⁷⁵Çështja C-112/00 *Schmidberger*, [2003] PVGJE I-05659.

Gjykatës së Drejtësisë”, por ai tregon gjithashtu se kuptimi i të drejtave është përcaktuar pjesërisht nga GJEDNJ-ja. Traktati i Lisbonës duhet t’i kishte shtuar katër klauzola të tjera nenit 52. Ndër të tjera, paragrafi (4) duhet të kishte përcaktuar se dispozitat e Kartës, që rridhnin nga traditat kushtetuese kombëtare, duhet të interpretoheshin në harmoni me këto tradita. Paragrafi (6) duhet ta kishte plotësuar këtë duke përcaktuar se duhej të merreshin parasysh “plotësisht” të drejtat kombëtare dhe praktikat siç specifikoheshin në Kartë. Paragrafi (7) do të kishte qenë një amendament interesant, me kërkesën e tij për t’i dhënë rëndësi ligjore memorandumit shpjegues të Kartës, i cili ishte hartuar nga sekretariati dhe që, megjithëse shpesh përbën një shpjegim ose mjedis të vlefshëm për një dispozitë, nuk ishte hartuar me synimin për të pasur forcë ligjore⁷⁶. Megjithatë, amendamenti më i kundërshtueshëm dhe më shumë i debatuar, që duhet të kishte futur Traktati, ishte se në paragrafin (5), i cili kërkonte të dallonte dispozitat e Kartës që përmbanin “parime” dhe të përcaktonte se dispozitat që përmbanin “parime” do të kishin “kompetencë gjyqësore” vetëm kur ato të ishin implementuar me akte legislative ose ekzekutive të BE-së ose të shteteve anëtare dhe vetëm në lidhje me interpretimin ose vendimet mbi ligjshmërinë e këtyre akteve. Megjithëse ky amendament ishte disi i komplikuar dhe i paqartë, duket se ka pasur synimin që të përfshijë në Kartë disa versione të dallimit tradicional (dhe shpesh të kritikuara) mes të drejtave civile dhe politike të orientuara negativisht dhe të drejtave ekonomike dhe sociale të orientuara pozitivisht, për t’i bërë këto të fundit kryesisht të pagjyqeshme. Neni 53 i kartës përmban një lloj klauzole të përgjithshme joprapavepruese, e cila është e ngjashme me atë në nenin 53 të KEDNJ-së dhe që i referohet jo vetëm KEDNJ-së, por gjithashtu edhe kushtetutave kombëtare dhe marrëveshjeve ndërkombëtare: “Asgjë në këtë Kartë nuk do të interpretohet si kufizim ose cenim i të drejtave dhe i lirive

⁷⁶Paragrafi (7) thotë: “shpjegimet e hartuara si një mënyrë për sigurimin e udhëzimit në interpretimin e Kartës së të drejtave themelore do të jepen në përshtatje me gjykatat e Unionit dhe të Shteteve Anëtare”.

themelore të njohura të njeriut në fushat e tyre përkatëse të aplikimit, nga e drejta e Unionit, nga e drejta ndërkombëtare dhe nga marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Unioni, Komuniteti ose të gjitha shtetet anëtare janë palë, përfshirë Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, si dhe nga kushtetutat e shteteve anëtare.”

Së fundi, neni 54 përmban një klauzolë të modeluar sipas nenit 17 të KEDNJ-së, e cila parashikon që asnjë dispozitë e Kartës nuk duhet të përfshijë të drejtën për t’u marrë me një aktivitet që synon cenimin ose kufizimin e tepruar të ndonjë prej të drejtave të përfshira aty.

Siç u vu re më lart, pavarësisht goditjes që i është dhënë efektit të plotë ligjor të Kartës nga mosratifikimi i Traktatit Kushtetues, i cili do të kishte përfshirë një version lehtësisht të amenduar të Kartës, në pjesën e dytë, Karta nuk është pa efekt ligjor aktual.

7.4. Statusi aktual i Kartës.

Sipas nenit 6, paragrafi 1, i Traktatit të Bashkimit Evropian, Karta për të Drejtat Themelore të Njeriut, i përmirësuar në 2007, është i detyrueshëm për t’u zbatuar dhe ka të njëjtën fuqi ligjore si edhe traktatet. Fusha e zbatimit dhe interpretimi i Kartës rregullohet nga titulli i VII i saj, neni 6 i Traktatit të Bashkimit Evropian si dhe nga protokollin 30.

Bashkimi njeh të drejtat, liritë dhe parimet e parashikuara në Kartën e të Drejtave Themelore, e përshtatur në Strasburg më 12 dhjetor 2007. Ajo ka të njëjtën fuqi me traktatet. Parimet e përgjithshme të së drejtës së Bashkimit përbëhen nga të drejtat themelore, siç garantohen nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut si dhe nga traditat kushtetuese që janë të përbashkëta për shtetet anëtare⁷⁷.

⁷⁷ Neni 6 parag. 3 i Kartës për të Drejtat Themelore të Njeriut.

Gjatë negociatave për adoptimin e Traktatit të Lisbonës, Mbretëria e Bashkuar dhe Polonia arritën të adoptonin edhe protokollin 30 për mënyrën zbatimit të Kartës në vendet e tyre. Këshilli Evropian⁷⁸, i mbajtur në dhjetor 2009, pas kërkesës së Presidentit çek z.Klaus, ra dakord që aplikimi i protokollit 30 të shtrihej edhe mbi shtetin çek. Çështjet që e shqetësonin më shumë Poloninë kishin të bënin me statusin e familjes, më konkretisht me martesën e personave homoseksualë. Po ashtu, Polonia pretendonte se kishte probleme edhe me të drejtën e pronësisë, pasi gjermanët e dëbuar nga ajo pas Luftës së Dytë Botërore mund të kërkonin që t'u ktheheshin pronat e tyre. Përsa i përket pretendimit të parë, është e vërtetë që Karta e shtrin mbrojtjen përtej Konventës, megjithatë këtë zgjerim ajo e vë në varësi të legjislacionit kombëtar. Përderisa legjislacioni polak nuk e njeh të drejtën për martesë të homoseksualëve, shtrirja e së drejtës për martesë që nënkupton Karta nuk mund të zbatohet në Poloni. Përsa i përket pretendimit të dytë, duhet theksuar se bëhet fjalë për të drejta të mbrojtura nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në të cilën Polonia është palë. Edhe ky pretendim është i pabazuar pasi deri më sot këto të drejta nuk janë kërkuar. Edhe nëse popullsia e dëbuar gjermane vendos t'i kërkojë këto të drejta, ajo mund t'i drejtohet drejtpërdrejt Konventës për mbrojtjen e tyre.

Mbretëria e Bashkuar ka shprehur rezerva në lidhje me Kartën, pasi ajo pretendon se të drejtat sociale dëmtojnë konkurrueshmërinë e ekonomisë britanike. Për të vlerësuar këtë pretendim duhet të marrim në konsideratë dy aspekte. Së pari, Mbretëria e Bashkuar ka dhënë kontributin e saj për hartimin e Kartës, si dhe ka nënshkruar Traktatin Kushtetues (ku Karta ka qenë pjesë integrale e tij). Së dyti, shumica e të drejtave sociale që garanton Karta ose ushtrohen në kushtet e parashikuara nga e drejta komunitare, ose në kushtet e parashikuara nga ligjet apo praktikat kombëtare. Si e tillë, ekzistenca e Kartës nuk luan ndonjë rol thelbësor në zbatimin e të drejtave sociale. Sipas presidentit çek,

⁷⁸ Marrë nga faqen e web-it: http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/ec/110889.pdf

zbatimi i Kartës mund të rriste pretendimet për të drejtën e pronësisë nga gjermanët e dëbuar nga shteti çek pas Luftës së Dytë Botërore. Bëhet fjalë për prona, të cilat ishin konfiskuar nga Çekia. Mendoj se ky pretendim nuk është i bazuar. Neni i Kartës për të drejtën e pronësisë përmban të njëjtin përkufizim si protokollin i parë i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në rast se personat e interesuar do të kërkonin njohjen e kësaj të drejte, ata mund t'i drejtohen direkt GJEDNJ-së. Ky nen nuk është interpretuar asnjëherë nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut sikur krijon një të drejtë absolute për kthimin e pasurive. Po ashtu, Karta nuk mund të zbatohet për situata që kanë ekzistuar përpara aderimit të një shteti në Bashkimin Evropian. Një arsye tjetër, që shkon në disfavor të këtij pretendimi, është edhe fakti që në atë kohë konfiskimet ishin trajtuar nga marrëveshjet midis aleatëve.

Protokollin 30 ka të bëjë me zbatimin e Kartës të të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian në Poloni dhe në Mbretërinë e Bashkuar. Ky protokoll u hartua për të qartësuar disa aspekte të zbatimit të Kartës për Poloninë dhe Mbretërinë e Bashkuar. Nëpërmjet këtij protokollin, palët kanë rënë dakord për shtimin e dy dispozitave: Traktatit për Bashkimin Evropian dhe Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian. Për këto dy shtete, Karta nuk e zgjeron aftësinë e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian ose të ndonjë gjykate tjetër të Polonisë ose të Mbretërisë së Bashkuar, për të konstatuar që ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative, praktikat ose veprimet e Polonisë ose të Mbretërisë së Bashkuar nuk janë në përputhje me të drejtat, liritë dhe parimet themelore që konfirmon ajo⁷⁹.

Asnjë dispozitë në titullin IV (Solidariteti) të Kartës nuk krijon të drejta të gjykueshme e të zbatueshme në Poloni ose në Mbretërinë e Bashkuar për aq sa këto të drejta janë të parashikuara në legjislacionin kombëtar të Polonisë ose të Mbretërisë së Bashkuar. Pra, nëse një nga këto të drejta është parashikuar si në titullin IV të Kartës, ashtu edhe në

⁷⁹ Neni 1 i Protokollit 30, "Për zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian në Poloni dhe në Mbretërinë e Bashkuar".

legjislacionin kombëtar të këtyre shteteve, atëherë për këto çështje do të zbatohen dispozitat përkatëse kombëtare të këtyre dy shteteve dhe ato do të gjykohen po sipas këtyre dispozitave. Kur një dispozitë e Kartës përmend legjislacionet dhe praktikatat kombëtare, ajo zbatohet për Poloninë ose Mbretërinë e Bashkuar vetëm atëherë sa të drejtat ose parimet që përmban njihen në legjislacionin ose praktikatat e këtyre shteteve⁸⁰.

Këto nene rikonfirmojnë dispozitat e Kartës. Neni 1, paragrafi i parë i protokollit 30, ripohon përmbajtjen e nenit 51 të Kartës, sipas të cilit ajo nuk krijon të drejta të reja, por bën më të dukshme të drejtat ekzistuese. Nërsa paragrafi i dytë, i protokollit është analog me nenin 52, paragrafi 5, të Kartës. Të dyja këto nene shprehin diferencën që ekziston ndërmjet parimeve dhe të drejtave. Titulli IV i Kartës parashikon parimet, ose detyrimet pozitive të shteteve për përmbushjen e tyre. Mospërmbushja e këtyre parimeve nuk mund të ngrihet përpara gjykatës për të realizuar zbatimin e parimeve.

Ndërsa neni 2 i protokollit konfirmon atë që parashikon neni 52/6 i Kartës, sipas të cilit: “merren plotësisht parasysh ligjet dhe praktikatat kombëtare kur Karta referon në legjislacionin kombëtar”. Nga sa u analizua më sipër, duket qartë se protokollit 30 nuk sjell ndonjë risi të dukshme në dy dispozitat e tij, por përforcon disa dispozita të Kartës. Objektivi kryesor i protokollit 30 është të sigurojë se edhe nëse Karta krijon të drejta të reja, protokollit 30 siguron se për Poloninë, Mbretërinë e Bashkuar dhe Çekinë, Karta duhet të interpretohet se nuk krijon të drejta të reja.

Megjithatë, ka autorë që e vënë në dyshim efikasitetin e protokollit 30 (Kaczorowska, 2011: 249). Në këtë aspekt ata marrin parasysh vetë preambulën e protokollit, sipas të cilit: “Protokollit nuk cenon detyrimet që lindin mbi Poloninë dhe Mbretërinë e Bashkuar sipas Traktatit për Bashkimin Evropian, Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian dhe të drejtës së Bashkimit në përgjithësi”. Rrjedhimisht, këto shtete kanë detyrimin të zbatojnë nenin 6, paragrafi 3 i Traktatit të Bashkimit Evropian.

⁸⁰ Neni 2 i Protokollit 30, “Për zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian në Poloni dhe në Mbretërinë e Bashkuar”.

Ky nen sanksionon se: “parimet e përgjithshme të Bashkimit Evropian janë të drejtat themelore siç garantohen nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe siç rrjedhin nga traditat kushtetuese që janë të përbashkëta për shtetet anëtare”. Ky nen, i cili është i pavarur nga Karta, sanksionon se çdo legjislacion i miratuar dhe zbatuar në Britani, Poloni apo Çeki duhet të respektojë të drejtat themelore të njeriut. Për këtë arsye, nëse Gjykata e Drejtësisë arrin në përfundimin se një e drejtë që parashikohet nga Karta përbën një parim të përgjithshëm të Bashkimit, atëherë mbrojtja e siguruar nga protokollin 30 nuk mund të zbatohet.

Një sërë aktorësh institucionalë kanë përdorur dispozitat e saj qysh nga koha që ajo u miratua. Komisioni, me anë të një vendimi të brendshëm të 13 marsit 2001, vendosi të drejtojë një formë kontrolli mbi pajtueshmërinë e Kartës dhe çdo propozim legjislativ mbi mbrojtjen e të drejtave themelore ta vlerësojë në lidhje me përputhjen e tij me dispozitat e Kartës, *inter alia*, nëpërmjet përfshirjes së fakteve në legjislacionin që bën fjalë për të drejtat përkatëse të Kartës. Katër vjet më vonë, Komisioni vazhdoi me një komunikatë mbi pajtueshmërinë e propozimeve legjislative me Kartën e të Drejtave (Toner, 2005) dhe porosi një raport të jashtëm mbi vlerësimin e ndikimit të propozimeve të politikës legjislative të BE-së në të drejtat e njeriut⁸¹. Përgjithësisht, praktika e Komisionit për të cituar dhe për të mbajtur parasysh dispozitat e Kartës duket se nuk u ndikua nga dështimi i ratifikimit të Traktatit Kushtetues dhe, në veçanti, nga referendimet negative në Francë dhe Holandë.

Edhe Ombudsmeni Evropian ka vazhduar t’i referohet rregullisht Kartës për aspekte të ndryshme të së drejtës për miradministrim dhe për të drejtën e njohjes me fjalimet dhe raportet vjetore të Ombudsmanit, sipas neneve 41-43 të saj. Në një fjalim të tij të datës 8 prill 2002 në Parlamentin Evropian, ai kritikoi institucionet e BE-së për dështimin e tyre në respektimin e shumë të drejtave të përfshira në Kartë, në veçanti, lidhur me

⁸¹Reporti Final marrë në: http://EC.europa.eu/justicehome/doc_centre/rights/doc/study_epEC_fund_rights_agency_en.pdf.

normat e tyre për marrjen në punë dhe me rregullat e stafit dhe deklaroi se “qytetarët evropianë kanë të drejtë të besojnë që Karta do të zbatohet nga ato institucione, presidentët e të cilave e shpallën solemnisht atë në Nisë në dhjetor të vitit 2000, domethënë, Këshilli, Parlamenti dhe Komisioni”. Në një fjalim më të vonë, në prill të vitit 2006, Ombudsmani aktual tregoi se debati, që u zhvillua mbi statusin ligjor të Kartës pas Traktatit Kushtetues, nuk ka ndryshuar ndonjë gjë në këtë aspekt: “për Ombudsmanin Evropian, parametri kryesor për të matur pajtueshmërinë me të drejtat e njeriut është Karta e të drejtave themelore”⁸².

Së fundi, pas disa vitesh heshtjeje mbi Kartën, GJED-ja përfundimisht ndoqi praktikën e kaq shumë avokatëve të saj të përgjithshëm dhe të GJSHP-së⁸³ duke iu referuar me ton aprovues Kartës si një rikonfirmim i parimeve të përgjithshme të së drejtës së përbashkët të shteteve anëtare. Në kursin e vendimit të saj mbi goditjen që i bëri Parlamenti Evropian Direktivës mbi bashkimin familjar, Çështja C-540/03 *Parlamenti Evropian k. Këshillit* GJED-ja deklaroi se: “Ndonëse Karta nuk është një instrument ligjorisht detyrues, legjislatura e Komunitetit prapë e njohu rëndësinë e saj duke deklaruar, në rreshtin e dytë të preambulës së direktivës se direktiva respekton parimet e njohura jo vetëm nga neni 8 i KEDNJ-së, por edhe nga Karta. Për më tepër, qëllimi kryesor i Kartës, siç duket nga preambula e saj, është të rikonfirmojë “në mënyrë të veçantë, të drejtat si rrjedhim i traditave kushtetuese dhe i detyrimeve ndërkombëtare të përbashkëta për shtetet anëtare, i Traktatit mbi Bashkimin Evropian, i Traktateve të Komunitetit, i KEDNJ-së, i kartave sociale të miratuara nga Komuniteti dhe Këshilli i Evropës dhe i praktikës gjyqësore të Gjykatës si dhe i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut”.

Në një gjykim të mëvonshëm, në çështjen *Reynolds Tobacco*, GJED-ja e konfirmoi këtë qëndrim duke iu referuar nenit 47 të Kartës mbi të drejtën për një kompensim efektiv

⁸² Shih www.ombudsman.europa.eu/speeches/en/2006-04-28.htm.

⁸³Çështja T-54/99 [2002] PVGJE II-313, paragrafët 48, 57; çështjet T-210/01, vendim i 14 dhjetorit 2005, çështjen T- 378/02 [2005] PVGJE II-5575.

dhe duke deklaruar se “megjithëse ky dokument nuk ka fuqi ligjore detyruese, ai tregon rëndësinë e të drejtave që parashtron në rendin ligjor të Komunitetit”.⁸⁴ Shenja e aprovimit, e dhënë përfundimisht nga Gjykata për Kartën si një burim i rëndësishëm i parimeve të përgjithshme të së drejtës së BE-së, konfirmon se Karta ka hyrë përfundimisht në praktikën kushtetuese të BE-së.

Kapitulli III: Veprimtaria e BE-së lidhur me të drejtat e njeriut.

Kundërshtimi i akteve ligjore dhe akteve administrative.

1. Veprimtaria e BE-së dhe roli i institucioneve lidhur me të drejtat e njeriut.

Të drejtat themelore duhet të zbatohen nga të gjitha institucionet e Bashkimit, zyrat dhe agjencitë e tij. Ato kanë si burim kryesor Kartën, Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe parimet e përgjithshme sipas nenit 6/3 të TKE-së.

Respektimi i të drejtave të njeriut nga institucionet e Bashkimit Evropian bëhet në përputhje me kompetencat përkatëse dhe kufizimet e tyre, ashtu siç ia kanë deleguar traktatet. Pra, të drejtat themelore të njeriut respektohen nga institucionet e Bashkimit vetëm kur ato zbatojnë legjislacionin e Bashkimit. Bashkimi nuk ka një kompetencë të posaçme për njohjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, por ai i garanton ato brenda kompetencave ose fushës së zbatimit të së drejtës së Bashkimit. Shtetet anëtare kanë detyrimin të respektojnë të drejtat themelore të njeriut kur ato marrin masa për zbatimin e së drejtës komunitare.

Një rol të rëndësishëm këtu ka Gjykata Evropiane e Drejtësisë. Që nga krijimi i GJED-së në 1952, misioni i saj ka qenë që të sigurojë “zbatimin e ligjit” në interpretimin dhe zbatimin e traktateve⁸⁵.

⁸⁴ Çështja C-131/03 [2006] PVGJE I-7795.

⁸⁵Numri i çështjeve që trajton tashmë GJED është rritur shumë ndjeshëm që nga krijimi i saj si organ në vitin 1951: nga 79 çështje në vitin 1970 në mbi 2,000 çështje në vitin 2010.

Nëpërmjet vendimeve historike Gjykata ka kontribuar në mënyrë vendimtare në përvijimin me saktësi të natyrës dhe të përmasave të së drejtës evropiane (Bana dhe Canaj, 2010), pavarësisht se për kohën më të madhe të ekzistencës së saj, GJED-ja ka qenë institucioni më pak i njohur e, madje, Gjykata dukej e lënë në hije nga institucionet e tjera. Pa dyshim që roli që ka sot GJED-ja nuk është roli që kishte në fillimet e ekzistencës së saj dhe ndoshta nuk është as ngushtësisht roli që përcaktonin traktatet në fillim. Ishte më se e qartë që pa një gjykatë me funksione e kompetenca të përcaktuara nuk do të kishte mundësi për të siguruar zbatimin e detyrimeve të Traktateve të BE-së të vetë komuniteteve dhe që, nga ana tjetër, do t'i lejonte të gjitha shteteve anëtare dhe shtetasit e tyre që të kishin të drejta të barabarta në fushën e juridiksionit të GJED-së. Rëndësia e një mekanizmi në nivelin e BE-së për zbatimin e së drejtës komunitare ishte e madhe. I gjithë procesi i integritit synonte në ndërtimin e një rendi ligjor autonom (i një lloji krejt të veçantë) dhe kjo nuk do të ishte e mundur pa ekzistencën e gjyqësorit. Koha tregoi se ishin vendimet e GJED-së një promotor i rëndësishëm në procesin e integritit, rendin e ri të krijuar nga traktatet si një rend juridik i mëvetësishëm në të cilin shtetet anëtare kishin ceduar një pjesë të sovranitetit të tyre, zbatimin e traktateve dhe të legjislacionit komunitar. Gjatë debateve publike në lidhje me Traktatin e Manstrihtit, studiuesit e akuzuan Komunitetin European se po tejkalonte kufijtë e kompetencave të tij dhe se Gjykata e Drejtësisë po e mbështeste një gjë të tillë. Gjykata u akuzua për “uzurpim të pushtetit”. Një nga gjykatësit e Gjykatës Kushtetuese Gjermane, Paul Kirchhof, deklaroi se shteti është i vetmi garantues i lirisë, barazisë dhe së drejtës (Zuleeg, 1997: 22-24). Fakti është që e drejta është një nga aspektet më thelbësore të sovranitetit kombëtar ndaj dhe si e tillë asaj nuk mund t'i mbivendosej apo të tejkalohet nga e drejta evropiane. Imponimi i standardeve evropiane ndaj shteteve anëtare sfidonte praktikën ligjore tradicionale të një shteti. Në sistemin *sui generis* të BE-së, nuk ka mjete të paracaktuara për zgjidhjen e konflikteve mes së drejtës së BE-së

dhe kushtetutave te vendeve aneter. Për më tepër, disa gjykata kushtetuese të shteteve anëtare janë shprehur se së drejtës së BE-së nuk mund t'i jepet përparësi në vendin e tyre në rastin kur bie në kontradiktë me kushtetutën e vendit. Në vendimin e famshëm *Solange I*, Gjykata Kushtetuese Gjermane e bëri të qartë se nëse drejta e komunitetit mund të shkelë një të drejtë themelore të mbrojtur nga ligji themelor gjerman, atëherë kjo e fundit do të kishte përparësi. Gjykata Kushtetuese Italiane mbajti të njëjtin qëndrim në vendimin e saj të çështjes *Frontini*.

Gjykata fillimisht ka refuzuar shqyrtimin e padive që kishin të bënin me të drejtat themelore të njeriut, pasi çështjet e së drejtës kushtetuese kombëtare nuk ishin në kompetencë të saj. Njohja dhe mbrojtja e të drejtave themelore të njeriut nga Gjykata e Drejtësisë ishte e domosdoshme për disa arsye. Së pari, për pranimin e parimit të epërsisë të së drejtës së Bashkimit mbi të drejtën e shteteve anëtare, duke përfshirë edhe kushtetutën. Shtetet anëtare e veçanërisht Gjermania dhe Italia nuk do ta praninin supermacinë e së drejtës së Bashkimit, pa pasur garanci se do të respektohen të drejtat e njeriut nga institucionet e Bashkimit Evropian. Së dyti, ishte e domosdoshme të sigurohej që mbrojtja e të drejtave themelore të njeriut në Bashkim nuk do të vinte në rrezik objektivat e arritur nga traktatet ndërkombëtare në këtë fushë. Gjykata e Drejtësisë ka luajtur një rol qendror në njohjen dhe zhvillimin e të drejtave themelore. Gjykata e ka interpretuar në mënyrë të zgjeruar dispozitën e Kartës që parashikon se, ajo është e detyrueshme për t'u respektuar “vetëm kur zbatohet legjislacioni i Bashkimit Evropian”⁸⁶.

Ndërkohë, GJED-ja ka dëgjuar një numër në rritje të kundërshtimeve të legjislacionit të BE-së, ku cenimi i të drejtave të njeriut është deklaruar si bazë. Gjykata duket gjithmonë e më e gatshme të shkojë përtej citimeve të dispozitave të të drejtave të njeriut dhe në veçanti për të shqyrtuar praktikën gjyqësore reale të Gjykatës Evropiane

⁸⁶ Neni 51 i Kartës.

të të Drejtave të Njeriut. Megjithatë, pavarësisht këtij angazhimi në rritje për argumentet e të drejtave të njeriut, numri i çështjeve në të cilat Gjykata ka anuluar aktualisht legjislacionin e kundërshtuar të BE-së mbetet mjaft i vogël. Ne do të shohim më poshtë se ka pasur një shkallë më të lartë sukcesi në kundërshtimin e akteve administrative individuale të Komisionit ose të aktorëve të tjerë të KE-së, por edhe që Gjykata ka mbetur respektuese e legjislacionit të BE-së (Clapham, 1990: 309, 331)

2. Kundërshtimi i legjislacionit të BE-së.

Megjithëse në çështjen *Nold*⁸⁷ Gjykata ka deklaruar se, në rast konflikti, “parimet e përgjithshme të së drejtës” do të merrnin përparësi ndaj masave specifike të Komunitetit, GJED-ja theksoi se në konfliktin në shqyrtim e drejta e pronës dhe e ushtrimit të tregtisë dhe profesionit nuk ishin absolute dhe se kufizimet ishin të justifikuar nga objektivat e përgjithshëm të KE-së. Edhe në një varg çështjesh që vijuan lidhur me pronësinë dhe të drejtat ekonomike, GJED-ja vazhdoi trajtimin e adoptuar në rastet *Nold* dhe *Hauer*, duke vendosur se kufizimet në të drejtën e pronësisë, për të mbështetur interesa të tjerë legjitimë, janë të pranueshme dhe se vetëm një ndërhyrje e shpërpjesëtuar dhe e patolerueshme ose arbitrare do ta bënte vërtet të pavlefshëm legjislacionin.

Në çështjen *Bosphorous*, lidhur me ndikimin që kishte mbi të drejtat e aplikantit një rregullore e KE-së, që zbatonte sanksionet e urdhëruara nga OKB-ja kundër ish-Jugosllavisë, GJED-ja vendosi se interesat themelore të komunitetit ndërkombëtar mund të justifikonin kufizimet e pronësisë ose të së drejtës së tregtisë shkaktuar nga konfiskimi i një linje ajrore të marrë me qira nga ish-Jugosllavia prej aplikantit, edhe pse ky i fundit dukej se ishte krejtësisht i papërfshirë në ndonjë aktivitet të shtetit

⁸⁷Çështja 4/73 [1974] PVGJE 491.

jugosllav.⁸⁸ Një vendim i ngjashëm u dha nga GJSHP-ja në çështjet *Yusuf* dhe *Kadi*, që përfshinte ngrirjen e asetëve të individëve me anë të një rregulloreje të KE-së për zbatimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit,⁸⁹ ndonëse në çështjen *Modjahedines* GJSHP-ja vendosi që kur asetet janë të ngrira nga autoritetet e BE-së (ndryshe kur janë të urdhëruara nga rezoluta e Kësh.Sig. OKB-së) zbatohet gjithmonë e drejta për një hetim korrekt, e drejta për të paraqitur arsyet dhe e drejta për një mbrojtje efektive gjyqësore, edhe nëse zbatohet në një formë të kufizuar.⁹⁰

Në çështjen *Booker Aquacultur*, Gjykata vendosi se një direktivë e KE-së mbi kontrollin e sëmundjeve të peshqve, e cila dështoi në kërkesën për kompensim për eliminimin e peshqve të sëmurë nga autoritetet kombëtare, nuk përbënte një kufizim të shpërpjesëtuar mbi të drejtën e pronës.⁹¹ Po ashtu, në një sërë goditjesh të tjera të masave të BE-së mbështetur mbi një larmi kërkesash për të drejtat e tregtisë dhe pronësisë, Gjykata theksoi në mënyrë të përsëritur legjitimitetin e kufizimeve “të arsyeshme” në përputhje me KEDNJ-në.⁹²

Madje edhe përtej sferës të të drejtave të pronësisë, kundërshtimi i legjislacionit të BE-së ka pasur një sukses të kufizuar. Në procedurën e ngritur nga qeveria gjermane për të goditur ligjshmërinë e direktivës për bioteknologjinë, me arsyen se dispozitat e saj lidhur me eksperimentimin me pjesë të veçuara të trupit cenonin të drejtën e dinjitetit dhe të integritetit njerëzor, GJED-ja iu përgjigj se dispozitat legislative në shqyrtim siguronin respekt të plotë për dinjitetin dhe integritetin njerëzor.⁹³ Për më tepër, në një padi të kohëve të fundit nga Parlamenti Evropian për një direktivë të BE-së mbi bashkimin familjar, duke u mbështetur në një varg argumentesh të të drejtave të njeriut, GJED-ja u përgjigj se direktiva nuk cenonte të drejtën për respektim të jetës familjare

⁸⁸Çështja C-84/95 [1996] PVGJE I-3953 gjithashtu edhe gjykimin e shkallës së parë në çështja T-184/95 [1998] PVGJE II-667, paragrafi 87-88.

⁸⁹Çështja T-315/01 *Kadi* dhe çështja T-306/01 *Yusuf*.

⁹⁰Çështja T-228/02, nr.25.

⁹¹Çështja C-20 dhe 64/00, PVGJE I-7411.

⁹²Çështjen C-37 dhe 38/02 [2004] PVGJE I-6911.

⁹³Çështja C-377/98 [2001] PVGJE I-7079.

ose detyrimin për të pasur kujdes interesin më të lartë të fëmijëve dhe se ajo u lë shteteve anëtare një marzh të mjaftueshëm vlerësimi në zbatimin e direktivës, në mënyrë që ato të jenë në përputhje me këto të drejta.⁹⁴

BE-ja zbatoi një tërësi masash ligjore duke përfshirë një sërë rregulloresh të hartuara për të implementuar një seri rezolutash të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, duke filluar me rezolutën 1267 (1999)⁹⁵. Këto rezoluta të OKB-së u zbatuan në prag të sulmeve të 11 shtatorit 2001 në SHBA dhe ajo u kërkoi të gjitha shteteve të ngrinin fondet dhe burimet e tjera financiare të personave ose subjekteve të kontrolluara drejtpërdrejt apo jodrejtpërdrejt nga Talibani, ose të shoqëruar me Osama Bin Laden, ose me rrjetin Al-Qaeda si dhe krijonte një komitet sanksionesh për të garantuar zbatimin e tyre. Pretenduesit ishin ndër personat e emëruar në listën e OKB-së të atyre, të lidhur me Osama Bin Laden ose me Al-Qaeda dhe u vendosën gjithashtu në listën e BE-së. Në vitin 2001, Kadi, së bashku me Yusuf dhe Fondacionin Al Barakaat, paraqitën një akt në GJSHP (tashmë Gjykata e Përgjithshme) e BE-së, duke pretenduar se Gjykata duhet të anulojë aktet implementuese të BE-së që i solli ata brenda qëllimit të sanksioneve. Ata argumentuan se rregulloret e kundërshtuara të BE-së shkelnin të drejtat e tyre themelore, sidomos të drejtën për të përdorur pasurinë e tyre dhe të drejtën e procesit të drejtë, duke caktuar sanksione të rënda civile dhe penale mbi ta pa i dëgjuar më parë ose pa u dhënë mundësinë atyre për të mbrojtur veten apo për të kërkuar rishikim gjyqësor. Pretenduesit thanë se atyre nuk u ishte thënë pse u ishin dhënë sanksionet në fjalë, se faktet dhe provat nuk u ishin komunikuar dhe se nuk kishin asnjë mundësi të shpjegonin vetveten. GJSHP-ja nuk e pranoi kërkesën e tyre për anulimin e masave të BE-së, duke vendosur se nuk kishte autoritet ose juridiksion për të vënë në dyshim rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, edhe në mënyrë të tërthortë, dhe jo për shkeljen e *jus*

⁹⁴Çështja C-540/03, nr. 27.

⁹⁵Çështjet C-402 dhe 415/05, 2008 I-6351.

*cogens*⁹⁶ dhe, në këtë rast, nuk ishte shkelje e *ius cogens*.⁹⁷ Pretenduesit apelian vendimin në GJED, i cili mbajti një qasje të ndryshme.

GJED-ja vendosi se në lidhje me këtë duhet kujtuar se Komuniteti bazohet në sundimin e ligjit, meqenëse as shtetet anëtare, as institucionet nuk mund të shmangin rishikimin e përputhshmërisë së akteve të tyre me Kartën Themelore Kushtetuese, Traktatin e KE-së, që vendoste një sistem ligjor mjetesh dhe procedurash të hartuara për të mundësuar Gjykatën e Drejtësisë që të rishikojë ligjshmërinë e akteve të institucioneve.⁹⁸ Duhet rikujtuar gjithashtu se një marrëveshje ndërkombëtare nuk mund të ndikojnë dhënien e kompetencave të caktuara nga traktati ose, si pasojë, autonominë e sistemit ligjor të Komunitetit, ruajtja e së cilës garantohet nga Gjykata në sajë të juridiksionit ekskluziv të dhënë nga neni 220 KE, juridiksion që Gjykata, për më tepër tashmë shprehu se bën pjesë në themelet e vërteta të Komunitetit.

Përveç kësaj, sipas praktikës gjyqësore të vendosur, të drejtat themelore përbëjnë një pjesë integruese të parimeve të përgjithshme të së drejtës, ruajtjen e të cilave e bën gjykata. Për këtë qëllim, Gjykata frymëzohet nga traditat kushtetuese të përbashkëta të shteteve anëtare dhe nga udhëzimet e krijuara nga instrumente ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në të cilat kanë bashkëpunuar ose në të cilat kanë nënshkruar. Lidhur me këtë, KEDNJ-ja ka një rëndësi të veçantë. Është gjithashtu e qartë nga praktika gjyqësore se respektimi i të drejtave të njeriut është një kusht për ligjshmërinë e akteve të Komunitetit (Opinion 2/94, paragrafi 34) dhe se masat e papajtueshme me respektin për të drejtat e njeriut nuk janë të pranueshme në Komunitet⁹⁹.

Nga të gjitha këto konsiderata, rrjedh se detyrimet e vendosura nga një marrëveshje ndërkombëtare nuk mund të kenë efektin e paragjyimit të parimeve kushtetuese të

⁹⁶ Çështja T-315/01 *Kadi* (n.38) [192]-[208], [221]-[225]; çështja T-306/01 [2005] PVGJE II-3533, [242]-[258], [272]-[276].

⁹⁷ Çështja T 315/01 *Kadi* (n. 38) [226]-[232]; çështja T-306/01 *Yusuf* (n. 84) [277]-[283].

⁹⁸ Çështja 294/83 *Les Verts v. Parliament* [1986] paragrafi 23

⁹⁹ Çështja C-112/00 *Schmidberger* [2003] I-5659, paragrafi 73 dhe praktika e cituar.

Traktatit KE, që përfshin parimin se të gjitha aktet e komunitetit duhet të respektojnë të drejtat themelore, duke përbërë një kusht të ligjshmërisë së tyre, çka i takon gjykatës të rishikojë kornizën e sistemit të tërë të mjeteve ligjore, përcaktuar nga traktati. Në këtë këndvështrim duhet theksuar se, në rrethana si ato të këtyre çështjeve, rishikimi i ligjshmërisë që duhet garantuar nga gjykatësit e komunitetit, zbatohet për aktet e komunitetit që synojnë të japin efekt për marrëveshjen ndërkombëtare për këtë çështje dhe për një çështje të mëvonshme. Është e vërtetë se neni 297 KE lejon në mënyrë të nënkuptuar pengesa për veprimet e tregut të përbashkët, kur ato vijnë nga masa të shkaktuara nga shtetet anëtare për të mënjanuar detyrimet ndërkombëtare, të cilat i kanë pranuar për qëllimin e ruajtjes së paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Këto dispozita nuk mund, gjithsesi, të kuptohen sikur ato autorizojnë ndonjë kufizim të parimeve të lirisë, demokracisë dhe respektit për të drejtat e njeriut apo liritë themelore, të theksuara në nenin 6 (1) BE si themel i Bashkimit. Neni 6 TBE, në asnjë rrethanë, nuk mund të lejojë kundërshtime ndaj parimeve që bëjnë pjesë në themelet e vërteta të sistemit ligjor të Komunitetit, një ndër të cilët është mbrojtja e të drejtave themelore, duke përfshirë ketu edhe rishikimin e ligjshmërisë së masave të Komunitetit nga gjykata. Nuk ka imunitet nga juridiksioni për rregulloren e kundërshtuar lidhur me rishikimin e përputhshmërisë së saj me të drejtat themelore, ngritur nga epërsia absolute e legjitimuar e rezolutave të Këshillit të Sigurimit, për të cilat ajo masë është hartuar që të japë efekt, të gjejë ndonjë bazë lidhur me hierarkinë e normave brenda sistemit ligjor të Komunitetit, gjithmonë nëse ato detyrime mund të klasifikoheshin në atë hierarki. Nga ana tjetër për shembull neni 300 (parg.7) KE parashikon se marrëveshjet e përfunduara sipas kushteve të vendosura në atë nen janë detyruese për institucionet e Komunitetit dhe për shtetet anëtare. Kështu, në saj të kësaj dispozite, duke supozuar se është e zbatueshme ndaj Kartës së Kombeve të Bashkuara, kjo e dyta do të kishte epërsi mbi aktet detyruese të së

drejtës së Komunitetit. Kjo epërsi në nivelin e së drejtës së Komunitetit, gjithsesi, nuk shtrihej në aktet parësore, sidomos në parimet e përgjithshme të të drejtave themelore.

Nga sa më sipër rrjedh se, gjykimi i Komunitetit, në përputhje me kompetencat e dhëna nga Traktati i KE-së, duhet të garantojë rishikimin, në parim rishikimin e plotë, të ligjshmërisë të të gjitha akteve të Komunitetit, nën dritën e të drejtave themelore, si pjesë integrale e parimeve të përgjithshme të së drejtës së Komunitetit, duke përfshirë rishikim të masave të Komunitetit të cilat, ashtu si rregullorja e kundërshtuar, janë hartuar për të ndikuar në rezolutat e zbatuara nga Këshilli i Sigurimit sipas kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Lidhur me këtë, sipas rrethanave aktuale, që rrethojnë përfshirjen e emrave të apeluesve në listën e personave dhe kombësive të mbuluara nga masat kufizuese të aneksit I për rregulloren e kundërshtuar, duhet përcaktuar se të drejtat e mbrojtjes, sidomos e drejta për t'u dëgjuar dhe e drejta e një rishikimi gjyqësor efektiv, nuk ishin respektuar.

Sipas praktikës gjyqësore të vendosur, parimi i mbrojtjes gjyqësore efektive është një parim i përgjithshëm i së drejtës së Komunitetit, që vjen nga traditat kushtetuese të përbashkëta të shteteve anëtare, që janë theksuar në nenet 6 dhe 13, të KEDNJ-së, duke riafirmuar këtë parim në nenin 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, të shpallur më 7 dhjetor 2000 në Nisë.

Gjithsesi, duhet thënë se rregullorja e kundërshtuar, për sa kohë prek apeluesit, u zbatua pa i dhënë ndonjë garanci komunikimit të provave fajësuese kundër tyre ose dëgjimit të tyre lidhur me këtë; kështu duhet theksuar se ajo rregullore u zbatua sipas një procedure në të cilën të drejtat e mbrojtjes së apeluesit nuk u ruajtën, çka ka çuar te pasoja e mëtejshme se parimi i mbrojtjes efektive gjyqësore është shkelur. Nga të gjitha konsideratat e mësipërme rrjedh se denoncimi i z. Kadi dhe Al Barakaat në mbështetje të veprimeve të tyre për anulimin e rregullores së kundërshtuar dhe shkeljes së pretenduar të të drejtave të mbrojtjes, sidomos të së drejtës për t'u dëgjuar dhe parimit

të mbrojtjes efektive gjyqësore, janë të pranuar. Më tej, nuk u shqyrtua nëse masa ngrirëse, e parashikuar nga rregullorja e kundërshtuar, ishte disproporcionale dhe ndërhyrja e patolerueshme që shkel thelbin e të drejtave themelore për respektimin e pasurisë së personit, që, si z. Kadi, janë përmendur në listën e vendosur në aneksin I, të asaj rregulloreje. Rregullorja e kundërshtuar, për sa i përket z. Kadi, u zbatua pa dhënë ndonjë garanci e cila lejon që ai ta çojë çështjen e tij para autoriteteve kompetente, në një situatë sipas së cilës kufizimi i të drejtave të pasurisë duhet parë si i rëndësishëm, duke parë zbatimin e përgjithshëm dhe vazhdimësinë aktuale të masave ngrirëse që e ndikojnë atë. Prandaj, duhet thënë se, në rrethanat e çështjes, vendosja e masave shtrënguese, të caktuara nga rregullorja e kundërshtuar, për z. Kadi, duke e përfshirë atë në listën e vënë në aneksin I, të rregullores, përbën një masë të pajustificuar të së drejtës së tij të pronësisë.

Rrjedh se, rregullorja e kundërshtuar, për aq sa prek apeluesin, sipas GJED-se duhet anuluar. Gjithsesi, GJED-ja vendosi se do të ruante fuqinë detyruese të rregullores përkatëse 881/2002 për tre muaj, për t'u dhënë kohë institucioneve të BE-së që të rregullojnë shkeljen procedurale dhe të rilistojë pretenduesit, gjë që e bënë realisht. Duke ndjekur publikimin dhe komunikimin ndaj apeluesve të përmbledhjes së arsyeve të parashikuara nga Komiteti i Sanksioneve të OKB-së dhe lejimin e një mundësie të një përgjigjeje ndaj pretendimeve, Komisioni, në nëntor të vitit 2008, zbatoi një rregullore që ruante sanksionet kundër z. Kadi dhe që sollën një veprimtari të mëtejshme për anulimin para Gjykatës së Përgjithshme (Rregullorja e Komisionit).

Në *Kadi II* Gjykata e Përgjithshme, duke kundërshtuar haptazi arsyetimin e GJED-së në *Kadi I*, lidhur me marrëdhënien e së drejtës së BE-së me të drejtën ndërkombëtare dhe Kartën e OKB-së dhe, në veçanti, rregulloren e Këshillit të Sigurimit, sidoqoftë ndoqi qasjen e saj në vendimin e parë.¹⁰⁰ Gjykata e Përgjithshme ndërmori një rishikim të

¹⁰⁰ Çështje T-85/09 *Kadi* (n. 40) [112]-[126] në veçanti.

shpejtë të përshtatshmërisë së provave të ofruara për justifikimin e sanksioneve dhe të ruajtjes të të drejtave të mbrojtjes nga Komisioni dhe nuk i pranoi duke i quajtur sipërfaqësore dhe të papërshtatshme. Si pasojë, Gjykata e Përgjithshme e anuloi rregulloren, por këtë herë pa e lënë në fuqi, pa lejuar ndonjë përpjekje për të rregulluar shkeljet e vazhdueshme të të drejtave procedurale.¹⁰¹

Çështjet *Kadi* dhe disa prej tyre që vijuan janë të rëndësishme dhe ngrenë çështje të ndërlikuara ligjore për BE-në dhe për shtetet anëtare dhe kanë sjellë kundërshtime ndërkombëtare, si dhe një llogari të rëndësishme globale të shumë sanksioneve. Por, ajo që është më mbresëlënëse lidhur me këtë kapitull, është se GJED-ja dhe GJSHP-ja/Gjykata e Përgjithshme kanë qenë më pak mosbesuese për institucionet e BE-së dhe për institucionet ndërkombëtare, si Këshilli i Sigurimit, kur merren parasysh kundërshtimet bazuar në të drejtat themelore. Kjo nuk vlen për të thënë se gjykatat evropiane kanë hedhur poshtë të gjitha këto masa ngrirëse ose nuk kanë bërë tolerime për institucionet e BE-së në rrethana të caktuara. Në një sërë çështjesh që përfshijnë sanksione të një natyre politike, për shembull, krahasuar me çështjet që përfshijnë asistencë të dyshuar individuale ndaj terrorizmit, GJSHP-ja, Gjykata e Përgjithshme dhe GJED-ja kanë ndërmarrë sanksione të BE-së dhe nuk kanë kundërshtuar pretendime për shkelje të të drejtave procedurale.¹⁰²

Më tej, edhe kur GJED-ja ose Gjykata e Përgjithshme kanë anuluar masa, fitorja ka qenë e madhe si, për shembull, në çështjen *Kadi I* ku GJED-ja ruajti masat e kundërshtuara për t'u dhënë institucioneve kohë të korrigjojnë shkeljet procedurale, ose Al-Aqsa ku, përveç anulimit të masës së kundërshtuar mbi baza procedurale, Gjykata e Përgjithshme vendosi se gjykata e brendshme kishte vendosur si çështje thelbësore që pretenduesit kishin pranuar se fondet e tyre po përdorreshin për qëllime terroriste.¹⁰³

¹⁰¹ Në kohën e të shkruarit çështja T-85/09 *Kadi II* është në apel në GJED.

¹⁰² Çështja T-181/08, 19 maj 2010 dhe çështja T-390/08 [2009] PVGJE II-3967.

¹⁰³ Çështja T-348/07 (n 81)[128]-[132].

Gjithsesi, gama e çështjeve të sanksioneve të një profili të lartë dhe politikisht në rritje vitet e fundit ka treguar se Gjykata e Përgjithshme dhe GJED-ja po shfaqin dëshirë më të madhe për të rishikuar dhe për të goditur legjislacionin e BE-së për shkelje të të drejtave themelore dhe vlerësojnë prioritetin e tyre në të drejtën e BE-së mbi legjislacionin dytësor dhe madje mbi normat më të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare.

2.1. Kundërshtimi i akteve administrative të BE-së.

Veçanërisht në dy kategori çështjesh, në çështjet e organikës dhe në procedurat e ligjit të konkurrencës, aplikantët kanë pasur një masë më të madhe suksesi në kundërshtimin e akteve specifike administrative (ndryshe nga masat e përgjithshme legjislative) për shkeljen e të drejtave themelore.

2.2. Çështjet që kanë të bëjnë me personelin.

Në një varg çështjesh të organikës dhe të marrjes në punë, GJED-ja ka pranuar argumentet e bazuara mbi paditë të tilla, si cenimi i lirisë së shprehjes,¹⁰⁴ lirisë së besimit,¹⁰⁵ të drejtës për jetë private dhe mosdiskriminimi¹⁰⁶ dhe u ka kërkuar institucioneve të BE-së të përmirësojnë disa nga praktikatat e tyre.

Një përjashtim i dukshëm është rasti *D k. Këshillit*, në të cilin GJED-ja vendosi se as parimi i trajtimit të barabartë, as mosdiskriminimi mbi bazën e seksit dhe as respektimi i jetës private dhe familjare nuk ishin shkelur nga refuzimi i Këshillit për të njohur bashkëjetesën e regjistruar të një punëmarrësi suedez me një partner të të njëjtit seks (të cilët kanë status civil të krahasueshëm me martesën në Suedi) si të barabartë me martesën, me qëllim për të fituar një leje nga BE-ja për staf shërbimi shtëpiak.¹⁰⁷ Edhe në rastin *Jowl De Bry*, GJED-ja vendosi se të drejtat e mbrojtjes nuk përfshinin ndonjë

¹⁰⁴Çështja 100/88 [1989] PVGJE 4285.

¹⁰⁵Çështja 130/75 [1976] PVGJE 1589.

¹⁰⁶Çështja C-404/92 *P X v. Commission* [1994] PVGJE I-4337;.

¹⁰⁷Çështjet C-122 dhe 125/99 *P D*, nr.46.

detyrim ndaj Komisionit për të dhënë një paralajmërim paraprak për një punëmarrës përpara vlerësimit të stafit.¹⁰⁸

2.3. Procedurat e konkurrencës.

Hapësira e kompetencave detyruese të Komisionit në procedurat e konkurrencës ka qenë një burim i padive, në të cilat parimet e përgjithshme të ligjit dhe të të drejtave themelore, shpesh grumbulli i të drejtave të referuara si “e drejta e mbrojtjes”¹⁰⁹, përfshirë të drejtën për t’u dëgjuar¹¹⁰ dhe parimet përkatëse, si mosprapaveprimi i përgjegjësisë penale,¹¹¹ janë përmendur shpesh për të goditur aktet administrative dhe ekzekutive të KE-së.

Kompetencat e Komisionit në procedurat e konkurrencës janë shumë të gjera, përfshirë autoritetin për të hetuar dhe për të bërë kërkime, po aq sa për të imponuar ndëshkime të ashpra financiare e prandaj dhe palët e ndikuara i kanë kërkuar në mënyrë të përsëritur Gjykatës të kufizojë dhe të kontrollojë ushtrimin e tyre me anë të referimit të parimeve ligjore themelore.¹¹²

Le të shohim tashmë një rast praktik dhe mjaft interesant të vendimit të Gjykatës: Çështjet 46/87 dhe 227/88, *Av.Përgj. Hoechst v. Komisionit*. Rasti relativisht i hershëm *Hoechst* përfshiu një kundërshtim të kompanisë aplikante për vendime të ndryshme të Komisionit, që urdhëronin një hetim për bizneset e saj në kontekstin e praktikave antikonkurrese.

Përpara se të shqyrtohen natyra dhe shtrirja e kompetencave të Komisionit për të hetuar sipas nenit 14 të rregullores nr.17, duhet përmendur se ai nen nuk mund të interpretohet në një mënyrë të tillë sa të japë rezultate që bien në kundërshtim me parimet e përgjithshme të së drejtës së Komunitetit dhe, në veçanti, me të drejtat themelore. Në

¹⁰⁸ Çështja C-344/05 [2006] PVGJE I-10915.

¹⁰⁹ Çështjen C-397/03 [2006] PVGJE I-4429.

¹¹⁰ Çështja C-185/95 *P Baustahlgewebe v. Commission* PVGJE I-8417, çështjet T-213/95 dhe 18/96 *SCK & FNK v. Commission* [1997] PVGJE II-1739.

¹¹¹ çështjet C-189-213/02 *P.DanskRorindustri et al. v. Commission* [2005] PVGJE I-5425.

¹¹² çështjet 17/74, nr.35 më lart; çështjet 209-215/78 *Van Landewyck v. Commission* [1980] PVGJE 3125.

interpretimin e nenit 14 të rregullores nr.17, vëmendje duhet pasur në veçanti për të drejtën e mbrojtjes së ofruar pronave të biznesit kundër ndërhyrjes së autoriteteve publike, një parim ky, natyra themelore e të cilit është theksuar në një sërë rastesh në vendimet e gjykatës¹¹³. Meqë aplikanti është mbështetur gjithashtu mbi kërkesat që rrjedhin nga e drejta themelore e paprekshmërisë së shtëpisë, duhet vërejtur se, megjithëse ekzistenca e një të drejte të tillë duhet pranuar në rendin ligjor të Komunitetit si një parim i përbashkët në legjislacionin e shteteve anëtare në lidhje me banesat private të personave fizikë, kjo nuk është e vërtetë në lidhje me ndërmarrjet, sepse nuk janë të papërfillshme mosmarrëveshjet mes sistemeve ligjore të shteteve anëtare lidhur me natyrën dhe shkallën e mbrojtjes së ofruar pronave të biznesit kundër ndërhyrjes së autoriteteve publike.

Asnjë rrjedhojë tjetër nuk duhet të nxirret nga neni 8 (1) i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut që parashikon se: “Çdokush ka të drejtë të respektohet në jetën e tij private dhe familjare, në shtëpinë e tij dhe në korrespondencën e tij”. Fusha mbrojtëse e këtij neni është e lidhur me zhvillimin e lirisë personale të njeriut dhe prandaj mund të mos jetë e shtrirë për pronat e biznesit. Për më tepër, duhet bërë e ditur se nuk ka praktikë gjyqësore të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mbi atë subjekt.

Megjithatë, në të gjitha sistemet ligjore të shteteve anëtare, çdo lloj ndërhyrje nga autoritetet publike në sferën e aktiviteteve private të një individi, qoftë natyrore ose ligjore, duhet të ketë bazë ligjore dhe të justifikohet me motivet e paraqitura nga ligji. Rrjedhimisht, këto sisteme sigurojnë mbrojtje ndaj ndërhyrjeve arbitrare të shpërpjesëtuara, ndonëse në forma të ndryshme. Nevoja për një mbrojtje të tillë duhet të njihet si një parim i përgjithshëm i së drejtës komunitare.

Gjykata u mbështet në faktet e çështjes për të vendosur nëse Komisioni nuk kishte shkelur asnjë prej parimeve të përmendura nga aplikantët. Ky vendim ishte kritikuar me

¹¹³ shih në veçanti gjykimin e 9 nëntorit 1983 në çështjen 322/81 *Michelin k. Commission* [1983] PVGJE 3461 paragrafi 7.

arsyen se Gjykata e hodhi poshtë shumë shpejt argumentin që pushteti i Komisionit për kërkime binte në kundërshtim me të drejtën e privatësisë së banesës, e cila është e mbrojtur nga KEDNJ-ja dhe nuk e kishte marrë parasysh praktikën gjyqësore ekzistuese të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ).¹¹⁴ Në vendimin e saj pasues në çështjen *Niemietz*,¹¹⁵ GJEDNJ-ja vendosi shprehimisht se e drejta për të respektuar jetën private sipas nenit 8 të Konventës nuk shtrihej mbi pronat e biznesit dhe kjo u njoh më vonë nga GJED-ja në çështjet e tjera, përfshirë *Roquette Freres*, ndonëse duke theksuar që ndërhyrja më e gjerë mund të justifikohet sipas nenit 8 KEDNJ, kur bëhet fjalë për pronat e biznesit ose për pronat tregtare.¹¹⁶

Po ashtu, në lidhje me të drejtën për një gjykim të drejtë sipas nenit 6 (1) të KEDNJ-së, vendimi i GJED-së në *Orkem*,¹¹⁷ në të cilin ajo u shpreh se neni 6 nuk të jepte të drejtën “për të mos dëshmuar kundër vetes”, ishte në kundërshtim me vendimin pasues të GJEDNJ-së në rastin *Funke*, ku gjykata tregoi se neni 6 mbronte të drejtën “për të ruajtur heshtjen dhe për të mos kontribuar në vetëinkriminim” (Van Overbeek, 1994: 127). Megjithatë, në vendimin e mëvonshëm të GJED-së për rastin *Huls*, gjithashtu lidhur me procedurën e ligjit të konkurrencës, Gjykata theksoi rëndësinë e KEDNJ-së në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, duke vendosur se prezumimi i pafajësisë aplikohet në procedurat e konkurrencës që mund të përfundojë me gjoba.¹¹⁸ Në rastin *Mannesmannrohren-Werke*, ku aplikanti u mbështet në nenin 6 të KEDNJ-së për të goditur ngulmimin e Komisionit, në ndëshkimin me gjobë, se aplikanti duhet t’u përgjigjet disa pyetjeve të parashtruara gjatë një hetimi të konkurrencës, GJSHP vendosi që aplikanti “nuk mund të kërkojë ndihmën e Konventës përpara Gjykatave të Komunitetit”, por në të njëjtën kohë pohoi se parimet e përgjithshme të së drejtës së

¹¹⁴Çështjen *Chapell*, App. Nr.10461/83.

¹¹⁵*Niemietz v. Germany*, Seritë A, nr.251(1992) 16 EHRR 97, paragrafi 31 në veçanti.

¹¹⁶ Çështja C- 94/00 *Roquettes Freres SA v. Commission* [2002] PVGJE I-9011, paragrafi 29.

¹¹⁷ Çështja 374/87 *Orkem*, nr. 66 më lart, paragrafi 30 i gjykimit.

¹¹⁸ Çështja C-199/92 *P.huls v. Commission* [1999] PVGJE I-4287, paragrafët 149-150.

KE-së, përfshirë të drejtat e ndryshme të mbrojtjes, siguronin mbrojtje të njëjlojtë¹¹⁹. Së fundi, gjithsesi as GJED-ja dhe as GJSHP-ja nuk konstatuan ndonjë shkelje të të drejtave të ndryshme të mbrojtjes nga Komisioni, qoftë në rastin *Huls* ose në rastin *Mannesmannrohren-Werke*, ose qoftë dhe në një seri rastesh të tjera lidhur me prezumimin e pafajësisë¹²⁰. Edhe në çështjen *Danzer*, ku aplikantët u përpoqën të shtrinin të drejtën kundër vetëinkriminimit në kontekstin e së drejtës së kompanive, GJSHP-ja, vendosi se e drejta nuk aplikohet për kërkesën mbi kompanitë sipas një direktive të KE-së mbi të drejtën e kompanive për të zbuluar bilancet e tyre vjetore¹²¹.

Kapitulli IV: Kundërshtimet ndaj veprimeve të shtetit anëtar lidhur me të drejtat themelore.

1. Kundërshtimi ndaj veprimeve të shtetit anëtar lidhur me të drejtat themelore.

Çështjet e të drejtave të njeriut marrin një spikatje gjithmonë e më të madhe brenda së drejtës dhe politikës së BE-së, në veçanti kur kemi parasysh kompetencat antidiskriminuese në nenin 13 KE dhe legjislacionin e miratuar sipas tij. Mekanizmi i sanksionit në nenin 7 TBE, megjithëse vështirë se zbatohet, e ka përforcuar këtë spikatje. Instrumente të reja, siç janë përgjithësimi i të drejtave të njeriut dhe vlerësimi i ndikimit të të drejtave të njeriut, janë zhvilluar nga Këshilli dhe nga Komisioni dhe janë ngritur organe të reja, të tilla si Rrjeti i Ekspertëve të Pavarur mbi të Drejtat Themelore dhe Agjencia e të Drejtave Themelore. Deri këtu është vlerësuar roli i të drejtave themelore si standarde për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të BE-së dhe si kufizime mbi aktet e institucioneve të BE-së. Megjithatë, gjatë viteve GJED-ja ka vendosur gjithashtu se të drejtat themelore janë të detyrueshme jo vetëm për institucionet e KE-së, por edhe për Shtetet Anëtare kur ata veprojnë brenda sferës së zbatimit të së drejtës

¹¹⁹Çështja T-112/98 *Mannesmannrohren-Werke*, nr.17 më lart, paragrafi 66-77.

¹²⁰Çështjen C-57/02 *P Axerinox v. Commission* [2005] PVGJE I-6689, paragrafët 87-89.

¹²¹Çështja T-47/02 *Danzer v. Council* [2006] PVGJE II-1779.

komunitare. GJED-ja kuptohet është autoriteti më i lartë gjyqësor në kuadrin e BE-së për ato fusha të cilat mbulohen dhe rregullohen nga e drejta e BE-së, duke tejkaluar kështu dhe gjykatat e larta në nivel kombëtar. Duke u bazuar në ish-nenin 220 KE, Gjykata i ka interpretuar gjerësisht kompetencat e saj (Paul, 2010: 287). Vetë natyra e rendit juridike të BE-së, si dhe parimet e rëndësishme të efektit të drejtpërdrejtë dhe të mbizotërimit të së drejtës së BE-së ndaj të drejtës së brendshme u kërkojnë shteteve anëtare marrjen e rrugëve ligjore për një mbrojtje juridike të efektshme në fushat që mbulon e drejta e Bashkimit. Neni 19 nuk ndalet specifikisht në përcaktimin e këtyre rrugëve, por si pjesë e traktatit është një normë me efekt të drejtpërdrejtë mbi shtetet anëtare të cilat duhet ta zbatojnë atë. Në bazë të nenit 19 TBE, paragrafi 1, pika 2, gjyqtari i së drejtës komunitare në rendin e brendshëm juridik është gjyqtari kombëtar. Duke qenë se traktati nuk vendos ndonjë hierarki midis gjyqtarit kombëtar dhe gjyqtarit komunitar, ky nen e rregullon marrëdhënien duke u bazuar në bashkëpunimin që krijohet midis tyre (Paul, 2010: 288). Statuti i GJED-së është përcaktuar në protokollin nr.3. Statuti mund të ndryshohet nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli me procedurë të zakonshme legislative (nenit 281 TFBE). GJED-ja, pra, ka vendosur se të drejtat themelore janë të detyrueshme edhe për Shtetet Anëtare kur ata veprojnë brenda sferës së zbatimit të së drejtës komunitare. Ky zhvillim mbetet i diskutueshëm, jo vetëm sepse nuk është gjithmonë e qartë kur dhe nëse shtetet janë duke vepruar “brenda sferës së zbatimit” të së drejtës komunitare, por kryesisht edhe sepse disa nga shtetet anëtare janë rezistuese ndaj idesë se është GJED-ja që i vendos standardet e mbrojtjes të të drejtave të njeriut, standarde që duhet t’i zbatojnë ata. Situatat e ndryshme, në të cilat të drejtat themelore të KE-së janë quajtur të detyruara për shtetet anëtare, janë paraqitur më poshtë. Nga ana tjetër, sipas GJED-së, përderisa Bashkimi është Bashkim i së drejtës, të gjitha aktet e institucioneve i nënshtrohen kontrollit të tij. Duke pasur parasysh se GJED-ja është autoriteti më i lartë gjyqësor në kuadrin e BE-së për ato fusha të cilat

mbulohen dhe rregullohen nga e drejta e BE-së, Gjykata vepron në fushën e kompetencave të saj, të cilat, gjithsesi, duke u bazuar në ish-nenin 220 KE, Gjykata i ka interpretuar gjerësisht. Tërësia e rekurseve është objekti i ndërtesës së jurisprudencës dhe përbën “një sistem të plotë rrugësh për rekurse dhe procedura”¹²². Ligjshmëria e një akti komunitar mund të kundërshtohet në dy mënyra: i interesuari i drejtohet drejtpërsëdrejti Gjykatës së Drejtësisë, ose gjyqtari kombëtar i drejton Gjykatës së Drejtësisë një kërkesë për interpretim paraprak të vlefshmërisë (Paul, 2010: 475). Kontrolli i drejtpërdrejtë i ligjshmërisë sigurohet në tri rrugë: rekursi për anulim që i lejon ankuesit të arrijë anulimin e një akti komunitar, rekursi për mosveprim që i lejon atij të kërkojë vendosjen e sanksioneve për mosveprim që bie ndesh me të drejtën komunitare dhe anulimi për mungesë të bazës ligjore, procedurë dytësore, që autorizon ankuesin t’i referohet paligjshmërisë së një rregulloreje për të mos lejuar zbatimin e saj (Paul, 2010: 475).

2. Orientimi i GJED-së lidhur me zbatimin e dispozitave të legjislacionit të BE-së bazuar në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

GJED-ja është institucioni dhe autoriteti juridik i BE-së. Detyra parësore e saj është garantimi i respektimit të ligjit në interpretimin dhe zbatimin e traktateve, kontrolli i ligjshmërisë së akteve të Bashkimit Evropian, interpretimi dhe zbatimi i njësuar i së drejtës së BE-së, çka bën që veprimtaria e saj të jetë heterogjene dhe e larmishme. Që nga themelimi i saj, të tria gjykatat kanë dhënë rreth 15000 vendime. GJED-ja, në bashkëpunim me gjykatat dhe tribunalet e shteteve anëtare, siguron aplikimin dhe interpretimin e njësuar të së drejtës së BE-së. Pra, në këtë aspekt një funksion thelbësor i Gjykatës është të promovojë më tej integrimin evropian¹²³.

Kur zbatojnë dispozitat e legjislacionit të KE-së, të cilat janë bazuar në mbrojtjen e të

¹²²Vendimi 23 prill 1986, *Les Verts c/Parlement*, çështja 294/8, rec.1339.

¹²³ Sipas Kapteyn, 1998, Gjykata Evropiane e Drejtësisë u krijua për të kryer 3 funksione të kufizuara për shtetet anëtare: Të siguronte se Komisioni dhe Këshilli i Ministrave nuk do të tejkalonin autoritetin e tyre. Plotësimin e boshllëqeve në të drejtën komunitare me anë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve si dhe të vendoste në rastet e mospërputhjeve të ngritura nga Komisioni ose shtetet anëtare.

drejtave të njeriut, shtetet anëtare veprojnë në përputhje me parimet e përgjithshme të së drejtës komunitare.

Në vendimin *Rutili* në vitin 1975, GJED-ja përshkroi dispozitat e direktivës 64/221, të cilat vënë limite në kufizimet që mund t'u imponohen shteteve anëtare mbi lëvizjen e lirë të punëtorëve, si shprehje specifike e parimeve më të përgjithshme të ruajtura nga KEDNJ-ja¹²⁴. Prandaj masat shtrënguese, të miratuara nga Franca, në atë rast duheshin kontrolluar për pajtueshmëri me dispozitat e direktivës që, nga ana e tyre, reflektonin dispozitat e KEDNJ-së.

Në mënyrë të ngjashme në çështjen *Johnston k. RUC*, GJED-ja deklaroi se kërkesa për kontroll gjyqësor, e caktuar në vitin 1976 në direktivën për trajtim të barabartë, reflektonte një parim të përgjithshëm të së drejtës komunitare që rridhte si nga traditat kushtetuese kombëtare dhe nga nenet 6 e 13 të KEDNJ-së dhe se, rrjedhimisht, kërkesa e direktivës duhej interpretuar si bazë e së drejtës për një kompensim efektiv¹²⁵.

GJED-ja dha një vendim të ngjashëm mbi marrëdhënien mes së drejtës për privatësi të nenit 8 të KEDNJ-së dhe direktivës së BE-së për përpunimin e të dhënave në çështjen *Osterreichischer Rundfunk*. Dispozitat përkatëse të direktivës do të interpretoheshin në dritën e Konventës dhe të praktikës gjyqësore të KEDNJ-së¹²⁶.

3. Shtetet anëtare si “faktorë” të BE-së.

Kur veprojnë si “faktorë” të së drejtës komunitare në implementimin ose zbatimin e masave të KE-së, shtetet anëtare bazohen në parimet e përgjithshme të së drejtës komunitare. Në një fazë të dytë, GJED-ja shkoi më tej dhe vendosi që, kur interpretojnë dhe implementojnë të drejtën e Komunitetit, shteteve anëtare iu është kërkuar të veprojnë dhe të nxjerrin ligje në një mënyrë që të respektohen të drejtat e parashikuara nga KEDNJ-ja, madje edhe kur masat e Komunitetit nuk mishërojnë vetë të drejtën e

¹²⁴Çështja 118/75 *Watson*, nr.16, 1207-1208.

¹²⁵Çështja 222/84 *Johnston*, nr.15.

¹²⁶Çështjet C-465/00, 138.

veçantë të kërkuar,¹²⁷ siç ishin rastet *Rutili, Johnston ose Osterreichischer Rundfunk*.

Në një çështje të ngritur nga Komisioni kundër Gjermanisë, për të kundërshtuar implementimin nga Gjermania të rregullores 1612/68 për punëtorët emigrantë, me anë të së cilës ishte imponuar një kusht paraprak për strehim të përshtatshëm para se anëtarët e familjes mund të bashkoheshin me një punëtor emigrant, GJED-ja përkrahu kundërshtimin e bërë nga Komisioni dhe vendosi që rregullorja duhej interpretuar në dritën e kërkesës për respektim të jetës familjare sipas nenit 8 KEDNJ¹²⁸. Në çështjen *Kent Kirk*, Gjykata vendosi që efekti i brendshëm

me aplikimit të një dispozite prapavepruese të një rregulloreje peshkimi të KE-së për një instrument ligjor të Britanisë së Madhe do të dhunonte parimin e mosprapaveprimit për përgjegjësinë penale, të parashikuar në nenin 7 të KEDNJ-së¹²⁹.

Qëndrimi ishte përshkruar qartë në vendimin *Wachauf*, në të cilin Gjykata vendosi që, kur zbatohet të drejtën e Komunitetit, shtetet anëtare janë të detyruara nga po ato parime të përgjithshme dhe të drejta themelore që e detyrojnë dhe Komunitetin në veprimet e tij¹³⁰. Në çështjen *Wachauf* kjo do të thotë se, me mbarimin e qiramarrjes së tij, shteti anëtar duhej të përpiqej të jepte kompensimin për një fermer qiramarrës që e kishte ndërprerë prodhimin e qumështit, sado që rregullorja e implementuar e KE-së nuk e parashikonte në mënyrë të veçantë një kompensim të tillë¹³¹.

Si në rastin *Lindqvist* lidhur me direktivën e mbrojtjes të të dhënave,¹³² edhe në kundërshtimin e nisur nga Parlamenti Evropian për direktivën e bashkimit familjar,¹³³ GJED-ja theksoi se ato direktiva në vetvete nuk cenonin të drejtat themelore duke ua lënë mundësinë e zgjedhjes shteteve anëtare, sepse direktivat nuk mund të

¹²⁷Çështja C-219/91 *Criminal Proceedings against Ter Voort* [1992] PVGJE I-5495.

¹²⁸Çështja 249/86 *Commission v. Germany* [1989] PVGJE 1263.

¹²⁹Çështja 63/83 *R. v. Kent Kirk* [1984] PVGJE 2689, çështjet C-74 dhe 129/95.

¹³⁰Çështja 5/88 *Wachauf v. Germany* [1989] PVGJE 2609, paragrafi 17-19. Shih gjithashtu çështjen C-292/97 *Karlsson* [2000] PVGJE I-2737.

¹³¹Çështja C-20 dhe 64/00 *Booker Aquacultur*, nr. 54 më lart; çështja C-2/92 *Bostock* [1994] PVGJE I-955.

¹³² Çështja C-101/01 *Lindqvist* [2003] PVGJE I-12971, paragrafi 84-90.

¹³³ Çështja C-540/03 *European Parliament v. Council*, nr.27 më lart, paragrafi 15-23.

interpretoheshin sikur u lejonin shteteve anëtare që ta përdornin lirinë e tyre të veprimit në një mënyrë të tillë sa të shkelte të drejtat themelore.

4. Shmangia e masave të së drejtës komunitare nga shtetet anëtare.

Kategoria paraardhëse lidhet me situata, në të cilat shtetet anëtare janë duke implementuar masat e KE-së, përfshirë këtu rastet kur ata gëzojnë liri veprimi në implementim. Megjithatë, disa shtete anëtarë janë të shmangin normat e gjithashtu të lejuara nganjëherë nga Traktati ose nga parime analoge të përpunuara nga GJED-ja KE-së në politikën e rendit publik ose në fusha të tjera.

Çështja *Rutili* përbën një shembull të një shtete të tillë, por, në atë rast një direktivë e KE-së, e cila caktonte fushën e shmangies, u kërkonte gjithashtu shteteve anëtare të mbrojnë disa të drejta të cilat janë të përfshira në KEDNJ. Megjithatë, më vonë në një numër çështjesh i qe argumentuar Gjykatës se kurdo që shtetet anëtare kërkojnë të mbështeten në një përjashtim nga zbatimi i normave të Komunitetit, ata veprojnë brenda fushës së së drejtës së Komunitetit dhe kështu që do të jenë të detyruara t'i respektojnë këto të drejta. Në çështjen *Cinetheque*,¹³⁴ GJED-ja fillimisht u duk, kundër këshillës së Avokatit të Përgjithshëm Slynn, se e rrëzoi këtë argument dhe në rastin *Demirel*, Gjykata përcaktoi në mënyrë të vendosur se ajo nuk do të ekzaminonte përputhshmërinë e së drejtës kombëtare me të drejtat themelore ose me ndonjë parim tjetër të përgjithshëm të ligjit, kur ligji kombëtar shtrihej “jashtë fushës të së drejtës komunitare”¹³⁵.

Megjithatë, në rastin *ERT*,¹³⁶ GJED-ja qartësoi pozicionin e saj mbi shmangien e së drejtës komunitare, duke deklaruar se ajo kishte për detyrë të sigurote që shtetet anëtare i kishin respektuar siç duhet ato të drejta themelore që ishin pjesë e së drejtës së Komunitetit.

¹³⁴ Çështja 60 dhe 61/84 *Cinetheque v. Federation Nationale des Cinemas Français* [1985] PVGJE 2605, paragrafi 25-26 në veçanti.

¹³⁵ Çështja 12/86 *Demirel v. Stadt Schwabisch Gmund* [1987] PVGJE 3719, paragrafi 28.

¹³⁶ Çështja C-260/89 *Elliniki Radiophonia Tileorassi AE (ERT) v Dimotiki Etairia Pliroforissis and Sotirios Kouvelas* e vitit 1991.

Le të sjellim këtu këte rast konkret, pra një vendim të GjED-së që të qartësojë këtë situatë. ERT-ja ishte një kompani greke radio-televizioni, e cila gëzonte të drejtat ekskluzive sipas ligjit dhe që kërkonte një vendim gjyqësor nga një gjykatë vendase kundër të paditurve, të cilët kishin themeluar një stacion televiziv dhe kishin filluar transmetimin e programeve në kundërshtim të hapur me të drejtën ekskluzive të ligjshme të ERT-së. Mbrojtja u mbështet kryesisht në legjislacionin komunitar mbi lëvizjen e lirë të mallrave dhe në normat mbi konkurrencën dhe monopolet, sikurse dhe në dispozitat e KEDNJ-së mbi lirinë e shprehjes. GjED-ja filloi me përsëritjen e fjalive të saj tradicionale mbi burimet e frymëzimit për të drejtat themelore në të drejtën komunitare dhe citoi vendimet e veta të çështjeve *Nold dhe Wachauf*. Gjykata, deklaroi se ajo nuk kishte kompetencë të shqyrtonte përputhshmërinë e normave kombëtare me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligje që nuk hyjnë në sferën e së drejtës së Komunitetit. Nga ana tjetër, aty ku këto norma hyjnë në sferën e së drejtës së Komunitetit dhe i janë referuar Gjykatës për një vendim paraprak, ato duhet të përmbajnë të gjitha kriteret e interpretimit që i nevojiten gjykatës kombëtare për të vendosur nëse këto norma janë në përputhje me të drejtat themelore, respektimin e të cilave e siguron Gjykata dhe që rrjedhin në veçanti nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Në mënyrë të veçantë kur një shtet anëtar mbështetet mbi dispozitat e kombinuara të neneve 56 dhe 66 për të justifikuar normat që mund të pengojnë ushtrimin e lirisë për të siguruar shërbimet, ky justifikim i parashikuar nga e drejta komunitare duhet interpretuar në dritën e parimeve të përgjithshme të së drejtës dhe në veçanti të të drejtave themelore. Kështu që normat kombëtare në fjalë mund të bëjnë pjesë në përjashtimet e parashikuara nga dispozitat e kombinuara të neneve 56 dhe 66, vetëm në qoftë se ato janë në përputhje me të drejtat themelore, mbrojtja e të cilave është siguruar nga Gjykata. Këtë rrjedh se, në një rast të tillë, i takon gjykatës kombëtare dhe, në qoftë e nevojshme, Gjykatës së Drejtësisë, të vlerësojë zbatimin e

këtyre dispozitave duke pasur parasysh të gjitha normat e së drejtës komunitare, përfshirë lirinë e shprehjes, të mishëruar në nenin 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si një parim i përgjithshëm i së drejtës, mbrojtja e të cilit është e siguruar nga Gjykata. Prandaj dhe përgjigjja për gjykatën kombëtare duhet të jetë që kufizimet e vendosura në kompetencën e shteteve anëtare për të aplikuar dispozitat referuar në nenet 56 dhe 66 të Traktatit për arsye të rendit publik, të sigurisë publike dhe shëndetit publik, duhet të vlerësohen në dritën e parimit të përgjithshëm të lirisë së shprehjes, të mishëruar në nenin 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Ky vendim përbën një zgjerim të mëtejshëm të juridiksionit të Gjykatës për të rishikuar respektimin e të drejtave themelore nga shtetet anëtare, kur ato përkrahin shmangiet nga normat bazë të traktatit, sikurse përbën edhe një cenim të mëtejshëm të “parimeve të përgjithshme të së drejtës së KE-së” nga sistemet ligjore të shteteve anëtare. Për ta thënë me fjalët e dy vrojtuesve me eksperiencë që komentojnë vendimin ERT-s, “disa nga këto shmangie janë të lidhura me nocionet themelore që rregullojnë marrëdhëniet midis shteteve dhe qytetarët e tyre nuk mund të mos e vlerësojnë ndikimin e mundshëm të atij gjykimi mbi sovranitetin kombëtar” (Mancini dhe Celing, 1991). Çështja pasuese *Familiapress* qartësoi se edhe kur një shtet anëtar nuk mbështetet në një nga shmangiet e Traktatit të llojit të bazuar në politikën e rendit publik, por përkundrazi në një varg më të gjerë të “justifikimeve për interes publik” të zhvilluara nga GJED-ja për masa kombëtare jodiskriminuese, masa e fundit do të vlerësohet nga GJED-ja për përputhshmëri me të drejtat themelore¹³⁷.

Pavarësisht argumenteve të bëra, madje edhe nga anëtarë të vetë Gjykatës, për të zvogëluar ose për të kufizuar sferën e këtyre vendimeve (Jacobs, 2001: 26), ato janë konfirmuar shumë herë që nga ajo kohë. Në fushën e ndjeshme të emigracionit, për shembull, ka pasur një varg të tërë vendimesh lidhur me të drejtën për jetë familjare, aty

¹³⁷Çështja C-368/95 *Vereinigte Familiapress Zeitungsverlags-und Vertriebs GmbH v. Heinrich Bauer Verlag* [1997] PVGJE I-3689.

ku shtetet janë mbështetur në shmangien për shkak të rendit publik ose interesit publik në dëbimin e një emigranti të mbrojtur nga e drejta komunitare ose për të refuzuar disa përfitime të tjera familjare. Në çështjet si *Orfanopoulos*,¹³⁸ *MRAX*,¹³⁹ *Baumbast*,¹⁴⁰ *Carpenter*,¹⁴¹ *Akrich*,¹⁴² dhe *Commission k. Germany*,¹⁴³ Gjykata theksoi kërkesat ndaj shteteve për të bërë vlerësimin e duhur të ndikimit të akteve të propozuara prej saj mbi të drejtën për jetë familjare, përderisa ajo mbrohet nga neni 8 i KEDNJ-së. Në të vërtetë, si në rastin *Carpenter* e madje në mënyrë më të dukshme në rastin *Akrich*, GJED-ja duket se e shtriu interpretimin e saj të mëparshëm mbi atë që përfshihej “brenda sferës të së drejtës së Komunitetit”.

Në çështjen *Carpenter*, Gjykata vendosi se propozimi i Britanisë së Madhe për të dëbuar bashkëshorten me kombësi jo nga BE-ja të një qytetari britanik përbënte një kufizim të mundshëm të lirisë së këtij të fundit për të siguruar shërbimet përtej kufirit, kështu që masa ishte në sferën e së drejtës së KE-së dhe ishte vlerësuar përfundimisht nga Gjykata se cenonte të drejtën e respektit për jetën familjare.¹⁴⁴ Në çështjen *Akrich*, ku përfshihej gjithashtu një propozim për të dëbuar nga Britania e Madhe një bashkëshorte me kombësi jo nga BE-ja, GJED-ja vendosi se, megjithëse bashkëshortja në këtë rast nuk ishte një banore e ligjshme dhe nuk ishte e mbrojtur nga e drejta komunitare mbi lëvizjen e lirë të punëtorëve ose të shërbimeve, fakti që ajo ishte martuar me një qytetar të BE-së dhe ishte rikthyer nga Irlanda në Britaninë e Madhe, do të thotë prapë që Britania e Madhe ishte e detyruar të siguronte respektin e duhur për të drejtën e jetës familjare.¹⁴⁵

Këto vendime sigurisht që e mbështetin komentin e bërë nga Mancini dhe Keeling për

¹³⁸Çështjet C-482 dhe 493/01 *Orfanopolous and Oliveri v. Landbaden-Wurtemberg* [2004] PVGJE I-5257, parag. 97-100.

¹³⁹Çështja C-459/99 *MRAX v. Belgium* [2002] PVGJE I-6591, paragrafi 53, 61, dhe 62.

¹⁴⁰Çështja C-413/99 *Baumbast and R. v. Home Secretary* [2002] PVGJE I-7091, paragrafi 72-73.

¹⁴¹Çështja C-60/00 *Carpenter v. Home Secretary* [2002] PVGJE I-6279.

¹⁴²Çështja C-109/01 *Home Secretary v. Akrich* [2003] PVGJE I-9607.

¹⁴³Çështja C-441/02 *Commission v. Germany* [2006] PVGJE I-3449, paragrafi 108-113.

¹⁴⁴Çështja C-60/00 *Carpenter*, nr. 94 më lart, paragrafi 37-46.

¹⁴⁵Çështja C-109/01 *Akrich*, nr. 95 më lart, paragrafi 58-60.

ndikimin e mundshëm të gjykimit *ERT* (dhe *Familiapress*) mbi sovranitetin kombëtar dhe ilustrojnë zgjerimin e vazhdueshëm të rishikimit nga GJED-ja të masave të shteteve anëtare për të qenë në përputhje me të drejtat themelore. E njëjta gjë mund të thuhet për çështjen *Karner*, në të cilën GJED-ja në mënyrë të ngjashme bëri të vetën një pikëpamje zgjeruese të asaj çka bie “brenda sferës së zbatimit të së drejtës komunitare” (Stuyck, 2004).

Në një mënyrë më pak të debatueshme, Gjykata ka konfirmuar gjithashtu se mbrojtja e të drejtave të njeriut përbën në vetvete një interes legjitim që do të justifikonte një kufizim të normave të KE-së për lëvizjen e lirë. Në vendimet *Schmidberger*¹⁴⁶ dhe *Omega Spielhallen*¹⁴⁷ Austria dhe Gjermania respektivisht pretenduan që baza e saktë për shmangien e tyre nga normat e KE-së për lëvizjen e lirë ishte mbrojtja e të drejtave themelore dhe GJED-ja i përkrahu pretendimet e tyre respektive.

Le të shohim gjithashtu çështjen C-112/00 *Schmidberger v. Austria* e vitit 2003. Austria u mbështet në mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe të tubimit, si një arsye e rendit publik për të justifikuar mbylljen e përkohshme të rrugëve (rrugëve tregtare) mes Austrisë dhe Italisë, me qëllim që të lejonte zhvillimin e një manifestimi mjedisor. GJED-ja gjithsesi e prezantoi rastin si një konflikt midis dy interesave ligjorë me peshë të barabartë, liria e lëvizjes e garantuar nga traktati i KE-së, nga njëra anë, dhe lira e shprehjes dhe e tubimit të demonstruesve, garantuar nga instrumentet e të drejtave të njeriut si KEDNJ-ja, nga ana tjetër, çdonjëra prej të cilave mund të kufizohet në dobi të një interesi tjetër të përgjithshëm. Në rendin e saj të referimit, gjykata kombëtare ngre gjithashtu çështjen nëse parimi i lëvizjes së lirë të mallrave, i garantuar nga Traktati, mbizotëron mbi këto të drejta themelore. Në përputhje me praktikën e konsoliduar gjyqësore, të drejtat themelore formojnë një pjesë integruese të parimeve të përgjithshme të së drejtës, respektimin e të cilave e siguron Gjykata. Për këtë arsye, Gjykata merr frymëzim nga

¹⁴⁶Çështja C-112/00 *Schmidberger*, nr.43.

¹⁴⁷Çështja C-36/02 *Omega Spielhallen*, nr.43.

traditat kushtetuese të përbashkëta të shteteve anëtare dhe nga udhëzimet e siguruara nga traktatet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në të cilat shtetet anëtare kanë bashkëpunuar ose në të cilat ato janë nënshkruese. KEDNJ-ja ka rëndësi të veçantë në këtë aspekt¹⁴⁸. Parimet e vendosura nga ajo praktikë gjyqësore ishin riafirmuar në preambulën e Aktit Unik Evropian dhe më pas në nenin F.2 të Traktatit mbi Bashkimin Evropian (Bosman, cituar më lart në paragrafin 79). Ajo dispozitë përcakton se “Unioni do të respektojë të drejtat themelore, ashtu siç janë garantuar nga Konventa Evropiane e të Drejtave dhe Liritë Themelore të Njeriut nënshkruar në Romë më 4 nëntor 1950 dhe ato që rezultojnë nga traditat kushtetuese të përbashkëta të shteteve anëtare, si parime të përgjithshme të së drejtës komunitare”. Këtë rrjedh se masat, që janë të papajtueshme me respektimin e të drejtave të njeriut të njohura në këtë mënyrë, janë të papranueshme për Komunitetin¹⁴⁹. Kështu, meqë si Komunitetit edhe shteteve të tij anëtare u është kërkuar të respektojnë të drejtat themelore, mbrojtja e këtyre të drejtave është një interes legjitim i cili, në parim, justifikon një kufizim të detyrimeve të imponuara nga e drejta komunitare, madje dhe për një liri themelore të garantuar nga traktati, siç është lëvizja e lirë e mallrave. Në rastin konkret, autoritetet kombëtare u mbështetën në nevojën për të respektuar të drejtat themelore, të garantuara si nga KEDNJ-ja, edhe nga Kushtetuta e shtetit anëtar të interesuar për të vendosur lejimin e një kufizimi të detyrueshëm ndaj një prej lirive themelore të parashikuara në traktat. Rasti në fjalë ngre kështu problemin e nevojës për bashkërendim të të drejtave themelore të Komunitetit me ato që burojnë nga një liri themelore e parashikuar në Traktat dhe, në mënyrë të veçantë, me problemin e sferës përkatëse të lirisë së shprehjes dhe të tubimit, garantuar nga nenet 10 dhe 11 të KEDNJ-së dhe të lëvizjes së lirë të mallrave, ku të parat janë mbështetur nga ne si justifikim për kufizimin e së dytës.

¹⁴⁸ shih, *inter alia*, çështjen C-260/89 *ERT* 1991 PVGJE I-2925, paragrafi 41; çështjen C-274/99 *P. Connolly k. Commission* 2001 PVGJE I-1611, paragrafi 37; dhe çështjen C- 94/00 *Roquete Freres* 2002 PVGJE I-9011, paragrafi 25.

¹⁴⁹ Shih, *vendimin ERT*, të përmendur më lart, paragrafi 41, dhe çështjet C-299/95 *Kremzow* 1997 PVGJE I-2629, paragrafi 14.

GJED-ja më pas vazhdoi të merrej me një analizë mjaft të hollësishme mbi natyrën dhe shkallën e kufizimit të imponuar ndaj lëvizjes së lirë të mallrave, nga masat e marra për mbrojtjen e lirisë së shprehjes e të tubimit dhe përfundimisht vendosi se ajo ishte kufizuar në mënyrë të nevojshme dhe të proporcionale¹⁵⁰.

Në rastin *Omega Spielhallen*, Gjermania mbrojti me sukses dinjitetin njerëzor si një bazë për kufizimin e tregtimit në Gjermani të lojërave laser që stimulonin vrasjen e krijesave humane. GJED-ja argumentoi se “shmangia e politikës publike në nenin 46 KE lejonte ndalimin e përdorimit komercial të lojërave të tilla mbi bazën e mbrojtjes së dinjitetit njerëzor”, që mbrohej në mënyrë të veçantë nga Kushtetuta gjermane. Duke deklaruar se mbrojtja e dinjitetit njerëzor ishte gjithashtu një parim i përgjithshëm i së drejtës së Komunitetit, edhe pse koncepte të veçanta mbi nivelin e përshtatshëm të mbrojtjes mund të ndryshojnë nga një shtet në tjetrin,¹⁵¹ GJED-ja përkrahu kufizimin kombëtar si një kufizim proporcional dhe të nevojshëm.

5. Shtetet anëtare dhe situatat jashtë sferës të së drejtës së Bashkimit Evropian.

Shtetet anëtare nuk janë të detyruara të pajtohen me parimet e përgjithshme të së drejtës komunitare në situatat që shtrihen “jashtë sferës të së drejtës së Komunitetit”. Pamë se GJED-ja në çështjen *Demirel* përcaktoi që ajo nuk do të shqyrtonte përputhshmërinë e masave të shteteve anëtare me të drejtat e njeriut, që dilnin jashtë sferës të së drejtës së Komunitetit. Por, në të njëjtën kohë, rastet si *Carpenter dhe Akrich* tregojnë se shpesh është i vështirë parashikimi i situatave për të cilat GJED-ja do të mendojë se shtrihen “jashtë” apo “brenda” fushës së aplikimit të së drejtës së KE-së për mbikëqyrjen e të drejtave të njeriut.

Në një varg çështjesh, që përfshijnë për më tepër “situata tërësisht të brendshme”, siç është rasti *Kremzow*,¹⁵² ose situatat të cilat nuk janë të rregulluara në ndonjë mënyrë

¹⁵⁰Çështja C-112/00 *Schmidbreger*, nr.43 më lart, paragrafi 81-94.

¹⁵¹Çështja C-36/02 *Omega Spielhallen*, nr.43.

¹⁵²Çështja C-299/95 *Kremzow*, nr.18.

tjetër nga e drejta e Komunitetit, siç janë çështjet *Grado e Bashir*¹⁵³ dhe *Annibaldi*,¹⁵⁴ ose dhe ca më të debatueshme si çështja *Vyacheslav Dem`yanenko*,¹⁵⁵ GJED-ja ka refuzuar të hetojë përputhshmërinë e masave kombëtare me të drejtat themelore.

Një krahasim i çështjeve *Maurin* dhe *Steffensen* lidhur me ndjekjen penale kombëtare për shkeljen e sigurisë në artikujt ushqimorë dhe në standardet e etiketimit nxjerr në pah ndryshimin e trajtimit në varësi të asaj nëse një situatë e dhënë vlerësohet që bie ose jo brenda sferës të së drejtës së KE-së. Në çështjen *Maurin*, i padituri ishte ndjekur penalisht për shitjen e artikujve ushqimorë pas datës së tyre të skadencës¹⁵⁶. Ai argumentoi se padrejtësia procedurale në gjyqin e tij shkelte të drejtat e tij për mbrojtje, të drejta të siguruar nga KEDNJ-ja, por GJED-ja vendosi se legjislacioni kombëtar dilte jashtë sferës të së drejtës së KE-së. Ndonëse kishte një direktivë që kërkonte që produktet ushqimore të tregojnë një datë skadence në etiketën e tyre, nuk kishte ndonjë masë të Komunitetit që të rregullonte shitjen pas datës së skadencës të produkteve ushqimore të etiketuara siç duhet, situatë që paraqitej edhe në rastin *Maurin*. Në çështjen *Steffensen*, përkundrazi, GJED-ja kërkoi që normat kombëtare të evidentimit të interpretoheshin në dritën e së drejtës së KEDNJ-së për një hetim të drejtë dhe, në veçanti, në dritën e së drejtës për të komentuar efektivisht dëshminë e parashtruar kundër një të padituri, pasi në atë rast Direktiva e KE-së mbi kontrollin zyrtar të produkteve ushqimore ishte e lidhur me ndjekjen penale.¹⁵⁷

¹⁵³ Çështja C-291/96 *Criminal Proceedings Against Grado and Bashir* [1997] PVGJE I-5531.

¹⁵⁴ Çështja C-309/96 *Annibaldi v. Sindaco del Comune di Guidoma* [1997] PVGJE I-7493.

¹⁵⁵ Çështja C-45/03 *Vyacheslav Dem`yanenko*.

¹⁵⁶ Çështja C-144/95 *Maurin* [1996] PVGJE I-2909.

¹⁵⁷ Çështja C-276/01 *Joachim Steffensen* [2003] PVGJE I-3735, veçanërisht paragrafi 69-78.

PJESA E DYTË

Kapitulli V: Situata aktuale e të Drejtave të Njeriut në BE. Zhvillimet politike dhe institucionale.

1. Zhvillimet e fundit politike dhe institucionale të të drejtave të njeriut.

GJED-ja ka marrë vendime në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me të drejta themelore, të tilla si: mosdiskriminimi, liria e besimit, e organizimit dhe e shprehjes. Me kryefjalën te integrimi ekonomik, kur u miratuan Traktati i Parisit (1951) dhe Traktati i Romës (1957), mbrojtjes të të drejtave të njeriut iu kushtua pak vëmendje; në dekadat e fundit përqasja ndaj çështjes të të drejtave të njeriut në dhe nga BE-ja u përqendrua në dy forma: nga njëra anë ishte aderimi në KEDNJ dhe nga ana tjetër miratimi i një katalogu të drejtash të vetë BE-së. Ishte vetë GJED-ja ajo e cila u shpreh nëse Komuniteti (por jo Bashkimi) kishte fuqi për të aderuar në KEDNJ. Gjykata vlerësoi kompetencën e Komunitetit për të nënshkrimin e marrëveshjes së anëtarësimit dhe përputhshmërinë e kësaj marrëveshjeje me Traktatin e Komunitetit Evropian, sidomos në lidhje me juridiksionin e Gjykatës¹⁵⁸. Sipas Gjykatës së Drejtësisë¹⁵⁹, Komuniteti nuk e kishte një kompetencë të tillë dhe as neni 308 nuk ishte bazë e mjaftueshme ligjore për t'i dhënë Komunitetit Evropian autoritetin e nevojshëm për ratifikimin e KEDNJ-së. Në vijim, në opinionin e saj, Gjykata u shpreh se: “Asnjë dispozitë e traktatit nuk i jep ndonjëherë prej institucioneve të Komunitetit një kompetencë të përgjithshme për miratimin e akteve për të drejtat e njeriut ose për të nënshkruar konventa ndërkombëtare në këtë fushë”. Në opinionin e saj 2/94 Gjykata theksoi se: “respekti për të drejtat e njeriut është një kusht i ligjshmërisë së akteve të Komunitetit”, një pikëpamje kjo e konfirmuar dhe në çështjet e GJED-së për disa dekada, madje dhe para se respektimi i të drejtave të njeriut të

¹⁵⁸ Marrë nga: House of Commons Library, v.2000, fq.16.

¹⁵⁹ Opinioni 2/94, i Gjykatës Evropiane e Drejtësisë, datë 28 mars 1996.

përmendej shprehimisht në traktate¹⁶⁰. Në rast të aderimit në KEDNJ, atëherë GJEDNJ-ja do të ushtronte kontroll juridik në lidhje me respektimin e të drejtave themelore nga institucionet e BE-së duke mbizotëruar mbi GJED-në në lidhje me çështjen e të drejtave të njeriut (House of Commons Library, 2000: 17). Meqë të gjitha shtetet anëtare kanë ratifikuar KEDNJ-në pothuajse të gjitha e kanë inkorporuar në të drejtën e tyre të brendshme dhe në përgjithësi Gjykata e Drejtësisë ka mbështetur të drejtat e njeriut, argumentohet se nuk ka një nevojë të ngutshme për miratimin e një instrumenti tjetër të të drejtave të njeriut (House of Commons Library, 2000: 13). Vendimet e Gjykatës të Drejtësisë kanë kontribuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së si dhe në zhvillimin e mbrojtjes të të drejtave të njeriut në rendin juridik të BE-së. Pozicioni i GJED-së ndaj GJEDNJ-së do të jetë analog me pozicionin e gjykatave kombëtare ndaj GJEDNJ-së. Në këtë aspekt, individët do të shterojnë ankimin e tyre pranë GJED-së për çështje në lidhje me BE-në para se t'i drejtohen dhe të vënë në lëvizje GJEDNJ. Pavarësisht kësaj, GJEDNJ-ja nuk do të marrë kompetencën e një gjykate të lartë ndaj GJED-së dhe as kjo e fundit nuk i nënrenditet GJEDNJ (si një gjykatë apeli ndaj gjykatës së lartë në vend). Aderimi nuk do të cenojë statusin e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian si autoriteti i lartë i interpretimit të së drejtës së BE-së, ndërkohë që GJEDNJ-ja do të mbetet autoriteti më i lartë për interpretimi e KEDNJ-së si një gjykatë e specializuar dhe me kompetence në këtë fushë dhe si një mekanizëm i jashtëm kontrolli. Prej kohësh ka lindur debati në lidhje me reformën në sistemin gjyqësor, një debat që lidhet dhe me rolin e GJED-së në vetë BE dhe rendin juridik të saj: pra, nëse GJED-ja është një uzurpuese e pushtetit apo një aktor më shumë në integrim. Pavarësisht ndryshimeve strukturore që solli krijimi i Gjykatës së Përgjithshme dhe Gjykata e Shërbimit Civil, roli primar mbetet i rezervuar në duart e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, e cila u pa si një kërcënim nga sistemet ligjore kombëtare. Një nga gjykatësit e Gjykatës Kushtetuese

¹⁶⁰Çështjet e bashkuara 60 dhe 61/84, Cinetheque SA kundër Federation Nationale de Cinemas Francais [1985] PVGJE 2605, paragrafi 26.

Gjermane, Paul Kirchof, më vonë gjykatës relator në çështjen e *Manstrihtit*, deklaroi se është shteti i cili është i vetmi garantues i lirisë, barazisë dhe së drejtës (Zuleeg, 1997: 22-24). Kështu në vendimin e famshëm *Solange I*, Gjykata Kushtetuese Gjermane e bëri të qartë se nëse e drejta e komunitetit mund të shkelë një të drejtë themelore të mbrojtur nga ligji themelor gjerman, atëherë kjo e fundit do të kishte përparësi. Gjykata Kushtetuese Italiane mbajti të njëjtin qëndrim në vendimin e saj të çështjes *Frontini v. Ministero delle Finance, Case 183 Corte Constitutionale (Italy), 1973 [1974], C.M.L.R. 372*. Gjithsesi roli i Gjykatës dhe rëndësia e saj u pa pikërisht në momentet kur dukej se ndërsa KE-ja dobësohej politikisht, ekonomikisht dhe institucionalisht, Gjykata e Drejtësisë, ngulmoi dhe përgatiti një numër të rëndësishëm çështjesh gjyqësore duke ruajtur shpejtësinë për një integrim më të thellë (Desmond, 2014: 142). Duke vepruar kështu Gjykata jo vetëm përcaktoi dhe i dha formë një rregulli të ri legal, por gjithashtu kontribuoi për rigjallërimin dhe transformimin e KE-së në vitet 1980. Në këtë aspekt, GJED-ja ka përmbushur më së miri detyrën e saj kryesore për forcimin e efektivitetit të së drejtës komunitare dhe promovimin e integritit të saj në sistemet ligjore kombëtare. Qasja e Gjykatës për t'i njohur të drejtat e njeriut si pjesë e “parimeve të përgjithshme të së drejtës komunitare” ishte aprovuar formalisht nga një deklaratë e përbashkët e Parlamentit, Këshillit dhe Komisionit në vitin 1977, në të cilën të tria institucionet u angazhuan edhe zyrtarisht për të siguruar respektimin e të drejtave themelore në ushtrimin e pushteteve të tyre. Kjo deklaratë e përbashkët, megjithëse jo ligjërish e detyrueshme, ishte simbolikisht e rëndësishme për të treguar që institucionet politike të Komunitetit mbështesnin Gjykatën në nxjerrjen e të drejtave nga KEDNJ-ja dhe nga parimet kushtetuese kombëtare. Një seri iniciativash të tjera jodetyruese deklaratash dhe rezolutash mbi të drejtat e njeriut ishin miratuar gjatë viteve nga institucionet, me veprime të veçanta ose të përbashkëta. Kjo përfshinte një deklaratë të përbashkët të tri institucioneve në vitin 1986, një varg deklaratash dhe rezolutash mbi racizmin dhe

ksenofobinë nga Këshilli i Evropës, një Deklaratë të drejtave dhe lirive themelore nga Parlamenti Evropian në vitin 1989, një Kartë e Komunitetit për të drejtat themelore sociale, nënshkruar nga njëmbëdhjetë prej dymbëdhjetë shteteve anëtare në v.1989, si dhe një varg të madh referencash në preambulën e Aktit Unik Evropian ndaj KEDNJ-së, Kartës Sociale Evropiane dhe “barazisë dhe drejtësisë sociale”.

2. Roli i Agjencisë të të drejtave themelore në BE.

Në vitin 2007 u krijua Agjencia e të Drejtave Themelore (ADTH) me synim zëvendësimin e qendrës ekzistuese të monitorimit të racizmit dhe ksenofobisë, e cila ishte themeluar në vitin 1997. Pati një sërë diskutimesh në lidhje me rolin e agjencisë; nëse ajo duhet të kishte fuqi të plotë monitorimi në shtetet anëtare nën nenin 7, të TBE, veçanërisht në momentin kur “network-u ekzistues i ekspertëve” e ka kryer këtë funksion në mënyrë informale. Por shtetet anëtare refuzuan ta përfshinin këtë brenda mandatit të agjencisë së re. Në vend të saj kjo agjenci mbulon aspektet informative, opinionbërëse, theksimin e praktikave të suksesshme, rrjetet me shoqërinë civile dhe publikimin e raporteve me natyrë tematike. Mbetet për t’u parë nëse kjo strukturë do të sjellë një vlerë dhe energji të re siç e kanë bërë edhe agjencitë që operojnë në fusha të ndryshme të politikëbërjes evropiane (De Schutter dhe Van Goethem, 2006: 587).

Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore është një nga agjencitë e decentralizuara të BE-së. Këto agjenci janë të krijuara për të siguruar këshilla të ekspertëve të institucioneve të BE-së dhe shteteve anëtare mbi një sërë çështjesh. Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore ndihmon për të siguruar se të drejtat themelore të njerëzve që jetojnë në BE janë realisht të mbrojtura. Sipas Agjencisë të drejtat themelore të mirëpërcaktuara janë standardet minimale për të siguruar që një person trajtohet me dinjitet. Këto të drejta duhet të gjitha të promovohen dhe të mbrohen. Nëpërmjet mbledhjes dhe analizës të të dhënave në BE, Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore ndihmon institucionet e BE-së dhe shtetet

anëtare të BE-së në të kuptuarit dhe trajtimin e sfidave për të mbrojtur të drejtat themelore të të gjithë personave në BE. Duke punuar në partneritet me institucionet e BE-së, shtetet anëtare dhe organizatat e tjera në nivelet ndërkombëtare, evropiane dhe kombëtare, Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore luan një rol të rëndësishëm me ndihmën e saj për të bërë që të drejtat themelore të njeriut të jenë një realitet për të gjithë ata që jetojnë në BE.

3. Politikat evropiane me fokus të drejtat e njeriut.

Në vitin 1994 GJED-ja vendosi që me hyrjen e BE-së në KEDNJ, Komunitetit Evropian i mungonte kompetenca, në bazë të juridiksionit të traktateve dhe kjo kërkonte me vendosmëri vendosjen e një amendamenti¹⁶¹. Asaj pjese të juridiksionit të Gjykatës i përgjigjet neni 6 (2) i TBE-s, i cili tashmë siguron aderimin në KEDNJ-s, por GJED-ja ka bërë komente të tjera me rëndësi në pjesën e opinionëve 2/94 mbi kompetencën e kufizuar të BE-së për të miratuar masat për të mbrojtur dhe për të promovuar të drejtat e njeriut. Ndryshimet e fundit të Traktatit kanë forcuar ndjeshëm statusin dhe rolin e të drejtave të njeriut në legjislacionin Evropian, siç edhe tregohet nga dispozitat e neneve 2, 3, 6 dhe 7 TBE. Asnjë dispozitë e Traktatit nuk u jep institucioneve të Komunitetit ndonjë pushtet të përgjithshëm për të dekretuar norma mbi të drejtat e njeriut ose për të përfunduar konventa ndërkombëtare në këtë fushë. Në mungesë të kompetencave të shprehura ose të nënkuptuara për këtë qëllim, është e nevojshme të vlerësohet nëse neni 235 i Traktatit mund të përbëjë një bazë ligjore për anëtarësim. Neni 235 është hartuar për të mbushur boshllëkun aty ku asnjë dispozitë specifike e Traktatit nuk u jep institucioneve të Komunitetit kompetenca të shprehura ose të nënkuptuara për të vepruar, në qoftë se kompetenca të tilla janë gjithsesi të nevojshme për t'i mundësuar Komunitetit të kryejë funksionet e tij për të arritur një nga objektivat e vendosur nga Traktati. Së pari duhet vënë re se rëndësia e respektimit të të drejtave të njeriut është

¹⁶¹Opinion 2/94, 1996 PVGJE-1795.

theksuar në deklaratat e ndryshme të shteteve anëtare dhe të institucioneve të Komunitetit. Respektimi i të drejtave të njeriut është përmendur gjithashtu në preambulën e Aktit Unik Evropian, në Preambulën, e Traktatit mbi Bashkimin Evropian. Unioni do të respektojë të drejtat themelore, ashtu siç garantohen veçanërisht nga Konventa. Neni 130 (2) i traktatit të BE-së parashikon se politika e Komunitetit në fushën e zhvillimit të bashkëpunimit do të kontribuojë për objektivin e respektimit të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut. Për më tepër, është vendosur tashmë se të drejtat themelore formojnë një pjesë integruese të parimeve të përgjithshme të së drejtës, mbrojtjen e të cilave e siguron gjykata. Për këtë arsye, gjykata merr frymëzim nga traditat kushtetuese të përbashkëta të shteteve anëtare dhe nga direktivat e siguruara prej traktateve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, për të cilat shtetet anëtare kanë bashkëpunuar ose në të cilat ata janë nënshkruese. Në këtë këndvështrim, Gjykata ka përcaktuar se Konventa ka një rëndësi të veçantë (shih në veçanti *ERT*). Respektimi i të drejtave të njeriut është kështu një kusht për ligjshmërinë e akteve të Komunitetit.

Megjithatë, pjesëmarrja në Konventë do të sillte një ndryshim thelbësor në sistemin e tanishëm të Komunitetit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, pasi do të sillte përfshirjen e Komunitetit në një sistem institucional ndërkombëtar të veçantë si dhe integrimin e të gjitha dispozitave të Konventës në rendin ligjor të Komunitetit.

Një modifikim i tillë i sistemit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Komunitet, me po aq ndërlikime themelore institucionale për Komunitetin dhe për shtetet anëtare, do të kishte rëndësi kushtetuese dhe do të shkonte përtej shtrirjes së nenit 235 të Traktatit. Ai mund të zbatohet vetëm me anë të rishikimit të Traktatit.

Jo vetëm që BE-ja (dhe më pas KE-ja) nuk kishte kompetencë në atë kohë për të aderuar në KEDNJ në bazë të implikimeve thelbësore institucionale të integritit, por sepse GJED-ja vendoste gjithashtu që asnjë dispozitë e traktatit nuk i jep pushtet të

përgjithshëm BE-së për të miratuar rregullat e të drejtave të njeriut ose të përfshijë konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Situata ka ndryshuar, veçanërisht në lidhje me kompetencat e jashtme të BE-së. Një shembull i rëndësishëm dhe shumë i goditur janë negociatat e fundit dhe konkluzionet e konventës së OKB-së mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, traktati i parë më i rëndësishëm ndërkombëtar i përfunduar nga Bashkimi Evropian (De Burca, 2010: 35). Megjithatë, deri në masën e kompetencave për të promovuar të drejtat e njeriut, situata brenda në BE nuk ka ndryshuar aq shumë. Pavarësisht deklaratës në nenin 2, në të cilin BE-ja njihet si palë ndërmjetësuese në respektimin e të drejtave të njeriut dhe kushtit në nenin 3 në të cilin sanksionohet qëllimi i BE-së për të promovuar këto vlera, BE-ja ende nuk ka kompetenca të veçanta, të rregulluara me dispozitat përkatëse në traktate për të marrë veprime konkrete. Traktatet ende nuk sigurojnë mundësinë që BE-ja të ketë çfarëdo pushteti për të dekretuar ligje për të drejtat e njeriut.

Megjithatë, BE-ja sot ka një mjet shumë të fuqishëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në fushën e diskriminimit, duke qenë se neni 19 KEDNJ i jep një kompetencë BE-së që të miratojë masa që luftojnë diskriminimin në një sërë fushash. Kjo specifikë do të diskutohet më gjatë në kapitullin 24. Një fushë tjetër me rëndësi e politikave të BE-së është mbrojtja e të dhënave që prej miratimit të direktivës 95/46. Përveç disa kompetencave specifike, dispozita mbi “kompetencat e mbetura” të nenit 352 TFBE mund të përdoret (vetëm ose bashkë me një dispozitë tjetër të traktatit) si një bazë ligjore për disa masa të lidhura me të drejtat e njeriut, sepse ajo vlente për miratimin e rregullores që sanksionon programin e jashtëm për të drejtat e njeriut dhe demokratizimit¹⁶² dhe për themelimin e qendrës për monitorimin dhe mbrojtjen nga racizmi dhe ksenofobia, e cila ishte paraardhësja e Agjencisë për Mbrojtjen e të Drejtave Themelore. Më tej, megjithëse promovimi i të drejtave të njeriut nuk është një

¹⁶² Rregulloret 975 dhe 976, v.1999.

detyrë specifike e BE-së, e mirëpërcaktuar në traktatet, respekti për të drejtat e njeriut shfaqet si vlerë dhe madje si një qëllim kryesor i politikës dhe i marrëdhënieve me jashtë të BE-së. Në bazë të Traktatit të Lisbonës, neni 3 (5) TBE siguron që BE-ja të japë kontributin e saj për respektimin e të drejtave të njeriut në lidhje me jashtë dhe neni 21 (1) i po këtij institucioni siguron që veprimi i BE-së në arenën ndërkombëtare të bëhet në bazë të parimeve të demokracisë, ligjit, universalitetit dhe pandashmërisë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, respektit për dinjitetin njerëzor, parimeve të barazisë dhe solidaritetit ndërmjet njerëzve. Kjo sanksionon fort politikën e BE-së në dekadën e fundit me synimin që të integrojë mbrojtjen e të drejtave të njeriut me politikën dhe me marrëdhëniet me jashtë. Praktika e rregullt e BE-së që prej vitit 1995 i ka përfshirë klauzolat e të drejtave të njeriut në marrëveshjet që kishin të bënin me tregtinë, zhvillimin dhe marrëdhëniet dypalëshe (Bartels, 2005) dhe shpesh ka vendosur sanksione ose ka tërhequr koncesione tregtare për shkak të shkeljes të të drejtave të njeriut siç është edhe rasti i Majmarit dhe Sri-Lankës. Ajo ka përdorur kondicionalitetin e bazuar mbi të drejtat e njeriut në procesin e integritetit të shteteve të reja anëtare (Ward, 2005: 59-82) dhe drejton një program të gjerë ndërkombëtar të përqendruar në të drejtat e njeriut dhe te demokratizimi sipas KEDNJ-së. Këto dhe aktivitete të tjera të BE-së në këtë fushë janë specifikuar çdo vit, qysh prej publikimit të raportit vjetor mbi të drejtat e njeriut në vitin 1999. Megjithatë nuk ka një përkushtim të hapur ndaj mbrojtjes së promovimit të të drejtave të njeriut në politikat e brendshme të BE-së, siç ndodh për politikën e jashtme. Ekzistojnë 4 klauzola kryesore në nenet 8, 9, 10 dhe 11 të KDNJ-së, të cilat kërkojnë prej politikave të BE-së dhe prej aktiviteteve të ndërmarra prej saj marrjen në konsideratë të elementeve, si barazia gjinore, rangu social, diskriminimi dhe mbrojtja e mjedisit, por nuk ka asnjë deklaratë konkrete për t'i përfshirë ato më gjerësisht në politikat e brendshme. Kjo diferencë midis mbrojtjes të të drejtave të njeriut në arenën e brendshme me atë të jashtme i ka dhënë jetë një debati

mbi dystandardshmërinë dhe përqaşjen e BE-së ndaj kësaj çështjeje, gjë kjo e pranuar edhe nga vetë Këshilli i Ministrave¹⁶³. Megjithatë kjo vazhdon të jetë një temë diskutimi në vazhden e kritikave ndaj këtij subjekti politik¹⁶⁴ (Osting, 2003). Nga ana tjetër statusi i përmirësuar i Kartës të të Drejtave dhe Lirive Themelore e ka nxitur Komisionin të zhvillojë më tej propozimin e saj për një Kartë të posaçme mbi vlerësimin e politikave të BE-së, e cila mund të ndihmojë në eliminimin e dystandardshmërisë. Një nga kritikantët më të fuqishme kundër BE-së lidhur me këtë çështje është mungesa e lidershit dhe humbja e influencës në arenën ndërkombëtare. Duket e drejtë të thuhet se përqaşja e shteteve anëtare për zhvillimin e fuqive juridike të BE-së në fushën e të drejtave të njeriut është e dyshimtë. Cilado fuqi e re, e mundshme, institucion apo normë e re ligjore, për të cilën bihet dakord, siç ishte edhe rasti i kompetencës antidiskriminim në nenin 19 të KDNJ-së, miratimi i kësaj karte ose themelimi i Agjencisë për Garantimin e të Drejtave Themelore duket të jetë një lëvizje kufizuese nga ana e aktorëve kyç, veçanërisht të qeverive të shteteve anëtare. Për shembull, insistimi në nenin 51 të Kartës në të cilin asnjë detyrë e re apo fuqi e re nuk është krijuar nga miratimi i saj, përpjekja për të ngushtuar qëllimin e aplikimit të kësaj Karte nga shtetet anëtare në nenin 51 dhe refuzimi që të lejohej monitorimi nga ana e Agjencisë për zbatim të nenit 7, janë të gjitha shembuj të asaj çka u tha më lart. Më përgjithësisht, reagimet politike të Shteteve Anëtare kur BE-ja ka tentuar të ndërhyjë mbi një çështje të tillë, siç ishte edhe rasti kur Franca dëboi romët nga territori i tyre në vitin 2010 (Severance, 2010) dhe, së fundi, reagimi hungarez ndaj kritikave që BE-ja bëri ndaj propozimit të tyre për kufizimet e propozuara në legjislacionin e medias¹⁶⁵, sugjerojnë se ekziston ende një rezistencë e fortë ndaj fuqizimit të këtij roli brenda BE-së.

¹⁶³ Marrë nga Annual Report on Human Rights for 2006.

¹⁶⁴ Marrë tek: www.Amnesty.eu/en/press-releases/all/amnesty-criticizes-eu-double-standard-on-human-rights-european-parliament-public-hearing-0114/.

¹⁶⁵ Hungary's PM, gjendet në <http://euobserver.com.9/31600>.

PJESA E TRETË

Kapitulli VI: Aderimi i mundshëm i Bashkimit Evropian në KEDNJ.

1. Rreth aderimit të mundshëm të BE-së në KEDNJ.

Aderimi i BE-së në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut është diskutuar që në fund të viteve 1970¹⁶⁶. Për më shumë se 30 vjet çështja e aderimit ka qenë në axhendën e shteteve anëtare të BE-së (Golsong, 1978: 376), megjithatë pengesat ligjore për realizimin e tij janë hequr vetëm vitet e fundit. Paragrafi i ri (neni 59/2 i KEDNJ) i shtuar nga protokollu i 14 i KEDNJ-së dhe neni 6 i Traktatit të Lisbonës bënin ligjërish të mundur aderimin e BE-së në KEDNJ.

Propozimet e para në lidhje me aderimin e BE-së në Konventë janë realizuar nga Komiteti Drejtues i të Drejtave të Njeriut, i Këshillit të Evropës, gjatë fillimit të vitit 2002. Negociatat për marrveshjen e aderimit kanë filluar në maj të 2010, dhe mendohej se do të përfundonin në qershor 2011. Në qershor 2010 hyri në fuqi protokollu i 14 i KEDNJ-së. Ndryshimet e nenit 59 të KEDNJ-së patën një rol ndihmës në ecurinë e negociatave. Në 21 maj 2011, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës nxorri një urdhër për Komitetin Drejtues të të Drejtave të Njeriut për të bashkëpunuar me përfaqësuesit e zgjedhur nga BE-ja. Brenda datës 30 qershor 2011, akti ligjor duhet të ishte në nivelin e draftit, i cili duhet të përcaktonte: “mënyrën e aderimit të BE-së në KEDNJ, përfshirjen e BE-së në sistemin e Konventës si dhe të ekzaminonte të gjitha çështjet ligjore që prekeshin nga aderimi”. Komiteti Drejtues i të Drejtave të Njeriut ngriti një grup ekspertësh me detyrën për të përgatitur draftin ligjor¹⁶⁷. Ky grup përbëhej nga 14 anëtarë, ku 7 ishin përfaqësues të shteteve anëtare të BE-së, ndërsa 7 të tjerët u zgjedhën nga shtetet joanëtare të BE-së. Më 4 qershor 2010, Këshilli vendosi se negociatat për marrëveshjen e aderimit i besoheshin Komisionit. Ndërmjet periudhës kohore të korrikut 2010 dhe qershorit 2011 u realizuan 8 takime ndërmjet grupit të

¹⁶⁶ Draft Marrëveshja e Aderimit të BE-së në KEDNJ, Shtojca V.

¹⁶⁷ Vendimi Komitetit Drejtues së të Drejtave të Njeriut, në mbledhjen e 15-18 Qershor 2010.

punës dhe Komisionit. Marrëveshja e parë u prezantua në shkurt 2011¹⁶⁸ dhe u rishikua në mars dhe maj 2011¹⁶⁹. Draftmarrëveshja e aderimit të BE-së në KEDNJ përfaqëson një tërësi të rregullave që duhet t'u shtoheshin rregullave të Komitetit të Ministrave për mbikëqyrjen e zbatimit të vendimeve të marra nga GJEDNJ-ja, si dhe raporti shpjegues për marrëveshjen e aderimit (CDDH-EU 2011). Megjithatë, marrëveshja, e cila duhet të ishte miratuar në tetor 2011, hasi pengesa brenda vetë BE-së. Franca dhe Mbretëria e Bashkuar kundërshtuan draftin e dërguar nga Komisioni në qershor 2011, duke deklaruar se teksti që u ishte prezantuar atyre ishte i papranueshëm. Po ashtu, nga shtatori i 2010 deri në prill të 2012 janë zhvilluar takime intensive të grupit të punës së Këshillit, për çështjet e rregullave të brendshme të BE-së pas aderimit. Mbretëria e Bashkuar shprehu mosaprovimin e saj përsa u përket këtyre rregullave të parashikuara në marrëveshje.

Në këto kushte, negociatat morrën një natyrë dyfishe, duke përfshirë si dimensionin e brendshëm, ashtu edhe atë të jashtëm. Dimensionin e jashtëm përfshinte bisedimet mbi mjetet ligjore për të arritur aderimin e BE-së në KEDNJ. Ndërsa ai i brendshëm kishte të bënte me negociatat brenda BE-së për përcaktimin e rregullave të brendshme në lidhje me veprimet e Bashkimit pas aderimit.

Duke marrë parasysh situatën e bllokuar, në maj 2012, Presidenti i BE-së publikoi një dokument në të cilin ftonë shtetet anëtare në një debat të ri mbi rregullat e brendshme të BE-së. Ftesa kishte si qëllim zgjidhjen e të gjitha çështjeve mbi rregullat e brendshme pas aderimit në KEDNJ. Pra, ajo nuk kishte si qëllim vetëm pjesëmarrjen e shteteve anëtare në debat por, duke prezumuar edhe ndihmën e Komisionit, të arrinte në një draft të rregullave të brendshme. Përcaktimi i këtyre rregullave u bë më i qartë në mbledhjet pasardhëse, përkatësisht ato të datës 11 qershor dhe 6 korrik 2012. Për të realizuar aderimin e BE-së në KEDNJ është e nevojshme të miratohet marrëveshja e aderimit

¹⁶⁸ Draft Marrëveshja e Aderimit të BE-së në KEDNJ, CDDH – UE (2011) 04.

¹⁶⁹ Draft Marrëveshja e Aderimit të BE-së në KEDNJ, CDDH – UE (2011) 06 dhe CDDH – UE (2011)

ndërmjet 47 shteteve palë të KEDNJ-së dhe BE-së. Kjo marrëveshje hyn në fuqi kur ratifikohet nga të gjitha palët kontraktuese. Përveç realizimit të procedurës së parashikuar nga KEDNJ-ja dhe TFBE-ja, hyrja në fuqi mund të shtyhet edhe nëse një ose më shumë shtete anëtare i kërkojnë GJED-së opinion për të përcaktuar përputhshmërinë e marrëveshjes së aderimit me traktatet themeluese (sipas nenit 218/11, të TFBE-së). Ky rregullim e bën GJED-në një subjekt të fuqishëm në kontekstin e përfundimit të marrëveshjeve ndërkombëtare nga BE-ja. Në përputhje me TBE-në, Gjykata shprehet me opinion pasi marrëveshja është përfunduar, por para se ajo të jetë ratifikuar.

2. Pasojat e aderimit në lidhje me të drejtat themelore.

Aderimi i Bashkimit në Konventë sjell disa pasoja me rëndësi themelore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Më poshtë janë listuar disa nga efektet ligjore që do të ketë BE-ja në rast se do të aderojë në KEDNJ. Së pari, do të ekzistojë vetëm një standard për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Evropë.

Së dyti, shtetet anëtare të Bashkimit nuk do të kenë përgjegjësi për shkeljen e të drejtave të njeriut nga Bashkimi, siç ndodhi në çështjen *Matthews kundër Mbretërisë së Bashkuar*¹⁷⁰. Në këtë çështje kërkuesi, i cili jetonte në Gjilbraltar, ishte përjashtuar nga e drejta për të votuar në Parlamentin Evropian. Gjykata fillimisht vlerësoi nëse Mbretëria e Bashkuar mbante përgjegjësi për mungesën e zgjedhjeve në Gjilbraltar. GJEDNJ-ja theksoi se aktet e Komunitetit Evropian nuk ishin në juridiksionin e saj pasi Komuniteti nuk ishte palë kontraktuese e KEDNJ-së. Gjithsesi, pavarësisht se shtetet anëtare kanë transferuar kompetenca tek KE-ja, përsëri shtetet kontraktuese mbanin përgjegjësi për të siguruar respektimin e të drejtave të parashikuara nga konventa dhe protokollet e saj. Në këto rrethana, GJEDNJ-ja konkludoi se Mbretëria e Bashkuar kishte shkelur nenin 3 të protokollit 1, i cili garantonte të drejtën e votës. Qytetarët do të gëzojnë mbrojtjen e të

¹⁷⁰Vendim i GJEDNJ *Matthews kundër Mbretërisë së Bashkuar*, datë 18.2.1999.

drejtave të tyre themelore nga aktet e institucioneve të Bashkimit, njësoj si nga aktet e shteteve palë në Këshillin e Evropës. Së treti, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut do të jetë autoriteti përfundimtar në gjykimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Institucionet e BE-së do të jenë subjekt i juridiksionit të kontrollit nga GJEDNJ-ja. Së katërti, Bashkimi Evropian do të mbrohet përpara GJEDNJ-së në çështjet ku Bashkimi është në mënyrë direkte ose indirekte i përfshirë. Gjithashtu, BE-ja do të ketë gjykatësin e vetë si të gjitha shtetet anëtare, i cili do të sigurojë njohjen e zbatimin korrekt të së drejtës së Bashkimit Evropian.

3. Rishikimi i akteve të GJED-së nga GJEDNJ-ja dhe influenza reciproke ndërmjet dy gjykatave, përpara aderimit.

Konventa nuk i ndalon palët kontraktuese t'ia transferojnë kompetencat një organizate ndërkombëtare. Gjithsesi, organizata ndërkombëtare nuk mban përgjegjësi sipas Konventës për vendimet e marra nga organet e saj, për sa kohë nuk është palë në Konventë. Shtetet, edhe pse kanë transferuar pushtetin e tyre sovran te këto organizata, përsëri kanë përgjegjësi përpara GJEDNJ-së për mospërbushje të detyrimeve sipas KEDNJ-së.¹⁷¹ Shteti palë do të jetë përgjegjës për të gjitha veprimet dhe mosveprimet e organeve të organizatës (kur ajo nuk është palë), pavarësisht nëse veprimi ose mosveprimi është pasojë e së drejtës kombëtare ose e nevojës për të qenë në pajtim me detyrimet ndërkombëtare. Sipas GJEDNJ-së, veprimi i shtetit, i ndërmarrë në përputhje me detyrime të tilla ligjore, është i justifikuar për aq kohë sa organizata përkatëse është vlerësuar se mbron të drejtat themelore. Garancitë e ofruara duhet të konsiderohen të paktën ekuivalente me atë që parashikon Konventa. Në rast se GJEDNJ-ja nuk do të pranonte përgjegjësinë e shteteve në këto raste, atëherë garancitë e Konventës mund të kufizoheshin ose të përjashtoheshin sipas dëshirës së shteteve. Po ashtu, kjo do të ishte e papranueshme me objektin dhe qëllimin e Konventës, pasi i heq asaj tiparin e

¹⁷¹Vendimi i GJEDNJ *M & Co kundër Gjermanisë*, datë 09.02.1990.

pakundërshtueshmërisë dhe efijencës së mbrojtjes.

Në rastin *Canntoni*¹⁷², qeveria franceze zbatoi direktivën 65/55 të BE-së, duke marrë masat që i gjykoi të nevojshme në Kodin e Shëndetit Publik francez. Direktiva përcaktonte termin “produkt mjekësor” dhe detyronte shtetet të arrinin rezultatet e parashikuara nga ajo për këtë kategori. Kërkuesi pretendonte shkelje të nenit 7 të KEDNJ-së, pasi këto masa cenonin parimin e mos prapaveprueshmërisë së përgjegjësisë penale. GJEDNJ-ja pranoi kërkesën, ku u shpreh se shteti francez kishte shkelur detyrimet e marra përsipër sipas KEDNJ-së.

Në çështjen *Guerin*¹⁷³, kërkuesi paditi 15 shtete anëtare të Bashkimit Evropian, me qëllim që të godiste vendimet e Komisionit të KE-së. Pretendohej se vendimet shkelnin nenet 6 dhe 13 të KEDNJ-së. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut anashkaloi faktin se aktet e goditura ishin masa të institucioneve të KE-së. Ajo u shpreh se nenet 6 dhe 13 nuk mbulonin të drejtat e pretenduara.

Një tjetër çështje kundër shteteve anëtare të BE-së është ajo *Senator Lines*¹⁷⁴. Kërkuesi, një kompani gjermane, pretendonte shkeljen e prezumimit të pafajësisë dhe të së drejtës për një gjykim të paanshëm. Dhunimi i të drejtave të pretenduara kishte ardhur nga një gjobë e Komisionit të KE-së, në bazë të ligjit të konkurrencës sipas të drejtës së Komunitetit. Edhe në këtë rast GJEDNJ-ja nuk iu referua faktit që masa e kundërshtuar qe një akt i Komisionit të KE-së dhe jo një akt i një shteti palë në KEDNJ. Madje, ky ishte edhe argumenti kryesor i pretenduar nga shtetet anëtare të KE-së. Gjykata rrëzoi kërkesën me arsyetimin se gjoba e vendosur nuk ishte zbatuar përfundimisht dhe ishte anuluar nga Gjykata e Shkallës së Parë e KE-së¹⁷⁵. Në të dyja këto raste GJEDNJ-ja, megjithëse rrëzoi kërkesat, ajo në nuk e bëri këtë me arsyen se i mungonte juridiksioni për të shqyrtuar dhunimet e kryera nga KE/BE-ja.

¹⁷²Vendim i GjEDNJ *Canntoni kundër Francës*, datë 15.11.1996.

¹⁷³Vendim i GjEDNJ *Guerin kundër 15 Shteteve Anëtare të BE-së*, datë 4.07.2000.

¹⁷⁴Vendim i GjEDNJ *DSR-Senator Lines GmbH kundër 15 Shteteve Anëtare të BE*, datë 10.03.2004.

¹⁷⁵ Vendim i GJED T-191/98 R *DSR Senator Lines kundër Komisionit*, [1999] PVGJE I-8733.

Një vendim mjaft i debatuar lidhur me juridiksionin e Gjykatës mbi aktet e KE-së është çështja *Bosphorus kundër Irlandës*¹⁷⁶. Kërkuesi ishte një firmë turke, e cila kishte marrë me kontratë qiraje linjë ajrore nga linja ajrore kombëtare e ish-Jugosllavisë. Sipas rregullores¹⁷⁷ së KE-së, shtetet anëtare detyroheshin të zbatonin sanksione kundër ish-Jugosllavisë gjatë luftës civile në fillim të viteve nëntëdhjetë. Rregullorja e BE-së transpozoi një rezolutë të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara¹⁷⁸. Në përmbushje të këtyre detyrimeve, Irlanda konfiskoi dhe mbylli pa shpërblim të gjitha linjat ajrore të ish-Jugosllavisë. Kompania kërkuese pretendoi për shkelje të së drejtës së pronës të parashikuar nga neni 1, Protokollin 1 i KEDNJ-së.

GJEDNJ-ja nëpërmjet një praktike të konsoliduar, ka mbajtur qëndrimin se veprimi i shtetit është në përputhje me Konventën, nëse organizata ku shteti është pjesë garanton dhe kontrollon të drejtat themelore në mënyrë ekuivalente me KEDNJ-në (çështja *M. & Co*). GJEDNJ-ja hetoi sistemin e mbrojtjes të të drejtave themelore nga BE-ja. Ajo vlerësoi se Irlanda pajtohej me detyrimet e veta të KEDNJ-së pasi BE-ja parashikonte një mbrojtje të të drejtave të njeriut “ekuivalente” me atë të sistemit të KEDNJ-së dhe sistemi i kontrollit të BE-së nuk kishte një mosfunksionim të tillë që të hidhte poshtë supozimin e rastit në fjalë.

Në disa çështje të mëvonshme, Gjykata është shprehur se veprimet e BE-së nuk bëjnë pjesë në juridiksionin e saj, ashtu siç kërkohet në nenin 1 të Konventës. Ky qëndrim është mbajtur në rastin *Connolly*,¹⁷⁹ i cili kishte të bënte me një mosmarrëveshje pune ndërmjet Bashkimit Evropian dhe punëtorëve të tij. Z. Connolly ishte i punësuar në Komisionin Evropian, i cili e pushoi nga puna. Kërkuesi u ankua në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe e ankimoi vendimin në GJED. Në gjykimin në GJED u refuzua kërkesa e tij, për të pranuar kundërshtimet për opinionin e Avokatit të Përgjithshëm të GJED-së.

¹⁷⁶ Vendim i GjEDNj, *Bosphorus kundër Irlandës*, datë 30 Qershor 2005.

¹⁷⁷ Rregullorja nr.990/93, Mbi Tregëtinë ndërmjet Komunitetit Ekonomik Evropian dhe Republikës Federale të Jugosllavisë.

¹⁷⁸ Rezoluta 820 e vitit 1993 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

¹⁷⁹ Vendim i GjEDNj *Connolly kundër 15 Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian*, datë 9.11.2008.

Conolly iu drejtua GJEDNJ-së për shkelje të nenit 6 të Konventës pasi, sipas tij, refuzimi i kërkesës shkelte të drejtën për proces të rregullt ligjor. GJEDNJ-ja argumentoi se shteti anëtar i BE-së, kundër të cilit u ngrit padia, nuk kishte marrë ndonjë veprim në këtë situatë, e, si rrjedhojë, aplikimi u deklarua i paparanueshëm. Në vazhdim, ky qëndrim është konfirmuar në çështjet *Beygo*,¹⁸⁰ *Rambus Inc*,¹⁸¹ etj.

Duke analizuar çështjet e mësipërme, arrijmë në përfundimin se kur një akt i BE-së, siç është një direktivë, që u krijon shteteve hapësirë në zgjedhjen e mjeteve për arritjen e qëllimit, shteti implementues mban përgjegjësi për çdo shkelje të KEDNJ-së (*rasti Cantoni*). Në rast se shteti vepron në përputhje me një marrëveshje ndërkombëtare ku ka aderuar lirisht (p.sh. BE), përsëri ai mban përgjegjësi përpara GJEDNJ-së për shkeljet e kryera (*rasti Matthews*). Kur një akt i BE-së, siç është një rregullore, nuk i lë shtetit liri veprimi në implementim, shteti do të prezumohet se ka vepruar në pajtim me KEDNJ-në. Ky prezumim zbatohet vetëm kur BE-ja (organizata ndërkombëtare) parashikon një nivel ekuivalent të mbrojtjes të të drejtave të njeriut me KEDNJ-në dhe nuk ka prova të mosfunksionimit të sistemit të kontrollit (*rasti Bosphorus*).

Në qëndrimet e tyre të hershme, midis GjEDNJ-së dhe GJED-së, ka pasur mospërputhje. Për shembull, vendimin e GJED-së në rastin *ERT*¹⁸² me atë të GjEDNJ-së në çështjen *Lentia* kundër *Austrisë*¹⁸³. GjEDNJ-ja konstatoi se monopoli i radios dhe i televizionit i Korporatës Austriake të Transmetimit përbënte cenim të nenit 10 të Konventës, ndërsa GJED-ja e la çështjen e nenit 10 të vendosëj nga gjykata kombëtare. Një rast tjetër kur janë shfaqur këto ndryshime është çështja *Vermeulen* dhe çështja *Emsa Sugar*¹⁸⁴. Në rastin *Vermeulen*,¹⁸⁵ GjEDNJ-ja konstatoi shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor sipas nenit 6/1 të KEDNJ-së. Mungesa e mundësisë për t'iu

¹⁸⁰ Vendim i GjEDNJ *Beygo kundër 46 Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës*, datë 16.06.2009.

¹⁸¹ Vendim i GjEDNJ *Rambus Inc. kundër Gjermanisë*, datë 16.06.2009.

¹⁸² Vendim i GJED C-260/89.

¹⁸³ Vendim i GjEDNJ *Informationsverein Lentia dhe të tjerë kundër Austrisë*, datë 24.11.1993.

¹⁸⁴ Vendim i GJED C-17/98 *Emsa Sugar kundër Aruba*, [2000] PVGJE I-665.

¹⁸⁵ Vendim i GjEDNJ *Vermeulen kundër Belgjikës*, datë 20.02.1996

përgjigjur parashtimeve të Prokurorit të Përgjithshëm para Gjykatës Belge të Kasacionit, cenonte procesin e rregullt. Dy vjet më vonë, kërkesja Emsa Sugar pretendonte para GJED-së se pamundësia për t'iu përgjigjur opinionit të Avokatit të Përgjithshëm para dhënies së vendimit përbënte cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor. Ky pretendim u mbështet edhe në vendimin *Vermeulen* të GJEDNJ-së. GJED-ja, mbajti qëndrimin se roli i Avokatit të Përgjithshëm në kontekstin e procedurave të KE-së ndryshonte në disa aspekte kryesore nga roli i Prokurorit të Përgjithshëm para gjykatës kombëtare. Në këto kushte nuk kishte shkelje të procesit të rregullt ligjor. Kërkesja u ankua në GJEDNJ,¹⁸⁶ pasi sipas saj GJED-ja i kishte dhunuar të drejtën e saj për t'u dëgjuar sipas nenit 6/1 të KEDNJ-së. Shteti anëtar dhe Komisioni, si palë e paditur, pretenduan se aplikimi ishte i papranueshëm, pasi ai ishte drejtuar kundër një akti të një institucioni të BE-së (GJED-së në rastin konkret). Sipas palës së paditur GJEDNJ-ja nuk kishte juridiksion në shqyrtimin e çështjes. Ky argument u injorua nga Gjykata, megjithatë ajo e deklaroi aplikimin të papranueshëm, për shkak se ai lidhej me pagimin e detyrimeve të importit, të cilat nuk kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet civile të parashkuara nga neni 6/1 i KEDNJ-së.

Gjithsesi kohët e fundit të dyja gjykatat kanë dhënë vendime duke u frymëzuar dhe referuar në jurisprudencën e njëra-tjetrës. Gjykata e Drejtësisë ka njohur raportin plotësues të Kartës me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. GJED-ja risolli çështjen e aplikimit të së drejtës për jetë familjare sipas Konventës, brenda së drejtës së Bashkimit. Ajo u shpreh se: "...gjykatat kombëtare të shteteve anëtare duhet të kontrollojnë nëse refuzimi i së drejtës për rezidencë shkel të drejtën për jetë private dhe familjare të parashikuar nga neni 7 i Kartës. Nga ana tjetër, nëse gjykata kombëtare arrin në konkluzionin se kjo situatë nuk është mbuluar nga e drejta e Bashkimit, atëherë duhet të marrë në shqyrtim edhe nenin 8 të KEDNJ-së. Të gjitha shtetet anëtare janë

¹⁸⁶Vendim i GJEDNJ *Emesa Sugar kundër Hollandës*, datë 13.01.2005.

palë në KEDNJ, e cila mishëron mbrojtjen e së drejtës për jetë familjare në nenin 8 të saj (paragrafi 72-73)¹⁸⁷.

4. Draft-marrëveshja e aderimit të BE-së në KEDNJ.

Negociatat në lidhje me aderimin e BE-së në KEDNJ kanë hasur pengesa si nga pikëpamja teknike, ashtu edhe nga ajo politike. Dispozitat e draftmarrëveshjes për nga përmbajtja mund të ndahen në katër grupe të mëdha:

- a) çështjet e përgjithshme;
- b) çështjet institucionale;
- c) çështjet e juridiksionit dhe
- d) çështjet financiare.

4.1. Çështjet e përgjithshme.

Këto kanë të bëjnë me çështje të përgjithshme që janë tipike në çdo marrëveshje ndërkombëtare. Në këtë kontekst është diskutuar nëse Bashkimi do të aderojë vetëm në KEDNJ apo edhe në protokollet e saj (Ridrujero, 2010)? Neni 59 paragrafi i dytë,¹⁸⁸ pohon se BE-ja mund të aderojë në Konventë, sipas draftmarrëveshjes së aderimit¹⁸⁹. Sipas nenit 1 paragrafi 2 i saj: “Bashkimi Evropian mund të aderojë në këtë Konventë dhe protokollet e poshtëshënuara. Aderimi i Bashkimit Evropian në protokolle do të udhëhiqet (governed), *mutatis mutandis*, nga neni 6 i protokollit, neni 7 i protokollit nr.4, nenet 7 dhe 9 të protokollit nr.6, nenet 4 dhe 6 të protokollit nr.12 dhe nenet 6 dhe 8 të protokollit nr.13” . Paragrafi pasardhës nr. 3 pohon se marrëveshja e aderimit të BE-së në KEDNJ përbën pjesë integrale të Konventës.

Modifikime të tjera të rëndësishme kanë të bëjnë me përkufizimin dhe me kuptimin e termave. Duke qenë se BE-ja është një organizatë ndërkombëtare, natyrshëm ka lindur diskutimi se çfarë do të kuptohet me termat p.sh. “Shtet”, “Palë e lartë kontraktuese”, “e drejta kombëtare”, “autoriteti kombëtar”, “siguria kombëtare”, “mirëqenia e vendit”,

¹⁸⁷Vendim i GJED C-256/11 *Derec dhe të tjerë*, [2011] PVGJE I-11315.

¹⁸⁸Shtuar me Protokollin 14 të KEDNJ-së, neni 17.

¹⁸⁹Raporti përfundimtar i Draft Marrëveshjes për Aderimin e Bashkimit Evropian në KEDNJ.

“integriteti territorial”, etj, në lidhje me BE-në. Për të zgjidhur këtë problem, nenit 59 do t’i shtohet një paragraf tjetër i cili do të përcaktojë kuptimin e këtyre termave në Konventë dhe protokollet e saj përkatëse. BE-ja gëzon të drejtat që kanë edhe shtetet palë të Konventës. Ajo ka të drejtë të aplikojë të njëjtat rregulla për rezervat mbi ratifikimin apo pranimin në lidhje me Konventën dhe protokollet e saj. Në këtë kontekst është ngritur pyetja nëse ka kuptim logjik fakti se BE ka të drejtë të bëjë rezervë ndaj KEDNJ-së, por BE-ja dhe shtetet palë të Konventës nuk kanë të drejtë të bëjnë rezervë për marrëveshjen e aderimit të BE-së në KEDNJ (Neni 11). Duhet pasur në konsideratë fakti se kjo marrëveshje, siç u përmend edhe më lart, është pjesë e Konventës dhe bën disa modifikime të rëndësishme të saj.

Marrëveshja do të hyjë në fuqi kur të gjitha palët e larta kontraktuese të KEDNJ-së (47 shtete) dhe BE-ja do të japin pëlqimin e tyre duke e miratuar dhe ratifikuar atë. Këshilli i BE-së duhet ta marrë vendim unanim për të autorizuar miratimin e marrëveshjes së aderimit. Të gjitha shtetet anëtare të BE-së duhet ta ratifikojnë marrëveshjen në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm. BE-ja duhet të ratifikojë marrëveshjen dhe Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës duhet të marrë vendim për të.

4.2. Çështjet institucionale.

Raporti¹⁹⁰ që Parlamenti Evropian përgatiti në lidhje me aderimin e BE-së në KEDNJ, identifikonte në mënyrë të qartë tri të drejta thelbësore në lidhje me institucionet. Së pari, e drejta për të paraqitur një list me tre kandidatë për postin e gjykatësit, një nga të cilët do të zgjidhet nga Asambleja Parlamentare e Këshillit për llogari të Bashkimit. Gjyqtari i Bashkimit do të marrë pjesë në GJEDNJ në pozitë të barabartë me gjykatësit e tjerë. Së dyti, e drejta e Komisionit Evropian për të marrë pjesë në votim për llogari të BE-së, në rastin e mbledhjeve të Komitetit të Ministrave kur ai monitoron ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së. Së treti, e drejta e Parlamentit Evropian (të BE-së) për të

¹⁹⁰ Raporti Parlamentit Evropian, Maj 2010.

dërguar një numër të caktuar përfaqësuesish në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Këto kanë qenë problemet kryesore që janë diskutuar gjatë negociatave (Jacque, 2011: 995-1023).

Prezenca e BE-së në Komitetin e Ministrave është konsideruar si një nga çështjet më të mprehta. Nga disa vende joanëtare të BE-së është ngritur diskutimi se për çështjet, të cilat kenë ndikim në BE, shtetet anëtare të BE-së dhe vetë BE-ja mund të koordinojnë qëndrimet e tyre duke krijuar një bllok prej 28 votash (BE + 27 shtetet anëtare). Koordinimi i qëndrimeve do të shkaktonte një mungesë ekulibri brenda Komitetit të Ministrave në favor të Bashkimit. Kjo situatë u referohet rasteve kur Komiteti Ministrave ka për detyrë të monitorojë zbatimin e vendimeve (nenet 39 dhe 46, KEDNJ) ose duhet të nxjerrë raporte dhe rekomandime (neni 47, KEDNJ). Në të dyja këto raste kërkohet një shumicë prej dy të tretave të votave të të gjithë anëtarëve, shumicë që arrihet me 32 vota.

Duhet vënë në dukje se në rastin e koordinimit të pozicioneve, BE-ja dhe shtetet anëtare janë shumë afër arritjes së shumicës vendimmarrëse prej 2/3 të votave. Në nenin 7, paragrafi 4(a) i draftmarrëveshjes, për më tepër parashikohet se: “.. kur Komiteti i Ministrave mbikëqyr përmbushjen e detyrimeve nga BE-ja (pavarësisht nëse është vetëm ndaj saj ose së bashku me një shtet anëtar), sipas traktateve të Bashkimit, BE-ja dhe shtetet e saj anëtare shprehin qëndrim dhe votojnë në mënyrë të koordinuar. Rregullat e Komitetit të Ministrave duhet të marrin masa për të siguruar që Komiteti i ushtron funksionet e tij me efikasitet edhe në këto situata”.

4.3. Çështjet juridiksionale.

Në lidhje me çështjet juridiksionale, në rol të rëndësishëm në marrëveshjen e aderimit zënë dhe procedurat e reja që do të bëhen pjesë e KEDNJ-së, për t'i mundësuar BE-së të ushtrojë të drejtat e palës në proces. BE-ja është në rolin e palës së paditur kur a) ka një pretendim nga kërkuesi se nëpërmjet veprimeve të institucioneve të BE-së janë shkelur

një nga të drejtat e parashikuara në Konventë; ose b) ka një pretendim nga kërkuesi kundër një ose më shumë shteteve anëtare të BE-së, ku dhunimi i të drejtave të Konventës ka arrdhur si rezultat i veprimit të shtetit në zbatim të së drejtës së Bashkimit.

Në rastin e Bashkimit, është plotësisht e mundur që subjekti, i cili nxjerr aktin (në këtë rast BE) dhe subjekti që e zbaton këtë akt (në këtë rast Shteti Anëtar) të jenë subjekte të ndryshme. Për këtë arsye duhej të parashikohej një mekanizëm që zgjidhte këtë situatë unike, e cila u rregullua nëpërmjet mekanizmit procedural të *bashkëndërgjyqësisë*.

Një situatë tjetër, që vjen si rezultat i natyrës së veçantë të sistemit gjyqësor të BE-së, është rasti kur çështja kundër Bashkimit ose një shteti anëtar, ngrihet përpara GJEDNJ-së pa u shprehur më parë GJED-ja. Në këtë rast kërkuesi pasi ka ezauruar ankimin e brendshëm të shtetit anëtar, i drejtohet GJEDNJ-së. Sipas KEDNJ-së, ezaurimi i rrugëve të ankimit të brendshëm është kusht për pranimin e kërkesës. Nga perspektiva e GJED-së, kjo mund të rezultojë problematike pasi ajo është organi hierarkik më i lartë për interpretimin e së drejtës së Bashkimit.

Ka edhe situata të tjera të cilat mund të kërkojnë modifikime të procedurave të parashikuara nga KEDNJ-ja, si rezultat i pranimit si palë kontraktuese e një organizate ndërkombëtare. Një nga këto raste është procedura e ndërhyrjes së palës së tretë ose pretendimet ndërshtetërore kundër Bashkimit.

a) Kërkesa për vendim të mëparshëm të GJED-së.

Sipas nenit 35 të KEDNJ-së, ezaurimi i mjeteve të ankimit të brendshëm është një nga kushtet për pranimin e aplikimit. Në bazë të kuadrit ligjor të Bashkimit, është plotësisht e mundur që një akt i BE-së të atakohet për cenim të të drejtave themelore, pa u shprehur GJED-ja më parë. Palët gjatë gjykimit në shtetin anëtar kanë të drejtë t'i kërkojnë gjykatës kombëtare ta referojë çështjen për vendim paragjykimor në GJED (neni 263/4 TFBE). Megjithatë, kjo kërkesë nuk është e detyrueshme për t'u zbatuar nga

gjkata kombëtare, ajo ka të drejtë ta refuzoj atë. Si rrjedhim, në këto raste, GJEDNJ-ja nuk mund të ushtrojë shqyrtimin e çështjes, përderisa nuk është ezauruar ankimi i brendshëm edhe nga GJED.

Sipas trakteteve të Bashkimit, kur çështja ngrihet përpara një gjykate të një shteti anëtar dhe kjo gjykatë është e mendimit se nevojitet një vendim paragjykimor në mënyrë që të zgjidhet drejt çështja, atëherë i *kërkon* GJED-së nxjerrjen e një vendimi paragjykimor (neni 267, TFBE). Ligjvënësi në këtë rast ka përdorur mënyrën urdhërore për të treguar se gjykatat kombëtare kanë detyrimin ta referojnë çështjen në GJED, kur ndodhen përpara një rasti të tillë. Megjithatë, pavarësisht mungesës së diskrecionit për referimin e çështjes, përsëri mund të ndodhë që gjykata kombëtare gabimisht nuk e ka bërë një gjë të tillë.

GJED-ja, nëpërmjet një jurisprudence të konsoliduar, ka vendosur se neni 267 i TFBE-së nuk është një mjet ankimi për individët në GJED.¹⁹¹ Mund të ndodhë që gjykata kombëtare gabimisht vlerëson se nuk ka detyrim të bëjë referencë në GJED në lidhje me çështjen konkrete ose ajo gabimisht argumenton se ekziston një nga përjashtimet e parashikuara nga neni 267 i TFBE-së, të shtjelluara edhe në çështjen *CILFIT*.

Një rast tjetër kur GJED-së nuk i është krijuar mundësia të shprehet mbi çështjen është ai i parashikuar nga neni 263 i TFBE. Ai parashikon se: “çdo person fizik ose juridik mund të fillojë proces kundër një akti që i drejtohet atij personi ose kur ai ka një interes të drejtëpërdrejtë...”. Çështjet që janë problematike kanë të bëjnë me rastet kur individi kundërshton një pjesë të legjislacionit ose aktit që i është adresuar një pale të tretë. Pra, akti nuk i është adresuar atij individualisht. Në këto kushte, kur kërkesa e individit në GJED do të konsiderohej e papranueshme sipas TFBE-së, a mund të konsiderohet ky mjet ankimi i detyrueshëm për t’u ezauruar? GJEDNJ-ja në çështjen *Vagrancy* është shprehur se kërkuesi nuk është i detyruar të ezaurojë ato mjete ankimi, të cilat sipas

¹⁹¹Vendim i GJED C-283/81 *CILFIT dhe Lanificio di Gavardo SpA kundër Ministrisë së Shëndetësisë*.

legjislacionit të vendit nuk i japin zgjidhje pretendimit të tij¹⁹². Rrjedhimisht individi nuk ka detyrimin që të ezaurojë këtë mjet ankimi, kur sipas GJEDNJ-së ai nuk është efektiv.

Për të zgjidhur këto situata, në draftmarrëveshjen e aderimit¹⁹³ u parashikua mekanizmi procedural i dërgimit të çështjes nga GJEDNJ-ja në GJED, në mënyrë që kjo e fundit të shprehej në lidhje me rastin. Parashikimi i këtij mekanizmi, i cili i krijon akses individit në GJED, të drejtë që ai nuk e ka pasur, është konsideruar si njohja e të drejtës së aksesit nëpërmjet “derës së prapme” (Besselink, 2013: 316). Në zgjidhjen e këtij problemi duhej të mbahej parasysh edhe fakti që GJED-ja është i vetmi organ që mund të deklarojë aktet e BE-së të paligjshme duke përfshirë edhe shqyrtimin e tyre në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut. Kjo e drejtë e posaçme është pjesë përbërëse e kompetencave të GJED-së, të cilat sipas protokollit nr.8 nuk duhet të preken nga aderimi¹⁹⁴. Në rast se çështja nuk do të referohej nga GJEDNJ në GJED, atëherë do të kishim vetëm konstatimin e shkeljes të të drejtave themelore, por akti do të vazhdonte të ishte në fuqi. Në marrëveshjen e aderimit nuk rregullohet situata se si kjo çështje do të zgjidhet brenda BE-së. Në këtë kontekst, GJED-ja duhet ta shqyrtojë çështjen shpejt pa shkaktuar vonesa të mëdha në gjykimin e rastit përpara GJEDNJ-së.

b) Mekanizmi i “bashkë-ndërgjyqësisë”.

Mekanizmi i *bashkëndërgjyqësisë* do të përfshihet në nenin 36, si paragraf i katërt në Konventë. Përmbajtja e tij do të rregullohet me hollësi në marrëveshjen e aderimit¹⁹⁵. Për të kuptuar këtë procedurë duhet të marrim parasysh faktin se pretendimi mund të ngrihet kundër një akti të shtetit anëtar të BE-së, kur ky veprim ishte i detyrueshëm të kryej sipas së drejtës së BE-së. Në këtë situatë është normale që duhej të hartohej një

¹⁹²Vendim i GjEDNJ *De Eilde Ooms and Versyp kundër Belgjikës*, Nëntor 1970.

¹⁹³ Draft Marrëveshjes së Aderimit të BE-së në KEDNJ, neni 3 paragrafi 6.

¹⁹⁴ Dokumenti mbi diskutimet e GJED-së në lidhje me disa aspekte të aderimit të BE-së në KEDNJ, Maj 2010, shih në faqen e web: http://curia.europa.eu/jcms/upload/docs/application/pdf/2010-05/conventionen_2010-05-2112-10-16272. Pdf.

¹⁹⁵Draft Marrëveshja e Aderimit, neni 3.

rregull i cili do t'i mundësonte edhe BE-së të ishte pjesë e procesit. Sipas grupit të punës së draftmarrëveshjes, BE-ja dhe shtetet anëtare nuk janë krejtësisht autonome nga njëra-tjetra përse i përket të drejtës së Bashkimit. Ky mekanizëm mund të shmangë boshllëkun në lidhje me përgjegjësinë sipas sistemit të Konventës¹⁹⁶.

Një problem i qënësishëm është fakti se kujt do t'i njihet e drejta për të caktuar bashkëndërgjyqësinë. Në përputhje me draftmarrëveshjen ekzistojnë tre mundësi. Vendimi mund të merret nga GJEDNJ-ja, nga pala e paditur ose nga bashkëndërgjyqasi i ardhshëm. Palët e larta kontraktuese të Konventës marrin pozitën procedurale të bashkëndërgjyqësit ose duke pranuar ftesën e bërë nga GJEDNJ-ja ose nëpërmjet vendimit të GJEDNJ-së mbi kërkesën e palës. Ky mekanizëm aplikohet edhe kur është ezauruar ankimi i brendshëm vetëm i njërit prej bashkëndërgjyqësve. Sipas Komitetit të Drejtave të Njeriut (CCDH) të Këshillit të Evropës, marrja e vendimit kryesisht nga GJEDNJ-ja për ta ftuar palën si bashkëndërgjyqës duhet të konsiderohet si rast përjashtimor. Gjykata mund të përfshihet në një paragjykim të çështjes mbi përgjegjësinë e shkeljes së Konventës nga palët.

Në këtë kontekst, çfarë ndodh nëse një shtet anëtar i BE-së kërkon të thirret si bashkëndërgjyqës Bashkimi, pavarësisht se çështja nuk ka lidhje me të drejtën e BE-së? Në këtë rast jemi përpara abuzimit me të drejtën e thirrjes si bashkëndërgjyqës, nga shteti anëtar. Ky veprim i shtetit anëtar shkel detyrimin e besnikërisë (TBE, neni 4 paragrafi 3 ish neni 10 i KE-së), sipas të cilit shtetet anëtare dhe Bashkimi duhet të bashkëpunojnë sinqerisht. Detyrimi i bashkëpunimit të sinqertë është elaboruar edhe nga GJED-ja në një sërë çështjesh¹⁹⁷, duke sanksionuar edhe përgjegjësinë e shteteve anëtare në rast të shkeljes së detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësia në Bashkim.

Situatat e ngjashme me çështjen *Bosphorus* shërbejnë si një shembull i mirë për të treguar përdorimin e këtij mekanizmi. Në këtë rast, autoritetet irlandeze konfiskuan një

¹⁹⁶Draft Marrëveshja e Aderimit të BE-së në KEDNJ, 2011: paragrafi 37.

¹⁹⁷Vendim i GJED C-54/81, [1982] PVGJE 1449; Vendim i GJED 205-215/82, [1983] PVGJE 2633.

linjë ajrore në përputhje me një rregullore të Bashkimit, sipas së cilës shtetet nuk kishin diskrecion në marrjen e masave alternative. Konfiskimi i linjës ajrore nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar mund të kryhet edhe për të ekzekutuar një vendim gjyqësor të formës së prerë. Rasti i fundit nuk ka të bëjë me detyrimet e shtetit sipas së drejtës së Bashkimit. Por, për një kërkues që nuk ka njohuri ligjore, këto çështje janë të vështira për t'u dalluar. Në të dyja rastet kemi veprimin e autoriteteve të shtetit për të kryer konfiskimin e linjës ajrore. Në mënyrë që kërkuesi të bëjë një vlerësim nëse konfiskimi erdhi si rezultat i detyrimeve të shtetit sipas së drejtës së Bashkimit apo nga e drejta e brendshme, do të duhej të kryente kërkim për çështjet ligjore të rastit. Hartimi i një mekanizmi, ku kërkuesit nuk do t'i kërkohej të dallonte veprimet e shtetit anëtar të kryer sipas së drejtës së BE-së, nga ato të kryera sipas të drejtës kombëtare, do ta ndihmonte kërkuesin në rregullimin e pasaktësive në legjitimitetin pasiv.

Sipas dispozitave të marrëveshjes, mund të gjendemi përpara tri situatave. Së pari, një pretendim mund të ngrihet vetëm kundrejt një ose më shumë shteteve anëtare, por jo kundër BE-së. Në këtë rast, BE-ja mund të ndërhyjë si bashkëndërgjyqës. Jemi përpara kësaj situate kur shteti anëtar, kundër të cilit pretendohet shkelja, ka qenë i detyruar të veprojë ose të mos veprojë sipas së drejtës së Bashkimit, pa pasur diskrecion në kryerjen e veprimeve.

Së dyti, pretendimi ngrihet vetëm kundër BE-së. Në këtë rast mund të ndërhyjë si bashkëndërgjyqës shteti anëtar. Kjo situatë mund të ndodhë kur një rregull i vendosur nga e drejta primare e BE-së mendohet se cenon të drejtat themelore të parashikuara në KEDNJ. Duke marrë parasysh natyrën e rregullave të të drejtës së BE-së dhe pasojat që ato kanë në rendin e brendshëm të shteteve sipas traktateve themeluese, është e arsyeshme që shteti anëtar të marrë pjesë si bashkëndërgjyqës.

Së treti, kërkuesi pretendon për shkelje si nga BE-ja ashtu edhe nga një ose disa shtete anëtarë. Në këtë rast shtetet anëtare ose Bashkimi (si palë e paditur) nuk janë të vetmet

që kanë marrë pjesë në miratimin e një akti, por ato janë të vetmet që kanë marrë masa për vënien në zbatim të aktit. Edhe në këtë situatë mund të përdoret ky mekanizëm p.sh. nga shtetet e tjera anëtare. Është me rëndësi të theksohet se bashkëndërgjyqësi do të ketë statusin e palës gjatë procesit dhe nuk do të konsiderohet si palë e tretë¹⁹⁸. Realizimi në praktikë i kësaj procedure do të bëjë të nevojshme ngritjen e një mekanizmi brenda BE-së, në mënyrë që instituti i bashkëndërgjyqësisë të funksionojë në mënyrë të qëndrueshme. Aplikuesi nuk do të penalizohet për gabime në legjitimitetin pasiv. Pranueshmëria e aplikimit do të vlerësohet pa u lidhur me pjesëmarrjen e bashkëndërgjyqësit në proces (neni 3 i draftmarrëveshjes).

Ndërrhyrja e BE-së, si palë bashkëndërgjyqëse dhe jo në rolin e palës së tretë, paraqet disa avantazhe. Së pari, pala e tretë nuk ka detyrim të ndërhyjë. Ndërrhyrja është në varësi të vullnetit të saj. Marrëveshja duhet të parashikojë rastet kur ndërhyrja e Bashkimit është e detyrueshme. Rasti i çështjes Bosphorus mund të shërbejë si shembull, pasi vetëm BE-ja kishte kompetencë të shfuqizonte rregulloren. Së dyti, vendimi nuk ka fuqi ndaj palës së tretë ndërhyrëse. Në rastin kur Bashkimi është në pozitën e bashkëndërgjyqësit, vendimi ka fuqi detyruese dhe përbën gjë të gjykuar edhe ndaj tij. Së treti, mekanizmi i bashkëndërgjyqësisë shton rritjen e efektivitetit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në rastet kur përfshihet e drejta e BE-së. Disavantazhet e kësaj procedure kanë të bëjnë me pozitën e kërkuarit. Probabiliteti i pranimit të kërkesës mund të zvogëlohet me rritjen e numrit të subjekteve kundër të cilave është ngritur padia. Sipas këtij mekanizmi kërkuari duhet të përballlet me më shumë palë sesa ai në mënyrë të arsyeshme mendonte në kohën e ngritjes së padisë.

c) Pretendimet nga BE-ja ose kundër saj dhe ndërhyrja e BE-së si palë e tretë.

Situatat më tipike në lidhje me çështjet juridiksionale janë ato ku kërkuari pretendon shkelje të të drejtave të parashikuara në KEDNJ nga një akt i BE-së ose nga një akt i

¹⁹⁸ Ndryshimet e Draftmarrëveshjes së aderimit, neni 36/2.

shteteve anëtare si rezultat i përmbushjes së detyrimeve ndaj BE-së. Megjithatë ka edhe situata të tjera ku BE-ja mund të përfshihet në procese gjyqësore, një rast i tillë janë procedurat në lidhje me pretendimet ndërmjet shteteve për shkelje të Konventës të cilat prekin të drejtën e BE-së (KEDNJ, neni 33). Përdorimi i kësaj procedure duhet të kufizohet sa më shumë të jetë e mundur, pasi sjell limitimin e juridiksionit të GJED-së, e cila nga ana e saj cenon pavarësinë e së drejtës së Bashkimit.

Po ashtu, është diskutuar se kush do të jetë pozita procedurale e BE-së, në rastet kur padia është ngritur jo nga një shtet anëtar i BE-së por nga një shtet joanëtar. A ka të drejtë BE-ja të jetë në rolin e palës paditëse në këtë rast, nëse pretendimi ka të bëjë me një marrëveshje të lidhur ndërmjet BE-së dhe një shteti joanëtar? Kjo çështje nuk është shtruar për diskutim nga grupet e punës (Nanclares, 2013: 12).

Aneksi i IV i draftmarrëveshjes së asociimit¹⁹⁹ rregullon zgjidhjen e pasojave në rastin e shkeljes së Konventës, por ai nuk merret nëse BE-ja ka të drejtë të ndërhyjë në proces dhe cila do të ishte pozita e saj procedurale. Si rregullohet rasti kur GJEDNJ-ja, në një çështje të gjykuar kundër shtetit X, ka konstatuar shkelje të konventës ose e protokolleve shtesë ku BE-ja është palë. Kjo shkelje ka ardhur nga një dipozitë e marrëveshjes ndërkombëtare e lidhur midis shtetit X (shtet joanëtar i BE-së) dhe BE-së, të cilën shteti X ka detyrimin ta zbatojë. BE-ja së bashku me shtetin X duhet të analizojë se çfarë masash duhet të merren nga Bashkimi për të zbatuar vendimin e GJEDNJ-së. Kjo procedurë do të realizohet në përputhje me marrëveshjen ndërkombëtare të nënshkruar nga të dyja shtetet.

Bashkimi Evropian mund të gjendet në situata ku mund të thirret si palë e tretë sipas neni 36 paragrafi 2 i Konventës, ku BE-ja mund të ftohet nga Presidenti i GJEDNJ-së për të marrë pjesë në proces. Në përputhje me dispozitat e KEDNJ-së, Bashkimi duhet të parashtrijë pretendimet që atij i duken të rëndësishme në lidhje me çështjen.

¹⁹⁹ Draft Marrëveshja e Aderimit të BE-së në KEDNJ, Shtojca IV.

Një rast i tillë është kur p.sh shteti X (shtet joanëtar i BE-së) kërkon që BE-ja të thirret si palë e tretë, në përputhje me nenin 36 (2) të Konventës. Do të jemi përpara kësaj situatë kur, për shembull shteti X është palë e paditur pranë GJEDNJ-së. Shkelja e pretenduar e Konventës ka ardhur nga një dispozitë e së drejtës së Bashkimit, si rezultat i një marrëveshjeje ndërkombëtare të lidhur midis shtetit X dhe BE-së. Vendimi për lidhjen e marrëveshjes ndërkombëtare është marrë në përputhje me TBE-në ose TFBE-në dhe shteti X ka detyrimin ta zbatojë atë²⁰⁰. Raste praktike të kësaj situatë mund të kenë të bëjnë me marrëveshjen për zgjerimin e zonës Schengen në shtetet joanëtare.

Çdo palë e lartë kontraktuese mund t'i referojë Gjykatës çdo shkelje të supozuar të dispozitave të Konventës dhe të protokolleve të saj nga pala tjetër e lartë kontraktuese (neni 33 KEDNJ). Në lidhje me këtë çështje është diskutuar gjithashtu nëse ky mekanizëm mund të përdoret nga Shtetet Anëtare të BE-së kundër BE-së ose ndërmjet shteteve anëtare, për çështje që lidhjen me të drejtën e BE-së dhe cenojnë të drejtat themelore? A duhet të përjashtohet zbatimi i këtij mekanizmi ndërmjet shteteve anëtare dhe BE-së?

Në rast se kjo e drejtë do t'u njëhej shteteve anëtare dhe BE-së, atëherë do të cenohet autonomia e së drejtës së BE-së dhe juridiksioni ekskluziv i GJED-së. Në këtë situatë duhet të marrim parasysh fatkin që problemet midis BE-së dhe shteteve anëtare duhet të ngrihen fillimisht në institucionet kompetente brenda BE-së, gjithashtu shtetet anëtare kanë mundësi të godasin gjyqësisht këto akte. Një shtet anëtar, i cili mendon se një shtet tjetër anëtar nuk e ka përmbushur një detyrim që rrjedh nga traktatet, mund ta ngrejë çështjen përpara Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian. Përpara se të ngrejë këtë padi, shteti anëtar duhet t'i drejtohet Komisionit. Komisioni nxjerr një opinion të arsyetuar pasi i ka dhënë secilit prej shteteve në fjalë mundësinë të paraqesin argumentet dhe komentet e tyre. Nëse Komisioni nuk e nxjerr opinionin brenda tre

²⁰⁰ Neni 1, i Aneksit të IV të Draft Marrëveshjes së Aderimit të BE-së në KEDNJ.

muajve, mungesa e tij nuk përbën shkak që çështja të mos kalojë në Gjykatë (neni 259, TFBE). GJED-ja ka kompetencë mbi çështjet e ngritura nga një shtet anëtar për shkelje të një kërkesë procedurale, për shkelje të traktateve ose të një norme ligjore që ka të bëjë me zbatimin e tyre (neni 263/2, TFBE).

Pas aderimit, KEDNJ-ja do të bëhet pjesë përbërëse e së drejtës së Bashkimit Evropian dhe rrjedhimisht juridiksioni i GJED-së do të shtrihet edhe tek KEDNJ-ja. Juridiksioni ekskluziv i GJED-së nuk është i limituar në mosmarrëveshjet midis shteteve anëtare. Shtetet anëtare angazhohen të mos përdorin asnjë mjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve lidhur me interpretimin ose zbatimin e traktateve, përveç mjeteve që parashikohen në traktate (neni 344 TFBE). Sipas opinionit 1/91 (PVGJE 1991), Gjykata e Drejtësisë e ka interpretuar nenin 344 të TFBE-së (ish-neni 292), se ai konfirmon juridiksionin ekskluziv të Gjykatës, i cili është pjesë thelbësore e traktateve. Për këtë arsye, GJED-ja ka kompetencë ekskluzive të interpretojë KEDNJ-në në gjykimet ndërmjet shteteve anëtare dhe Bashkimit Evropian.

Këto gjykime duhet të përjashtohen nga juridiksioni i GJEDNJ-së. Një dispozitë e tillë, që përjashton në mënyrë të shprehur juridiksionin e GJEDNJ-së në këto çështje, mund të vendoset në marrëveshjen e aderimit ose me marrëveshje midis shteteve anëtare dhe Bashkimit (Lock, 2009: 375, 391-395). KEDNJ-ja parashikon mundësinë e hartimit të marrëveshjeve ndërmjet palëve të larta kontraktuese për të hequr dorë reciprokisht për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që rrjedhin nga interpretimi ose zbatimi i Konventës, në mënyrën që parashikon Konventa në fjalë (neni 55, KEDNJ). Në heqjen e së drejtës së GJEDNJ-së për gjykimin e këtyre çështjeve duhet të marrim në konsideratë faktin që aplikimet kundër shteteve janë shumë të vogla në numër (Harris, 2009: 822).

ç) Çështjet financiare.

Çështjet financiare janë konsideruar si probleme të dorës së dytë. Ato nuk kanë qenë pjesë qendrore e negociatave të zhvilluara midis grupit të punës të Komitetit Drejtues të

të Drejtave të Njeriut (CCDH) dhe Komisionit Evropian. Draftmarrëveshja e aderimit merret me rregullimin e çështjeve financiare në nenin 8 të saj. Bashkimi do të kontribuojë çdo vit, ashtu si dhe shtetet e tjera dhe kjo shumë do t'i shtohet shumës që 27 shtetet e saj anëtare kontribuojnë.

Çështjet financiare duhet të shqyrtohen edhe në kuadrin e brendshëm, pra rregullimi i raporteve midis Bashkimit dhe shteteve anëtare kur GJEDNJ-ja ka gjetur shkelje. Mund të ndodhë që dënimi të pranohet nga të dyja subjektet dhe ato të bashkëpunojnë në rregullimin e situatës. Megjithatë, nuk përjashtohet mundësia që shtetet anëtare të mos kenë vullnetin për të pranuar shkeljen. Arsyet mund të jenë politike, p.sh. në rast se në shtetin anëtar ekziston një presion politik për të mos u fajësuar zyrtarisht në lidhje me një çështje që konsiderohet e ndjeshme ose delikate. Do të ishim përpara një situatë të tillë kur p.sh. qeveria në pushtet deklaron se ka si politikë prioritare mbrojtjen e minoriteteve, ndërkohë që GJEDNJ është shprehur se BE-ja dhe shteti anëtar (në fjalë) kanë shkelur nenin 14 të Konventës dhe nenin 1 të protokollit 12, pasi kanë trajtuar në mënyrë diskriminuese një minoritet të caktuar²⁰¹.

Mosmarrëveshje mund të lindin edhe në rast se kërkuesit i është njohur e drejta e kompensimit sipas nenit 41 të KEDNJ-së, duke qenë se janë të përfshirë interesa monetare. Në këto kushte, do të ishte i domosdoshëm hartimi i një marrëveshjeje ndërmjet shteteve anëtare dhe Bashkimit në lidhje me ndarjen e përgjegjësisë ndërmjet subjekteve.

5. Problemet e mundshme pas aderimit.

a) Mekanizmi i bashkëndërgjyqësisë.

Përsa i përket këtij mekanizmi kanë lindur disa debate. Së pari, nëse pala, kundër të

²⁰¹Neni 14 i Konventës sanksionon: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”

cilës nuk është ngritur çështja, do t'i bashkohet procedimit në mënyrë vullnetare apo në mënyrë të detyrueshme. Në këtë aspekt, sipas disa autorëve (Nanclares, 2013: 14) është shqyrtuar shkaku i shkeljes, pra nëse ai ka ardhur si rezultat i së drejtës primare të Bashkimit apo nga e drejta sekondare e Bashkimit. Kur pretendimi i shkeljes të të drejtave themelore është shkaktuar nga e drejta primare, do të ishte e vështirë të pranohet se bashkëndërgjyqësi nuk do të ishte pjesë e procesit automatikisht ose në mënyrë të detyrueshme. Probabiliteti më i madh është që kërkuesi të pretendojë shkeljen e të drejtave nga e drejta dytësore e Bashkimit, p.sh., kur është paditur vetëm Bashkimi. Natyra e ndërhyrjes së shtetit anëtar si bashkëndërgjyqës do të ishte më shumë vullnetare. Gjithashtu, GJEDNJ-ja në marrjen e vendimit si për bërjen e ftesës për të marrë pjesë në procedim, si në rastin e pranimit të kërkesës nga BE-ja si shtet anëtar, duhet të marrë në shqyrtim të drejtën e Bashkimit. A përbën ky vlerësim cenim të autonomisë të së drejtës së Bashkimit? Sipas disa autorëve në këtë rast kemi cenim të parimit të autonomisë së rendit ligjor të BE-së (Lock, 2011: 1045).

Një problem tjetër që është ngritur ka të bëjë me ndarjen e përgjegjësisë ndërmjet Bashkimit dhe shtetit anëtar, në rast se GJEDNJ-ja ka konstatuar shkelje të Konventës nga bashkëndërgjyqësit. Qartësimi i rregullave të brendshme ndërmjet BE-së dhe shteteve anëtare në ndarjen e përgjegjësisë ndikon drejtpërdrejt në ekzekutimin e vendimit. Ka raste ku përcaktimi i përgjegjësisë për shkeljen e Konventës është i vështirë. Për shembull, në rastin e një direktive të BE-së, e cila është bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm të një shteti anëtar. A ka të drejtë shteti anëtar të pretendojë se shkelja e dispozitave të Konventës ka ardhur si rezultat i direktivës dhe shteti nuk kishte diskrecion në marrjen e masave për këtë pjesë të direktivës. Në këtë rast GJEDNJ-ja duhet të bëjë një vlerësim të situatës duke interpretuar direktivën, për sa i përket së drejtës që kanë shtetet në zgjedhjen e mjeteve për transpozimin e saj. Një interpretim i tillë, përveçse mund të rezultonte mjaft i vështirë në disa raste, ai gjithashtu

do të binte në kundërshtim me autonominë e së drejtës së Bashkimit. Kjo situatë është rregulluar nga draftmarrëveshja. Kur veprimi ose akti kryhet nga organet e një shteti anëtar të Bashkimit ose nga një person që vepron për llogari të tij, atëherë veprimi do t'i atribuohet shtetit anëtar, pavarësisht nëse akti apo veprimi është kryer si rezultat i zbatimit të së drejtës së Bashkimit. Megjithatë, kjo nuk do të përjashtojë përgjegjësinë e Bashkimit Evropian sipas mekanizmit të bashkëndërgjyqësisë²⁰². Pra, shteti anëtar nuk mund të mbrohet duke pretenduar se veprimi i tij është ndërmarrë në kuadër të së drejtës së Bashkimit dhe ai nuk ka pasur diskrecion në marrjen e masave.

Nuk përjashtohet rasti që shkelja e dispozitave të Konventës ka ardhur nga zbatimi në praktikë i së drejtës së Bashkimit. Më konkretisht, nëse Bashkimi ka nxjerrë një direktivë mbi konkurrencën e cila është në përputhje me Konventën, por masat që merr shteti anëtar në zbatimin e saj shkelin të drejtat themelore. A ka përgjegjësi Bashkimi në rast se ai ka qenë *bashkëndërgjyqës* me shtetin anëtar gjatë procesit? A ka të drejtë individi t'u drejtohet institucioneve të Bashkimit për realizimin e të drejtës së tij, si palë solidarisht e detyruar me shtetin anëtar? Në rast se do të pranohej kjo e drejtë e aplikantit, a mund të themi se kjo do të rëndonte së tepërmi pozitën e Bashkimit, edhe në rastin kur nëpërmjet një procedure të caktuar atij do t'i njihej e drejta e kthimit ndaj shtetit anëtar?

Senatori francez Robert Badinter ka shprehur dyshimin e tij për zgjidhjen e dhënë nga ky mekanizëm. Në konsekuencë të situatës së mësipërme, Bashkimi Evropian mund të dënohej për shkelje të të drejtave të njeriut në më shumë raste seç duhet. Sipas senatorit, kjo ka efekt më negativ sesa dënimi i një shteti palë në Konventë, duke qenë se Bashkimi Evropian është një bashkim shtetesh. Dënimi i Bashkimit do të thotë dënimi i të gjitha shteteve anëtare, e cila nuk do të kishte ndodhur në mungesë të Bashkimit si

²⁰² Draft Marrëveshja e Aderimit të BE-së në KEDNJ, neni 1 paragrafi 4.

bashkëndërgjyqës. Gjithsesi, sipas draftmarrëveshjes së aderimit²⁰³, GJEDNJ-ja, pasi ka dëgjuar palët, mund të përjashtojë njërin nga bashkëndërgjyqësit nga përgjegjësia.

Zgjidhja e situatave praktike, që mund të vijnë përpara GJEDNJ-së mund të ketë si pasojë cenimin e autonomisë të së drejtës së Bashkimit dhe cenimin e këtij sistemi. Si duhet të vepronte GJEDNJ-ja përballë një rasti si *Šneersone* dhe *Kampanella kundër Italisë*²⁰⁴? Rasti kishte të bënte me një nënë nga Letonia, Šneersone, e cila morri djalin e saj (Kampanella) nga Italia në Letoni, pa marrë lejen e babait të fëmijës. Sipas rregullores nr.2201/2003, në situata të tilla vendimi i marrë nga shteti italian duhet të ekzekutohet nga gjykatat e Letonisë dhe autoriteve të saj kompetente.

Gjykatat italiane nxorrën një urdhër për dërgimin e fëmijës në Itali pranë të atit, pasi nëna kishte rrëmbyer fëmijën në mënyrë të paligjshme. Babai kishte pasur një kontribut minimal në rritjen e fëmijës. Ai asnjëherë nuk e kishte marrë fëmijën në shtëpinë e tij, si dhe gjatë disa viteve kishte kontaktuar shumë pak herë me fëmijën, duke mos bërë asgjë për të krijuar afrimet me të. GJEDNJ-ja mbajti qëndrimin se gjykatat italiane kishin ndërhyrë në të drejtën për jetë familjare ndërmjet kërkueses dhe djalit të saj, e parashikuar në nenin 8 të KEDNJ-së. Sipas Gjykatës, ndërhyrja në të drejtat e kërkuesve për respektimin e jetës së tyre familjare nuk ishte “e domosdoshme në një shoqëri demokratike” sipas kuptimit të nenit 8/2 të Konventës. Përfundimisht, Gjykata vendosi se kishim një shkelje të nenit 8 të Konventës nga gjykatat italiane, nëpërmjet urdhrit për kthimin e fëmijës në Itali.

Në rast se marrëveshja e aderimit do të ishte në fuqi, atëherë BE-ja do të kishte mundësi të shfrytëzonte mekanizmin e bashkëndërgjyqësisë dhe të ndërhynte kundër z. Šneersone. Rasti ka të bëjë me zbatimin e rregullores në fjalë, e cila shtron çështjen e përputhshmërisë të saj me Konventën. Shkelja e së drejtës së parashikuar nga neni 8 i KEDNJ-së do të shmangej, nëse nuk do të merreshin parasysh detyrimet e rregullores

²⁰³ Draft Marrëveshja e Aderimit të BE-së në KEDNJ, neni 3 paragrafi 7.

²⁰⁴ Vendim i GJEDNJ, datë 12.07.2011, rasti Šneersone dhe Kampanella kundër Italisë.

për zbatimin e vendimit të gjykatës italiane në shtetin letonez.

Në këtë rast BE-ja do të shpjegonete se pikësynimi i rregullores është besimi i ndërsjellë në sistemin e drejtësisë të shteteve anëtare në lidhje me çështjet martesore dhe përgjegjësinë prindërore, zgjidhja e të cilave ka karakter të ngutshëm. Në rast se shteteve ku do të zbatohet vendimi, do t'u kërkohej të vlerësonin përputhshmërinë e tij me Konventën, atëherë kjo do të cenonte vetë sistemin. Çfarë duhet të vendosë GJEDNJ-ja nëse ndodhet përpara një rasti të tillë? Çfarë roli do të kishte sistemi i BE-së në respektimin e të drejtave themelore sipas Konventës?

b) Kërkesa për vendim të mëparshëm të GjED-së.

GJEDNJ-ja duhet ta interpretojë të drejtën e BE-së në lidhje me çështjen në atë mënyrë që nuk ndryshon traktatet themeluese. Duhet të krijohen rregulla procedurale të nevojshme për të realizuar zbatimin efektiv të kësaj procedure për të mundësuar bashkëpunimin ndërmjet dy gjykatave. Kjo mund të kërkojë ndryshime të paktën në statutin e GJED-së apo edhe në traktatet themeluese. Në rast se këto dokumente nuk ndryshohen, a është e mundur që kjo kompetenë e re t'i njihet GJED-së nëpërmjet një traktati ndërkombëtar, ku BE-ja është palë? A do të cenohet në këtë rast autonomia e së drejtës së BE-së?

Në përputhje me nenin 35 të Konventës kërkohet ezaurimi i ankimit të brendshëm. Pas aderimit në Konventë, procesi gjyqësor në GJED nuk do të konsiderohet si gjykim ndërkombëtar dhe Gjykata e Drejtësisë do të mendohet si gjykatë e juridiksionit të brendshëm në lidhje me BE-në. Pra, një kërkesë mund të ngrihet nga aplikuesi pasi ka ezauruar ankimin e brendshëm të shtetit anëtar, por para se çështja të gjykohet në GJED. GJEDNJ-ja nuk mund ta deklarojë kërkesën të papranueshme sipas nenit 35/1, sepse kërkuesi e ka ezauruar ankimin e brendshëm të një "pale të lartë kontraktore" të KEDNJ-së (pra të shtetit anëtar të BE-së). Parashikimi i këtij mekanizmi që i jep të drejtën vetëm një pale të lartë kontraktuese (BE-së) t'i referohet çështja nga GJEDNJ-ja

për t'u shprehur, përbën trajtim të pabarabartë me palët e tjera kontraktuese. Asnjë gjykatë e palëve të tjera kontraktuese, nuk i është dhënë mundësia të shmangin riskun e shkeljes së konventës duke mbajtur qëndrim përpara se GJEDNJ-ja të shprehet mbi një rast të referuar nga ajo vetë.

Praktika mund të sjellë situata të tilla, të cilat kërkojnë interpretimin e nocionit “ezaurim i ankimit të brendshëm”. Palët në proces nuk mund ta detyrojnë gjykatën kombëtare për të referuar çështjen për vendim paragjykimor në GJED. Po ashtu, gjykata kombëtare ka diskrecion të plotë në përcaktimin e pyetjeve që do t'i drejtojë GJED-së. Në këtë situatë lindin dy raste problematike. Nëse gjykata kombëtare nuk i shtron përpara GJED-së të gjitha çështjet që kanë rëndësi për të vendosur mbi përputhshmërinë me të drejtat e njeriut. Ose nëse gjykata kombëtare paraqet përpara GJED-së të gjitha çështjet që kanë rëndësi për të vendosur mbi përputhshmërinë me të drejtat e njeriut, por nuk kërkon që GJED-ja të shprehet për respektimin e të drejtave themelore dhe GJED-ja në vendimin e saj nuk shprehet për përputhshmërinë e çështjeve të ngritura me të drejtat e njeriut.

Në të dyja këto raste GJED-ja është shprehur. Në rastin e parë ajo është shprehur për disa nga çështjet mbi respektimin e të drejtave të njeriut, por jo për të gjitha. Ndërsa në rastin e dytë, në vendimin e GJED-së nuk shqyrtohet përputhshmëria e çështjeve të ngritura me të drejtat themelore. Në këto siutata, a duhet të bëjë kërkesë GJEDNJ-ja për t'u shprehur më parë GJED-ja në lidhje me rastin, pasi nuk është ezauruar ankimi i brendshëm i BE-së?

Përsa i përket këtij mekanizmi janë shtruar për diskutim çështjet nëse ai përbën një mjet ankimi efektiv? E drejta e Bashkimit nuk parashikon kompensim në rast të shkeljes së Konventës nga e drejta primare e BE-së. E drejta primare e Bashkimit ka funksion të ngjashëm me kushtetutat e shteteve anëtare. Në rastet kur kërkuesi pretendon përpara GJEDNJ-së për shkelje të Konventës nga dispozitat e së drejtës primare të BE-së, a duhet t'ia referojë GJEDNJ-ja çështjen GJED-së për t'u shprehur ajo më parë me

vendim? Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së ky mjet ankimi nuk është efektiv. GJEDNJ-ja është shprehur se: “mjetet e ankimit kombëtar duhet të ezaurohen vetëm në rastin kur ekziston një kompensim efektiv për të drejtat e shkelura ...”.²⁰⁵ Megjithatë, zgjidhja e rastit konkret do t’i lihet inerpertimit të Gjykatës së Strasburgut.

Një çështje tjetër e ngritur për diskutim është edhe pozita e kërkuetit. Procedura e kërkesës për vendim të mëparshëm të GJED-së cenon pozitën e kërkuetit, duke ndikuar negativisht në mbrojtjen e tij. Natyra e këtij mekanizmi është e tillë që kërkueti sillet përpara një gjykate, në të cilën ai as ka pasur akses më parë, as nuk ia ka adresuar çështjen. Kërkueti e gjen veten përpara një gjykate tjetër, ku duhet të ndjekë një procedurë të ndryshme nga ajo për të cilën ai ishte përgatitur.

Një aspekt tjetër negativ i zbatimit të këtij mekanizmi është edhe vonesa në gjykimin e rastit. Sa është periudha kohore që GJED-ja duhet ta shqyrtojë çështjen? Shqyrtimi i çështjes nuk mund të bëhet me një procedurë të ndryshme nga ato që parashikohen në traktate, pasi do të përbente një ndryshim të tyre dhe do të cenonte autonominë e së drejtës së Bashkimit. Pra, nga njëra anë në draftmarrëveshjen e aderimit kërkohet që procesi në GJED të mos sjellë vonesa të tepërta, nga ana tjetër është theksuar se në asnjë rast, nëpërmjet këtij mekanizmi nuk duhet të preken kompetencat e GJED-së²⁰⁶.

Në draftraportin shpjegues të Marrëveshjes së Aderimit të BE-së në KEDNJ, prezantohet një mënyrë për procedurën që do mund të ndiqet pa cenuar autonominë e rendit ligjor të Bashkimit. Sipas tij, traktatet parashikojnë procedurën e përsheptuar dhe GJED-ja e ka përdorur këtë procedurë për të dhënë vendime brenda 6-8 muajve. Procedura e përsheptuar parashikohet nga statuti i Gjykatës së Drejtësisë²⁰⁷, i cili ka të njëjtin status ligjor me protokollet e traktateve (TFBE, neni 281), pra statuti është pjesë e së drejtës primare. Kjo procedurë mund të kryhet edhe në rastin e kërkesës për vendim

²⁰⁵Vendim i GJEDNJ *Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë* datë 31.07.2012, Vendim i GJEDNJ *Scoppola kundër Italisë*, Shtator 2009.

²⁰⁶Draft Marrëveshja e Aderimit të BE-së në KEDNJ, neni 3 paragrafi 6.

²⁰⁷ Statuti i Gjykatës së Drejtësisë, Neni 23/a, F.Z. 2010.

të mëparshëm të GJED-së. Një tjetër aspekt i periudhës kohore brenda së cilës duhet të zhvillohet gjykimi ka të bëjë me afatin e parashkrimit të së drejtës. Traktati parashikon që GJED-ja shqyrton paligjshmërinë e akteve. Ky proces duhet të fillojë brenda dy muajve nga botimi i masës ose nga njoftimi i masës paditësit ose, në mungesë të kësaj, nga dita kur ai ka marrë dizeni për këtë të fundit (TFBE, neni 263/6). Aktet e institucioneve të Bashkimit nuk mund të jenë objekt i rishikimit gjyqësor nga GJED-ja, nëse ka kaluar afati 2-mujor. Sipas jurisprudencës së konsoliduar të GJED-së, ky afat ka të bëjë me sigurinë juridike dhe nuk është objekt i diskrecionit të palëve apo të GJED-së²⁰⁸. Problemi që ngrihet në këtë rast është nëse ky afat do të zbatohet edhe në rastin e mekanizmit të kërkesës për vendim të mëparshëm të GJED-së? Në rast se ky afat do të zbatohet, atëherë ky mekanizëm vështirë se do të aplikohet ndonjëherë. Nëse ky afat nuk do të zbatohet, a mund të themi se jemi përpara ndryshimit të funksioneve të GJED-së? A cenohet në këtë rast autonomia e së drejtës së Bashkimit?

Një çështje tjetër problematike është vendimi i GJEDNJ-së që përcakton se cilat raste do t'i referohen Gjykatës së Luksenburgut. Ky vendim do të ishte i vështirë të merrej pa bërë një paragjykim të çështjes. Për shembull, kur kërkuesi është paraburgosur në përputhje me dispozitat e Urdhrit të Arrresit Evropian²⁰⁹ dhe pretendon se gjatë qëndrimit në paraburgim ai ka qënë subjekt i trajtimit degradues, në shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së. Në mënyrë të qartë Urdhri i Arrestit Evropian është shkaku përcaktues për shkaktimin e shkeljes duke qënë se ai e bën të mundur shkeljen, megjithatë urdhri nuk autorizon trajtim degradues. A duhet Gjykata e Strasburgut ta referojë çështjen në GJED në këtë rast? A sjell ky vlerësim një paragjykim të rastit?

c) Autonomia e Bashkimit Evropian.

Për të sqaruar interpretimin e nenit 6, pika 2, është hartuar protokollu 8 i Traktatit të Lisbonës. Sipas tij, marrëveshja e aderimit ruan karakteristikat specifike të Bashkimit

²⁰⁸Vendim i GJED-se T-121 & 151/96 (çështje të bashkuara).

²⁰⁹ Vendim i Këshillit 2002/584 Justice and Home Affairs [2002] GZBE L190/1.

dhe të së drejtës së Bashkimit. Protokollin nuk specifikon cilat janë këto karakteristika, megjithatë argumentohet se ato përfshijnë autonominë e rendit ligjor të BE-së (Lock, 2010: 781, vol.35). Marrëveshja siguron që aderimi të mos prekë kompetencat e Bashkimit ose të institucioneve. Asnjë parashikim i saj nuk ndikon te situatat e shteteve anëtare në lidhje me Konventën Evropiane dhe protokollet shtesë, sidomos në lidhje me masat që u shmangen detyrimeve të Konventës (KEDNJ, neni 15) dhe rezervave të formuluar nga shtetet.

Neni 6/2 i Traktatit të Lisbonës është interpretuar se e vendos Bashkimin nën detyrimim për t'u anëtarësuar në KEDNJ. Megjithatë, asnjë dispozitë në Traktat nuk sugjeron se neni 6/2 kërkon që çdo formë e marrëveshjes së aderimit në KEDNJ do të jetë e pranueshme, pavarësisht përmbajtjes së saj. Marrëveshja e aderimit në KEDNJ duhet të jetë në përputhje me traktatet themeluese të BE-së dhe si rrjedhim është edhe objekt i mundshëm i një opinioni të GJED-së, sipas nenit 218/11 i TFBE-së. Çështja më e rëndësishme e një marrëveshje ndërkombëtare, ku palë është BE-ja, ka të bëjë me ruajtjen e autonomisë të së drejtës së BE-së (Lock, 2011: 1028, vol 48). Për këtë arsye, draftmarrëveshja duhet të vlerësohet nën këndvështrimin e standardeve të vendosura nga GJED-ja për parimin e autonomisë të së drejtës së BE-së. Në një seri çështjesh dhe opinionesh, GJED-ja ka shtjelluar konceptin e autonomisë së rendit ligjor të BE-së. Në rastin *Costa kundër Enel*²¹⁰, Gjykata për herë të parë shfaqti konceptin e autonomisë të së drejtës së traktateve. Për këtë arsye, legjislacionet e shteteve anëtare nuk mund të shkelnin të drejtën e Bashkimit, duke vendosur kështu edhe përparësinë e saj mbi të drejtën kombëtare të shteteve anëtare. Ky është konsideruar si dimension i brendshëm i autonomisë. Në lidhje me marrëdhënien midis BE-së dhe së drejtës ndërkombëtare, GJED-ja ka përdorur po ashtu konceptin e “autonomisë” për ta përpunuar atë. Normat që rregullojnë marrëdhënien ndërmjet BE-së dhe së drejtës ndërkombëtare përbëjnë

²¹⁰Vendim i GJED 6/64 *Flaminio Costa kundër Enel*, [1964] PVGJE 1251.

dimensionin e jashtëm të autonomisë. Gjykata, për herë të parë, e ka përmendur atë në opinionin 1/91 (1991, PVGJE I-6079), në të cilin hodhi poshtë draftmarrëveshjen mbi Zonën Ekonomike Evropiane (EEA), për shkak të mospërputhjes së saj me autonominë e së drejtës së BE-së.

Tre ishin arsyet kryesore pse marrëveshja nuk respektonte autonominë e së drejtës së BE-së. GJED-ja kritikon juridiksionin e Gjykatës së Zonës Ekonomike Evropiane. Draftmarrëveshja parashikonte krijimin e një gjykate, e cila do të kishte juridiksion të vendoste mbi konfliktet ndërmjet “palëve kontraktuese”. Me termin “palë kontraktuese” kuptohej Bashkimi, shtetet anëtare ose të dyja bashkë, në varësi të ndarjes së kompetencave ndërmjet tyre. Nenet 19/1 të TBE -së dhe neni 344 TKE, (ish nenet 220 dhe 292) të TFBE-së i njohin GJED-së juridiksion ekskluziv në interpretimin e traktateve.²¹¹

Draftmarrëveshja nuk garantonte që Gjykata e Zonës Ekonomike Evropiane do të ishte e detyruar të zbatonte interpretimin e së drejtës së BE-së të bërë nga GJED-ja. Në këtë kontekst duhet marrë parasysh fakti që disa nga dispozitat e marrëveshjes mbi Zonën Ekonomike Evropiane, kishin të njëjtën përmbajtje me TKEE-në, pasi dispozitat e Traktateve të BE-sëishin marrë si bazë. Sipas Gjykatës së Drejtësisë dispozitat nuk do të interpretoheshin domosdoshmërisht në të njëjtën mënyrë, pasi ato kishin qëllim dhe objekt të ndryshëm. Në këtë mënyrë, çdo interpretim i këtyre dispozitave të marrëveshjes së Zonës Ekonomike Evropiane do të cenonte interpretimin e dispozitave që kishin të njëjtën përmbajtje në TKEE.

Një tjetër argument në lidhje me kufizimin e autonomisë ka të bëjë me njohjen e kompetencave të reja institucioneve të BE-së. Marrëveshja parashikonte që gjykatat kombëtare të shteteve palë të EFTA-s (European Free Trade Association) kishin të drejtë të bënin kërkesë për vendim paragjykimor në GJED në lidhje me interpretimin e

²¹¹Vendim i GJED C- 459/03 Komisioni *kundër Irlandës*, [2006] PVGJE I-4635.

Marrëveshjes së Zonës Ekonomike Evropiane. GJED-ja ka pranuar se një marrëveshje mund t'i akordojë asaj juridiksionin për të interpretuar dispozitat e saj në lidhje me zbatimin e tyre në shtetet joanëtare. Megjithatë, ky transferim nuk duhet të ndryshojë natyrën e funksioneve të GJED-së. Problemi qëndronte në faktin që vendimi paragjykimor i GJED-së nuk do të kishte fuqi detyruese. Gjykata u shpreh se sipas së drejtës së Bashkimit çdo vendim i dhënë nga GJED-ja ka fuqi detyruese për gjykatën kombëtare që ka bërë kërkesën. Ky ndryshim i funksioneve të GJED-së sjell *de facto* një amendim të traktateve themeluese, i cili mund të realizohet vetëm në përputhje me nenin 42 të TKE-së (TBE, aktualisht neni 48).

Më pas në opinionin 1/00 (2002, PVGJE I-3493), GJED-ja identifikoi këto dy aspekte të dimendionit të jashtëm të autonomisë. Së pari, autonomia e së drejtës së Bashkimit kërkon që “kompetencat thelbësore ... të institucioneve të ngelin të pandryshuara”. Së dyti, kërkohet që procedurat që zbatohen në interpretimin e marrëveshjes ndërkombëtare, kur ka mosmarrëveshje ndërmjet palëve, nuk duhet të kenë efekt detyrues mbi Komunitetin dhe institucionet e tij. Ato nuk duhet ta detyrojnë KE-në t'i ushtrojnë kompetencat e tij në përputhje me interpretimin e normave të marrëveshjes ndërkombëtare, kur këto të fundit janë referuar në traktatet themeluese. Pra, një gjykatë ndërkombëtare nuk mund të interpretojë normat e traktateve themeluese, në një mënyrë që është e detyrueshme për t'u zbatuar nga Bashkimi.

Në çështjen *Kadi*²¹², Gjykata e Drejtësisë e çoi edhe më tej këtë argument. Ajo u shpreh se autonomia e së drejtës së BE-së jo vetëm që ndalon një marrëveshje ndërkombëtare të ndryshoj kompetencat brenda BE-së, por marrëveshja duhet gjithashtu të mos ndikojë në cenimin e parimeve kushtetuese të traktateve. Pjesë e parimeve kushtetuese janë edhe të drejtat themelore të njeriut. Ky qëndrim e lidh autonominë e rendit ligjor të BE-së me hierarkinë e normave brenda tij. Sipas tij e drejta primare dhe parimet kanë prioritet mbi

²¹² Vendim i GJED C-402/05 [2008] PVGJE I-06351.

të drejën dytësore dhe marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura nga BE-ja. Si rrjedhim, çdo marrëveshje që i cakton GJEDNJ-së kompetenca që ushtrohen nga institucionet e BE-së sipas së drejtës së Bashkimit, është e papajtueshme me autonominë e rendit ligjor të BE-së.

Në një opinion tjetër të mëvonshëm, GJED-ja interpretoi se parimi i autonomisë së Bashkimit shtrihej përveçse në kompetencat e institucioneve të BE-së, edhe në detyrimet që kishin marrë përsipër shtetet anëtare të BE-së, në kuadër të së drejtës së Bashkimit. GJED-ja me opinionin 1/09 (2011), mbi draftmarrëveshjen e Gjykatës së Patentave të Evropës dhe Komunitetit konkludoi se ajo ishte në mospërputhje me parimin e autonomisë. Marrëveshja sanksiononte se Gjykata e Patentave do të kishte juridiksion ekskluziv për çështjet që kishin të bënin me patentat²¹³, duke u lënë shteteve palë rol dytësor në zgjidhjen e këtyre rasteve. GJED-ja argumentoi se marrëveshja do t'u hiqte shteteve edhe kompetencat në lidhje me interpretimin e aplikimit të së drejtës së Bashkimit për çështjet e patentave.

Gjykatës së Patentave i ishte njohur e drejta të kërkonte vendim paragjykimor në GJED. Gjykata e Drejtësisë vlerësoi se nuk ekzistonin garanci të mjaftueshme për përfshirjen e saj në këtë proces, pasi nuk ishte parashikuar detyrimi për kërkimin e një vendimi paragjykimor. Në kontrast me këtë situatë, nëse një shtet anëtar nuk përmbush detyrimin e tij për ta referuar çështjen në GJED, kjo përbën shkelje. Si rrjedhim, ose Komisioni ose një shtet tjetër anëtar mund të nisnin procedimin për këtë shkelje në bazë të neneve 258 dhe 259 të TFBE-së. Ky opinion ka rëndësi pasi i shton parimit të autonomisë një dimension tjetër. Sipas GJED-së, jo vetëm institucionet e BE-së nuk duhet të preken nga marrëveshjet ndërkombëtare, por edhe institucionet e shteteve anëtare, të cilat kanë marrë përsipër detyrime sipas së drejtës së Bashkimit. Autonomia e rendit ligjor të BE-së deporton edhe në rendet ligjore kombëtare dhe pjesërisht i

²¹³ Draft Marrëveshja e Aderimit të BE-së në KEDNJ, neni 15.

përfshin ato. Normat e së drejtës së Bashkimit nuk mund të interpretohen nga një organizëm i jashtëm, por vetëm nga institucionet e vetë Bashkimit Evropian, ku kryesisht këtë kompetencë e ka GJEDN-ja. Pas aderimit, individët kanë të drejtë t'i drejtohen GJEDNJ-së për shkelje të Konventës nga Bashkimi. Problemet që lindin në këtë situatë përse i përket autonomisë të së drejtës së BE-së janë dy. Së pari, interpretimi që GJEDNJ-ja do t'i bëjë të drejtës së BE-së a do të ketë fuqi detyruese? Së dyti, vendimi i GJEDNJ-së, që e drejta e BE-së është në shkelje të Konventës, a është në përputhje me parimin e autonomisë së drejtës së Bashkimit? Në çështjen *Huwig*,²¹⁴ GJEDNJ-ja mbajti qëndrimin se: “në radhë të parë u takon autoriteteve kombëtare, kryesisht gjykatave, të interpretojnë dhe zbatojnë legjislacionin e brendshëm. Prandaj, nuk i takon GJEDNJ-së të shprehë një opinion në kundërshtim me interpretimin e tyre...” Në përputhje me këtë qëndrim, Gjykata nuk do të kryejë një interpretim të përmbajtjes të së drejtës së Bashkimit.

Megjithatë, a është e mundur që GJEDNJ-ja të mos interpretojë të drejtën e Bashkimit kur ndodhet përpara rasteve si p.sh: për të vendosur nëse një mjet ankimi është “efektiv” (neni 13, KEDNJ), nëse ndërhyrja në të drejtat themelore është “parashikuar nga ligji” (përmendet në nenet 8/2, 9/2, 10/2, 11/2 të KEDNJ), ose kur dikush është privuar liria e tij “në përputhje me procedurën e parashikuar nga ligji” (neni 5, KEDNJ). GJEDNJ-ja e ka marrë këtë në shqyrtim në çështjen *Kemmanche*.²¹⁵ Gjykata thekson se fjalët “në përputhje me procedurën e parashikuar nga ligji” referojnë në legjislacionin e brendshëm, ku ato duhet të jenë në përputhje me procedurat e parashkuara nga ligji. Megjithatë, vetë legjislacioni i brendshëm duhet të jetë në përputhje me Konventën, duke përfshirë edhe parimet e përgjithshme të shprehura apo të nënkuptuara në Konventë. Për më tepër, GJEDNJ-ja, në çdo rast, duhet të vendosë nëse shkelja ka ndodhur nga dispozita të së drejtës primare, dytësore apo si rezultat i veprimit të

²¹⁴Vendim i GJEDNJ, datë 24.04.1990, çështja *Huwig*.

²¹⁵Vendim i GJEDNJ, datë 02.11.1993, çështja *Kemmanche*.

organeve administrative apo gjyqësore. Ky vlerësim do të duhet të bëhet duke interpretuar traktatet, e cila mund të përbëjë shkelje të autonomisë së rendit ligjor të BE-së.

Përsa i përket problemit të dytë, pra rastit kur GJEDNJ-ja vlerëson se një pjesë e legjislacionit dytësor të BE-së cenon të drejtat e KEDNJ-së. Të drejtën ekskluzive për të vendosur mbi paligjshmërinë e një akti të BE-së do ta ketë përsëri vetëm GJED-ja. Vendimet e GJEDNJ-së kanë natyrë deklarative dhe janë të detyrueshme sipas së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, GJED-ja në vendimin e saj mbi ligjshmërinë e një akti të BE-së do të jetë e detyruar të zbatojë dispozitivin e vendimit të GJEDNJ-së (neni 46, KEDNJ). Natyrisht që ky detyrim cenon pavarësinë e së drejtës së BE-së, por shtetet anëtare e kanë parashikuar këtë cenim në momentin që kanë miratuar nenin 6/2 të traktatit të Lisbonës. Duke qenë se autonomia e rendit ligjor të BE-së derivon nga traktatet, përjashtimet që bëjnë vetë dispozitat e traktateve nuk mund të konsiderohen cenime të autonomisë.

Çështja komplikohet në rast se GJEDNJ-ja duhet të vendosë mbi përputhshmërinë me Konventën të një dispozite të së drejtës primare të Bashkimit. Gjatë hartimit të draftmarrëveshjes është diskutuar për përjashtimin e së drejtës primare, kryesisht traktateve, nga juridiksioni i GJEDNJ-së²¹⁶. Ky propozim nuk u përfshi në draftmarrëveshje, pasi nuk ishte e mundur të përjashtoheshin disa pjesë të së drejtës së Bashkimit nga shqyrtimi i GJEDNJ-së. Arsyeja e këtij propozimi ka të bëjë me çështjen e cenimit të autonomisë të së drejtës të Bashkimit edhe me faktin që BE-ja nuk mund të ndryshoj vetëm me vullnetin e saj të drejtën primare. Rrjedhimisht ajo nuk duhet të jetë përgjegjëse për këtë (Köngeter, 2005: 230, 245).

Përsa i përket së drejtës primare të Bashkimit, ajo është vendosur në krye të hierarkisë të normave. Kjo do të thotë se ka prioritet në rast të mospërputhjes me dispozitat e së

²¹⁶Qendrimi i Qeverisë Franceze, në faqen web <http://www.senat.fr/europe/r25052010.html>

drejtës dytësore dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Natyrshëm lind diskutimi nëse GJEDNJ-ja do të ketë të drejtë të shqyrtojë të drejtën primare dhe parimet e së drejtës së Bashkimit. Në rast se GJEDNJ-së do t'i njihej kjo kompetencë, ajo do të cenonte autonominë e Bashkimit. Po ashtu do të lindë një konflikt mbi hierarkinë e normave, pasi sipas rendit ligjor të BE-së dhe jurisprudencës së GJED-së, marrëveshja ndërkombëtare qëndron nën të drejtën primare të Bashkimit. Në rast se GJEDNJ-së nuk do t'i njihej kjo kompetencë, edhe ky rast do të ishte problematik. Bashkimi Evropian do të ishte e vetmja "Palë e lartë kontraktuese", dispozitat kushtetuese të të cilit nuk do të shqyrtoheshin nga GJEDNJ-ja. Në këtë mënyrë do të kishim një diskriminim në trajtimin e palëve kontraktuese të Konventës.

Kapitulli VII: Rast studimor.

Mbrojtja e së drejtës për jetë familjare sipas GJEDNJ-së dhe sipas GJED-së.

1. Kuptimi i të drejtës për jetë familiare sipas GJEDNJ.

Nocioni i jetës familjare dhe kuptimi i fjalës "familje" është zhvilluar me kohën, në përputhje me sjelljen e shoqërisë evropiane. Në të janë marrë parasysh diversiteti i problemeve të familjes moderne, çështjet e divorcit dhe përparimet në mjekësi. "Jeta familjare" presupozon lidhje të ngushta personale, por përveç marrëdhënies prindërore, nuk kërkon që anëtarët e familjes të jetojnë së bashku. Jeta familjare nuk do të kufizohet vetëm në marrëdhënjet e krijuara nga martesat, por do të përfshijë edhe marrëdhënje të tjera të cilat *de facto* kanë lidhje të ngushta ndërmjet anëtarëve të tyre.

Si rregull i përgjithshëm, Gjykata vendos mbi ekzistencën e jetës familjare në bazë të fakteve të çdo ëështjeje dhe parimi i përgjithshëm që duhet të zbatohet është që të shqyrtohet nëse ekzistojnë lidhje të ngushta personale midis palëve. Megjithatë, metoda e shqyrtimit rast pas rasti e çështjeve, do të thotë që nuk është gjithnjë e mundur që të renditen të gjitha marrëdhëniet që përbëjnë jetë familjare dhe ato të cilat nuk e përbëjnë

atë. Një numër në rritje marrëdhëniesh tashme gëzojnë automatikisht mbrojtje nga neni 8 i Konventës. Jurisprudenca e GJEDNJ-së ka dhënë një kontribut të pazëvendësueshëm në zhvillimin e kësaj të drejte. Gjykata, në jurisprudencën e saj, përveçse ka ecur me hapin e zhvillimit shoqëror, shpesh ka qenë edhe prijësja e zhvillimit dhe njohjes së mëtejshme të së drejtës për jetë familjare.

2. Standardet e vendosura nga GJEDNJ mbi shtrirjen e “jetës familjare”.

Në 10 vitet e fundit Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme fushën e mbrojtjes nga neni 8 i KEDNJ. Ky nen parashikon një të drejtë relative dhe, si e tillë për zbatimin e saj kërkohet vendosja e një ekulibri midis mbrojtjes të të drejtave të njeriut dhe të drejtës së shteteve kontraktuese për të pasur “liri vlerësimi” në këto çështje. Gjykata e Strasburgut përballë një rasti konkret zbaton metodën e analizës dyfazëshe. Pra, çështja vlerësohet në dy faza. Në fazën e parë përcaktohet nëse e drejta e pretenduar mbrohet nga neni 8 i Konventës. Nëse po, a ekziston një detyrim pozitiv mbi shtetin që të respektojë të drejtën e një individi dhe a është përmbushur ajo? Testi i përdorur nga gjykata në fazën e dytë të vlerësimit konsiston në analizën e dy çështjeve: së pari, a ka ndodhur një ndërhyrje në të drejtën e nenit 8? së dyti, nëse ka ndodhur ndërhyrje, a është ajo në përputhje me ligjin? A ndjek ajo një synim legjitim? A është ajo e nevojshme në një shoqëri demokratike?

Në njërin prej vendimeve²¹⁷ të saj të para në lidhje me këtë të drejtë, Gjykata zhvilloi konceptin e familjes duke u njohur një status të barabartë fëmijëve të lindur jashtë martesë me fëmijët e lindur nga një martesë. Gjykata nënvizoi se neni 8 i Konventës gjen zbatim edhe në "jetën familjare të familjes së paligjshme". Në këtë çështje, kërkuese ishte Aleksandra Marckx lindur më 16 tetor 1973, shtetase belge. Më 29 tetor 1973, në përputhje Kodin Civil Belg, e ëma e Aleksandrës e njohu atë ligjërisht. E ëma e Aleksandrës, Paula Marckx, në momentin e njohjes vullnetare të amësisë ishte beqare.

²¹⁷ Vendim i GJEDNJ *Marckx kundër Belgjikës*, datë 13.06.1979.

Paula bëri njohjen vullnetare të amësisë të vajzës së saj duke qënë se iu refuzua pranimi i mëmësisë që nga momenti i lindjes. Njohja vullnetare kishte efekt nga dita që ishte bërë kërkesa. Sipas ligjit belg, një nënë e pamartuar mund ta përcaktonte amësinë vetëm me njohje vullnetare, ndërsa amësia e një fëmije “të ligjshëm” përcaktohej thjesht nga lindja. Fëmija i “paligjshëm” që ishte njohur nga nëna e tij, në parim, konsiderohej se ishte jashtë familjes të së ëmës. Fëmija i “jashtëligjshëm” kishte mundësi të kufizuara për të përfituar me dhurim ose trashëgim pasurinë e nënës së tij. Gjykata nënvizoi se neni 8 gjen zbatim në “jetën familjare të familjes së paligjshme”. Kur shteti përcakton regjimin e zbatueshëm për disa familje, duhet të veprojë në mënyrë që t’i lejojë ato të bëjnë një jetë familjare normale. Shteti duhet të shmangë çdo diskriminim bazuar në lindjen. “Jeta familjare” sipas nenit 8 përfshin të paktën lidhjet midis kushërinjve të afërt dhe ky “respektim” përbën detyrim për shtetin. Gjykata konstatoi se kërkesja vihej përpara një dileme. Ajo mund ta njihte vullnetarisht amësinë por do të kufizonte të drejtën e saj për t’i dhuruar apo trashëguar pasurinë e saj fëmijës së paligjshëm. Kjo dilemë në të cilën ndodhet nëna nuk përputhet me respektimin e së drejtës familjare. Gjykata pranoi se në kohën e hartimit të Konventës u konsiderua i lejueshëm dhe i pranueshëm dallimi midis familjes së “paligjshme” dhe të “ligjshme”. Megjithatë Konventa duhet të interpretohet nën dritën e kushteve aktuale. Jeta familjare nuk përfshin vetëm marrëdhëniet me karakter shoqëror, moral ose kulturor, por edhe interesa materialë. Aleksandra Marckx i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga neni 14 i kombinuar me nenin 8, për shkak të kufizimeve të aftësisë së saj për të marrë të mira nga nëna e saj dhe të pamundësisë për të trashëguar nga të afërmit e saj nga ana e nënës. Në lidhje me Paula Marckx, Gjykata nënvizoi se neni 8 nuk i garantonte një nëne lirinë absolute për t’i dhuruar ose trashëguar pasurinë e saj fëmijës. Por dallimi i bërë midis nënave beqare dhe të martuara nuk justifikohet objektivisht dhe në mënyrë të arsyeshme. Si rredhim, gjeti shkelje të nenit 8 së bashku me nenin 14.

E drejta për jetë familjare shtrihet edhe në të drejtën e prindërve ose të afërmeve për t'u takuar me fëmijët ose të afërm të tjerë të familjes. Në disa vendime të saj, Gjykata ka konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës, kur autoritetet publike të një shteti kanë refuzuar ose kanë ndaluar të atin të mbajë kontakte me fëmijët e tij të lindur jashtë martese. E drejtë e prindërve për të mbajtur lidhje me fëmijët e tyre shtrihet edhe pas divorcit.²¹⁸

Në çështjet *Sahin, Sommerfeld* dhe *Hoffman*, të tre kërkuesit kanë pasur fëmijë të lindur jashtë martesës dhe në lidhje me këta fëmijë atyre iu mohua e drejta për t'iu drejtuar gjykatave gjermane. Kërkuesit ankoreshin se vendimet e gjykatave gjermane për të mos pranuar kërkesat që ata kishin bërë për të takuar fëmijët e tyre shkelnin nenin 8 të Konventës dhe nenin 14 të saj për diskriminim. Z. Sommerfeld dhe z. Hoffman ankoreshin gjithashtu për mohim të së drejtës për të pasur një gjykim të drejtë duke u bazuar në nenin 6 të Konventës.

Përsa i përket çështjes *Sahin kundër Gjermanisë*,²¹⁹ gjykatat kompetente gjermane ia refuzuan z. Sahin kërkesën për të pasur mundësi të takohet me fëmijën e vet, duke u bazuar në deklaratat e bëra nga kërkuesi, nëna e fëmijës, nga dëshmitarët, nga komentet e zyrës së fëmijëve dhe nga mendimi i ekspertit. Këta kishin mbajtur parasysh marrëdhëniet jonormale ndërmjet prindërve dhe kishin konstatuar që kontaktet nuk do të ishin në interes të fëmijës.

Sipas mendimit të Gjykatës së Strasburgut, mosdëgjimi nga ana e gjykatave gjermane të fëmijës nxori në pah se kërkuesi nuk ishte përfshirë aq sa duhej në procedurat gjyqësore. Ishte themelore që gjykatat kompetente të jepnin një vlerësim të kujdesshëm të asaj që ishte në interesin më të mirë të fëmijës pasi të kishin pasur kontakt të drejtpërdrejtë me të. Një informacion i saktë dhe i plotë në lidhje me marrëdhënien e fëmijës me kërkuesin, kur prindi kërkonte të kishte kontakte me të, ishte një kusht i

²¹⁸ Vendim i GjEDNj *Hansen kundër Turqisë*, datë 23.09.2003.

²¹⁹ Vendim i GjEDNj *Sahin kundër Gjermanisë*, datë 03.07.2003.

domosdoshëm paraprak për vlerësimin e dëshirave reale të fëmijës. Vetëm në këtë mënyrë mund të viheshin në një balancë të drejtë interesat që ishin në lojë në këtë rast. Për këto arsye, Gjykata konstatoi shkelje të nenit 8 të Konventës.

Në lidhje me çështjen *Sommerfeld kundër Gjermanisë*,²²⁰ GJEDNJ-ja vuri në dukje se Gjykata e Rrethit ia refuzoi kërkesën Z.Sommerfeld për mundësi vizitash fëmijës së tij, duke u bazuar në deklaratat e bëra nga fëmija. Fëmija është pyetur nga ana e Gjykatës së Rrethit në vitin 1994 në moshën 13-vjeçare si dhe në një proces të mëparshëm për të njëjtin qëllim, në moshën 10-vjeçare. Gjykata e Rrethit arriti në konkluzionin se kontaktet nuk ishin në interes të fëmijës, duke vlerësuar gjithashtu komentet e bëra nga ana e zyrës për fëmijët dhe materialet e marra gjatë fazës së parë të procedurave në lidhje me mundësinë e takimit. Gjykata e Apelit Ia në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit duke u bazuar në të njëjtat argumente.

Gjykata e Strasburgut vlerësoi se në këtë rast duhet pasur parasysh deklaratat paksa sipërfaqësore të psikologut në çështjen e parë, kalimin e kohës deri në çështjen e dytë si dhe objektin e çështjes, i cili ka të bëjë me marrëdhënien ndërmjet një babai dhe fëmijës së tij. Gjykata e Rrethit nuk duhet të kishte qenë kënaqur vetëm me dëgjimin e dëshirave të fëmijës në lidhje me këtë çështje pa pasur në dispozicion prova nga ana e një eksperti psikolog, me qëllim që të vlerësonte dëshirat e vërteta të fëmijës. Një informacion i saktë dhe i plotë në lidhje me marrëdhënien e fëmijës me kërkuesin ishte një kusht i domosdoshëm paraprak për vlerësimin e dëshirave reale të fëmijës. Moskërkimi i një raporti psikologjik nga ana e gjykatave gjermane në lidhje me mundësitë e vendosjes së kontakteve ndërmjet fëmijës dhe kërkuesit nxori në pah që kërkuesi nuk kishte qenë përfshirë sa duhet në procesin e vendimarrjes. Për këtë arsye, Gjykata vendosi se kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës.

²²⁰ Vendim i GJEDNJ *Sommerfeld kundër Gjermanisë*, datë 03.07.2003.

Në rastin *Hoffman kundër Gjermanisë*,²²¹ GJEDNJ-ja arriti në përfundimin se nuk kishte shkelje të nenit 8 të Konventës në këtë rast. Gjykata vuri në dukje se gjykatat kompetente të brendshme nuk i njohën të drejtën për t'u takuar me fëmijën e vet z.Hoffman. Ato e bazuan vendimin në deklaratat e bëra nga ana e kërkuarit, të nënës së fëmijës, në komentet e Zyrës Mulheim për Fëmijët, në mendimin e ekspertit dhe në veçanti në deklaratat e bëra nga fëmija që ishte pyetur nga Gjykata e Rrethit kur ai ishte 7 vjeç. Gjykatat mbajtën parasysh marrëdhëniet jonormale ndërmjet prindërve dhe konstatuan se çdo kontakt i mëtejshëm do të dëmtonte fëmijën. Gjykata konstatoi se gjykatat gjermane kishin të drejtë ta vlerësonin refuzimin e kontakteve si të nevojshëm dhe se argumentet e tyre për të arritur në këtë përfundim ishin të “të mjaftueshme”, prandaj nuk kemi shkelje të Konventës.

Këto tri raste kanë të bëjnë me ligjin gjerman, tashmë të amenduar, që rregullon kontaktet ndërmjet fëmijëve dhe baballarëve natyrorë të cilët nuk kanë qenë martuar me nënat e këtyre fëmijëve. Në këtë kuadër, kishte një prezumim të vagët në lidhje me të drejtën për kontakt për prindërit e divorcuar ose të ndarë por jo për baballarët e pamartuar, të cilëve iu duhej të hapnin një proces gjyqësor për të siguruar kontakte të tilla.

Të tre këto raste kanë të bëjnë me atë që shumë ekspertë e quajnë “sindroma e përkatësisë prindërore” dhe që është rasti kur një prind që është armiqësuar pandryshueshmërisht me prindin tjetër e kthen edhe fëmijën kundër këtij prindi. Shkelja në themel në lidhje me rastin Sommerfeld u konstatua në lidhje me dështimin e autoriteteve gjermane në kërkimin e një raporti psikologjik, i cili do të mund të kishte vendosur nëse mendimet e shprehura nga ana e fëmijës ishin të sinqerta dhe nuk kishin qenë manipuluar. Në rastin Sahin, shkelja u bazua në mosdëgjimin e fëmijës. Ndërsa në rastin Hoffman Gjykata nuk konstatoi shkelje në thelb të nenit 8 për shkak se sipas saj

²²¹ Vendim i GJEDNJ *Hoffman kundër Gjermanisë*, datë 11.01.2002.

kërkuesi kishte marrë pjesë në mënyrë të mjaftueshme në procesin e vendimmarrjes. Sidoqoftë ajo konstatoi shkelje të këtij neni të marrë së bashku me nenin 14 për shkak se si edhe në rastet e tjera, ai ishte trajtuar në mënyrë më pak të favorshme se sa një baba i divorcuar.

Gjykata ka vlerësuar se bashkëshorti dhe bashkëshortja kanë të drejta të barabarta në lidhje me krijimin e mundësive për të çuar përpara një jetë familjare. Mundësia për të kontribuar në jetën familjare është e barabartë midis burrit dhe gruas. Në disa vendime të saj²²², ajo ka theksuar se një masë joproporcionale dëbimi nga territori i një shteti, pavarësisht shkaqeve legjitime, çon në shkelje të nenit 8. Masat e marra për dëbimin e emigrantëve të paligjshëm të cilët kanë një jetë familjare, përbën cenim të jetës së tyre familjare nëse ato nuk janë proporcionale.

Po ashtu, autoritetet publike, në masat që japin për izolimin e individëve për të cilët dyshohet se kanë kryer një vepër penale, duhet të kujdesen që këto masa të jenë në përputhje me ligjin, të nevojshme në një shoqëri demokratike dhe të jenë në interes të sigurisë publike. Një balancë midis interesit të publikut për rend e siguri dhe së drejtës për jetë familjare të individit duhet mbajtur parasysh. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut²²³ ka vlerësuar se kemi shkelje të së drejtës për jetë familjare, kur autoriteti publik ka vendosur një ndalim të pakufizuar në kohë për të banuar në një vend të caktuar.

E drejta për jetë familjare nuk ekziston mëvetësisht. Ajo në disa raste mund të përplaset me të drejta të tjera të mbrojtura nga Konventa. Një rast i tillë është edhe rasti i abortit të nënës pa pëlqimin e babait. Gjykata²²⁴ në disa vendime të saj ka vlerësuar se babai mund të konsiderohet si vikimë e shkeljes të së drejtës për jetë familjare. Gjykata të referon në ligjin e brendshëm për të kuptuar atë standart të brendshëm shoqëror dhe

²²²Vendim i GjEDNj, datë 28.05.1985; Vendim i GjEDNj *Beldjoudi kundër Francës*, datë 26.03.1992 dhe Vendim i GjEDNj *Boultif kundër Zvicrës*, datë 2.08.2001.

²²³ Vendim i GjEDNj *Radovanovic kundër Austrisë*, datë 22.04.2004.

²²⁴ Vendim i GjEDNj *X kundër Mbretërisë së Bashkuar*, datë 13.05.1980, Vendim i GjEDNj *H kundër Norvegjisë*, datë 19.05.1992 dhe Vendim i GjEDNj *Boso kundër Italisë*, datë 05.09.2002.

ligjor, që e lejon ose jo abortin, për rastin konkret. Në këtë pikë, e drejta për jetë familjare përplaset me të drejtën për jetë private të gruas dhe të drejtën për jetë të fetusit. Gjykata është treguar e kujdesshme që të mos i japë të drejtë përparësie ndonjëres prej të drejtave të mësipërme, por të referohet në standardet e brendshme ligjore për të vlerësuar nëse në rastin konkret ka pasur ose jo shkelje të të drejtave që konfliktohen me njëra-tjetrën.

Në konceptin e jetës familjare futet edhe e drejta e prindërve për t'u kujdesur për edukimin e fëmijëve të tyre. Në rastin kur prindërit janë të pazotë për t'u kujdesur, shteti duhet të marrë masa për caktimin e mënyrës së edukimit të fëmijëve. Detyrimi pozitiv i shtetit duhet të baraspeshohet dhe të jetë proporcional me gjendjen e prindërve. Në rastin kur shteti merr një masë për vendosjen e fëmijës nën kujdestari, ai duhet t'u lërë hapësira vendimmarrëse edhe personave që më parë kishin kujdestarinë e fëmijës, gjithmonë, kjo e vlerësueshme nga rrethanat konkrete.

Gjykata,²²⁵ në rastin e urdhrave emergjentë për kujdestari, përcaktoi se nuk ishte e mundur të merrnin pjesë në vendimmarrje edhe personat që kishin kujdestarinë e fëmijës, për shkak të karakterit urgjent të situatës. Pjesë e vlerësimit të gjykatave kombëtare do të ishte edhe fakti nëse gjendja e personave që kishin kujdestarinë mund të përbente rrezik të menjëhershëm për fëmijën. Gjykata përcaktoi se detyra parësore e autoriteteve publike është mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës. Në një situatë joemergjente dhe kur gjendja e personave që kanë kujdestarinë nuk përbën rrezik për fëmijën, ata mund të marrin pjesë në vendimmarrje për vendosjen e fëmijës në kujdestari. Këtë qëndrim, Gjykata ka pasur edhe në çështjen T.P. dhe K.M kundër Mbretërisë së Bashkuar.²²⁶ Megjithatë, Gjykata ka avancuar edhe më tej, kur shprehet se shtetet anëtare duhet të krijojnë mjete efektive ankimi të cilat duhet të parashikojnë edhe mundësinë e kompensimit, kur vendosja në kujdestari e fëmijës është gjendur e gabuar

²²⁵ Vendim i GjEDNj *K. dhe T. kundër Finlandës*, datë 12.07.2001.

²²⁶ Vendim i GjEDNj *T.P dhe K.M kundër Mbretërisë së Bashkuar*, datë 10.05.2001.

dhe, për pasojë, personat që kanë kujdestarinë kanë të drejtën e zhdëmtimit nga një akt i gabuar i autoriteteve publike. Në të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve, Gjykata ka si qëllim parësor interesin më të lartë të fëmijës.²²⁷ Autoriteti publik duhet të ketë si synim këtë interes, kur merr vendime apo masa që prekin të drejtat e tij dhe jo ndonjë të drejtë tjetër të personave të tjerë që mund të preken në të drejtat e tyre.

2.1. Familja e bazuar në marrëdhënie martesore.

Mbrojtja që sigurohet nga neni 8 gjithmonë shtrihet në marrëdhëniet martesore që mund të shfaqen si të ligjshme dhe të vërteta. Çështja komplikohet kur lidhja e martesës ka vese (rastet e pavlefshmërisë relative) apo martesa ekziston vetëm formalisht. Për shembull, nëse një martesë është fiktive pasi është bërë me qëllim që të shmangë rregullat e emigrimit ose që të merret nënshtetësia, a i përket ajo qëllimit të nenit 8? Në një rast të tillë marrëdhënia e krijuar ndërmjet bashkëshortëve nga kjo martesë nuk konsiderohet se është brenda qëllimit të nenit 8. Një fëmijë i lindur nga prindër që janë të martuar ligjërisht në mënyrë të rregullt do të jetë pjesë e kësaj marrëdhënieje që nga momenti i lindjes së tij. Kështu, marrëdhënia midis prindërve të martuar dhe fëmijëve të tyre do t'i përkasë gjithnjë qëllimit të nenit 8, paragrafi 1.

Neni 8 zbatohet automatikisht në marrëdhëniet midis një nëne dhe fëmijës së saj, pavarësisht nga statusi i saj martesor. Marrëdhënie të tilla gjithnjë do të kërkojnë mbrojtjen e nenit 8. Në praktikë janë hasur probleme lidhur me faktin nëse lidhja e martesës duhet të bazohet vetëm në vullnetin e shfaqur të dy personave që e kërkojnë atë apo martesa u nënshtrohet edhe kushteve të tjera?

E drejta për martesë është e garantuar nga neni 12 i KEDNJ²²⁸. Limitimi i vetëm i kësaj

²²⁷ Vendim i GjEDNj *Pini dhe të tjerë kundër Rumanisë*, datë 22.06.2004.

²²⁸Neni 12 parashikon se: “Burri dhe gruaja, që kanë mbushur moshën për martesë, kanë të drejtë të martohen dhe të krijojnë familje, sipas ligjeve kombëtare që rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte”. Ndërsa neni 5 i Protokollit 7, e zgjeron te drejten e garantuar nga neni 12 i KEDNJ-së, duke u shprehur se: “Bashkëshortët duhet të gëzojnë të drejta të barabarta midis tyre dhe në marrëdhëniet me fëmijët e tyre

të drejte sipas Konventës është gjinia dhe mbushja e moshës ligjore për t'u martuar, e cila referon në “ligjet e brendshme të shtetit që rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte”. Kufizimet e vendosura nga ligjet e brendshme në lidhje me ushtrimin e kësaj të drejte duhet të bëhen vetëm për arsye legjitime, si për shembull ndalimi i martesave poligame apo incestit dhe nuk duhet të tejkalojnë qëllimet ligjore që ato synojnë të arrijnë.

Në çështjen *B dhe L kundër Mbreterisë së Bashkuar*,²²⁹ gjykates iu kërkua të konsideronte ligjshmërinë e rregullit ekzistues në Britaninë e Madhe i cili parandalonte martesën midis vjehrrit dhe nuses së djalit, nëse ish-burri i nuses dhe nëna e tij jetonin. Qëllimi i këtij rregulli ishte mbrojtja e integritetit të familjes nëpërmjet parandalimit të një gare të mundshme seksuale midis prindit dhe fëmijës. Edhe përpara këtij gjykimi në Britaninë e Madhe kishte pasur kërkesa për heqjen e kësaj dispozite, duke qënë se ajo nuk ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë në arritjen e qëllimeve publike. Sidoqoftë, Gjykata konkludoi se një rregull i tillë binte në kundërshtim me nenin 12 të KEDNJ-së. Në një çështje tjetër, një i dënuar me burgim në Angli, i cili më vonë u deportua në Pakistan, ankohej se autoritetet i kishin mohuar atij të drejtën për t'u martuar me shtetasen C. Ajo jetonte në Angli dhe ishte gjithashtu edhe nëna e fëmijës së tij. Sipas informacionit që qeverria angleze kishte në dispozicion në atë kohë rezultonte që në kohën kur atij i ishte mohuar e drejta për t'u martuar, ai kishte një grua me dy fëmijë në Pakistan. Aplikuesi pretendonte se ai ishte ndarë nga gruaja e tij në Pakistan para se të ekstradohej, por kjo u vërtetua vetëm përpara Komisionit dhe pasi ai ishte deportuar. Aplikuesi nuk u kishte bërë të qartë autoriteteve angleze para se të ekstradohej statusin e tij ligjor dhe që nuk ishte i martuar më në Pakistan. Komisioni e hodhi poshtë ankimin si të pabazuar.

E drejta e një çifti të martuar për të krijuar familje mund të kufizohet relativisht nga ndërjegjësimi i shoqërisë për efekt mbipopullimi. Pra, neni 12 nuk përjashton

gjatë martesës dhe në rast ndarje. Ky nen nuk duhet të ndalojë shtetit nga marrja e masave të nevojshme në interes të fëmijëve”.

²²⁹ Vendim i GjEDNJ, datë 13.09.2005, çështja *B dhe L kundër Mbreterisë së Bashkuar*.

mundësinë e ekzistences së rregullave për planifikim familjar brenda një shteti, nga ku kërkesat financiare apo të tjera mund të jenë të tolerueshme për arritjen e planifikimit familjar. Ka pasur disa përpjekje nga aplikues të ndryshëm për të mundësuar që në nenin 8 dhe 12 të përfshihet gjithashtu dhe e drejta për t'u divorcuar. Në çështjen *Johnston*²³⁰ Gjykata konkludoi se e drejta për t'u divorcuar nuk mund të nënkuptohet në nenin 8 apo 12.

Një çështje mjaft interesante e kohëve të fundit është ajo e *H kundër Finlandës*.²³¹ Kërkuesi ka lindur mashkull dhe është martuar me një femër. Bashkëshortët janë bërë me fëmijë në vitin 2002. Kërkuesi iu nënshtrua operacionit të ndryshimit të gjinisë, duke u transformuar në femër. Aplikuesit iu njoh e drejta të ndryshonte emrin, por jo gjininë në kartën e tij të identitetit. Ndryshimi i gjinisë në kartë identiteti do të bëhej vetëm nëse: a) gruaja e aplikuesit prante ta transformonte martesën në bashkëjetesë civile; ose b) bashkëshortët do të zgjidhnin martesën. Si aplikuesi ashtu edhe gruaja e tij dëshironin të ishin të martuar pasi divorci ishte në kundërshtim me bindjet e tyre fetare, ndërsa bashkëjetesa civile nuk ofronte të njëjtat garanci si martesë për fëmijën e tyre.

Në këtë rast, gjykata u shpreh se nuk kemi shkelje të nenit 8 të Konventës. Neni 12 nuk parashikon detyrimin e shteteve kontraktuese të njohin martesat ndërmjet personave të së njëjtës gjini. Neni 8, i cili është një dispozitë më e përgjithshme se neni 12, nuk mund të interpretohet se vendos një detyrim të tillë për shtetet. Kërkuesit (kërkueses) i janë krijuar mundësitë reale që të korrigjojë kartën e identitetit duke e transformuar martesën në bashkëjetesë civile ose duke e zgjidhur martesën. Pra, në këtë rast nuk është cenuar e drejta e identitetit gjinor dhe rrjedhimisht nuk kemi shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së.

Në çështjen *Schalk and Kopf*²³² kundër Austrisë, Gjykata mbajti qëndrimin se neni 12 nuk detyron shtetin austriak të njohë të drejtën e martesës për çiftet e së njëjtës gjini. Si rezultat, nuk kemi shkelje të nenit 12 të Konventës. Gjykata pranoi se marrëdhënia

²³⁰Vendim i GjEDNj, datë 18.12.1986.

²³¹Vendim i GjEDNj, datë 13.11.2012.

²³² Vendim i GjEDNj, datë 24.06.2010.

ndërmjet çifteve të së njëjtës gjini prek jo vetëm të drejtën për jetë private por gjithashtu edhe të drejtën për jetë familjare sipas nenit 8. Marrëdhënia e kërkuesve e cila bazohet në një bashkëjetesë të qëndrueshme, përbën “jetë familjare” në të njëjtën mënyrë që do të konsiderohej për marrëdhënien ndërmjet çifteve me gjini të ndryshme. Megjithatë Konventa duhet të interpretohet si një e tërë. Duke marrë parasysh faktin se neni 12 nuk i detyron shtetet të njohin martesat e çifteve homoseksuale, atëherë ky detyrim nuk mund të rrjedhë nga një nen më i përgjithshëm si neni 8 ose neni 14 i Konventës.

2.2. Bashkëjetesa.

Bashkëjetesa nuk është një kusht i domosdoshëm i jetës familjare pavarësisht nga statusi martesor i prindërve. Kështu, anëtarët e familjes që nuk jetojnë së bashku për shkak të divorcit apo ndarjes me marrëveshje, gjithsesi mund të gëzojnë mbrojtje nga neni 8.

Gjykata²³³ pohon se koncepti “jetë familjare” sipas nenit 8 të KEDNJ-së nuk kufizohet vetëm tek marrëdhëniet e bazuara në martesë, por mund të përfshijë edhe marrëdhënie të tjera familjare *de fakto*, të cilat rrjedhin nga bashkëjetesa. Një fëmijë i lindur si rrjedhojë e kësaj marrëdhënieje është *ipso jure* pjesë e asaj njësie “familjare” që nga çasti i (dhe për shkak) të lindjes. Për rrjedhojë, ekziston midis prindërve dhe fëmijëve një marrëdhënie që krijon jetën familjare.

Në çështjen *Boughanemi kunder Francës*,²³⁴ Gjykata u shpreh se koncepti i jetës familjare mbi të cilën është bazuar neni 8, përfaqëson lidhjen midis një prindi dhe fëmijes së tij. Jeta familjare do të ekzistojë edhe kur nuk ka bashkëjetese, si dhe pavarësisht nga fakti nëse fëmija është “i ligjshëm” apo jo. Kjo lidhje mund të prishet nga ngjarje që mund të ndodhin në të ardhmen, megjithatë do të jemi përpara kësaj situatë vetëm në raste përjashtimore. Duke zbatuar këtë parim, Gjykata u shpreh se marrëdhënia e kërkuesit me djalin e tij, të lindur jashtë martese, i përkiste jetës familjare

²³³ Vendim i GjEDNJ, datë 01.06.2004.

²³⁴ Vendim i GjEDNJ, datë 24.04.1996

brenda kuptimit të asaj klauzole. Në këtë rast, as vonesa e babait për të njohur fëmijën e tij apo dështimi i tij për të mbështetur fëmijën financiarisht, apo vendimi i tij për të lënë fëmijën nën kujdesin e të afërmeve të tij kur emigroi në një nga shtetet e konventës, nuk u konsideruan se përbenin rrethana përjashtuese në këtë kuadër.

Në rrethanat kur një prind krijon probleme në zhvillimin e lidhjeve familjare të prindit tjetër me fëmijën, rasti gëzon mbrojtje nga neni 8, pasi cenohet mundësia potenciale për të pasur jetë familjare. Kjo u diskutua në çështjen *Keegan kunder Irlandes*²³⁵, ku vajza e kërkuessit ishte çuar për adoptim nga nëna e fëmijës pa dijeninë dhe pëlqimin e tij. Si pasojë, ky fakt e kishte privuar të atin nga mundësia për të krijuar lidhje të ngushta personale me vajzën e tij. Prindërit e fëmijës fillimisht kishin bashkëjetuar, kishin planifikuar shtatzaninë dhe kishin si qëllim që të martoheshin. Gjykata u shpreh se jeta familjare që ekzistonte ndërmjet babait dhe fëmijës i përkiste qëllimit të nenit 8, pavarësisht se ata ishin takuar vetëm në një rast të vetëm.

Gjykata për herë të parë pranoi se marrëdhënja ndërmjet çifteve të së njëjtës gjini prek jo vetëm të drejtën për jetë private, por gjithashtu edhe të drejtën për jetë familjare sipas nenit 8. Marrëdhënia e kërkuessve, e cila bazohet në një bashkëjetesë të qëndrueshme, përbën “jetë familjare” në të njëjtën mënyrë që do të konsiderohej për marrëdhënien ndërmjet çifteve me gjini të ndryshme.²³⁶ Në çështjen *Schalk and Kopf kundër Austrisë*, ankuesit, kanë lindur respektivisht në vitin 1962 dhe 1960. Ata janë çift i të njëjtit seks dhe jetonin në Vjenë. Më 10 shtator 2002, aplikantët i kërkuan Zyres së Gjendjes Civile fillimin e formaliteteve për lidhjen e martesës. Me vendimin e datës 20 dhjetor 2002, Zyra refuzoi kërkesën e aplikantëve. Ajo i`u referua nenit 44 të Kodit Civil dhe vendosi se martesë mund të lidhet vetëm ndërmjet dy personave të gjinisë së kundërt. Sipas jurisprudencës së konsoliduar kombëtare, një martesë e lidhur nga dy persona të gjinisë së njëjtë është e pavlefshme. Po ashtu, neni 12 i KEDNJ-së ia njeh të drejtën për

²³⁵ Vendim i GjEDNJ, datë 26.05.1994

²³⁶ Vendim i GjEDNJ, 24.06.2010.

martese personave të sekseve të ndryshme.

Ankuesit pretendonin se pamundësia ligjore për t'u martuar përbënte shkelje në të drejtën e tyre për respektimin e jetës private dhe familjare dhe të parimit të mosdiskriminimit. Ata argumentuan se nocioni i martesës ka evoluar që nga hyrja në fuqi e Kodit Civil në vitin 1812. Në perceptimin e sotëm, martesë është më tepër një bashkim i përhershëm që përfshin të gjitha aspektet e jetës. Nuk kishte asnjë arsye objektive për përjashtimin nga martesë e çiftëve të të njëjtit seks. Sipas tyre, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka pranuar se për dallimet në bazë të orientimit seksual, duhet të ekzistojnë arsye veçanërisht të rënda. Vendet e tjera evropiane kanë lejuar martesat homoseksuale ose kanë ndryshuar legjislacionet e tyre për t'i dhënë status të barabartë partnerëve të të njëjtit seks.

Sipas GJEDNJ-së, neni 12 siguron të drejtën themelore të një burri dhe një gruaje të martohet dhe të krijojë familje. Ushtrimi i kësaj të drejte është objekt i ligjeve kombëtare të shteteve kontraktuese, por kufizimet nuk duhet të cenojnë këtë të drejtë në atë masë sa të cenohet thelbi i së drejtës. Gjykata vëren se formulimi i nenit 12 mund të interpretohet në mënyrë që të mos përjashtojë martesën ndërmjet dy burrave apo dy grave. Në këtë përfundim ajo arrin duke iu referuar edhe *Kartës të të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian*. Në krahasimin e nenit 12 të Konventës me nenin 9 të Kartës, GJEDNJ-ja ka vërejtur se Karta qëllimisht ka referuar në ligjet kombëtare. Në të njëjtën kohë, referenca në ligjin e brendshëm pasqyron shumëllojshmërinë e rregullave kombëtare, të cilat kanë tendencë të shkojnë në lejimin e martesës së personave të të njëjtit seks. Në përputhje me nenin 9 të Kartës mund të thuhet se nuk ka asnjë pengesë për të njohur martesat e personave të të njëjtit seks. Gjithsesi, ky nen nuk kërkon që ligjet kombëtare duhet të lejojnë martesë të tilla.

Për këtë arsye, duke pasur parasysh nenin 9 të Kartës, GJEDNJ-ja nuk do ta interpretojë të drejtën për t'u martuar sipas nenit 12, se ajo duhet të kufizohet vetëm në martesën

mes dy personave të gjinisë së kundërt. Rrjedhimisht, nuk mund të thuhet se neni 12 është i pazbatueshëm për kërkesën e ankuesve. Pra, çështja nëse do të lejohen apo jo martesat mes homoseksualëve është lënë në rregullimin nga ligji kombëtar i shtetit kontraktues. Në përfundim, Gjykata konstaton se neni 12 i Konventës nuk imponon detyrimin e qeverisë së paditur për t'i dhënë një çifti të të njëjtit seks të drejten për martesë. Si pasojë, nuk ka pasur shkelje të nenit 12 të Konventës.

Në lidhje me shkeljen e pretenduar të nenit 14, ai merret në lidhje me nenin 8 të Konventës. Gjykata ka mbajtur parasysh faktin që neni 14 plotëson dispozitat e tjera thelbësore të Konventës dhe protokolleve të saj. Është i padiskutueshëm në këtë rast që marrëdhëniet e një çifti të të njëjtit seks, si ajo e aplikantëve, bëjnë pjesë në nocionin e "jetës private" të nenit 8. Megjithatë, në dritën e komenteve të palëve Gjykata e gjen të përshtatshme për ta adresuar çështjen nëse marrëdhëniet e tyre përbëjnë "*jetë familjare*". Për rrjedhojë, Gjykata konkludon se faktet e çështjes në fjalë bien në nocionin e "jetës private" si dhe "jetës familjare" brenda kuptimit të nenit 8. Si pasojë, neni 14 i marrë në lidhje me nenin 8 zbatohet. Gjykata në jurisprudencën e saj ka mbajtur qëndrim konstant se në mënyrë që një rast të konsiderohet se është në kushtet e nenit 14, duhet të ketë një ndryshim në trajtimin e personave në situata të ngjashme apo të njëjta, ose një trajtim të njëjtë të personave në situata të ndryshme. Trajtimi është diskriminues, nëse nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm të mbështetur në ligj. Shtetet kontraktuese gëzojnë një marzh vlerësimi në përcaktimin e situatave që i konsiderojnë të njëjta, të ngjashme ose të ndryshme.

Në funksion të evolucionit të shoqërisë, Gjykata e konsideron artificial qëndrimin se, në kontrast nga një çift i sekseve të ndryshme, një çift i të njëjtit seks nuk mund të gëzojë "*jetë familjare*" për qëllimet e nenit 8. Si pasojë, marrëdhëniet e aplikantëve, të cilët bashkëjetojnë në një lidhje të qëndrueshme *de facto*, bie në nocionin e "jetës familjare", ashtu si lidhja e një çifti me gjini të ndryshme në të njëjtën situatë. Në përfundim,

Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të nenit 14 të Konventës të marra në lidhje me nenin 8. Kjo çështje paraqet rëndësi, jo vetëm për faktin se për herë të parë u pranua se marrëdhënia ndërmjet çifteve të së njëjtës gjini përbën “jetë familjare”, por edhe për faktin se GJEDNJ-ja iu referua drejtpërdrejtë Kartës së BE-së për të interpretuar Konventën.

2.3. Jeta familjare dhe mungesa e lidhjeve të gjakut.

Në marrjen e vendimit nëse ekziston jeta familjare, Gjykata vë qartësisht theksin në kushtet sociale më shumë sesa në ato biologjike të një shtate të caktuar. Për sa më sipër, konkludoi se jeta familjare ekzistonte edhe ndërmjet personave që nuk kishin lidhje gjaku me njëri-tjetrin. Në çështjen *X, Y & Z kundër Mbretërisë së Bashkuar*,²³⁷ Gjykata u shpreh se marrëdhënia midis një çifti transeksual (femra) dhe femijes së tyre të lindur nga inseminimi artificial nga një dhurues përbën jetë familjare. Në arritjen e një konkluzioni përfundimtar Gjykata shpalli si të rëndësishëm, së pari faktin se marrëdhënia e tyre nuk ndryshonte nga jeta familjare që gëzonin familjet tradicionale, dhe së dyti, se çifti transeksual mori pjesë në procesin e inseminimit artificial në rolin e babait të fëmijës gjithashtu.

Mungesa e një lidhjeje biologjike nuk përjashton faktin që marrëdhënia mund t’i përkasë jetës familjare, thjesht një lidhje gjaku apo gjenetike duket se nuk është e mjaftueshme për këtë qëllim. Kështu, marrëdhënia midis një dhuruesi sperme dhe fëmijës së lindur si rezultat i përdorimit të saj, normalisht nuk përbën jetë familjare sipas nenit 8. Në këtë rast, përjashtohet situata kur ka prova të mjaftueshme të ekzistencës së lidhjeve të tyre të ngushta personale.

Gjykata vendos për ekzistencën apo jo të jetës familjare në lidhje me llojet e tjera të marrëdhënieve bazuar në faktet e secilës çështje. Për sa i përket familjes së zgjeruar dhe llojeve të tjera, kategoritë janë, si më poshtë: jeta familjare mund të ekzistojë midis

²³⁷Vendim i GjEDNJ, datë 22.04.1997.

fëmijëve dhe gjyshërve të tyre duke qenë se ata luajnë një “rol të rëndësishëm në jetën familjare”. Lidhjet farefisnore, si fëmijët, ashtu edhe të rriturit gjithashtu i përkasin kuptimit të jetës familjare. Marrëdhënia midis një xhaxhai ose tezeje me nipin apo mbesën e tij mund t’i përkasë kuptimit të jetës familjare, kur ka prova të dukshme të lidhjeve të ngushta personale. Kështu, në çështjen *Boyle kundër Mbretërisë së Bashkuar*²³⁸, u gjet që ekzistonte jeta familjare midis xhaxhait dhe nipit të tij në bazë të faktit që djali qëndronte për fundjavë me xhaxhain e tij, i cili ishte konsideruar nga autoritetet vendase se ishte “nje figurë e mirë prindërore” për djalin. Jeta e familjes mund të ekzistojë midis prindërve dhe fëmijëve të lindur nga marrëdhënie jashtëmartesore, ose ndërmjet fëmijëve të lindur si rezultat i një marrëdhënieje jashtëmartesore, apo tradhëtie bashkëshortore, veçanërisht kur atësia e fëmijëve është njohur dhe kur palët gëzojnë lidhje të ngushta personale. Marrëdhënia midis prindërve adoptues dhe fëmijëve në parim mbrohet nga nenit 8. Nëse lidhja midis fëmijes dhe prindërve të tij që e kanë nën kujdestari rezulton një jetë familjare, kjo do të varet në veçani nga lidhjet e ngushta personale të fëmijës me prindërit e tij natyralë dhe nga kohëzgjatja kur ai ka qenë nën kujdesin e familjes që e ka marrë përsipër. Sa më e gjatë të jetë marrëdhënia e kujdestarisë, aq më shumë ka gjasa që të konsiderohet se ekziston lidhja familjare.

Me krijimin e jetës së familjes ajo nuk përfundon kur zgjidhet martesë, ose kur palët nuk jetojnë më së bashku, apo kur merret vendimi për të çuar fëmijën nën kujdestari. Megjithëse, ngjarjet e mëvonshme të jetës familjare midis një xhaxhai dhe nipit, adoptimi ose dëbimi, mund të prishin lidhjen e jetës së familjes, Gjykata ka vendosur që kjo mund të ndodhë vetëm në rrethana përjashtuese.

²³⁸ Vendim i GjEDNj, datë 09.02.1993, çështja *Boyle kundër Mbretërisë së Bashkuar*.

2.4. Mbrojtje e posaçme e fëmijëve dhe Konventa e Hagës mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve.

GJEDNJ-ja²³⁹ është shprehur në të gjitha çështjet, që kanë të bëjnë me të mitur, duhet mbajtur parasysh interesi më i lartë i fëmijës. Këto interesa nuk janë të njëjta me interesin e prindit. Gjykata në këtë aspekt i ka dhënë një rol të veçantë Konventës së Hagës mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve, për rastet që kanë të bëjnë me të. Ajo ka qartësuar se neni 8 i KEDNJ-së duhet të interpretohet nën dritën e Konventës së Hagës së vitit 1980, me kusht që shteti ta ketë ratifikuar atë. Mospërbushja e detyrimeve të Konventës së Hagës përbën shkelje të së drejtës për jetë familjare²⁴⁰. Madje, veprimi me shpejtësi dhe kujdesin e duhur të autoriteteve shtetërore sipas përcaktimeve të bëra nga Konventa e Hagës, është detyrim në kuadër të përmbushjes së detyrimeve për jetë familjare sipas nenit 8 të KEDNJ-së²⁴¹.

Në çështjen *Bianchi kundër Zvicrës*²⁴², përveç se konsolidohet interpretimi i së drejtës për jetë familjare në përmbushje të detyrimeve të Konventës së Hagës, Gjykata vlerëson edhe mënyrën e përmbushjes së këtyre detyrimeve. GJEDNJ-ja arriti në përfundimin se kemi shkelje të nenit 8 nga Zvicra, pasi ajo ka dështuar në marrjen e *masave të nevojshme* për të përmbushur në mënyrë efektive qëllimin dhe objektivat e marrë përsipër sipas Konventës së Hagës së vitit 1980. Kërkuesi ka qenë shtetasi S.B, një 44-vjeçar me shtetësi italiane dhe vendbanim në Itali. Në 26 qershor 1988 ai u martua me E.H në Itali, i cili ishte edhe vendi i banesës së përbashkët. Në 28 nëntor 1999 E.H lindi një djalë. Në qershor të vitit 2002 ata u divorcuan dhe E.H, pa u caktuar ende lënia e fëmijës për rritje dhe edukim, e morri atë në Zvicër pa autorizimin e S.B-së.

Në 2 shkurt 2003 Gjykata e Rrethit në Pistoia (Itali), vendosi dhënien e kujdestarisë

²³⁹Vendim i GjEDNJ, datë 26.11.2013.

²⁴⁰Vendim i GjEDNJ, datë 25.01.2000.

²⁴¹Vendim i GjEDNJ, datë 26.06.2003.

²⁴² Vendim i GjEDNJ, datë 12.06.2008.

vetëm babait të fëmijës S.B. Më 30 shtator 2002, S.B u kërkoi autoriteteve zviceriane rikthimin e fëmijës në Itali, sipas Konventës së Hagës “Mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës”. Më 23 prill 2003 Gjykata Federale e Zvicrës urdhëroi kthimin e fëmijës në Itali. Fëmija dhe nëna u kthyen në Itali dhe fëmija iu rikthye babait.

Gjatë kohës që fëmija kishte shkuar të takonte nënën (23 dhjetor 2003), kjo e fundit e merr djalin dhe nuk e kthen më atë, duke u larguar edhe nga vendbanimi i deklaruar. Më 6 janar 2004 S.B, duke u bazuar te Konventa e Hagës, i kërkoi Gjykatës së Rrethit në Willsau, rikthimin e djalit. Në 7 janar 2004, gjykata vendosi mbajtjen e fëmijës në Zvicër deri në përfundimin e procesit të rikthimit të fëmijës. Nuk u morr asnjë vendim mbi të drejtën e takimit të fëmijës me babain.

Më 14 prill, me kërkesë të S.B, gjykata e Willsau i njohu të drejtën atij për takimin e fëmijës 4 orë në javë. Më 3 maj kjo Gjykatë refuzoi kërkesën e S.B për kthimin e fëmijës në Itali, pasi ajo mori në konsideratë mundësinë e mungesës së përshtatjes së fëmijës nëse do të kthehej në Itali si dhe faktin se ai kishte lidhje më të ngushta me nënën sesa me babain. Ky vendim u apelua nga S.B. Gjykata e Apelit e Kantonit të Lucernës vendosi kthimin e fëmijës në Itali brenda datës 31 korrik 2004. Nëna e fëmijës e apeloj këtë vendim për shkelje të rendit publik. Sipas raportit të datës 27 gusht 2004 nga autoritetet mbikëqyrëse, u konstatua se: “në të nënta taktimet e ndodhura nga 24 prilli – 18 korrik 2004, rezultoi se S.B i ka përmbushur të gjitha kushtet e vendosura nga Gjykata e Rrethit”.

Më 15 gusht, E.H u paraqit vullnetarisht në polici ku deklaroi se ajo refuzonte të zbulonte vendndodhjen e fëmijës. Ajo konfirmonte se djali i saj gëzonte shëndet të mirë dhe ai ishte i lumtur që do të qëndronte me të. Gjithashtu deklaroi se do t’i bindej çdo vendimi që do të merrte Gjykata e Apelit. Pas kësaj interviste që zgjati 40 minuta, oficerët e policisë e lejuan E.H-në të largohej. Nga shtatori 2004 e në vazhdim,

autoritetet e Kantonit të Lucernës morën disa masa për të gjetur E.H dhe fëmijën, duke përfshirë kërkimin në vendbanimin e fundit dhe rrethinat, hetimet në bankë dhe postë, përgjimet telefonike etj. Kërkuesi pretendoi për shkelje të nenit 8 nga autoritetet zvicerane, pasi nuk kishin përmbushur detyrimet sipas Konventës së Hagës. Gjykata vlerësoi se refuzimi i nënës së fëmijës për t'ia kthyer fëmijën S.B, pas përfundimit të afatit të takimit, bie në kundërshtim me Konventën e Hagës. Për të përcaktuar nëse kemi shkelje të nenit 8, GJEDNJ-ja vendosi të analizojë faktet sipas detyrimeve të parashikuara nga Konventa e Hagës.

Gjykata ngriti dyshime mbi saktësinë e vendimit të Gjykatës së Rrethit të Willsau-t, e cila urdhëroi mbajtjen e fëmijës në Zvicër deri sa të përfundonte gjykimi mbi rikthimin e fëmijës në Itali. Duke marrë parasysh se ky gjykim kishte të bënte deri diku me vlerësimin e situatës së krijuar nga veprimi ilegal i E.H në rrëmbimin e fëmijës, i cili kishte ndodhur edhe më parë. Gjithashtu Gjykata e Willsau-t, në vendimin e 7 janarit 2004, nuk arsyeton pse në rastin konkret aplikohet neni 13 i Konventës së Hagës. GJEDNJ-ja, vuri në dyshim nëse vendimi i Gjykatës së Willsau-t për të kryer një hetim të ri ishte i përshtatshëm, duke marrë parasysh faktin se Gjykata Federale Zvicerane kishte hetuar e kishte vendosur një herë për këtë çështje rreth 9 muaj më parë (në 23 Prill 2003). Gjykata theksoi se: “as autoritetet e Kantonit të Lucernës as qeveria zvicerane nuk kishin pretenduar ndryshime të rëndësishme të rrethanave, të cilat do të çonin në nevojën e rivlerësimit të situatës ligjore të vendosur nga gjykatat italiane dhe zvicerane. Duhet marrë në konsideratë edhe fakti që Gjykata e Willsau-t nuk vendosi të drejtën e kërkuesit për takimin e fëmijës gjatë kohës që do të vazhdonte gjyqi. Kjo e drejtë iu njoh kërkuesit vetëm pas kërkesës së tij. Gjykata e Willsau-t mori vendim pasi kishin kaluar 4 muaj nga kërkesa e S.B. Ky fakt duhet parë i lidhur me nenin 11 të Konventës së Hagës, i cili kërkon që autoritetet administrative dhe gjyqësore duhet të veprojnë veçanërisht shpejt në çështjet që kanë të bëjnë me kthimin e fëmijëve.”.

Gjykata vë në dukje se: “ishte e paarsyeshme lënia e lirë e nënës së fëmijës nga oficeri i policisë pas deklaratës që ajo dha në polici (më 15 gusht 2004), duke marrë parasysh faktin se ndaj saj ishte dhënë më parë një vendim gjyqësor për rrëmbim të të miturit.”. Gjykata arriti në përfundimin se: “autoritetet e Kantonit të Lucernës, nga shtatori 2004 e në vazhdim, kanë ndërmarrë një sërë masash për të gjetur vendodhjen e nënës dhe të fëmijës. Megjithatë, mënyra e veprimit të tyre nga rrëmbimi i fëmijës deri në kontaktin e tyre të fundit me nënën më 15 gusht 2004 ka qenë jo e kujdesshme. Këto veprime jovigjilente të autoriteteve shtetërore janë në kundërshtim me objektin dhe qëllimin e Konventës së Hagës, si dhe me parashikimet e saj, të cilat janë të qarta dhe rigoroze. Gjykata konkludoi se të drejtat e kërkuarit për t’u respektuar e drejta për jetë familjare, nuk janë garantuar në mënyrë efektive sipas KEDNJ-së. Si rezultat, ka pasur shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së.”. Në disa çështje rradhazi, GJEDNJ-ja ka elaboruar kuptimin e interesit më të latë të fëmijës, në rastet e zbatimit të Konventës së Hagës. Në çështjen *Neulinger dhe Shuruk*,²⁴³ GJEDNJ-ja, theksoi se, gjykatat kombëtare duhet të vepronin duke analizuar në thellësi situatën e familjes në tërësi. Ato duhet të vlerësonin të gjithë faktorët faktikë, emocionalë, psikologjikë, materialë duke balancuar e vlerësuar interesat e çdo anëtari të familjes. Në këtë çështje kërkuarit janë Isabelle Neuglinger dhe djali i saj Noam Shuruk. Ata janë shtetas zviceranë dhe jetojnë në Lausanne (kanton i Zvicrës). Kërkuarit kanë lindur respektivisht më 1959 dhe 2003. Në vitin 1999 Znj. Neulinger u zhvendos në Izrael, ku u martua me Shai Shuruk në vitin 2001. Djali i tyre lindi në vitin 2003. Isabelle Neuglinger pati frikë se djali i saj do të ndiqte nëpërmjet të atit lëvizjen “Chabad-Lubavitch”, e cila sipas saj ishte ultra-orthodokse, raciste dhe fetare. Për këtë arsye, ajo bëri kërkesë në Gjykatën e Tel Aviv, e cila, në vitin 2004, vendosi ndalimin e zhvendosjes së Noam nga vendi deri sa ai të bëhej maxhoren. Nënës iu njoh kujdestaria e përkohshme e fëmijës, ndërsa përgjegjësia

²⁴³ Vendim i GJEDNJ, datë 6.07.2010.

prindërore do të ushtrohej nga të dy prindërit bashkarisht. Të drejtat e babait për takim u kufizuan duke marrë parasysh sjelljen e tij.

Në shkurt 2005, znj. Neuglinger dhe z. Shuruk u divorcuan. Në qershor të këtij viti nëna u largua së bashku me fëmijën në Zvicër. Më 30 maj 2006, Gjykata e Tel Aviv, mbi kërkesën e babait të fëmijës vërejti se fëmija e kishte vendqëndrimin në Tel Aviv dhe prindërit gëzonin të drejtën e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore së bashku. Ajo vendosi se zhvendosja e fëmijës nga Izraeli pa pëlqimin e babait ishte i kundërligjshëm sipas neni 3 të Konventës së Hagës²⁴⁴. Me vendimin e 29 gushtit 2006, Gjykata e Rrethit të Lausanne (Zvicër) rrëzoi kërkesën e babait të fëmijës për kthimin e tij në Izrael. Sipas kësaj gjykate, ekzistonte risku se nëse fëmija do të kthehej në Izrael ai do të pësonte dëm psikologjik ose do të vendosej në një situatë shumë të vështirë. Gjykata e Kantonit të Vaud rrëzoi ankimin e babait, duke konfirmuar se rasti konkret bënte përjashtim nga parimi i kthimit të menjëhershëm të fëmijës, sipas nenit 13 , paragrafi (b), i Konventës së Hagës²⁴⁵.

Më 16 gusht 2007 Gjykata Federale e Zvicrës pranoi ankimin e babait, me arsyetimin se neni 13 i Konventës së Hagës ishte interpretuar gabim dhe urdhëroi z. Neulinger ta kthente fëmijën në Izrael.

²⁴⁴ Neni 3 i Konventës së Hagës: “Largimi ose mbajtja e një fëmije konsiderohet e padrejtë në rastet kur: a. konsiston në shkeljen e të drejtave të kujdestarisë që i janë dhënë një personi, një institucioni apo organi tjetër, qoftë kolektivisht apo individualisht, sipas ligjit të shtetit në të cilin fëmija ka qenë banor i zakonshëm para largimit apo mbajtjes; dhe b. në kohën e largimit apo mbajtjes këto të drejta janë ushtruar, qoftë kolektivisht apo individualisht, ose që mund të kenë qenë ushtruar me përjashtim të largimit apo mbajtjes.”

²⁴⁵ Neni 13 i Konventës së Hagës parashikon: “Pavarësisht nga dispozitat e nenit të mësipërm, autoriteti gjyqësor apo administrativ i shtetit të kërkuar nuk është i detyruar të urdhërojë kthimin e fëmijës, nëse personi, institucioni apo organi tjetër që e kundërshton kthimin ose mbajtjen e tij, vendos që: a) personi, institucioni apo organi tjetër që kujdeset për fëmijën nuk po ushtronin të drejtat e kujdestarisë në kohën e largimit apo mbajtjes ose kanë rënë dakord, ose si rrjedhojë të kenë pranuar në heshtje largimin apo mbajtjen; ose b) ekziston një rrezik serioz që kthimi i tij ose i saj ta ekspozojë fëmijën ndaj dëmit fizik ose psikologjik, ose ta vërë fëmijën para një situatë të patolerueshme. Autoriteti gjyqësor ose administrativ mund të refuzojë të urdhërojë kthimin e fëmijës, nëse zbulon se fëmija kundërshton të kthehet dhe ka arritur një moshë dhe një shkallë pjekurie, sipas së cilës është në gjendje të vendosë vetë për jetën e vet. Në marrjen parasysh të rrethanave që i referohen këtij neni, autoritetet gjyqësore dhe administrative do të marrin në konsideratë informacionin në lidhje me prejardhjen sociale të fëmijës, të siguruar nga autoriteti qendror ose ndonjë autoritet tjetër kompetent i vendbanimit të zakonshëm të fëmijës”.

Dhoma e Madhe e GJEDNJ-së konstatoi se nëna e Noam- it e ka zhvendosur atë nga Izraeli në mënyrë të “jashtëligjshme”. Sipas ligjit izraelit parimi i përgjegjësisë prindërore, i cili përfshin edhe të drejtën për të vendosur për vendbanimin e fëmijës, është i krahasueshëm me të drejtën e kujdestarisë sipas Konventës së Hagës. Këto të drejta janë shkelur, sepse ushtrimi i përgjegjësisë prindërore u përkiste të dy prindërve bashkarisht.

Për të përcaktuar nëse është vendosur një balancë e drejtë ndërmjet interesave të palëve, përkatësisht atyre të fëmijës, të prindërve dhe të rendit publik, duhet të mbajmë parasysh se duhet të prevalojë interesi më i lartë i fëmijës. Interesi më i lartë i fëmijës është koncept qendror në Konventën e Hagës. Kjo Konventë kërkon parimisht kthimin e menjëhershëm (ose të shpejtë) të fëmijës të rrëmbyer, përveç kur kthimi i tij do të kishte rrezik ta dëmtonte atë psikologjikisht ose fizikisht”. Gjykata vuri në dukje se: “në lidhje me këtë çështje gjykatat kombëtare kanë mbajtur qëndrime të ndryshme, fillimisht e kanë rrëzuar ndërsa më pas e kanë pranuar ankimin e babait të fëmijës. Sipas raportit të ekspertëve në rast se Noam do të kthehej në Izrael, ai duhej domosdoshmërisht të shoqërohej nga nëna e tij, pasi në të kundërt ekzistonte një rrezik i madh që fëmija të pësonte tronditje të mëdha. Konventa e Hagës përbën një instrument me natyrë procedurale dhe jo një traktat për të drejtat e njeriut. Noam është shtetas zviceran dhe ka ardhur të jetojë në Zvicër që në moshën 2-vjeçare. Sipas kërkuesve ai është përshtatur mjaft mirë në Zvicër, di të flasë vetëm frëngjisht, si dhe ka filluar të ndjekë shkollën”.

Sipas dhomës së GJEDNJ-së, megjithëse ai ishte përshtatur në Zvicër, djali ishte vetëm 7 vjeç, moshë në të cilën ai ka kapacitet të përshtatet. Dhoma e Madhe vlerëson se: *“edhe pse është dakord me vlerësimin e dhomës, përsëri zhvendosja e djalit në Izrael mund të sillte pasoja serioze për të”*.

Sipas dokumenteve të dërguara nga autoritetet izraelite, ekzistonte mundësia që nëna e fëmijës të ndiqej penalisht. “Nëse z. Neulinger do të burgosej, kjo situatë nuk do të ishte

në interesin më të lartë të fëmijës, pasi nëna ishte i vetmi person me të cilin fëmija ishte i lidhur. Për këto arsye, refuzimi i z. Neulinger për t'u kthyer në Izrael, nuk ishte i pajustificuar". Duke marrë në konsideratë të gjitha këto vlerësime, veçanërisht zhvillimet më të fundit sipas vendimit të vitit 2009. GJEDNJ-ja nuk u bind se: "do të ishte në interesin më të lartë të fëmijës të kthehej në Izrael. Përsa i përket nënës, ajo do të pësonte një ndërhyrje disproporcionale në të drejtën e saj për respektimin e jetës familjare, nëse ajo do të kthehej në Izrael. Rrjedhimisht, GJEDNJ-ja, vlerëson se kemi shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së".

Një rast tjetër ku GJEDNJ-ja, është shprehur se si duhet të kuptohet dhe të zbatohet interesi më i lartë i fëmijës është çështja *X kundër Letonisë*²⁴⁶ Kërkesja X është shtetase nga Letonia. Ajo mban edhe nënshtetësinë australiane dhe jeton në Australi. Në vitin 2004, ndërkohë që jetonte në Austali dhe ishte e martuar, kërkesja filloi bashkëjetesën me një burrë tjetër T. Në vitin 2005 ajo lindi një vajzë, në certifikatën e së cilës nuk shënohej atësia. Si rezultat i marrëdhënieve të këqia, kërkesja në 2008 largohet nga Australia dhe shkon në Letoni së bashku me vajzën e saj 3 vjeçe e 5-muajshe.

Pas largimit të X, T-ja aplikojë për njohjen e atësisë së fëmijës dhe gjykatat familjare australiane njohën atësinë e T për fëmijën dhe vendosën përgjegjësinë e përbashkët prindërore që nga lindja e fëmijës. Në zbatim të Konventës së Hagës, autoritetet australiane dëgjuan kërkesë autoriteteve homologe në Letoni për kthimin e fëmijës në Australi. Në vitin 2008, Gjykata e Shkallës së Parë vendosi se lëvizja e fëmijës nga shteti australian në Letoni ishte i paligjshëm pasi nuk ishte marrë pëlqimi i T-së, të drejtat prindërore të të cilit ishin njohur nga gjykata australiane.

Kërkesja e apeloj vendimin duke pretenduar se nuk ishin marrë parasysht lidhja që ekzistonte ndërmjet fëmijës dhe shtetiti të Letonisë; ankesa në lidhje me sjelljen e T;

²⁴⁶ Vendim i GjEDNj, datë 26 Nëntor 2013.

mungesa e informacionit në lidhje me kushtet në rast se vajza do të kthehej në Australi. Për të mbështetur pretendimet e saj ajo paraqiti një akt ekspertimi të psikologut i cili konstatonte se: “ndarja e menjëhershme e fëmijës nga nëna do t’i shkaktonte fëmijës traumë psikologjike”. Gjithashtu, kërkuesja pretendoi se Konventa e Hagës nuk mund të aplikohet pasi në kohën që fëmija ishte larguar nga Australia, T nuk ishte babai i saj, kështu që nuk ishte i domosdoshm pëlqimi i tij.

Gjykata e shkallës së parë e rrëzoi kërkesën. Gjykata e apelit në Letoni u shpreh se: “njohja e atësisë dhe e përgjigjesisë prindërore ishte bërë nga një gjykatë australiane dhe gjykatat e Letonisë nuk kishin kompetencë të shqyrtonin këtë vendim. Akti i ekspertimit nuk mund të merrej në shqyrtim pasi ai kishte të bënte me çështjen e vendosjes së kujdestarisë dhe jo me çështjen konkrete. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë u la në fuqi”.

GJEDNJ-ja u shpreh se: “Në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me të mitur, duhet mbajtur parasysh interesi më i lartë i fëmijës. Këto interesa nuk janë të njëjta me interesin e prindit, i cili kërkon kthimin e fëmijës sipas Konventës së Hagës. Të drejtat e prindit duhet të interpretohen sipas qëllimit që ka dashur të arrijë Konventa e Hagës, sidomos çështjet që kanë të bëjnë me vlerësimin e (nenit 12) dhe ekzistencën e “rrezikut serioz” (neni 13/b).

Në mënyrë që të mos cenohen të drejtat e parashikuara nga neni 8 i KEDNJ-së duhet të vlerësohet e gjithë situata e familjes. Pra, në njërin anë, duhet të vlerësohen pretendimet e “rrezikut serioz”, që mund të pësojnë fëmijët në rast të kthimit, dhe nga ana tjetër, duke marrë të gjitha provat për t’u bindur se ekzistojnë garanci të mjaftueshme për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në shtetin ku do të kthehet”. Gjykata arriti në konkluzionin se: “Me refuzimin e aktit të ekspertimit psikologjik, i cili paraqeste ekzistencën e mundshme të “rrezikut serioz” për fëmijën sipas nenit 13(b) të Konventës së Hagës, autoritetet e Letonisë kanë shkelur detyrimet e parashikuara nga neni 8 i

Konventës”.

Gjykata arriti në përfundimin se: “Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Konventa e Hagës për Çështjet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve (25 Tetor 1980) duhet të zbatohen në mënyrë të harmonizuar me njëra-tjetrën në mënyrë që të mbrohen interesat më të lartë të fëmijës. Në çështjen konkrete, gjykatat e Letonisë nuk kanë përmbushur detyrimet që rrjedhin nga neni 8, pasi ato kanë refuzuar të vlerësojnë një pretendim të arsyeshëm për “risqe serioze” të fëmijës në rast se ai do të kthehej në Australi”.

GJEDNJ-ja ka vlerësuar se megjithëse Konventës së Hagës i është njohur një vend qendror nga Gjykata, kjo e fundit duhet të interpretohet ose udhëhiqet nga detyrimet e vendosura sipas KEDNJ.²⁴⁷ Në disa raste, kur shteti ka zbatuar Konventën e Hagës pa marrë në konsideratë parashikimet e KEDNJ-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, Gjykata ka konstatuar keqpërdorimin e Konventës së Hagës nga autoritetet shtetërore sipas nenit 8 të KEDNJ-së. Në çështjen *Monory*²⁴⁸ kërkuesi G.M është shtetas hungarez. Në 1994 ai u martua me C.M, e cila ka dynënshtetësi, përkatësisht atë rumune dhe hungareze. Në shkurt të vitit 1995 vajza e tyre V lindi. Në dhjetor të vitit 1998 ata vizituan familjen e C.M në Rumani. Kërkuesi u kthye në Hungari, ndërsa CM qëndroi në Rumani me V. dhe i premtoi atij se do të kthehej në Hungari brenda 30 janarit 1999. Më 4 Janar, C.M (nëna e fëmijës) ngriti padi në gjykatën e Satu Mare (Rumani) për zgjidhje martese dhe lënien e fëmijës për rritje dhe edukim. Në 8 tetor të vitit 2003, Gjykata e Satu Mare vendosi lënien e fëmijës C.M dhe të drejtën e takimit për G.M. Gjatë kësaj kohe, kërkuesi më 20 janar 1999 paraqiti kërkesë për kthimin e vajzës në Hungari, sipas nenit 3 të Konventës së Hagës. Më 2 shkurt 2000, Gjykata e Apelit Oradea rrëzoi kërkesën e tij duke argumentuar se ishte në interesin më të lartë të fëmijës të qëndronte me nënën. Paralelisht në 28 prill 1999 G.M kërkoi lënien e fëmijës për

²⁴⁷Vendim i GjEDNj, datë 29.04.2003.

²⁴⁸ Vendimi i GjEDNj, datë 5.04.2005.

rritje dhe edukim. Në 8 tetor 2003 gjykata ia la fëmijën nënës C.M.

GJEDNJ-ja ka vlerësuar se: “Detyrimet pozitive të vendosura mbi shtetet nga neni 8 i KEDNJ-së përfshijnë edhe marrjen e masave për t’i siguruar prindërve ribashkimin me fëmijën”. Gjykata nëpërmjet një jurisprudence të qëndrueshme ka theksuar se këto detyrime pozitive të shtetit duhen interpretuar nën dritën e Konventës së Hagës. Gjykata vlerëson se: “Autoritetet kanë dështuar të përmbushin detyrimet e tyre sipas nenit 7 të Konventës së Hagës dhe mënyra e interpretimit të garancive nga gjykatat kombëtare të Konventës së Hagës shkakton shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së.

Këto çështje kërkojnë zgjidhje urgjente dhe kalimi i kohës ka pasoja të pakthyeshme në lidhje me marrëdhëniet midis fëmijës dhe prindit me të cilin ai nuk jeton. Neni 11 i Konventës vendos se periudha maksimale e marrjes së vendimit është 6 javë. Organi procedues çdo vonesë tej këtij afati duhet ta justifikojë. Në kundërshtim me natyrën urgjente të çështjes, autoriteteve iu desh 12 muaj për të marrë një vendim mbi kërkesën e G.M, për rikthimin e fëmijës. Asnjë shpjegim i arsyeshëm nuk u paraqit nga autoritetet shtetërore për këtë vonesë”.

Gjykata ripërsëriti se: “Interesi më i lartë i fëmijës mbizotëron në këto çështje.”

GJEDNJ-ja vuri në dukje se: “Gjykatat vendase refuzuan kërkesën e G.M. me arsyetimin se fëmija gjatë periudhës kohore prej 8 muajsh ishte përshtatur me mjedisin e ri si dhe ishte në interesin më të lartë të fëmijës të qëndronte në Rumani me mamanë e saj. Ky vendim u morr një një kohë kur nuk ishte vendosur përfundimisht lënia e fëmijës për rritje dhe edukim si dhe vendqëndrimi i fëmijës. Duke marrë parasysh kohën që gjykatat morën vendim përfundimtar, në çështjen konkrete ato kanë dështuar të veprojnë me urgjencë për situatën. Ndryshimi i rrethanave të fëmijës u influencua në mënyrë të konsiderueshme nga veprimet e ngadalta të autoriteteve. GJEDNJ-ja vlerësoi se autoritetet rumune kanë dështuar në marrjen e masave të përshatshme dhe efektive për të ndihmuar kërkuesin për kthimin e fëmijës dhe ushtrimin e të drejtave prindërore.

Gjykata unanimesht vendosi se ka pasur shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së”.

Në këtë aspekt, një vendim mjaft i rëndësishëm është edhe *Bajrami kundër Shqipërisë*²⁴⁹. Në kuadër të nenit 8 të KEDNJ-së, shtetet pavarësisht nëse e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, ato duhet të ndërmarrin hapa efektivë për të siguruar kthimin e fëmijëve kur mbahen ose rrëmbehen në mënyrë të paligjshme. Pra, GJEDNJ-ja edhe në rastet kur shteti nuk e ka ratifikuar Konventën e Hagës, ai duhet të përmbushë detyrimet e saj në kuadër të nenit 8 të KEDNJ-së.

Kërkuesi, Agim Bajrami është shtetas kosovar. Më 28 prill 1993 ai u martua me F. M., shtetase shqiptare. Çifti lindi një fëmijë I. B. më 20 janar 1997. Në vitin 1998 kërkuesi dhe F. M u ndanë. F. M, së bashku me të bijën, u zhvendosën në shtëpinë e prindërve të saj, në Vlorë. Më 6 maj 1999, duke përdorur dokumente të falsifikuara, F. M u martua me një person tjetër. Më 15.9.1999 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë e deklaroi të pavlefshme martesën e lidhur nga F. M. Më vonë F. M., në një datë të papërcaktuar, u martua me një shtetas shqiptar që banonte në Greqi. Gjatë viteve në vazhdim F. M udhëtoi disa herë drejt Greqisë, herë duke e lënë fëmijën e saj në Vlorë, e herë duke e marrë me vete pa pëlqimin e kërkuesit z. Bajrami. F. M dhe prindërit e saj e ndaluan kërkuesin që të kishte kontakt me fëmijën e tij. Ai arriti të takojë fëmijën vetëm në shtator 2000 dhe maj 2003.

Më 24 qershor 2003 kërkuesi paraqiti padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë me objekt zgjidhjen e martesës me F. M dhe lënien e fëmijës për rritje dhe edukim. Më 26 qershor 2003 ai i kërkoi policisë së qarkut Vlorë që të bllokonte pasaportën e fëmijës së tij, në mënyrë që F. M të mos e merrte dot me vete në Greqi. Megjithatë F. M e mori vajzën me vete në Greqi, duke përdorur një certifikatë jozyrtare në të cilën vajza ishte regjistruar me emrin I. M. duke përdorur mbiemrin e F. M. Kjo e fundit nuk mori pjesë në procesin për zgjidhjen e martesës. Babai i saj që u paraqit në gjyq deklaroi se e bija

²⁴⁹ Vendim i GJEDNJ, datë 12.12.2006.

dhe mbesa ndodheshin në Greqi si refugjate ekonomike. Më 4 shkurt 2004 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë vendosi zgjidhjen e martesës midis Agim Bajramit dhe F. M, duke ia lënë kërkesit Agim Bajrami vajzën për rritje dhe edukim. Më 19 mars 2004 vendimi mori formë të prerë. Më pas, kërkesi Bajrami kërkoi lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, më datë 5.4.2004. Ky urdhër u lëshua nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë në të njëjtën datë. Z. Bajrami iu drejtua zyrës së përmbarimit, e cila për shkak se nuk dihej vendbanimi i F.M në Greqi, vendosi pushimin e ekzekutimit të detyrueshëm. Kërkesi i është drejtuar edhe Ministrisë së Drejtësisë, Avokatit të Popullit, Ambasadës Greke etj, me qëllim që të mundësohet sjellja e vajzës së tij nga Greqia në Shqipëri. Ai paraqiti kallëzim penal ndaj një nëpunësi civil (A. C) për falsifikimin e dokumenteve që ndihmuan F.M që të largonte I.B për në Greqi. Po ashtu, ai paraqiti kallëzim penal kundrejt ish-bashkëshortes së tij për rrëmbimin e fëmijës I. B. Zhvillimet e fundit të konstatuara nga GJEDNJ pasqyrojnë se Gjykata e Apelit Vlorë ka prishur vendimin e zgjidhjes së martesës dhe lënies së fëmijës për rritje dhe edukim, për shkak se njoftimi për F.M ka qenë i parregullt. Kjo çështje ishte sjellë për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Kërkesi shprehej se nuk ishte njoftuar për një gjë të tillë.

GJEDNJ-ja u shpreh se: “Objekti thelbësor i nenit 8 është të mbrojtë individin nga veprimet arbitrare të autoriteteve publike. Ekzistojnë edhe detyrime pozitive që kanë të bëjnë me një “respektim” efektiv të jetës familjare. Në të dyja rastet, vëmendje i duhet kushtuar peshimit të drejtë të interesave që konkurrojnë midis individit dhe shoqërisë në tërësi dhe në këto raste shteti gëzon një hapësirë të caktuar vlerësimi. Në lidhje me detyrimin e shtetit për të marrë masa pozitive, Gjykata ka theksuar se: “Neni 8 përfshin të drejtën e prindit për marrjen e masave me qëllim ribashkimin me fëmijën e tij dhe detyrimin e autoriteteve shtetërore për marrjen e masave për të lehtësuar këtë ribashkim. Në çështjet që kanë të bëjnë me ekzekutimin e vendimeve në fushën e së drejtës familjare, ajo që është përcaktuese, është nëse autoritetet shtetërore kanë ndërmarrë të

gjithë hapat e nevojshëm për të lehtësuar ekzekutimin, për aq sa mund të kërkohet në mënyrë të arsyeshme në çdo rast konkret. Në raste si ky, objekt gjykimi, përshtatshmëria e masave duhet gjykuar në lidhje me shpejtësinë e zbatimit të tyre, pasi kalimi i kohës mund të sjellë pasoja të pariparueshme në marrëdhënien midis fëmijës dhe prindit që nuk jeton me të. Ndonëse masat shtrënguese kundrejt fëmijëve nuk janë të dëshirueshme, ato nuk duhen dhënë nëse prindi me të cilin jeton fëmija mund të ndër marrë veprime të paligjshme.”

Sipas Gjykatës: “Nuk u dhanë shpjegime të mjaftueshme për vonesën e përmbartjes. Ajo çmoi se autoritetet shqiptare nuk bënë asnjë hap për të përcaktuar vendndodhjen e F.M. nëpërmjet autoriteteve greke, mundësi kjo që krijohet edhe nga marrëveshja dypalëshe midis dy vendeve. Rezulton se përpjekjet e kërkuesit për t’i vënë në dijeni autoritetet për rrëmbimin e fëmijës kanë kaluar pa u vënë re. Moskërkimi nga aplikanti i një mase të përkohshme nuk mund të konsiderohet se çliron autoritetet nga detyrimi për ekzekutimin e vendimeve, pasi janë ata që ushtrojnë autoritetin publik dhe kanë të gjitha mjetet në dispozicion për të tejkaluar problemet që mund të dalin gjatë ekzekutimit. Për më tepër, kërkuesi nuk mund të fajësohet se nuk i ka drejtuar kërkesë gjykatave greke, pasi marrëveshja dypalëshe kërkonte patjetër përfshirjen e dy Ministrive të Drejtësisë.

Në lidhje me legjislacionin shqiptar Gjykata vëren: “Shkalla e gjerë e masave ligjvënëse që janë ndër marrë nga qeveria shqiptare me qëllim të përshtatjes me shtetin e së drejtës, si dhe me të drejtën e Bashkimit Evropian dhe traktateve ndërkombëtare nuk përfshin ndonjë masë efektive që bën të mundur sigurimin e ribashkimit të fëmijës me prindin që ndodhet në rastin në të cilin gjendet kërkuesi Bajrami. Në veçanti, nuk ka ndonjë mjet mbrojtjeje apo sanksionimi që të pengojë rrëmbimin e fëmijëve nga Shqipëria. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut nuk vendos mbi shtetet detyrimin që të ratifikojnë traktatet ndërkombëtare. Sidoqoftë, ajo u kërkoi atyre që të marrin të gjitha masat e nevojshme, sipas zgjedhjes së tyre, për të siguruar të drejtat e individit që

garantohen nga neni 8 i Konventës dhe, në veçanti, të sigurojë ribashkimin e prindërve me fëmijët e tyre, sipas një vendimi gjyqësor përfundimtar, të marrë për këtë qëllim.

Pavarësisht nga mosratifikimi nga Shqipëria i instrumenteve të rëndësishme të fushës, Gjykata vëren se sistemi ligjor shqiptar, ashtu siç është tani, nuk ka parashikuar ndonjë bazë alternative ligjore që t'i mundësojë kërkuesit mbrojtjen praktike dhe efektive që kërkohet si detyrim pozitiv i shtetit konform nenit 8 të KEDNJ. Duke qenë se përpjekjet e Shqipërisë kanë qenë të pamjaftueshme në këtë fushë, Gjykata në rastin konkret gjen shkelje të nenit 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

2.5. Kur mbaron jeta familjare?

Lidhjet familjare mund të formohen edhe *de facto* pa qenë e domosdoshme të jenë formalizuar nëpërmjet martesës, megjithatë mund të ndodhë që këto lidhje edhe të shkëputen. Shkëputja e lidhjeve të jetës familjare ndodh vetëm në raste përjashtimore. Sipas jurisprudencës së Strasburgut, ngjarjet e mëposhtme nuk mund të të çojnë automatikisht në shkëputjen e lidhjeve familjare.

Megjithatë, në raste përjashtimore, familja mund të mbarojë si rezultat i:

- divorcit²⁵⁰;
- ndërprerjes së jetesës së përbashkët, kur është shoqëruar nga një dëbim jashtë shtetit,²⁵¹
- vendimit për të marrë kujdestarinë e fëmijës²⁵²;
- adoptimit²⁵³.

3. E drejta për jetë familjare sipas GjED-së.

Formulimi i nenit 7 të Kartës, në lidhje me të drejtën për respektimin e “jetës private dhe familjare, venbanimint dhe komunikimit” është identik me formulimin e nenit 8/1 i Konventës, përveç faktit që Karta përdor termin “komunikim” në vend të termit

²⁵⁰ Vendim i GjEDNJ *Berrehab kundër Hollandës*, datë 21.06.1988.

²⁵¹ Vendim i GjEDNJ *Yousef kundër Mbretërisë së Bashkuar*, datë 30.06.1992

²⁵² Vendim i GjEDNJ *Margareta dhe Roger Andersson kundër Zvicrës*, datë 25.02.1992

²⁵³ Vendim i GjEDNJ *X kundër Mbretërisë së Bashkuar*, datë 01.07.1977

“korrespondencë” të përdorur nga Konventa. Në këto kushte, neni 7 i Kartës përmban të drejta që i korrespondojnë atyre të garantuara nga neni 8/1 i Konventës. Neni 7 i Kartës duhet t’i jepet i njëjti kuptim me fushën e veprimit të nenit 8/1 të Konventës, ashtu siç është interpretuar nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut²⁵⁴.

Në çështjen *J. McB. kundër L. E.*, kërkuesi ishte i ati biologjik i fëmijës. Fëmija kishte lindur si rezultat i një lidhjeje jashtëmartesore dhe kërkuesi nuk kishte bërë njohjen vullnetare të atësisë. Kërkuesi pretendonte se fëmija ishte zhvendosur në mënyrë të jashtëligjshme nga nëna e tij dhe, si rezultat, atij i ishte cenuar e drejta për jetë familjare. I ati i fëmijës e bazonte pretendimin e tij në nenin 7 të Kartës dhe nenin 8/1 të KEDNJ-së. Sipas tij, zhvendosja e fëmijës pa pëlqimin e të dy prindërve, vinte në kundërshtim me Konventën e Hagës “Mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve”. Sipas jurisprudencës së konsoliduar të GJEDNJ-së, respektimi i kësaj Konvente ishte i detyrueshëm për të mbrojtur të drejtën për jetë familjare në përputhje me nenin 8/1 të KEDNJ-së. GJED-ja theksoi se formulimi i Kartës dhe Konventës përsa i përket të drejtës për jetë familjare është i njëjtë. Në interpretimin e kësaj të drejte GJED-ja do t’i referohet jurisprudencës së GJEDNJ-së. Sipas Gjykatës së Drejtësisë, “Në rastin e lindjes së fëmijës nga një lidhje jashtë martesore, në ndryshim nga nëna, i ati biologjik nuk e fiton automatikisht të drejtën e kujdestarisë mbi fëmijën sipas kuptimit të nenit 2 të rregullores 2201/2003²⁵⁵. Po ashtu, atij nuk i cenohet e drejta për jetë private dhe familjare, e parashikuar nga neni 7 i Kartës, kur i është siguruar e drejta për t’iu drejtuar gjykatës për njohjen e të drejtave të kujdestarisë. Kur kujdestaria ushtrohet vetëm nga nëna, zhvendosja e fëmijës nga një shtet në tjetrin përfaqëson ushtrimin e të drejtave legjitime të nënës, si liria e lëvizjes, të garantuara nga traktatet themeluese.”. I njëjti qëndrim është mbajtur edhe nga GJEDNJ-ja, në çështjen *X kundër Letonisë*, i ati

²⁵⁴ Vendim i GJED C-400/10 *J. McB. kundër L. E.*,

²⁵⁵ Rregullorja nr.2201/2003, Mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve për çështjet martesore dhe përgjegjësisë prindërore.

biologjik i fëmijës kërkoj kthimin e fëmijës sipas Konventës së Hagës, vetëm pasi më parë bëri me vendim gjyqësor njohjen e atësisë.

Në çështjen *Dereci dhe të tjerë*²⁵⁶, GJED-ja mbajti qëndrimin se: “Direktiva 2003/86²⁵⁷ dhe Direktiva 2004/38²⁵⁸, nuk janë të zbatueshme në çdo rast për anëtarët e familjes së vendeve të treta. Anëtarët e familjes, që kërkojnë të drejtën e qëndrimit në mënyrë që të bashkohen me personat që kanë qytetarinë e Bashkimit, nuk mund ta përfitojnë këtë të drejtë nëse shtetasit e një shteti anëtar nuk e kanë ushtruar asnjëherë të drejtën e tyre të lëvizjes në një shtet tjetër anëtar.”.

Sipas Gjykatës, neni 3/3 i direktivës 2003/86, nuk aplikohet te të gjithë anëtarët e familjes së vendeve të treta, të një qytetari të Bashkimit. Pra, direktiva zbatohet kur plotësohen dy kushte kumulative: a) Vetëm personat që konsiderohen “anëtarë të familjes”, sipas kuptimit të nenit 2/2, mund të kërkojnë të drejtën e rezidencës në shtetin anëtar, dhe b) Kur personi, që përfiton nga statusi i qytetarit të Bashkimit, ka ushtruar të drejtën e tij të lirisë të lëvizjes, duke u vendosur në një shtet tjetër anëtar të ndryshëm nga ai i shtetësisë që mban.

Fakti i vetëm që ekzistenca e anëtarëve të familjes nga vendet e treta do të ishte e dëshirueshme dhe do t’i sillte lehtësira ekonomike qytetarit të Bashkimit nuk është i mjaftueshëm për të pranuar kërkesën për rezidencë të anëtarëve të tij të familjes. Ky fakt nuk mund të interpretohet se këto kushte do ta detyronin qytetarin e Bashkimit të largohej nga territori i Bashkimit, nëse kjo e drejtë nuk do t’i garantohej. Megjithatë, në çdo rast Gjykatat kombëtare duhet të analizojnë nëse refuzimi i kërkesës për rezidencë të anëtarëve të familjes do të cenonte nenin 7 të Kartës. Nga ana tjetër, nëse gjykatat kombëtare arrijnë në konkluzionin se Karta nuk është e zbatueshme në rastin konkret (sipas nenit 51 të saj), gjykatat patjetër duhet të marrin në konsideratë parashikimet e

²⁵⁶ Vendim i GJED C-256/11 *Dereci dhe të tjerë*, [2011] PVGJE I-11315

²⁵⁷ Direktiva 2003/86 “Mbi të drejtën e bashkimit familjar”.

²⁵⁸ Direktiva 2004/38 “Mbi të drejtën e qytetarëve të Bashkimit dhe anëtarëve të familjes së tyre për të lëvizur dhe qëndruar lirisht në territorin e Shteteve Anëtare”

nenit 8/1 të Konventës për të Drejtët dhe Liritë Themelore të Njeriut. Të gjitha shtetet anëtare janë palë në Konventë, e cila parashikon detyrimin e respektimit të së drejtës për jetë private dhe familjare në nenin 8 të saj.

Në çështjen *Kreshnik Ymeraga dhe të tjerë*²⁵⁹, rrethanat kanë qenë pothuajse të njëjta me atë të çështjes *Dereci*. GJED-ja është shprehur se: “Kur qytetari i Bashkimit nuk e ka ushtruar asnjëherë lirinë e tij të lëvizjes në një shtet tjetër anëtar, situata e anëtarëve të familjes, që i përkasin vendeve të treta, nuk rregullohet as nga direktiva 2004 “Mbi të drejtën e qytetarëve të Bashkimit dhe anëtarëve të familjes së tyre për të lëvizur”, as nga direktiva 2003/86 “Mbi të drejtën e Bashkimit familjar”. Refuzimi i shtetit anëtar për të lejuar të drejtën e rezidencës së anëtarëve të familjes nga vendet e treta nuk duhet të ketë efekt cenes në gëzimin e të drejtës për punësim, e cila rrjedh nga statusi i qytetarit të Bashkimit. Kur mospranimi nuk ka një efekt të tillë, atëherë ai nuk është pjesë e së Drejtës së Bashkimit. Rrjedhimisht, në bazë të nenit 51 të Kartës, nuk mund të vlerësohet nëse veprimi i shtetit anëtar është në përputhje me Kartën. Megjithatë, ky konkluzion nuk paragjykon vlerësimin e rastit mbi bazën KEDNJ-së. Në çdo rast, shtetet anëtare duhet të analizojnë të drejtën e rezidencës së anëtarëve të familjes të vendeve të treta, edhe në kuadër të respektimit të së drejtës për jetë familjare, sipas nenit 8 të Konventës.”.

Në një rast tjetër ku kërkuesi ka pretenduar shkeljen e së drejtës për jetë familjare, pasi i është refuzuar qëndrimi në një shtet anëtar, është edhe çështja *Yoshikazu Lida kundër Stadt Ulm*²⁶⁰. Në vitin 1998, z. Lida me shtetësi japoneze u martua me znj. N-I, shtetase gjermane. Në 27 gusht të vitit 2004 lindi në Amerikë vajza e tyre Mia, e cila kishte shtetësi gjermane, japoneze dhe amerikane. Në dhjetor 2005 familja u zhvendos në Gjermani. Në janar z. Lida mori lejen e qëndrimit për bashkim familjar. Në shkurt 2006 ai filloi punë me kohë të plotë, mbi bazën e një kontrate pune me kohëzgjatje të

²⁵⁹ Vendim i GJED C-87/12 *Kreshnik Ymeraga dhe të tjerë*, [2013] PVGJE.

²⁶⁰ Vendim i GJED C-40/, [2012] PVGJE.

pacaktuar.

Në verë të vitit 2007, bashkëshortja e z. Lida filloi punë me kohë të plotë në Vjenë. Që nga janari i vitit 2008 bashkëshortët jetojnë përfundimisht të ndarë, megjithatë ata nuk janë divorcuar. Të dy prindërit ushtrojnë përgjegjësinë prindërore mbi vajzën e tyre, por e ëma dhe vajza që nga marsi i 2008-ës e kanë vendbanimin e zakonshëm në Vjenë, ku vajza ka filluar edhe shkollën.

Në 30 maj të vitit 2008 z. Lida kërkoi nga Bashkia e Ulm-it ta paiste atë me “kartën e qëndrimit si anëtar i familjes së një qytetari të Bashkimit”. Kjo kërkesë u refuzua nga organi administrativ dhe Gjykata Administrative. Në vitin 2010, z.Lida, brenda afatit ligjor të parashikuar, apeloj vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Ai gjithashtu aplikoi për një leje qëndrimi me kohë të gjatë, por më vonë e tërhoqi aplikimin. Ndër të tjera, përpara GJED-së u ngritën si pyetje: A mund të përfshihet brenda konceptit të “anëtarit të familjes” ky rast duke e interpretuar në mënyrë të zgjeruar nenin 2/2 të Direktivës 2004/38, parë kjo në kuadër të neneve 7 e 24 të Kartës dhe të nenit 8 të KEDNJ-së. Pra, a mund të konsiderohet anëtar familjeje sipas direktivës prindi që është shtetas i një vendi të tretë, i cili ushtron përgjegjësinë prindërore për një fëmijë që është qytetar i Bashkimit, por që nuk është në ngarkim të këtij fëmije?

GJED-ja, arriti në konkluzionin se direktiva 2003/109²⁶¹ nuk është e aplikueshme në rastin konkret, pasi megjithëse kërkuesi i plotëson të gjitha kushtet, ai në mënyrë vullnetare tërhoqi aplikimin. Ky i fundit është një kusht *sine qua non* nuk mund të jepet leja e qëndrimit afatgjatë. Për sa i përket direktivës 2004/38, ajo zbatohet ndaj të gjithë qytetarëve të Bashkimit kur ata zhvendosen në një shtet anëtar, të ndryshëm nga ai, shtetësinë e të cilit kanë, si dhe ndaj anëtarëve të tyre të familjes. Sipas saj, jo të gjithë anëtarët e familjes të vendeve të treta përfitojnë nga e drejta e qëndrimit në një shtet anëtar të Bashkimit, por e kanë këtë të drejtë vetëm ata që konsiderohen të tillë sipas

²⁶¹ Direktiva 2003/109, Për dhënien e lejeve të qëndrimit për shtetasit e vendeve të treta.

nenit 2/2 të direktivës dhe vetëm kur plotësojnë disa kushte.

Në lidhje me statusin e “anëtarit të familjes”, në rastin konkret duhet të bëhet një ndarje për lidhjet që ekzistojnë ndërmjet kërkuesit dhe fëmijës dhe ndërmjet tij dhe bashkëshortes. Për rastin e parë (kërkues e bija), kërkuesi është “anëtar i familjes” sipas nenit 2/2/d të direktivës, por ai duhet të plotësojë edhe kushtin e dytë, sipas të cilit qytetari i Bashkimit duhet ta ketë anëtarin e familjes në ngarkim. Në përputhje me qëndrimin e GJED-së, statusi i anëtarit të familjes në “ngarkim” është çështje fakti, ku suporti financiar për anëtarin e familjes sigurohet nga mbajtësi i së drejtës së rezidencës. Si rrjedhim, kërkuesi nuk mund të konsiderohet si “anëtar i familjes” së vajzës së tij pasi nuk përmbush kushtin e varësisë.

Për rastin e dytë duhet të vihet në dukje se “anëtari i familjes”, sipas nenit 2/2/a të direktivës, martesë nuk quhet e zgjidhur kur bashkëshortët nuk jetojnë së bashku, përveç rastit kur ka një vendim të formës së prerë për zgjidhjen e martesës. Bashkëshorti nuk është i detyruar të jetojë në mënyrë të vazhdueshme me bashkëshortin qytetar të Bashkimit, në mënyrë që të përfitojë të drejtën e qëndrimit. Megjithatë, edhe pse z. Lida konsiderohet “anëtar i familjes” i gruas së tij, atij nuk mund t’i jepet leja e qëndrimit në Gjermani. Sipas nenit 3/1 të Direktivës, kërkohet që antëtari i familjes i qytetarit të Bashkimit zhvendoset në shtetin anëtar, që është i ndryshëm nga shteti i shtetësisë së qytetarit të Bashkimit, duke shoqëruar qytetarin e Bashkimit. Gjithashtu, duhet theksuar se i mituri ka një anëtar të familjes, qytetar të Bashkimit, i cili kujdeset për të (çështja *Zhu dhe Chen*).

Pra, anëtari i familjes përfiton të drejtën e qëndrimit në shtetin anëtar pritës²⁶². Rrjedhimisht, duke qenë se z. Lida as nuk ka shoqëruar, as nuk i është bashkuar anëtarëve të familjes në shtetin pritës, të cilët janë qytetarë të Bashkimit, atëherë ai nuk mund të përfitojë nga e drejta e qëndrimit sipas direktivës 2004/38. Gjykata vë në dukje

²⁶²Vendimi GJED C-291/05, [2007] ECR I-10719.

se nenet 20 dhe 21 të TFBE-së nuk parashikojnë të drejta autonome për shtetasit e vendeve të treta. Këta shtetas i përfitojnë të drejtat e tyre si të drejta të prejardhura nga ushtrimi i statusit të qytetarit të Bashkimit të anëtarëve të tyre të familjes.

GJED-ja u shpreh se për të vlerësuar nëse refuzimi i lejes së qëndrimit do të cenonte të drejtën për jetë private dhe familjare sipas neneve 7 dhe 24 të Kartës, duhet të shikojmë nëse në rastin konkret kemi të bëjmë me zbatimin e së drejtës së Bashkimit (neni 51 i Kartës). Çështja e marrjes së “kartës së qëndrimit si anëtar i familjes së qytetarit të Bashkimit”, në pamje të parë, ka të bëjë me zbatimin e së drejtës së Bashkimit. Gjithsesi, duke qënë se në rrethanat konkrete të rastit nuk plotësohen kushtet formale për të përfituar këtë kartë, në përputhje me nenin 10 të direktivës 2004/38, çështja është jashtë fushës së veprimit të së drejtës së Bashkimit. Për më tepër, në mungesë të aplikimit nga ana e tij për të përfituar qëndrim me kohë të gjatë në përputhje me direktivën 2003/109, rasti nuk paraqet asnjë lidhje me të drejtën e Bashkimit.

Në këtë vendim të GJED-së vërehet se ajo nuk ka parashikuar detyrimin e gjykatave kombëtare për ta analizuar rastin konkret edhe nga aspekti i respektimit të jetës familjare sipas nenit 8 të KEDNJ-së. Në përputhje me jurisprudencën e GJED-së, respektimi i të drejtave themelore të parashikuara në KEDNJ është pjesë e parimeve të përgjithshme të së drejtës së Bashkimit. Për më tepër që kjo ishte edhe një nga çështjet e ngritura përpara saj dhe GJED-ja nuk duhet ta kishte anashkaluar këtë çështje.

Kapitulli VIII: Konkluzione dhe rekomandime.

Komuniteti Ekonomik Evropian i themeluar nga Traktati i Romës në vitin 1957 nuk është në vetvete një traktat i të drejtave të njeriut. Megjithëse në traktatet themeluese të Bashkimit Evropian u parashikuan disa të drejta themelore, si për shembull: ndalimi i diskriminimit, e drejta e qarkullimit të lirë të mallrave, kapitaleve, shërbimeve, liria e lëvizjes së personave etj., qëllimi kryesor i shteteve anëtare ishte krijimi i tregut të përbashkët dhe jo respektimi i të drejtave themelore. Të drejtat e mësipërme u

formësuan në këtë kuadër dhe individi mbrohej vetëm si një nga protagonistët e tregut të përbashkët. Megjithatë edhe pse traktatet themeluese kishin karakter ekonomik, përsëri ato nuk mund të shmangin rrezikun e interferencës midis legjilacionit komunitar dhe të drejtave të njeriut. Legjilacioni i komuniteteve në vite nuk ka arritur të garantojë siç duhet respektimin e të drejtave të njeriut. Mbrojtja e këtyre të drejtave ishte sanksionuar në shumicën e kushtetutave të shteteve anëtare. Po ashtu këto të drejta mbroheshin edhe nga Konventa, ku shtetet anëtare ishin palë. Nga njëra anë, shtetet anëtare duhet të përmbushnin detyrimet e *aquis communautaire*, ku GJED-ja kishte sanksionuar efektin e përparësisë dhe efektin e drejtëpërdrejtë të saj edhe mbi kushtetutat e shteteve anëtare. Nga ana tjetër, të gjitha shtetet anëtare ishin palë edhe në KEDNJ. Zbatimi i të drejtës së komunitetit do të sillte si pasojë humbjen e të drejtës së individëve për t'iu drejtuar me rekurs individual GJEDNJ-së, për kompetencat e transferuara nga shtetet anëtare në Komunitet. Në mënyrë të qartë, kjo e fundit do të shkaktonte shkeljen e detyrimeve të marra përsipër sipas KEDNJ-së.

Gjykatës Evropiane të Drejtësisë shumë shpejt iu desh të interpretojë nëse kompetencat që ushtroheshin në kuadër të *aquis communautaire*, duhet të respektonin të drejtat themelore. GJED-ja fillimisht refuzoi të gjitha paditë që kishin të bënin me të drejtat themelore, me arsyetimin se çështjet e së drejtës kushtetuese kombëtare nuk ishin në kompetencë të saj. Ky arsyetim i Gjykatës së Drejtësisë hasi në kundërshtinë e gjykatave kushtetuese të shteteve anëtare. Sipas tyre, përderisa KE-ja nuk ishte në gjendje të garantonte të drejtat themelore të njeriut, atëherë të drejtat themelore do të garantohen nga gjykatat kushtetuese të shteteve anëtare. Pra, shtetet anëtare nuk pranonin efektin e përparësisë së të drejtës së Bashkimit lidhur me të drejtat e njeriut. Në këto kushte, GJED-ja ndryshoi qëndrim.

Fillesat e mbrojtjes të të drejtave të njeriut nga GJED-ja kanë të bëjnë me respektimin e parimit të mosdiskriminimit, si: ndalimi i trajtimit diskriminues mbi bazën e kombësisë,

gjinisë, racës, përkatësisë fetare, etnike, trajtimi i barabartë në lidhje me katër liritë themelore etj. Në konkluzionet e saj ajo pranoi se respektimi i të drejtave themelore bën pjesë në parimet e përgjithshme të rendit juridik të Komunitetit, rend të cilin Gjykata e Drejtësisë e ka për detyrë ta garantojë. Pra, ajo njihte ekzistencën e një kuadri juridik të KE-së edhe për të drejtat themelore. Gjykata Evropiane e Drejtësisë ka mbajtur qëndrimin se e drejta e Komunitetit është sigurisht e lidhur me parime të përgjithshme të pashkruara, që e kanë origjinën nga burime të ndryshme. Parimet e përgjithshme të së drejtës formësohen nga traktatet ndërkombëtare si dhe traditat kushtetuese që janë të përbashkëta për shtetet anëtare. Traktatet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ku shtetet anëtare janë palë, mund të përdoren si udhëzuese. Në çështjet e kohëve të fundit, Gjykata i cilëson si “parime kushtetuese” të drejtat themelore duke i vendosur në të njëjtin nivel, e madje edhe në nivel më të lartë se dispozitat e tjera të Traktatit (*çështja Kadi*). Detyrimi i zbatimit të parimeve të përgjithshme shtrihet edhe mbi shtetet anëtare, kur ato zbatojnë të drejtën e Komunitetit. Shtetet anëtare janë të detyruara të respektojnë po ato parime të përgjithshme dhe të drejta themelore që e detyrojnë edhe Komunitetin në veprimet e tij.

Ekzistojnë diferenca ndërmjet gjuhës së përdorur nga traktatet dhe jurisprudencës së GJED-së, për shembull kujt i adresohet për mbrojtjen e normave. Sipas praktikës gjyqësore të GJED-së është Gjykata ajo që siguron mbrojtjen e parimeve të përgjithshme; në periudhën ndërmjet Traktatit të Mastritit dhe Traktatit të Lisbonës është Bashkimi ai që i respekton ato; ndërsa në Traktatin e Lisbonës nuk është specifikuar se kujt i adresohet mbrojtja e parimeve të përgjithshme. Çështja më problematike në ndryshimet që kanë pësuar traktatet, është mungesa e përmendjes së konventave të tjera të të drejtave të njeriut përveç KEDNJ-së. Traktati i Lisbonës përcakton se parimet e përgjithshme rrjedhin nga KEDNJ-ja dhe traditat e përbashkëta kushtetuese të shteteve anëtare (neni 6/3).

GJED-ja ka mbajtur qëndrimin se traktatet e tjera ndërkombëtare sigurojnë një mbrojtje të mëtijshme të të drejtave themelore brenda Bashkimit Evropian dhe ato bëjnë pjesë në parimet e përgjithshme të së drejtës së Bashkimit. Si rrjedhim, subjektet e legjitimuara mund të mbështeten në traktatet e tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përveç KEDNJ-së, ku shtetet anëtare janë palë. Mbetet për t'u parë nga jurisprudenca e GJED-së se cila nga traktatet ndërkombëtare do të këtë atë rëndësi sa të konsiderohet pjesë e parimeve të përgjithshme të së drejtës së Bashkimit.

Praktika gjyqësore e Gjykatës është mbështetur shumë më pak në dispozitat kushtetuese kombëtare sesa në KEDNJ-në dhe në instrumentet e tjera ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut. Është më e vështirë për GJED-në të mbrojë një qasje “të përbashkët”, ku një e drejtë e caktuar nuk shfaqet në çdo kushtetutë kombëtare. Megjithatë, edhe kur ka një konsensus të përgjithshëm të shteteve anëtare për njohjen e një të drejte të caktuar, duket se është e pashmangshme që të arrihet konsensus për mënyrën e kuptimit dhe interpretimit të kësaj të drejte. Për këtë arsye mënyra se si “përkthehet” në parim të përgjithshëm një e drejtë, mund të ngjallë kontestime nga shtetet anëtare. Në këto kushte, ka ndodhur që edhe pse GJED-ja ka pranuar se një e drejtë duhet të njihet si pjesë e së drejtës së Komunitetit, mënyra se si Gjykata vendos ta interpretojë atë mund të dallojë nga mënyra që ajo zbatohet në ligjin kombëtar dhe, si rrjedhim, aplikanti të ngelet i zhgënjyer megjithëse e drejta iu njoh (çështjet *Hauer* dhe *Handerlsgesellschaft*). GJED-ja nuk është treguar e qartë në interpretimin e saj se përse disa të drejta janë pjesë e parimeve të përgjithshme të së drejtës së Bashkimit sipas nnit 6/3 të TBE. Në disa raste janë njohur si parime të përgjithshme të drejta që nuk i përkasin as konventave ndërkombëtare, as traditave të përbashkëta të shteteve anëtare. Në këto raste Gjykata është bazuar në parime të tjera të cilat kanë të njëjtin efekt që mund të kishin të drejtat themelore, p.sh. e drejta për të mbrojtur hapësirat e biznesit, parimi i transparencës në çështjet administrative, e drejta e aksesit në dokumentet publike etj.

Neni 6/3 ka rëndësi të veçantë në nxitjen e koherencës të rendit kushtetues së Bashkimit dhe të shteteve anëtare. Ky nen përfaqëson një mundësi për të drejtën e Bashkimit për t'u përditësuar me zhvillimet e përbashkëta kushtetuese të shteteve anëtare. Të drejtat themelore të njeriut nuk janë statike pasi ato zhvillohen me kohën. Megjithatë, koncepti ligjor i “parimeve të përgjithshme” ka edhe mangësitë e tij, të cilat mund të ndikojnë negativisht në të drejtat themelore. Kjo ka të bëjë kyesisht me anën formale të normave. Parimet e përgjithshme nuk kanë qartësinë që paraqesin rregullat e shkruara. Ato në përgjithësi janë të përgjithshme dhe qëndrojnë në nivelin e parimeve.

Një burim të rëndësishëm për të drejtat themelore paraqesin edhe nenet 2 dhe 7 të TBE-së. Nëse në lidhje me të drejtat themelore të njeriut do të merrnim në konsideratë vetëm nenin 6 të TBE-së, kjo do të ishte mjaft kufizuese, pasi të drejtat e njeriut janë një nga vlerat e BE-së. Të drejtat themelore përbëjnë çështje më gjithëpërfshirëse sipas nenit 2 të TBE-së. Detyrimi i veprimit në përputhje me vlerat e Bashkimit rëndon edhe mbi shtetet anëtare. Si rezultat i këtij interpretimi, institucionet e Bashkimit kanë kompetencë të mbikëqyrin përputhshmërinë e veprimeve të shteteve anëtare me vlerat e parashikuara nga neni 2 i TBE-së, duke zbatuar procedurën e parashikuar nga neni 7. Ky i fundit është interpretuar se në situata specifike mund të zbatohet edhe në rast se çështja është jashtë fushës së verpimit të Kartës. Do të ishim përpara një situatë të tillë, në rastin e shkeljeve sistematike të thelbit të të drejtave themelore, ku qytetaria e Bashkimit duhet të aktivizohet për të rivendosur të drejtat e saj.

Ndryshimi i qasjes ndaj të drejtave themelore sipas jurisprudencës së GJED-së u reflektua edhe në traktatet themeluese. Aktualisht, Traktati i Lisbonës pohon se të drejtat themelore të parashikuara në Kartë kanë të njejtën fuqi ligjore si Traktatet. Po ashtu, Bashkimi anëtarësohet në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Në nenin 2 të Traktatit të Bashkimit Evropian listohen vlerat e tij, ku të drejtat dhe liritë

themelore janë konsideruar si një prej tyre. Këto ndryshime përbëjnë një nga arritjet më kryesore në këtë fushë.

Karta përbën instrumentin kryesor për mbrojtjen e të drejtave themelore në Bashkim. Për herë të parë në një dokument të këtij tipi gjejmë të bashkuara të drejtat civile dhe politike me të drejtat ekonomike dhe sociale. Ekuilibri i arritur midis këtyre dy kategorive përcakton ato që sot quhen vlera të përbashkëta të të gjitha shteteve anëtare. Të drejtat civile e politike janë të përbashkëta me KEDNJ-në. Në rastin e Kartës këto të drejta janë më gjithëpërfshirëse. Që në preambul sqarohet se Karta nuk krijon të drejta të reja. Ajo synon të bëjë një përmbledhje krijuese të të drejtave të përfshira në marrëveshjet e ndryshme ndërkombëtare dhe në kushtetutat kombëtare, të cilat GJED-ja kishte vite tashmë që i përdorte.

Të drejtat themelore të njeriut respektohen nga institucionet e Bashkimit vetëm kur ato zbatojnë legjislacionin e Bashkimit. Po ashtu, shtetet anëtare kanë detyrimin të respektojnë të drejtat themelore të njeriut kur ato marrin masa për zbatimin e *aquis communautaire*. Karta nuk zbatohet në rastin e së drejtës kombëtare të shteteve anëtare, kur kjo e drejtë nuk vjen si rezultat i zbatimit të legjislacionit të Bashkimit. BE-ja nuk ka një kompetencë të posaçme për njohjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, por ai i garanton ato brenda kompetencave ose fushës së zbatimit të së drejtës së tij. Asnjë dispozitë e traktatit nuk u njeh institucioneve të Komunitetit ndonjë pushtet të përgjithshëm normativ për të miratuar norma mbi të drejtat e njeriut. Megjithatë Komunitetit i është njohur e drejta të miratojë masa për të eliminuar diskriminimin, brenda kompetencave të parashikuara nga Traktatet.

Përsa i përket zbatimit të të drejtave themelore ndërmjet palëve, nga interpretimi literal i nenit 51/1 të Kartës përjashtohet efekti i drejtëpërdrejtë i klauzolës horizontale, duke qenë se palët private nuk bëjnë pjesë në subjektet të cilave u drejtohet Karta. Pavarësisht formulimit të këtij neni, GJED-ja në praktikën e saj të konsoliduar i ka dhënë efekt

hoizontal të drejtëpërdrejtë lirisë së lëvizjes së punëtorëve, lirisë së ofrimit të shërbimeve, lirisë së vendosjes, të drejtave kolektive (neni 28 i Kartës) etj. Po ashtu të drejtave të qytetarisë së BE-së u është njohur efekt i drejtëpërdrejtë, të cilat janë mishëruar tashmë edhe në Kartë.

Fusha e veprimit të Kartës është kufizuar nga Protokollit 30 për tri shtete, konkretisht, Mbretërinë e Bashkuar, Poloninë dhe Çekinë. Protokollit 30 nuk sjell ndonjë risi të dukshme në dy dispozitat e tij. Përgjithësisht, ai rikonfirmon dispozitat e Kartës, përkatësisht nenet 51, 52 paragrafi 5 dhe 52 paragrafi 6 të saj. Objektivi kryesor i Protokollit 30 është të sigurojë se edhe nëse Karta krijon të drejta të reja, ajo duhet të interpretohet se nuk krijon të drejta të reja për këto shtete. Në interpretimin e këtij Protokollit duhet marrë parasysh preambula e tij, e cila parashikon se : “Protokollit nuk cenon detyrimet që lindin mbi Poloninë dhe Mbretërinë e Bashkuar sipas Traktatit për Bashkimin Evropian, Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian dhe të drejtës së Bashkimit në përgjithësi”. Rrjedhimisht, këto shtete kanë detyrimin të zbatojnë nenin 6/3 të TBE-së. Ky nen sanksionon se: “parimet e përgjithshme të Bashkimit Evropian janë të drejtat themelore siç garantohen nga KEDNJ-ja dhe siç rrjedhin nga traditat kushtetuese që janë të përbashkëta për shtetet anëtare”. Ky nen i cili është i pavarur nga Karta, sanksionon se çdo legjislacion i miratuar dhe zbatuar në Britani, Poloni apo Çeki duhet të respektojë të drejtat themelore të njeriut. Për këtë arsye, nëse Gjykata e Drejtësisë arrin në përfundimin se një e drejtë që parashikohet nga Karta përbën një parim të përgjithshëm të Bashkimit, atëherë mbrojtja e siguruar nga Protokollit 30 nuk mund të zbatohet.

Përsa i përket raportit Kartë- Konventë, KEDNJ-ja përmendet shprehimisht nga e drejta e Bashkimit në nenin 6 të TBE-së dhe në nenin 52 e 53 të Kartës. Konventa është pjesë e parimeve të përgjithshme të së drejtës së Bashkimit (neni 6). Të drejtat e parashikuara në Kartë që janë të njëjta me ato të KEDNJ-së duhet të kuptohen dhe të interpretohen në

të njëjtën mënyrë që parashikohen në Konventë. Kjo e fundit do të shërbejë si standard minimum. Ndërsa, të drejtat e njohura nga Karta të cilat janë të bazuara mbi traktatet themeluese do të ushtrohen në kushtet dhe brenda kufijëve të caktuar nga këto traktate. Karta nuk mund të interpretohet se kufizon të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, ashtu siç njihen nga e drejta ndërkombëtare dhe nga marrëveshjet ndërkombëtare në të cilat Bashkimi dhe shtetet anëtare janë palë.

GJEDNJ-ja është shprehur se: “Konventa është një instrument dinamik, i cili duhet të interpretohet nën dritën e kushteve aktuale”. Të drejtat e parashikuara në Kartë mund të zhvillohen si rezultat i zhvillimit të traditave kushtetuese të shteteve anëtare, të cilat mund të kenë një interpretim më të përparuar me kalimin e kohës. Gjithashtu në këtë kuadër edhe GJEDNJ-ja do të ketë një rol të rëndësishëm në interpretimin dinamik të Kartës. Shumica e traditave të përbashkëta kushtetuese të shteteve anëtare përkojnë me të drejtat e parashikuara në KEDNJ, ashtu siç janë interpretuar nga GJEDNJ-ja.

Gjykata ka interpretuar kufizimin e normave për liritë bazë sipas traktateve, nga parimet e përgjithshme të së drejtës së Komunitetit. Pra, GJED-ja ka vlerësuar përparësinë që ekziston ndërmjet lirive themelore të parashikuara nga traktatet themeluese nga njëra anë dhe të drejtave të parashikuara në KEDNJ ose Kartë. Përsa i përket vlerësimit të të drejtave ose peshës që ato kanë, Gjykata ka vlerësuar se nuk ka diferencë ndërmjet tyre, pra çdo e drejtë mund të përdoret për të kufizuar një të drejtë tjetër themelore. Për shembull, në çështjet *Schmidberger*, *Omega*, *Laval*, e drejta për t’u grumbulluar dhe liria e shprehjes kanë shërbyer si kufizim i lirisë së lëvizjes së mallrave dhe shërbimeve. Ndërsa në çështjen *Viking*, e drejta për të ndërmarrë veprime kolektive ka kufizuar lirinë e vendosjes sipas TKE-së.

Konventa nuk i ndalon palët kontraktuese t’i transferojnë kompetencat një organizate ndërkombëtare. Gjithsesi, organizata ndërkombëtare nuk mban përgjegjësi sipas Konventës për vendimet e marra nga organet e saj, për sa kohë nuk është palë në

Konventë. Shtetet, edhe pse kanë transferuar pushtetin e tyre sovran të këto organizata, përsëri kanë përgjegjësi përpara GJEDNJ-së për mospërbushje të detyrimeve sipas KEDNJ-së.

Në rast se shteti vepron në përputhje me një marrëveshje ndërkombëtare ku ka aderuar lirisht (p.sh BE), ai mban përgjegjësi përpara GJEDNJ-së për shkeljet e kryera (rasti *Matthews*). Një akt i BE-së, siç është një direktivë, që i krijon shteteve hapësirë në zgjedhjen e mjeteve për arritjen e qëllimit, shteti implementues përsëri mban përgjegjësi për çdo shkelje të KEDNJ-së (rasti *Cantoni*). Kur një akt i BE-së, siç është një rregullore, nuk i lë shtetit liri veprimi në implementim, shteti do të prezumohet se ka vepruar në pajtim me KEDNJ-në. Ky prezumim zbatohet vetëm kur BE-ja (organizata ndërkombëtare) parashikon një nivel ekuivalent të mbrojtjes të të drejtave të njeriut me KEDNJ-në dhe nuk ka prova të mosfunksionimit të sistemit të kontrollit (rasti *Bosphorus*).

Në qëndrimet e tyre të hershme, midis GJEDNJ-së dhe GJED-së, ka pasur mospërputhje. Gjithsesi, kohët e fundit të dyja Gjykatat kanë dhënë vendime duke u frymëzuar dhe referuar në jurisprudencën e njera-tjetrës. Gjykata e Drejtësisë ka njohur raportin plotësues të Kartës me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Duke u bazuar në analizën e qëndrimit të GJED-së dhe GJEDNJ-së mbi të drejtën për jetë familjare, të shqyrtuar në rastin studimor, arrijmë në përfundimin se të dyja Gjykatat referojnë në qëndrimet e njera-tjetrës. GJED, ka theksuar se, formulimi i Kartës dhe Konventës përsa i përket të drejtës për jetë familjare, është i njejtë. Në interpretimin e kësaj të drejte GJED do ti referohet jurisprudencës së GJEDNJ-së. Sipas GJED-së “...nëse gjykatat kombëtare arrijnë në konkluzionin se Karta nuk është e zbatueshme në rastin konkret (sipas nenit 51 të saj), gjykatat patjetër duhet të marrin në konsideratë parashikimet e nenit 8/1 të KEDNJ-së.”. Të gjitha shtetet anëtare janë palë në Konventë, e cila parashikon detyrimin e respektimit të së drejtës për jetë private dhe familjare në

nenin 8 të saj. (çështjet *Dereci dhe të tjerë; Kreshnik Ymeraga dhe të tjerë*). Edhe GJEDNJ-ja i është referuar drejtpërdrejt Kartës së BE-së për të interpretuar Konventën. Në çështjen *Schalk dhe Kopf kundër Austrisë*, për interpretimin e së drejtës për martesë sipas nenit 12 të KEDNJ-së, GEDNJ-ja i është referuar nenit 9 të Kartës. GJED-ja do të ketë detyrimin të marrë në konsideratë jurisprudencën e GJEDNJ-së për interpretimin e të drejtave themelore, vetëm pas aderimit. Aderimi i BE-së në Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut është diskutuar që në fund të viteve 1970. Megjithatë pengesat ligjore për realizimin e tij janë hequr vetëm vitet e fundit. Paragrafi i dytë i nenit 59, i shtuar nga Protokollin i 14 të KEDNJ-së dhe neni 6 i Traktatit të Lisbonës bënë ligjërisht të mundur aderimin e BE-së në KEDNJ. Për të realizuar aderimin e BE-së në KEDNJ është e nevojshme të miratohet marrëveshja e aderimit ndërmjet 47 shteteve palë të KEDNJ-së dhe BE-së. Kjo marrëveshje hyn në fuqi kur ratifikohet nga të gjitha palët kontraktuese. Dispozitat e draft – marrëveshjes²⁶³ për nga përmbajtja mund të ndahen në katër grupe të mëdha:

- a) çështjet e përgjithshme;
- b) çështjet institucionale;
- c) çështjet e juridiksionit dhe
- d) çështjet financiare.

Prezenca e BE-së në Komitetin e Ministrave është konsideruar si një nga çështjet më të mprehta. Nga disa vende joanëtare të BE-së është ngritur diskutimi se për çështjet të cilat kanë ndikim në BE, shtetet anëtare të BE-së dhe vetë BE-ja mund të koordinojnë qëndrimet e tyre duke krijuar një bllok prej 28 votash (BE + 27 shtetet anëtare). Koordinimi i qëndrimeve do të shkaktonte një mungesë ekulibri brenda Komitetit të Ministrave në favor të Bashkimit. Kjo situatë i referohet rasteve kur Komiteti Ministrave ka për detyrë të monitorojë zbatimin e vendimeve ose duhet të nxjerrë

²⁶³Draft Marrëveshjes së Aderimit të BE-së në KEDNJ, (2013) drafti i fundit që palët kanë rënë dakord në momentin e këtij punimi.

raporte dhe rekomandime (nenet 39, 46 dhe 47 të KEDN-së). Në të dyja këto raste kërkohet një shumicë prej dy të tretave të votave të të gjithë anëtarëve, shumicë që arrihet me 32 vota. Duhet vënë në dukje se në rastin e koordinimit të pozicioneve, BE-ja dhe shtetet anëtare janë shumë afër arritjes së shumicës vendimmarrëse prej 2/3 të votave.

Aderimi i BE-së prek aspekte aq thelbësore saqë vetë GJED-ja në opinionin 2/94 të saj e ka konsideruar aderimin me “rëndësi kushtetuese”. Pranimi si palë kontraktuese e një organizate ndërkombëtare kërkon modifikime të procedurave të parashikuara nga KEDNJ-ja. Në rastin e Bashkimit është plotësisht e mundur që subjekti i cili nxjerr aktin (në këtë rast BE) dhe subjekti që e zbaton këtë akt (në këtë rast shteti anëtar) të jenë subjekte të ndryshme. Për këtë arsye u parashikua mekanizmi procedural i bashkëndërgjyqësisë.

Sipas dispozitave të marrëveshjes mund të gjendemi përpara tri situatave. Së pari, një pretendim mund të ngrihet vetëm kundrejt një ose më shumë shteteve anëtare, por jo kundër BE-së. Në këtë rast BE-ja mund të ndërhyjë si bashkëndërgjyqës. Së dyti, pretendimi ngrihet vetëm kundër BE-së. Në këtë rast mund të ndërhyjë si bashkëndërgjyqës shteti anëtar. Kjo situatë mund të ndodhë kur një rregull i vendosur nga e drejta primare e BE-së mendohet se cenon të drejtat themelore të parashikuara në KEDNJ. Duke marrë parasysh natyrën e rregullave të së drejtës së BE-së dhe pasojat që ato kanë në rendin e brendshëm të shteteve sipas traktateve themeluese, është e arsyeshme që shteti anëtar të marrë pjesë si bashkëndërgjyqës. Së treti, kërkuesi pretendon për shkelje si nga BE-ja ashtu edhe nga një ose disa shtete anëtare. Në këtë rast shtetet anëtare ose Bashkimi (si palë e paditur) nuk janë të vetmet që kanë marrë pjesë në miratimin e një akti, por ato janë të vetmet që kanë marrë masa për vënien në zbatim të aktit. Edhe në këtë situatë, mund të përdoret ky mekanizëm p.sh. nga shtetet e tjera anëtare.

E drejta për të caktuar bashkëndërqyqësinë mund të merret nga GJEDNJ-ja, nga pala e paditur ose nga bashkëndërgjyqasi i ardhshëm. Palët e larta kontraktuese të Konventës marrin pozitën procedurale të bashkëndërgjyqasit ose duke pranuar ftesën e bërë nga GJEDNJ-ja ose nëpërmjet vendimit të GJEDNJ-së mbi kërkesën e palës. Bashkëndërgjyqësi do të ketë statusin e palës gjatë procesit dhe nuk do të konsiderohet si palë e tretë. Aplikuesi nuk do të penalizohet për gabime në legjitimitetin pasiv. Pranueshmëria e aplikimit do të vlerësohet pa u lidhur me pjesëmarrjen e bashkëndërgjyqasit në proces (neni 3 i draftmarrëveshjes).

Disavantazhet e kësaj procedure kanë të bëjnë me pozitën e kërkuarit. Probabiliteti i pranimit të kërkesës mund të zvogëlohet me rritjen e numrit të subjekteve kundër të cilëve është ngritur padia. Sipas këtij mekanizmi kërkuari duhet të përballet me më shumë palë sesa ai në mënyrë të arsyeshme mendononte në kohën e ngritjes së padisë.

BE-ja mund të jetë në proces edhe në rolin e palës së tretë. Një rast i tillë është kur një shtet joanëtar i BE-së kërkon që BE-ja të thirret si palë e tretë, në përputhje me nenin 36.2 të Konventës. Do të jemi përpara kësaj situatë kur shteti joanëtar i BE-së është palë e paditur pranë GJEDNJ-së. Shkelja e pretenduar e Konventës ka ardhur nga një dispozitë e së drejtës së Bashkimit, si rezultat i një marrëveshjeje ndërkombëtare të lidhur midis këtij shteti dhe BE-së.

Çdo palë e lartë kontraktuese mund t'i referojë Gjykatës çdo shkelje të supozuar të dispozitave të Konventës dhe të protokolleve të saj nga pala e tjetër e lartë kontraktuese. Do të ishte i rekomandueshëm përjashtimi i zbatimit të këtij mekanizmi ndërmjet shteteve anëtare dhe BE-së, për çështje që lidhen me të drejtën e BE-së, të cilat cenojnë të drejtat themelore. Draftmarrëveshja e aderimit nuk shprehet për këtë çështje. Pas aderimit, KEDNJ-ja do të bëhet pjesë përbërëse e së drejtës së Bashkimit Evropian dhe rrjedhimisht juridiksioni i GJED-së do të shtrihet edhe tek KEDNJ-ja. Shtetet anëtare angazhohen të mos përdorin asnjë mjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve lidhur me

interpretimin ose zbatimin e traktateve, përveç mjeteve që parashikohen në traktate. Në opinionin 1/91, Gjykata e Drejtësisë e ka interpretuar nenin 344 të TFBE-së se ai konfirmon juridiksionin ekskluziv të Gjykatës, i cili është pjesë thelbësore e traktateve. Për këtë arsye, GJED-ja ka kompetencë ekskluzive të interpretojë KEDNJ-në në gjykimet ndërmjet shteteve anëtare dhe Bashkimit Evropian. Në rast se kjo e drejtë do t'i njëhej shteteve anëtare dhe BE-së, atëherë do të cenohet autonomia e së drejtës së BE-së dhe juridiksioni ekskluziv i GJED-së. Në këtë situatë duhet të marrim parasysh faktin që problemet midis BE-së dhe shteteve anëtare duhet të ngrihen fillimisht në institucionet kompetente brenda BE-së, gjithashtu shtetet anëtare kanë mundësi të godasin gjyqësisht këto akte.

Një dispozitë e tillë, që përjashton në mënyrë të shprehur juridiksionin e GJEDNJ-së në këto çështje, mund të vendoset në marrëveshjen e aderimit ose me marrëveshje midis shteteve anëtare dhe Bashkimit. KEDNJ-ja parashikon mundësinë e hartimit të marrëveshjeve ndërmjet palëve të larta kontraktuese, për të hequr dorë reciprosht për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që rrjedhin nga interpretimi ose zbatimi i Konventës, në mënyrën që parashikon Konventa në fjalë. Në kuadër të institucioneve të BE-së, është plotësisht e mundur që aplikimi kundër Bashkimit ose një shteti anëtar ngrihet përpara GJEDNJ-së pa u shprehur më parë GJED-ja. Do të ndodhemi përpara kësaj situate në dy raste. Së pari, kur kërkuesi pasi ka ezauruar ankimin e brendshëm të shtetit anëtar, i drejtohet GJEDNJ-së. Sipas KEDNJ-së, ezaurimi i rrugëve të ankimit të brendshëm gjyqësor është kusht për pranimin e kërkesës. GJEDNJ-ja nuk mund ta deklarojë kërkesën të papranueshme sipas nenit 35/1 sepse kërkuesi e ka ezauruar ankimin e brendshëm të një "Pale të lartë kontraktuese" të KEDNJ-së (pra të shtetit anëtar të BE-së). Së dyti, aplikuesi ka kërkuar pranë gjykatave kombëtare t'ia referojnë çështjen për vendim paragjykimor në GJED, por kërkesa e tij është nuk është pranuar. Mund të ndodhë që gjykata kombëtare gabimisht vlerëson se nuk ka detyrim të bëjë referencë në

GJED në lidhje me çështjen konkrete ose ajo gabimisht argumenton se ekziston një nga përjashtimet e parashikuara nga traktatet ose se kërkuesi nuk legjitimohet në bazë të traktateve. Për të zgjidhur këto situata, në draftmarrëveshjen e aderimit, u parashikua mekanizmi procedural i dërgimit të çështjes nga GJEDNJ-ja në GJED, në mënyrë që kjo e fundit të shprehej në lidhje me rastin.

Draftmarrëveshja e aderimit nuk ka arritur të parashikojë zgjidhje për të gjitha problemet e mundshme praktike që evidentohen nga aderimi i BE-së në KEDNJ. Zgjidhja e tyre mund të jetë objekt shqyrtimi në marrëveshjet e ardhshme të aderimit, duke qenë se akoma nuk është hapur procesi i nënshkrimit, ose e praktikës së GJEDNJ-së.

Neni 6/2 i Traktatit të Lisbonës është interpretuar se e vendos Bashkimin nën detyrimim për t'u anëtarësuar në KEDNJ. Megjithatë, asnjë dispozitë në Traktat nuk sugjeron se neni 6/2 kërkon që çdo formë e marrëveshjes së aderimit në KEDNJ do të jetë e pranueshme, pavarësisht përmbajtjes së saj. Marrëveshja e aderimit në KEDNJ duhet të jetë në përputhje me traktatet themeluese të BE-së dhe si rrjedhim është edhe objekt i mundshëm i një opinionioni të GJED-së, (neni 218/11 i TFBE-së). Një nga çështjet më të rëndësishme të një marrëveshjeje ndërkombëtare, ku palë është BE-ja, ka të bëjë me ruajtjen e autonomisë të së drejtës së BE-së. Për këtë arsye, draftmarrëveshja duhet të vlerësohet nën këndvështrimin e standardeve të vendosura nga GJED-ja për parimin e autonomisë të së drejtës së BE-së.

Autonomia e së drejtës së Bashkimit kërkon që “kompetencat thelbësore të institucioneve të ngelin të pandryshuara”. Po ashtu, kur një marrëveshje ndërkombëtare përmban norma të cilat janë referuar në traktatet themeluese, ato nuk mund të interpretohen nga një gjykatë ndërkombëtare në mënyrë detyruese për Bashkimin. Pra, një gjykatë ndërkombëtare nuk mund të interpretojë normat e traktateve themeluese, në një mënyrë që detyron BE-në t'i ushtrojë kompetencat e tij në përputhje me këtë

interpretim. GJED-ja është shprehur se jo vetëm institucionet e BE-së nuk duhet të preken nga marrëveshjet ndërkombëtare, por edhe institucionet e shteteve anëtare, të cilat kanë marrë përsipër detyrime sipas së drejtës së Bashkimit. Autonomia e rendit ligjor të BE-së deporton edhe në rendet ligjore kombëtare dhe pjesërisht i përfshin ato.

Autonomia e rendit ligjor të BE-së është parë e lidhur edhe me hierarkinë e normave brenda tij. E drejta primare dhe parimet kanë prioritet mbi të drejtën dytësore dhe marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura nga BE-ja. Si rrjedhim, çdo marrëveshje që i cakton GJEDNJ-së kompetenca që ushtrohen nga institucionet e BE-së sipas së drejtës së Bashkimit, është e papajtueshme me autonominë e rendit ligjor të BE-së.

Përsa i përket mekanizmit të bashkëndërgjyqësisë, mund të lindin disa probleme në praktikë. Zgjidhja e situatave praktike që mund të vijnë përpara GJEDNJ-së mund të ketë si pasojë cenimin e autonomisë të së drejtës së Bashkimit dhe cenimin e këtij sistemi. P.sh., respektimi i një rregulloreje mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore të gjykatave të shteteve anëtare mbi çështje që konsiderohen të ngutshme. Pikësynimi i rregullores është besimi i ndërsjellë në sistemin e drejtësisë të shteteve anëtare. Në rast se shteteve ku do të zbatohet vendimi do t'u kërkohej të vlerësonin përputhshmërinë e tij me Konventën, atëherë kjo do të cenonte vetë sistemin. Çfarë duhet të vendosë GJEDNJ-ja nëse vendimi që ka zbatuar shteti anëtar, si rezultat i rregullores, ka qenë në shkelje të Konventës (*çështja Šneersone dhe Kampanella kundër Italisë*). Çfarë roli do të kishte sistemi i BE-së në respektimin e të drejtave themelore sipas Konventës?

Një problem tjetër që është ngritur ka të bëjë me ndarjen e përgjegjësisë ndërmjet Bashkimit dhe shtetit anëtar, në rast se GJEDNJ-ja ka konstatuar shkelje të Konventës nga bashkëndërgjyqësit. Qartësimi i rregullave të brendshme ndërmjet BE-së dhe shteteve anëtare në ndarjen e përgjegjësisë ndikon drejtpërdrejt në ekzekutimin e vendimit. Shteti anëtar nuk mund të mbrohet duke pretenduar se veprimi i tij është

ndërmarrë në kuadër të së drejtës së Bashkimit dhe ai nuk ka pasur diskrecion në marrjen e masave. Rekomandohet të parashikohet një procedurë e qartë lidhur me ndarjen e përgjegjësive dhe ekzekutimin e vendimeve në marrëveshjen e aderimit ose në të drejtën e Bashkimit.

Dënimi i Bashkimit ka efekt më negativ sesa dënimi i një shteti palë në Konventë, duke qenë se Bashkimi Evropian është një bashkim shtetesh. Dënimi i Bashkimit do të thotë dënimi i të gjitha shteteve anëtare, e cila nuk do të kishte ndodhur në mungesë të Bashkimit si bashkëndërgjyqës. Në rast se shkelja ka ardhur si nga Bashkimi ashtu edhe nga shteti anëtar, atëherë të dyja palët kontraktuese do të gjobiten për shkeljen. A do të cenohet në këtë rast parimi i mosdënimit dy herë, duke qenë se shteti anëtar i dënuar duhet të kontribuojë edhe për shlyerjen e gjobës nga ana e Bashkimit? Të dyja çështjet e ngritura më sipër ka shumë mundësi të gjejnë zgjidhje nga jurisprudenca e GJEDNJ-së. Draftmarrëveshja e aderimit nuk ka zgjidhur rastet e ndërhyrjes së detyrueshme të bashkëndërgjyqësit. Pala, kundër së cilës nuk është ngritur çështja, do t'i bashkohet procedimit në mënyrë vullnetare apo në mënyrë të detyrueshme. Rekomandohet që kur pretendimi i shkeljes të të drejtave themelore është shkaktuar nga e drejta primare, bashkëndërgjyqasit duhet të jenë pjesë e procesit në mënyrë të detyrueshme. Edhe parashikimi i mekanizmit për vendim të mëparshëm të GJED-së, paraqitet problematik në disa aspekte. Dhënia e së drejtës vetëm një pale të lartë kontraktuese (BE-së) ti referohet çështja nga GJEDNJ-ja për tu shprehur, përbën trajtim të pabarabartë me palët e tjera kontraktuese. Asnjë gjykatë të palëve të tjera kontraktuese nuk i është dhënë mundësia të shmangë mundësinë e shkeljes së Konventës duke mbajtur qëndrim përpara se GJEDNJ-ja të shprehet mbi një rast të referuar nga ajo vetë. Praktika mund të sjellë situata të tilla, të cilat kërkojnë interpretimin e nocionit “ezaurim i ankimit të brendshëm”. Palët në proces nuk mund ta detyrojnë gjykatën kombëtare për të referuar çështjen për vendim paragjykimor në GJED. Po ashtu, gjykata kombëtare ka diskrecion

të plotë në përcaktimin e pyetjeve që do t'i drejtojë GJED-së. Në këtë situatë lindin dy raste problematike. Nëse gjykata kombëtare nuk i shtron përpara GJED-së të gjitha çështjet që kanë rëndësi për të vendosur mbi përputhshmërinë me të drejtat e njeriut. Ose nëse gjykata kombëtare paraqet përpara GJED-së të gjitha çështjet që kanë rëndësi për të vendosur mbi përputhshmërinë me të drejtat e njeriut, por nuk kërkon që GJED-ja të shprehet për respektimin e të drejtave themelore dhe GJED-ja në vendimin e saj nuk shprehet për përputhshmërinë e çështjeve të ngritura me të drejtat e njeriut.

Në të dyja këto raste GJED-ja është shprehur. Në rastin e parë ajo është shprehur për disa nga çështjet mbi respektimin e të drejtave të njeriut, por jo për të gjitha. Ndërsa në rastin e dytë në vendimin e GJED-së nuk shqyrtohet përputhshmëria e çështjeve të ngritura me të drejtat themelore. Në këto siutata, a duhet të bëjë kërkesë GJEDNJ-ja për t'u shprehur më parë GJED-ja në lidhje me rastin, pasi nuk është ezauruar ankimi i brendshëm i BE-së?

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është periudha kohore brenda së cilës duhet të zhvillohet gjykimi, në mënyrë që e drejta të mos parashkruhet sipas traktateve. Traktati parashikon që GJED-ja shqyrton paligjshmërinë e akteve. Ky proces duhet të fillojë brenda dy muajve nga botimi i masës ose nga njoftimi i masës paditësit ose, në mungesë të kësaj, nga dita kur ai ka marrë dizeni për këtë të fundit (neni 263/6 i TFBE). Aktet e institucioneve të Bashkimit nuk mund të jenë objekt i rishikimit gjyqësor nga GJED-ja, nëse ka kaluar afati 2-mujor. GJED-ja është shprehur se ky afat ka të bëjë me sigurinë juridike dhe nuk është objekt i diskrecionit të palëve apo të GJED-së. Problemi që ngrihet në këtë rast është nëse ky afat do të zbatohet edhe në rastin e mekanizmit të kërkesës për vendim të mëparshëm të GJED-së? Në rast se ky afat do të zbatohet, atëherë ky mekanizëm vështirë se do të aplikohet ndonjëherë. Nëse ky afat nuk do të zbatohet, mund të themi se jemi përpara ndryshimit të funksioneve të GJED-së dhe rrjedhimisht do të cenohet autonomia e së drejtës së Bashkimit.

Dërgimi i çështjes përpara GJED-së jo në të gjitha rastet përbën mjet ankimi efektiv. GJEDNJ-ja ka qëndrim të konsoliduar në lidhje me “mjetin e ankimit efektiv”. E drejta e Bashkimit nuk parashikon kompensim në rast të shkeljes së Konventës nga e drejta primare e BE-së. E drejta primare e Bashkimit ka funksion të ngjashëm me kushtetutat e shteteve anëtare. Në rastet kur kërkuesi pretendon përpara GJEDNJ-së për shkelje të Konventës nga dispozitat e së drejtës primare të BE-së, a duhet t’ja referojë GJEDNJ-ja çështjen GJED-së për t’u shprehur ajo më parë me vendim?

Problematika përse i përket autonomisë të së drejtës së Bashkimit ka të bëjnë edhe me fuqinë detyruese të interpretimit që GJEDNJ-ja do t’i bëjë të drejtës së Bashkimit. GJEDNJ-ja në çdo rast duhet të vendosë nëse shkelja ka ndodhur nga dispozita të së drejtës primare, dytësore apo si rezultat i veprimit të organeve administrative apo gjyqësore. Ky vlerësim do të duhet të bëhet duke interpretuar traktatet.

Vendimet e GJEDNJ-së kanë natyrë deklarative dhe janë të detyrueshme sipas së drejtës ndërkombëtare. GJED-ja në vendimin e saj mbi ligjshmërinë e një akti të BE-së do të jetë e detyruar të zbatojë dispozitivin e vendimit të GJEDNJ-së. Megjithëse ky detyrim cenon pavarësinë e së drejtës së BE-së, shtetet anëtare e kanë parashikuar atë në momentin që kanë miratuar nenin 6/2 të Traktatit të Lisbonës. Duke qenë se autonomia e rendit ligjor të BE-së derivon nga traktatet, përjashtimet që bëjnë vetë dispozitat e traktateve nuk mund të konsiderohen cenime të autonomisë. Çështja paraqitet më e komplikuar kur GJEDNJ-ja duhet të vendosë mbi përputhshmërinë me Konventën të një dispozite të së drejtës primare të Bashkimit. Në rast se GJEDNJ-së do t’i njihej kompetenca të shqyrtonte të drejtën primare dhe parimet e së drejtës së Bashkimit, kjo do të cenonte autonominë e Bashkimit. Po ashtu do të lindë një konflikt mbi hierarkinë e normave, pasi sipas rendit ligjor të BE-së dhe jurisprudencës së GJED-së, marrëveshja ndërkombëtare qëndron nën të drejtën primare të Bashkimit. Në rast se GJEDNJ-së nuk do t’i njihej kjo kompetencë, edhe ky rast do të ishte problematik. Bashkimi Evropian

do të ishte e vetmja “Palë e lartë kontraktuese”, dispozitat kushtetuese të të cilit nuk do të shqyrtoheshin nga GJEDNJ-ja. Në këtë mënyrë do të kishim një diskriminim në trajtimin e palëve kontraktuese të Konventës.

Aderimi i BE-së në KEDNJ do të shtojë mundësitë e mbrojtjes të të drejtave të njeriut, pasi do të rritet aksesin në gjykatë. Pasojat më të rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut do të jenë: Së pari, do të ekzistojë vetëm një standard për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Evropë. Së dyti, shtetet anëtare të Bashkimit nuk do të kenë përgjegjësi për shkeljen e të drejtave të njeriut nga Bashkimi, siç ndodhi në çështjen *Matthews kundër Mbretërisë së Bashkuar*. Së treti, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut do të jetë autoriteti përfundimtar në gjykimin e çështjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Institucionet e BE-së do të jenë subjekt i juridiksionit të kontrollit nga GJEDNJ-ja. Së katërti, Bashkimi Evropian do të mbrohet përpara GJEDNJ-së, në çështjet ku Bashkimi është në mënyrë direkte ose indirekte i përfshirë. Gjithashtu, BE-ja do të ketë gjykatësin e vet si të gjitha shtetet anëtare, i cili do të sigurojë njohjen e zbatimin korrekt të së drejtës së Bashkimit Evropian. Në zgjidhjen e problematikave pas aderimit, një rol të rëndësishëm do të luajë dhe jurisprudenca e GJEDNJ-së në interpretimin e çështjeve ku palë do të jetë BE-ja.

Gjithsesi, në gjykimin tim, ky aderim do të zgjasë edhe për disa vite, edhe pse rekomandimi është që aderimi duhet të realizohet sa më shpejt. Konkretisht, në mënyrë paralele studimet e fundit shkencore në këtë fushë tregojnë për një “konstitucionalizim” të të drejtave të njeriut brenda vetë Bashkimit Evropian, gjë që e vështirëson akoma dhe më shumë aderimin.

Gjej rastin të citoj këtu një studiuese të kësaj fushe, Eleni Franztou, e cila saktëson:

“The three lines of case law cited in this paper have illustrated the willingness with which the CJEU has assumed a wider scope for adjudicating in the vast spectrum of human rights claims. Fundamental rights have gradually become part and parcel of

European Union law, initially respected, then protected and nowadays even asserted, qua general principles and through the Charter, against market values. As some commentators have argued, in a time of crisis for the Union's old ideals, strong liberal democratic principles and an express commitment to the protection of human rights now form an integral part of the EU's normative foundations. The care that the Court has taken in the last two years to ensure the uniform and autonomous application of fundamental rights throughout the Union, irrespective of the existence of a traditional EU law setting, signals a "constitutionalisation" of rights which is single-handedly carrying through the polity-building process initiated by the Lisbon Treaty. The Union has come a long way from the debate this paper started with. Time will show whether the edifice will ever be completed."²⁶⁴

Falēminderit

²⁶⁴ Franztou E., 2011-2012 in: accademia.edu/2056049/Developments_in_the_case_law_of_the_CJEU_20102011_Human_Rights_and_the_Scope_of_EU_Law, May, May 2012

LISTA E REFERENCAVE / BIBLIOGRAFIA

Literatura e përdorur.

Akte Ndërkombëtare:

- A strategy for the Effective Implementation of the Charter of Fundamental Rights, COM (2010).
- Annual Report on Human Rights for 2006.
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.
- Direktiva 2003/109 “Për dhënien e lejeve të qëndrimit për shtetasit e vendeve të treta”.
- Direktiva 2004/38 “Mbi të drejtën e qytetarëve të Bashkimit dhe anëtarëve të familjes së tyre për të lëvizur dhe qëndruar lirisht në territorin e Shteteve Anëtare”.
- Direktiva e Këshillit 2000/43, FZBE 1180/22.
- Direktiva e Këshillit 2000/78, FZBE 300/16.
- Direktiva e Këshillit 2003/86, Mbi të drejtën e bashkimit familjar.
- Dokumenti mbi diskutimet e GJED-së në lidhje me disa aspekte të aderimit të BE në KEDNJ, 5 Maj 2010 – http://curia.europa.eu/jcms/upload/docs/application/pdf/2010-05/conventionen_2010-05-21_12-10-16_272.pdf.
- Draft Marrëveshja e Aderimit të BE-së në KEDNJ, CDDH – UE (2011) 04.
- Draft Marrëveshja e Aderimit të BE-së në KEDNJ, CDDH – UE (2011) 06.
- Draft Marrëveshja e Aderimit të BE-së në KEDNJ, CDDH – UE (2011) 10.
- Draft Marrëveshja e Aderimit të BE-së në KEDNJ, CDDH – UE (2013) 008rev2.
- Draft Marrëveshja e Aderimit të BE-së në KEDNJ, CDDH– UE (2010) 14.
- Draft Marrëveshja e Aderimit të BE-së në KEDNJ, CDDH– UE (2011) 009.
- Draft Marrëveshja e Aderimit të BE-së në KEDNJ, CDDH– UE (2011) 05.

- Draft Marrëveshja e Aderimit të BE-së në KEDNJ, Shtojca V, CDDH – UE (2013) 008rev2.
- Draft Marrëveshja e Aderimit të BE-së në KEDNJ, Çështjet teknike dhe ligore mbi mundësinë e aderimit të KE/BE-së në KEDNJ, CCDH (2002) 010.
- Hungary's PM; *EU cannot tell us what to do on Media Law*, 6 Janar 2011, gjendet në: <http://euobserver.com.9/31600>.
- Karta e Bashkimit Evropian, për të Drejtat Themelore.
- Karta e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.
- Karta për të Drejtat Themelore.
- Karta Sociale Evropiane e Këshillit të Evropës, nënshkruar në Torino më 18.10.1961.
- Këshilli i Bashkimit Evropian (1 dhjetor 2009), Këshilli Evropian i Brukselit 29/30 Tetor 2009: Konkluzionet e Presidentit, 15265/1/09 Rev, i vlefshëm në faqen e web-it: <http://www.consilium.europa.eu/uedocs/cmsdata/docs/pressdata/en/ec/110889pdf> (14/3/10).
- Konventa e Hagës.
- Kushtetuta e Qipros.
- Memorandumi i Komisionit mbi adermimin e Komuniteteve Evropiane në KEDNJ, Buletini i Komuniteteve Evropiane, Suplementi 2/79.
- Opinion i GJED 1/00 [2002] PVGJE I-3493.
- Opinion i GJED 1/09, [2011].
- Opinion i GJED 2/94 Mbi anëtarësimin e Komunitetit në KEDNj, [1996] PVGJE I-1759.
- Opinioni i GJED 1/91 [1991] PVGJE I-6079.
- Pakti Ndërkombtar i të Drejtave Civile dhe Politike.
- Pakti Ndërkombtar i të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.

- Protokollu 30, Për zbatimin e Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian në Poloni dhe në Mbretërinë e Bashkuar.
- Protokollu i 14 i KEDNJ.
- Protokollu nr. 8, Në lidhje me nenin 6/2 të Traktatit për Bashkimin Evropian për Aderimin e Bashkimit në KEDNJ [2010] OJ C83/273.
- Qendrimi i Qeverisë Franceze, “Communication de M.Robert Badinter sur le mandate de negociation (E 5248)”, 25 Maj 2010, e vlefshme në faqen e web-it: <http://www.senat.fr/europe/r25052010.html>.
- Raportet e Këshillit Evropian mbi Marrëdhëniet e Jashtme, e vlefshme në faqen e web-it: www.europa.eu/content/programmes/C36/
- Raporti mbi aspektet institucionale të aderimit të Bashkimit Evropian në KEDNJ, A7-0144/2010, datë 6 Maj 2010.
- Raporti përfundimtar i Draft Marrveshjes për Aderimin e Bashkimit Evropian në KEDNJ, sipas negociatave të pesta ndërmjet grupit të punës së Komitetit Drejtues së të Drejtave të Njeriut dhe Komisionit Evropian, datë 3-5 Prill 2013, CDDH – UE (2013) 008rev2.
- Report Commission on the Practical Operation of the Methodology for a Systematic and Rigorous Monitoring of Compliance with the Charter of Fundamental Rights, COM (2009) 205.
- Rezoluta 820 e vitit 1993 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.
- Rregullorja nr.2201/2003, Mbi njohjen dhe zbatimin e vendimeve për çështjet martesore dhe përgjegjësisë prindërore.
- Rregullorja nr.990/93, Mbi Tregëtinë ndërmjet Komunitetit Ekonomik Evropian dhe Republikës Federale të Jugosllavisë.
- Rregullorja nr.990/93, Mbi Tregëtinë ndërmjet Komunitetit Ekonomik Evropian dhe Republikës Federale të Jugosllavisë.

- Shpejegime në lidhje me Kartën e të Drejtave Themelore. Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian (OJEU), nr.C 303, datë 14.12.2007, e vlefshme në faqen e web: http://www.cvce.eu/content/publication/2010/6/9/11b81cf7-22fc-4463-873f1db65a733a8c/publishable_en.pdf.
- Statuti i Gjykatës së Drejtësisë, C 83/210 F.Z. 2010, Neni 23/a Strasbourg: Yearbook of European Convention of Human Rights.
- Memorandumi i Komisionit mbi adermimin e Komuniteteve Evropiane në KEDNJ, Buletini i Komuniteteve Evropiane, Suplementi 2/79.
- The Commission Communication on Compliance with the Charter of Fundamental Rights in Commission legislative proposals: Methodology for Systematic and Rigorous Monitoring COM (2005)172.
- Traktati i Amsterdamit.
- Traktati i Bashkimit Evropian.
- Traktati i Funkcionimit të Bashkimit Evropian.
- Traktati i Lisbonës.
- Traktati i Mastritit.
- Vendim i Këshillit 2002/584 JHA [2002] GZBE L190/1.
- Voggenhuber Report dhe Resolution of the European Parliament, Eur Parl Doc A6-0034/2007(2007).

Libra:

- Arnall A. (2007), “Does Europe Need a Fundamental Right Agency?”.
- Alston P., Heenan J. dhe Bustelo M. (1999) (eds), The EU and Human Rights, Oxford University Press.
- Besselink L. (2013). Should the European Union Ratify the European Convention for Human Rights? Some Remarks On the Relations between the European Court of Human Rights and the European Court of Justice. New Yourk: Cambridge University

Press.

- Borchardt K.D. (2011), ABC-ja e së Drejtës së Bashkimit Evropian, Ministria e Integritimit.
- Bartels L. (2005), “Human Rights Conditionality in the EU’s International Agreements”, Oxford University Press.
- Cambridge University Press, (1999) “The Constitution of Europe”.
- Canaj E, Bana S. (2014). E Drejta e Bashkimit Evropian. Tiranë: Onufri.
- Canaj E. (2014). Lëvizja e lirë e personave në BE. Tiranë: UETPRESS.
- Craufurd-Snmith R. (1997), Broadcasting Law and Fundamental Rights, Oxford Univerisy Press.
- Daci D. (2011). Të drejtat e Njeriut. Tiranë: Julvin 2.
- Desmond D. (2014), “Institucionet e Bashkimit Evropian”, AIIS.
- Feldman D. (2002) Civil Liberties and Human Rights in England and Wales, faqe. 5 l. Oxford: Oxford University Press.
- Golsong H. (1978). Grundrechtsschutz im Rahmen der Europäischen Gemeinschaften, Europäische Grundrechtezeitschrift. Strasbourg: Yearbook of European Convention of Human Rights.
- Harris D., O’Boyle M., Bates E., Buckley C. (2009). Law of thw European Convention on Human Rights. Oxford: Oxford University Press.
- Hartley T.C. (1999), Constitutional problems of European Union, Oxford and Portland, Oregon.
- Jacquè J. P. (2010). E drejta institucionale e Bashkimit Evropian. Tiranë: Papirus.
- Lenearts K. and De Smijter E. (2001) “The Charter and the Role of the European Courts”.
- Jacobs F. (2001), “Human Rights in the European Union: The Role of the Court of Justice”.

- Kaczorowska A. (2011) “European Union Law” Second edition, faqe 244. London and New Yourk: Routledge.
- Komentari mbi Përgjegjësinë e Shteteve për Aktet e Paligjshme (2001), miratuar nga Asamblea e Përgjithshme e OKB-së dhe botuar në Librin Vjetor të Komisionit për të Drejtën Ndërkombëtare, viti 2001, vol. II, pjesa e dytë.
- Köngeter M. (2005), Völkerrechtliche und Innerstaatliche Probleme eines Beitritts der Europäischen Union zur EMRK. Die Europäische Verfassung, Verfassungen In Europa, faqe Baden: Nomos.
- Khaliq U. (2009), “Ethical Dimensions of the Foreign Policy of the EU; A legal Analysis” Cambridge University Press.
- Lemmens P. (2001), “The Relationship between the Charter of Fundamental Rights of the EU and the ECHR: Substantive Aspects”.
- Milo P. (2002) Bashkimi Evropian, fq. 310. Tirane: albPAPER.
- Parmar S. (2001), “International Human Rights Law and the EU Charter”.
- Riedel. E, Will.M. (1999). Human Rights Clauses in External Agreements of the E.C. The E.U and Human Rights. Oxford: Oxford University Press.
- Rosenfeld M., (2000) “Comparing constitutional review by the European Court of Justice and the U.S. Supreme court”.
- Shaw M. (2008). International Law 6th edition, faqe 369. New Yourk: Cambidge University Press.
- Teitgen-Colly C. (2006), “The European Union and Asylum: An Illusion of Protection”.
- Tulkens F. (2000), “Towards a Greater Normative Coherence in Europe: The Implications of the Draft Charter of Fundamental Rights of the European Union”.
- Zajmi I. (2009) E drejta Evropiane. Tiranë: OMBRA GVG.
- Williams A. (2004), The Irony of Human Rights in the European Union (Oxford

University Press.

Revista:

- Besselink L. (2012). The protection of fundamental rights post-Lisbon: The interaction between the Charter of Fundamental Rights of the European Union, the European Convention on Human Rights and national constitutions.
- Baquero Cruz J. (2004), *Revista de Derecho Comunitario Europeo* 935.
- Besselink L.F.M. (2012) General report, In Laffranque J. (Ed.), (2012) Reports of the FIDE Congress Tallinn. - Vol. 1: The protection of fundamental rights post-Lisbon: The interaction between the Charter of Fundamental Rights of the European Union, the European Convention on Human Rights and national constitutions Tallinn: Tartu University Pres.
- “Compliance with Charter of Fundamental Rights in Commission Legislative Proposal: Methodology for Systematic and Rigorous Monitoring”, COM (2005).
- Canaj E. (2010). Analizë e disa problematikave mbi të drejtat e emigrantëve, sipas Kartës së të Drejtave Themelor të Bashkimit Europian. *Jeta Juridike*, Numri 2.
- De Witte B. dhe Toggenburg G. (2005), “Human Rights and Membership of the European Union”.
- Dausès M. (1985), “The Protection of Fundamental Rights in the Community Legal Order”, 10 *ELRev*, 398, 399.
- DeBurca G., “Human Rights: The Charter and Beyond”, të gjitha nga *Punime të Jean Monnet* 10/01, www.jeanmonnetprogram.org/papers.
- DeBurca G. (2001), “The Drafting of the EU Charter of Fundamental Rights” 26*ELRev*.126.
- De Schutter O. dhe Van Goethem V. (2006), “The Fundamental Rights Agency”, *Towards an Active Fundamental Rights Policy of the Union*, 7 *ERA Forum* 587.

- Fjalimi i Holovaty S. (prill 2005), Kryetarit të Asamblesë Parlamentare të Komitetit të Këshillit të Europës mbi çështjet ligjore, në Konferencën e Dytë të Ministrave të Drejtësisë së Europës.
- Fjalimi i Komisionerit Vitorino A. në Parlamentin Evropian në 17 prill 2002. “The Future of fundamental Rights in the EU”.
- Golsong H. (1978) Grundrechtsschutz im Rahmen der Europäischen Gemeinschaften, Europäische Grundrechtezeitschrift.
- Jacque J.P. (2011), The Accession of the European Union to the European Convention of Human Rights and Fundamental Freedoms: Common Market Law Review.
- Lock T. (2011). Walking on tightrope: The draft ECHR accession agreement and the autonomy of the EU legal order. Common Market Law Review, vol 48.
- Lock T. (2009). The ECJ and the ECtHR: The Future Relationship between the Two European Courts. The Law and Practice of International Courts and Tribunals, vol 8.
- Lock T. (2010). EU Accession to the ECHR: Implication for the Judicial Review in Strasbourg. Thomson Reuters (Legal) Limited and Contributors, vol. 35.
- McCrudden C., “The Future of the EU Charter of Fundamental Rights”, Dutheil J. de la Rochere, “Droits de l’homme: La Charte des droits fondamentaux et au delà”.
- Nanclares P. (2013). The accession of European Union to the ECHR: More than just a legal issue. Madrid: Instituto de Derecho Europeo e Integration Regional (IDEIR).
- Osting D. (2003) of Amnesty International, Respect for Fundamental Rights within the EU, gjendet tek: http://EC.europa.eu/justice_home/doccentre/rights/doc/study_epEC_fund_rights_agency_en.pdf
- Official Journal of the European Union (OJEU). 14.12.2007, No C 303. [s.l.]. ISSN 1725-2423. "Explanations" relating to the Charter of Fundamental Rights".

- Peers S. dhe Ward A. (2005) (eds), *The EU Charter of Fundamental Rights*, Hart.
- P.Pescatore (1981), “The Context and Significance of Fundamental Rights in the Law of the European Communities” 2 HRLJ 295.
- Qeveria Franceze, “Communication de M.Robert Badinter sur le mandate de negociation (E5248)”, 25 Maj 2010, e vlefshme në faqen e web-it: <http://www.senat.fr/europe/r25052010.html>.
- Ridrujero P. (2010) *Sobre la adhesion de la Union Europea e la Convencion de Roma: Duadernos Europeos de Deusto*, nr. 43.
- Rosenfeld M., “Comparing constitutional review by the European Court of Justice and the U.S. Supreme court”.
- Stuyck J. (2004), 41 CMLRev.1683 dhe De Cecco F. (2006), “Room to Move? Minimum Harmonization and Fundamental Rights”.
- Triantafyllou D. (2002), “The European Charter of Fundamental Rights and the “Rule of Law”: Restricting Fundamental Rights by reference” 39 CMLRev.53.
- Toner H. (2006), “Impact Assessment and Fundamental Rights Protection in EU Law” 31 EL Rev.316.
- Toggenburg B. (2009), “The role of the New Fundamental Rights Agency, Debating the Sex of Angels or improving Europe’s Human Rights Performance, 33 ELRev 385.
- Schonlau J., “Drafting Europe’s Value Foundation: Deileberation and Arm-twisting in formulating the Preamble to the EU Charter of Fundamental Rights”, në (bot) Eriksen et al.
- Van den Berghe F. (2003) “The EU and the Protection of Minorities; How Real is the Alleged Double Standard?” 22 YBEL 155.
- Schilling T. (1996), “The autonomy of the Community legal order – an analysis of possible foundations”, 37 Harvard International Law Journal, 389.

- Vaughne M. (2000), Human Rights in the EU: the Charter of Fundamental Rights, International Affairs and Defence Section, House of Commons Library, 20/3/2000
www.Amnesty.eu/en/press-releases/all/amnesty-criticizes-eu-double-standard-on-human-rights-european-parliament-public-hearing-0114/
- Von Bogdandy A. dhe Von Bernstorff J. (2009), “The Consideration of Fundamental Rights in Impact Assessment: Final Report”, në: “The EU Fundamental Rights Agency in the European and International Human rights Architecture”, 46 CMLRev 1035.
- Zuleeg M. (1997), The European Constitution under Constitutional constraints: The German scenario, 22 European Law Review.

Vendime të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut:

- Vendim i GjEDNj Abdulaziz, Cabales dhe Balkandi kundër Mbretërisë së Bashkuar, dt.28.05.1985.
- Vendim i GjEDNj B. dhe L. kundër Mbreteri e Bashkuar, dt.13.09.2005.
- Vendim i GjEDNj Bajrami kundër Shqipërisë, dt.12.12.2006.
- Vendim i GjEDNj Beldjoudi kundër Francës, dt.26.03.1992.
- Vendim i GjEDNj Berrehab kundër Hollandës, dt.21.06.1988.
- Vendim i GjEDNj Beygo kundër 46 Shteteve Anëtare të Këshillit të Evropës, dt.16.06.2009.
- Vendim i GjEDNj Bianchi kundër Zvicrës, dt.12.06.2008.
- Vendim i GjEDNj Boso kundër Italisë, dt.05.09.2002.
- Vendim i GjEDNj Bosphous kundër Irlandës, dt.30.06.2005.
- Vendim i GjEDNj Boughanemi kundër Francës , dt.24.04.1996.
- Vendim i GjEDNj Boultif kundër Zvicrës, dt.2.08.2001.
- Vendim i GjEDNj Boyle kundër Mbreterisë së Bashkuar, dt.09.02.1993.
- Vendim i GjEDNj Canntoni kundër Francës, dt.15.11.1996.

- Vendim i GjEDNj Connolly kundër 15 Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, dt. 9/11/2008.
- Vendim i GjEDNj De Eilde Ooms and Versyp kundër Belgjikës, dt 18/11/1970.
- Vendim i GjEDNj Demir dhe Baykara kundër Turqisë, dt.12.11.2008.
- Vendim i GjEDNj DSR-Senator Lines Gmbh kundër 15 Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, dt.10.03.2004.
- Vendim i GjEDNj Emesa Sugar kundër Hollandës, dt.13.01.2005.
- Vendim i GjEDNj Guerin kundër 15 Shteteve Anëtare të BE-së, dt.4.07.2000.
- Vendim i GjEDNj H kundër Finlandës, dt.13.11.2012.
- Vendim i GjEDNj H kundër Norvegjisë, dt.19.05.1992.
- Vendim i GjEDNj Hansen kundër Turqisë, dt.23.09.2003.
- Vendim i GjEDNj Hoffman kundër Gjermanisë, dt.11.01.2002.
- Vendim i GjEDNj Huvig kundër Francës, dt.24.04.1990.
- Vendim i GjEDNj Iglesias Gill dhe AUI kundër Spanjës, dt.29.04.2003.
- Vendim i GjEDNj Ignaccolo-Zenide kundër Rumanisë, dt.25.01.2000.
- Vendim i GjEDNj Informationsverein Lentia dhe të tjerë kundër Austrisë, dt.24.11.1993.
- Vendim i GjEDNj Johnston dhe të tjerët kundër Irlandës, dt.18.12.1986.
- Vendim i GjEDNj K. dhe T. kundër Finlandës, dt.12.07.2001.
- Vendim i GjEDNj Keegan kundër Irlandës , dt.26.05.1994.
- Vendim i GjEDNj Kemmache kundër Francës, dt.02.11.1993.
- Vendim i GjEDNj Lebbink kundër Hollandës, dt. 01.06.2004.
- Vendim i GjEDNj M & Co kundër Gjermanisë, dt.09.02.1990.
- Vendim i GjEDNj Maire kundër Portugalisë, dt.26.06.2003.
- Vendim i GjEDNj Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë, dt.31.07.2012.
- Vendim i GjEDNj Marckx kundër Belgjikës, dt.13.06.1979.

- Vendim i GjEDNj Margareta dhe Roger Andersson kundër Zvicrës, dt.25.02.1992.
- Vendim i GjEDNj Matthews kundër Mbretërisë së Bashkuar, dt.18.2.1999.
- Vendim i GjEDNj Neulinger dhe Shuruk kundër Zvicrës, dt.6.07.2010.
- Vendim i GjEDNj Niemietz kundër Gjermanisë, dt.16.12.1992.
- Vendim i GjEDNj Pini dhe të tjerë kundër Rumanisë, dt.22.06.2004.
- Vendim i GjEDNj Radovanovic kundër Austrisë, dt.22.04.2004.
- Vendim i GjEDNj Rambus Inc. kundër Gjermanisë, dt.16.06.2009.
- Vendim i GjEDNj Sahin kundër Gjermanisë, dt.03.07.2003.
- Vendim i GjEDNj Schalk and Kopf kundër Austrisë, dt.24.06.2010.
- Vendim i GjEDNj Schmidt dhe Dahlstrom kundër Suedisë, dt.shkurt 1976.
- Vendim i GjEDNj Scoppola kundër Italisë, dt.17 Shtator 2009.
- Vendim i GjEDNj Šneerson dhe Kampanella kundër Italisë, dt.12.07.2011.
- Vendim i GjEDNj Sommerfeld kundër Gjermanisë, dt. 03.07.2003.
- Vendim i GjEDNj T.P dhe K.M kundër Mbretërisë së Bashkuar, dt.10.05.2001.
- Vendim i GjEDNj Vermeulen kundër Belgjikës, dt.20.02.1996
- Vendim i GjEDNj X kundër Letonisë, dt.26.11.2013.
- Vendim i GjEDNj X kundër Mbretërisë së Bashkuar, dt.01.07.1977.
- Vendim i GjEDNj X kundër Mbretërisë së Bashkuar, dt.13.05 1980.
- Vendim i GjEDNj X, Y & Z kundër Mbretërisë së Bashkuar, dt.22.04.1997.
- Vendim i GjEDNj Yousef kundër Mbretërisë së Bashkuar, dt.30.06.1992.
- Vendim i GjEDNj Monory kundër Hungarisë dhe Rumanisë, dt.5.04.2005.
- Vendim i Komisionit X kundër Mbretërisë së Bashkuar, dt.22.07.1970.

Vendime të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.

- Vendim i GjED 1/58 Stork & Cie kundër Autoritetit të Lartë të Komunitetit të Qymyrit dhe Çelikut, [1959] PVGJE 17.
- Vendim i GjED 11/70 Internationale Handelsgesellschaft, [1970] PVGJE 1125.

- Vendim i GJED 13/76 Donà, [1976] PVGJE 1333.
- Vendim i GJED 155/79 AM & S, [1982] PVGJE 1575, 1631.
- Vendim i GJED 159/90 Society for the protection of Unborn Children c/ Grognan et autres, [1991] PVGJE I-4685.
- Vendim i GJED 205-215/82 Deutsche Milchkontor GmbH kundër Gjermanisë, [1983] PVGJE 2633.
- Vendim i GJED 227/88 Hoechts, [1989] PVGJE 2919.
- Vendim i GJED 24/69 Nebe, [1970] PVGJE 145.
- Vendim i GJED 227/83 Moussis, [1984] PVGJE 3133.
- Vendim i GJED 265/87 Schröder, [1989] PVGJE 2237.
- Vendim i GJED 29/69 Stauder, [1969] PVGJE 419.
- Vendim i GJED 36/74 Walrave and Koch, [1974] PVGJE 1405.
- Vendim i GJED 374/87 Orkem kundër Komisionit, [1989] PVGJE 3283.
- Vendim i GJED 4/73 Nold, [1974] PVGJE 491.
- Vendim i GJED 44/79 Liselotte Hauer kundër Land Rheinland-Pfalz, [1979] PVGJE 3727.
- Vendim i GJED 5/88 Wachauf kundër Gjermanisë, [1989] PVGJE 2609.
- Vendim i GJED 6/64 Flaminio Costa kundër Enel, [1964] PVGJE 1251.
- Vendim i GJED 85/87 Don Benelux, [1989] PVGJE 3150.
- Vendim i GJED 99/87 Don Cheramica Iberica, [1989] PVGJE 3181.
- Vendim i GJED C 51/96 dhe C 191/97 (çështje të bashkuara) Deliège, [2000] PVGJE I 2549.
- Vendim i GJED C-101/01 (çështje të bashkuara) Lindqvist, [2003] PVGJE I-12971.
- Vendim i GJED C-112/00 Schmidberger, [2003] PVGJE I-05659.

- Vendim i GJED C-117/01 K.B kundër Agjensisë Kombëtare të Shëndetit për Pensionet, [2004] PVGJE I-00541.
- Vendim i GJED C-144/04 Mangold, [2005] PVGJE I-09981.
- Vendim i GJED C-17/98 Emesa Sugar, kundër Aruba, [2000] PVGJE I-665.
- Vendim i GJED C-200/02 Zhu & Chen, [2004] PVGJE I-09925.
- Vendim i GJED C-244/06 Dynamic Medien, [2008] PVGJE I-505.
- Vendim i GJED C-246/95 Coen, [1997] PVGJE I-403.
- Vendim i GJED C-249/96 Grant kundër South-West Trains ltd, [1998] PVGJE I-3361.
- Vendim i GJED C-249/96 Grant, [1998] PVGJE I-621
- Vendim i GJED C-256/11 Derec dhe të tjerë, [2011] PVGJE I-11315.
- Vendim i GJED C-256/11 Dereci dhe të tjerë.
- Vendim i GJED C-260/89 Elliniki radiophonia Tileorassi AE (ERT) kundër Dimotiki Etairia Pliroforissis dhe Sotirios Kouvelas, [1991] PVGJE I-2925.
- Vendim i GJED C-281/98 Angonese, [2000] PVGJE I 4139.
- Vendim i GJED C-282/10 Dominguez, [2012].
- Vendim i GJED C-283/81 CILFIT dhe Lanificio di Gavardo SpA kundër Ministrisë së Shëndetësisë, [1982] PVGJE 3415.
- Vendim i GJED C-291/05 Eind, [2007] PVGJE I-10719.
- Vendim i GJED C-297/88 dhe C-197/89 (çështje të bashkuara) Dzodzi, [1990] PVGJE I-3763.
- Vendim i GJED C-299/95 Kremzow kundër Austrisë, [1997] PVGJE I-2629.
- Vendim i GJED C-303/05 Advocaten voor de wareld VZW kundër Leden van de Ministerraad [2007] PVGJE I-3635.
- Vendim i GJED C-309/96 Annibaldi, [1997] PVGJE I-07493.
- Vendim i GJED C-309/99 Wouters dhe të tjerë, [2002] PVGJE I 1577.

- Vendim i GJED C-34/09 Ruiz Zambrano, [2011] PVGJE I-01177.
- Vendim i GJED C-341/05 Laval un Partneri Ltd kundër Svenska Byggnadsarbetareförbundet, [2007] PVGJE I- 11767.
- Vendim i GJED C-344/04 R. kundër Departamentit të Transportit, [2006] PVGJE I-403.
- Vendim i GJED C-40/11 Yoshikazu Lida kundër Stadt Ulm, [2012] PVGJE.
- Vendim i GJED C-400/10 J. McB. kundër L. E.
- Vendim i GJED C-402/05 Kadi kundër Këshillit dhe Komisionit, [2008] PVGJE I-06351.
- Vendim i GJED C-411/05 Palacios de la Villa, [2007] PVGJE I-08531.
- Vendim i GJED C-411/10 N.S dhe C-493/10 M.E dhe të tjerë (çështje të bashkuara), [2011] PVGJE I-13905.
- Vendim i GJED C-415/05 Kadi kundër Këshillit dhe Komisionit, [2008].
- Vendim i GJED C-438/05 Federata Ndërkombëtare e Transportit të Punëtorëve dhe Bashkimi i Marinarëve Finlandez kundër Viking Line ABP dhe OU Viking Line Esti, [2007] PVGJE I-10779.
- Vendim i GJED C-438/05 Viking, [2007] PVGJE I-10779.
- Vendim i GJED C-459/03 Komisioni kundër Irlandës, [2006] PVGJE I-4635.
- Vendim i GJED C-465/00, C-138/01 dhe C-139/01 (çështje të bashkuara) Österreichischer Rundfunk dhe të tjerë, [2003] PVGJE I-04989.
- Vendim i GJED C-54/81 Firma Fromme kundër Bundesanstalt für landwirtschaftliche Markordnung, [1982] PVGJE 1449.
- Vendim i GJED C-540/03 Parlamenti Evropian kundër Këshillit, [2006] PVGJE I-5769.
- Vendim i GJED C-540/03 Parlamenti kundër Këshillit, [2006] PVGJE I- 5769.
- Vendim i GJED C-540/03 Parlamenti kundër Këshillit, [2006] PVGJE I -5769.

- Vendim i GJED C-555/07 Küçükdeveci, [2010] PVGJE I-00365.
- Vendim i GJED C-60/00 Carpenter, [2002] PVGJE I-6279.
- Vendim i GJED C-73/08 Bressol, [2010] PVGJE I- 02735.
- Vendim i GJED C-87/12 Keeshnik Ymeraga dhe të tjerë, [2013] PVGJE.
- Vendim i GJED T-121 & 151/96 (çështje të bashkuara) Mutual Aid Administration Services, [1997] PVGJE II-1355.
- Vendim i GJED T-191/98 R DSR Senator Lines kundër Komisionit, [1999] PVGJE I-8733.
- Vendim i GJED T-276/97 Guérin automobiles, [1998] PVGJE II-261.

Vendime të Gjykatave Kushtetuese të Vendeve Anëtare të BE-së:

- Vendim i Gjykatës Kushtetuese Gjermane Solange I, dt.29.03.1974.
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese Gjermane Solange II, dt.22.10.1986.
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane Frontini et Pozzani, dt.27.12.1972.
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese Italiane Granital, dt.8.06.1984.